Iljasa Salihu u lind me 10 prill 1984 në Llojan, fshat ky i cili gjendet në mes të Preshevës dhe Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të makinerisë në Kumanovë. Studimet për ekonomi i kreu në Universitetin e Prishtinës. Menjëherë pas diplomimit regjistrohet në studimet postdiplomike në UEJL në Tetovë, drejtimi "Studime të Sigurisë". Përskaj punës së tij të rregullt në Ministrinë e Mbrojtjes si administrator financiar në Shkup, njëkohësisht merret edhe me publicistikë. Ka qenë redaktor i revistës mujore, "Zëri i Shqiptarit", me seli në Prishtinë. Është kontribuues i rregull me shkrime edhe në gazetat shqiptare në Maqedoni, në revistën "Paqja" – Prishtinë, si dhe në disa portale elektronike. Aktualisht jeton në vendlindje.

Në kohën e pakohë, në kohën kur të paaryeshmit gjykojnë kinse me arsye, në kohën kur kriminelit po i thuhet i drejtë - qeveritar e të drejtit kriminel, siç ishte dhe është rasti me sepotasit e pafajshëm, me palestinezët që në tokat e tyre u shndërruan në argat të shtypur, me atdhetarët shqiptarë të cilët u internuan nëpër burgjet e Jugosllavisë (Serbisë) dhe të Maqedonisë (FYROM-it) dhe me ish-ushtarët e UÇK-së të arrestuar pafajësisht në Kosovën Lindore, si dhe në kohën kur shumica e njerëzve të zezës po i thonë të bardhë dhe anasjelltas, trumbetimi dhe predikimi për të vërtetën është dhe mbetet një sfidë e radhës, që shpeshherë di të lëz edhe me dinjitetin e njeriut dhe me fatet e kombeve.

Tanimë Kosova është bërë shtet (edhe pse jo i plotë), Shqipëria në NATO, si dhe sensibilizimi i kauzës kombëtare shqiptare ka filluar edhe zyrtarisht të bisedohet, po ashtu prej njerëzve eminentë dhe zyrtarë. Të kuptohemi, ende jemi në gjymtë të rrugës së mundimshme, ende presim dhe duhet të punojmë që fytëti t'i njelim në tërësi, por nuk duhet ta harrojmë faktin se, historia e njerëzve hipokritë dhe spiunë po na përsëritet...

ILJASA SALIHU RRUGËTIMI NËPËR MJEGULLA



© AlbaniaPress.com

Me respekt dhe përkushtim, gruas sime, Mikjales dhe djalit tim, Fatjonit

Iljasa SALIHU

RRUGËTIMI NËPËR MJEGULLA

Ese, artikuj dhe studime, përballë sfidave dhe problemeve të shumta

Shkup, 2010

Recensent:
Qerim PLLANA
(Lidhja e shkrimtarëve të Kosovës-Prishtinë)
Mr. Ardian Ramadani
(Universiteti i Evropës Juglindore në Tetovë)

Lektor:
Pranvera Nuhiu-Xheladini

Ballina dhe faqosja:
Milaim MUSTAFA

Botues:
Autori

Shtypi:
Print *ISM* - Shkup

© Të drejtat e rezervuara të autorit

CIP – Каталогизација во публикација
Народна и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

821.18(497,7) -4

SALIHU, Iljasa
Rrugëtimi nëpër mjegulla: ese, artikuj dhe studime, përballë sfidave dhe problemeve të shumta / Iljasa Salihu. – Shkup : Salihu I., 2010. – 306 стр.; 21cm

Фусноти кон текстот. – Библиографија: стр. 304

ISBN 978-608-65164-0-6

COBISS.MK-ID 83282954

PARATHËNIE
(Dy fjalë për librin)

Libri **"Rrugëtimi nëpër mjegulla",** paraqet një ndihmesë dhe plotësim të madh nga fusha të ndryshme, të shkruara me një stil të bukur dhe të mprehtë, me një penë të gdhendur dhe të pajisur me vlera shkencore. Përmes këtij libri dhe tematikave të ndryshme përbrenda saj, autori na bën të ditur shumë gjëra, bën ndriçimin e shumë dukurive dhe fenomeneve të ndryshme që e shqetësojnë shkencën, shoqërinë dhe njeriun, si pjesë përbërëse të shoqërisë. Autori, analizon dhe zbulon gjëra që në dukje janë të lehta për t'u kuptuar, por nëse futemi në detaje do të gjendemi përballë shumë dilemave për t'i zbërthyer, por do ta kemi të lehtë për t'i kuptuar për shkak të thjeshtësisë, e thjeshtësia është perfeksion. Këto dilema autori i heq pa mëdyshje, duke qartësuar dhe elaboruar shumë gjëra që shfaqen si gjëegjëza e që kërkojnë trajtim adekuat dhe cilësor. Është rast i veçantë dhe njëherazi mjaft i gëzueshëm, kur një studiues mjaft i ri, rritet së bashku me rritjen e demokracisë dhe proceseve demokratike në këtë pjesë të globit, merr pjesë aktive në procese të ndryshme shoqërore-politike dhe kulturore-edukative, si dhe me një portret të mprehtë, me një qëndrim serioz, me një disiplinë, dëshirë, kurajo dhe angazhim të pazakontë, i përqaset gjërave që duhet qasur me shumë vëmendje dhe mprehtësi.

Tekstet e paraqitura në këtë libër, shumica janë më parë të botuara nëpër revista të ndryshme dhe gazeta, e që tani janë të përmbledhura si një tërësi homogjene dhe të lidhura në varg të njëpasnjëshëm, saqë të japin përshtypjen se i ndihmojnë njëra-tjetrës dhe që çdo heqje eventuale e ndonjë teksti mund të prishë kohezionin logjik të librit. Autori përmes shkrimeve mëton të

thotë “ Atë që e bëra për shkencën i takon tërë botës”, thënie kjo mjaft domethënëse.

Autori i librit përmes teksteve na bën me dije që shkenca pa ndërgjegje është shkatërrim i shpirtit. Andaj edhe është mjaft i ndërgjegjshëm për tekstet në fjalë. Të merresh me shkencë është kënaqësi dhe guxim, por njëkohësisht është edhe sfidë dhe përgjegjësi e madhe. Rruga e suksesit nuk është e lehtë, andaj edhe rruga e trasuar për autorin nuk është aspak e lehtë. Ajo bart në vete shumë sfida, provokime të kohës, por njëkohësisht edhe sfidën e përgjegjësisë dhe të autenticitetit të shkrimeve. E dëshmoj së këto artikuj janë autentikë dhe burimorë të gdhendur bukur nga një studiues i mirëfilltë shqiptar i cili i takon plejadës së mirëfilltë shkencore të gjeneratës së re. Andaj mund të shtojmë se inteligjenca nuk është diçka që mund të krijohet aty për aty. Ajo rritet dalëngadalë sikurse foshnja, kultivohet dhe gradualisht ngjizet, për t’u bërë e pavdekshme. I mjerë është ai popull i cili injoron inteligjencën e vet, por vaj halli për inteligjencën që nuk është në shërbim të popullit dhe kombit. Autori i këtij libri bën pjesë në kategorinë e njerëzve të shkencës që e shohin veten si pjesë të inteligjencës aktive dhe jo pasive.

Interesant në këtë libër është edhe stili i të shkruarit. Gjuha e përdorur në këtë libër është mjaft e pasur, kohezive dhe e kapshme për lexuesin, sepse autori shkruan me një stil të drejtpërdrejtë, të qartë, pa ambiguitete.

Megjithë kritikat eventuale që do të ishin të mirëseardhura, ky libër i ka vlerat e veta teorike dhe, si i tillë paraqet një kontribut të çmueshëm për ndriçimin e shumë dukurive dhe fenomeneve, sidomos të përditshmërisë sonë.

Qëndrimet e veta autori i shpreh me një origjinalitet që është karakteristike për njerëzit e dijes dhe shkencës. Shpresojmë se ky libër në masë të madhe do të bind edhe lexuesin për konstatimet tona. Le të shërbejë si një udhërrëfyes dhe model, edhe për të tjerët që duan të merren me shkencë.

Nuk më mbetet asgjë tjetër, përpos që ta përgëzoj Iljasaun për këtë përkushtim, dhe t'i uroj sukses në punën e tij të mëtejme si studiues, dhe si intelektual mbi të gjitha.

Qerim Pllana, shkrimtar

Prishtinë, 19.03.2010

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE 5
HYRJE 13

Kapitulli 1
ÇËSHTJE EKONOMIKE 15
Përse, ekonomia në shërbim të politikës? 17
Fuqia e parasë 21
Korrupsioni - faktor destabilizues ekonomiko-social dhe i sigurisë 24
Liberalizimi i tregtisë, e pengon apo e ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës? 32
Prapambeturia ndër shqiptarët 35
Kriza financiare gjunjëzon ekonominë globale 39
Krimi ekonomik dhe indiferenca e shoqërisë ndaj këtij krimi 42
Administrata publike dhe korrupsioni 46
Faktorët ekonomiko-politik dhe cenimi i sigurisë në Ballkan 50
Republika e Maqedonisë, prej krizës në kriza 55
Mjetet e luftës ekonomike 58
Neomerkantilizmi dhe investimofobia në Maqedoni 61
Ndikimi i faktorëve ekonomik dhe politik në destabilizimin e Ballkanit 65
Maqedonia ndërmjet krizës financiare dhe krizës së identitetit 77
Kur, edhe korrupsioni korruptohet!!! 81
Disa veçori të kryerësve të krimit ekonomik 84
Menaxhmenti në rrafshin kulturor dhe religjioz 87
Kontradiktat ekonomike 92
Pisllëku i lartë, mundësi e mirë për larje të parave 96
Krizë sociale, edhe për të punësuarit 100
Zgjohu qytetar, e mos e shiko korrupsionin si qyqar!!! 103
"Falë" kërkesës për azil ekonomik, doli në shesh një pjesë e krimit ekonomik ... 106
Sikur kryetari, kryeministri, ministrat dhe deputetët t`a kenë
rrogën nga 320 euro!!! 110
Meqë dolëm prej recesionit, pse nuk e ndërtojmë një teleferik për në Hënë?! ... 113

Kapitulli 2

SFIDA SHOQËRORE 116
Fati i një studenti 118
Shkolla, "institucion edukativo-arsimor"?! 122
Ndikimi i shkollës dhe i mësuesit në psikologjinë e nxënësve 125
Njeriu, përballë rreziqeve madhore 130
"Shëmbëlltyra"?! 133
Sikur të dua... 137
Promotori i ndryshimeve 140
Sporti dhe intelektuali 144
Pranë shtetit pa pushtet 147
Një metaforë reale dhe rrëqethëse për Ushtritë Çlirimtare 150
Roli dhe këndvështrimi i Televizionit Privat A1, ndaj tezave të liderëve shqiptar për ndryshimin e kushtetutës në Republikën e Maqedonisë 155
Kujdes! Dëshmorët dëgjojnë dhe flasin 161
Pse i gjithë ky sulm ndaj nacionalizmit? 165
Klithmat që (nuk) i dëgjoj shumë(as)kush 169
Nuse për shkijet e Shumadisë 174
Familja e shëndoshë – garanci e së ardhmes 177
Mishmashet e dhembshme me UÇK-në 182
Mjaft u flijuam për të tjerët 185
Përse, oj nëna ime Shqipëri, ke kaq shumë frikë, prej Islamit në Shqipërinë Lindore!? 188
Durimi dhe Gënjeshtari 192

Kapitulli 3

PËRBALLË PROBLEMEVE AKTUALE 201
Stimulim, apo nënçmim i natalitetit 203
Zgjedhjet dhe zgjidhja 206
"Ç'të mbjellësh do të korrësh" 210
Sfidat e sigurisë në Republikën e Maqedonisë 214
Festa e 28 nëntorit, ndërmjet gëzimit dhe pikëllimit 218
Tragjedia për shqiptarin dhe ndaj shqiptarëve, nuk ka të ndalur 221
Kambanat për Kosovën Lindore 225
Aneksimi i gjymtyrëve dhe vuajtja e tërë trupit 229

Sërish vjen marsi 232
Vë bast për ardhmërinë 239
Urime Shqipëri, ngushëllime Maqedoni 242
Maqedonia ndërmjet të kaluarës dhe të "shkuarës" 245
Në ç'farë Maqedonie do jetojmë? Apo 249
Kombëtar, i drejtë dhe në post shtetëror, aktualisht e pamundur 253
Edhe për sa marrëveshje kemi nevojë? 256
Maqedonia ndërmjet Evropës dhe Ev(g)ropës 260
Mirupafshim mërgimtarë 263
"Dituria është forcë, dituria është fuqi" 266
Enciklopedia, si rrjedhojë e rrjedhave të deritanishme 269
Filloi të shkruhet enciklopedia e vërtetë 273
Dashuria dhe urrejtja e parë nuk harrohen dot 276
Ngjasimi i fushatave parazgjedhore 279
Nostalgjia për "vlerat" maqedonase 282
Bujanoci - vendi më i (pa)sigurt në Serbi 286
Viti 20(01)10, ndërmjet kërcënimeve dhe hipokrizisë 289
Kryearkitekti i arkitektëve rrënues 293
Sikur deputetët shqiptarë të kërkojnë azil politik 297
Për hir të së kaluarës maqedonase, po ikë e tanishmja shqiptare 300
Rrugëtimi nëpër mjegulla 303
Shënime për autorin 307
Literatura e shfrytëzuar 308

HYRJE

“E gjatë dhe e mundimshme është rruga që shpie nga errësira në dritë” (*Xh. Milton)*

Në të shumtën e rasteve, problemet të cilat na paraqiten prej faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm, për nga natyra njerëzore nuk jemi edhe aq të prirë t'i besojmë, sepse thjeshtë, nuk i konvenon askujt problemi, i cili mizorisht do e çrregullojë harmoninë dhe ekuilibrin e jetës. Deshëm, apo nuk deshëm ne, problemet janë realiteti ynë, ashtu siç është e vërtetë edhe dëshira për të qenë larg problemeve. Nuk është tragjedi edhe aq paraqitja e problemeve dhe risia e tyre, por tragjedi dhe tmerr i vërtet është mungesa e guximit për t'u ballafaquar me problemet përkatëse. Sepse, në heshtje asnjëherë problemet nuk shuhen. Shqipëria, pastaj Kosova, pavarësinë e tyre nuk e fituan me heshtje, por me punë konkrete, pra duke u përballur seriozisht me problemet.

Si shumë njerëz të tjerë, edhe unë si pjesë e këtij epilogu të tmerrshëm ndaj shqiptarëve, vendosa të përballem me problemet shumëdimensionale të shoqërisë shqiptare. Përballja ime (besoj se edhe e juaja, lexues i nderuar) me këto probleme reale, ka filluar prej atëherë kur nëna më lindi, apo thënë më qartë, për shkaqe mosbesuese ndaj institucioneve mjekësore, kemi qenë të detyruar të dalim në këtë jetë, në një vend jopërkatës dhe i destinuar për lindje. Besojë që nuk i keni harruar vitet e tmerrshme, kur pakujdesia dhe shfrenimi në eksperimente qëllimkëqija, ishte bërë normale kundrejt nënave dhe fëmijëve të porsalindur shqiptarë.

Përmes këtyre eseve dhe studimeve, të cilët në vete ngërthejnë probleme dhe padrejtësi aktuale, do e fillojmë rrugëtimin tonë së bashku, do të paraqesim sinteza për paqartësi të shumta, do e themi të vërtetën e hidhur edhe pse për dikë do jetë helm, por

para se gjithash shërues dhe mëshirues për të devotshmit. Një pjesë e këtyre shkrimeve janë të botuar nëpër gazeta, revista dhe portale të ndryshme, duke i shprehë kështu një falënderim të gjithë mediave të cilët më bënë të mundur t'i artikulojë mendimet e mia subjektive në studime objektive.

Në këtë përmbledhje shkrimesh, kemi paraqitur studime të ndryshme, të cilat ndërlidhen me problemet shoqërore aktuale. Jam munduar të jem vigjilent mbi rrjedhat dhe vëzhgimin e shumicës së problemeve, të cilat kanë qenë të trashëguara, apo probleme të sapo-shfaqura në Maqedoni dhe rajon. Do të ishte anormale dhe alogjike të themi se i kemi paraqitur dhe studiuar të gjitha problemet në këtë përmbledhje studimesh. Sepse, problemet që paraqiten në këto treva, janë shumë më të madha se madhësia territoriale e këtyre trevave. Meqenëse problemet kanë qenë të natyrave të ndryshme, edhe qasja ndaj tyre, është bërë prej këndvështrimeve të ndryshme. Kështu që, qasjen tonë kryesisht e kemi orientuar dhe shikuar nga prizmi shoqëror (problemet shoqërore aktuale) dhe ekonomiko-politikë, duke e ndarë kështu librin në tri pjesë: ***Çështje ekonomike; Sfida shoqërore; Përballë problemeve aktuale.***

Se çka në të vërtet kemi dashur të themi në këto ese dhe studime, do të mund ta shihni brenda kopertinave të këtij punimi. Ndoshta pas një kohe të gjatë, këto studime dhe ese, më nuk do të korrespondojnë edhe me aktualitetin, sepse çdo ditë e re është cenim i aktualitetit të djeshëm dhe të sotshëm, por, kur kihet parasysh fakti se këto shtjellime dhe trajtime i kemi bërë përballë problemeve të freskëta dhe reale, fillon të na shfaqet një dritë afatgjate në tunelin e errët, ku vet simboli na tregon se, të kuptuarit e këtyre shtjellimeve dhe trajtimeve të problemeve në fjalë, me kalimin e kohës vetëm se do të rifreskohen e assesi të vjetërsohen!

(Autori)

Kapitulli

1

ÇËSHTJE EKONOMIKE

●○●○●○● ● ● ○●○●○●

■ Përse, ekonomia në shërbim të politikës?
■ Fuqia e parasë
■ Korrupsioni - faktor destabilizues ekonomiko-social dhe i sigurisë
■ Liberalizimi i tregtisë, e pengon apo e ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës
■ Kriza financiare gjunjëzon ekonominë globale
■ Prapambeturia ndër shqiptarët
■ Krimi ekonomik dhe indiferenca e shoqërisë ndaj këtij krimi
■ Administrata publike dhe korrupsioni
■ Faktorët ekonomiko-politik dhe cenimi i sigurisë në Ballkan
■ Republika e Maqedonisë, prej krizës në kriza
■ Mjetet e luftës ekonomike
■ Neomerkantilizmi dhe investimofobia në Maqedoni

■ Ndikimi i faktorëve ekonomik dhe politik në destabilizimin e Ballkanit
■ Maqedonia ndërmjet krizës financiare dhe krizës së identitetit
■ Kur, edhe korrupsioni korruptohet
■ Disa veçori të kryerësve të krimit ekonomik
■ Menaxhmenti në rrafshin kulturor dhe religjioz
■ Kontradiktat ekonomike
■ Pisllëku i lart, mundësi e mirë për larje të parave
■ Krizë sociale, edhe për të punësuarit
■ Zgjohu qytetarë, e mos e shiko korrupsionin si qyqar
■ "Falë" kërkesës për azil ekonomik, doli në shesh një pjesë e krimit ekonomik
■ Sikur kryetari, kryeministri, ministrat dhe deputetët ta kenë rrogën nga 320 euro
■ Meqë dolëm prej recesionit, pse nuk e ndërtojmë një teleferik për në hënë?!

Përse, ekonomia në shërbim të politikës?

Në të shumtën e rasteve, postet dhe pozitat i kanë ndërruar vendet, duke e zëvendësuar vendin e tyre natyral me një vend që natyrshëm nuk i takon. Më pastaj i tërë mekanizmi shtetëror është gjendur përballë kontradiktave dhe komplikimeve të shumta dhe, të pazgjidhshme. Ky ngatërrim i profesioneve i ngjanë mjekut i cili punon si automekanik dhe, automekanikut i cili i operon dhe mjekon njerëzit. Pra, rezultatet paraprakisht i kemi të njohura nga ushtrimi i veprimtarive të tilla.

Si në të kaluarën ashtu edhe tash, politika dhe ekonomia kanë qenë dy fenomene të pandara, por gjithmonë duke qëndruar njëra mbi tjetrën, duke mos u gjendur pothuajse asnjëherë në paralelizëm. Njerëzimi në të kaluarën e largët, apo qysh në fillet e para të civilizimit është përballur me këto dy dukuri. Por, ajo çka neve na intereson dhe na ngjallë kureshtje është se, me cilën dukuri ka pasur sukses më shumë, me politikën, apo me ekonomi-në, si dhe këto dy dukuri madhore a kanë qenë ndonjëherë me të vërtet në vendin dhe natyrshmërinë e tyre? Nëse bazohemi në kuptimin dhe domethënien e nocioneve do të shohim se kanë dy kuptime mjaft të ndërlidhura dhe të përafërta njëra me tjetrën, si për shembull "poli- shumë, dhe etik-moral" ndërsa "ekonomi-rend shtëpiak, kursim, investim". Nga kjo shihet dhe mund të aludojmë se, për të qenë mbajtës i rendit shtëpiak duhet të jemi të moral-shëm dhe, për të qenë një kursimtar i mirë duhet të jemi edhe më të moralshëm, por për të qenë shumë i moralshëm do të duhet të kemi rend të mirëfilltë shtëpiak, sepse prej aty fillon gjithçka. Po shihet qartë se këto dy nocione nuk mund të qëndrojnë ndaras, por

kush e kënd duhet sunduar? Apo njëri me tjetrin duhet bashkëpunuar, pa qenë sundues dhe i sunduar as njëri, e as tjetri!

Me siguri se shumë kush mendon se ata të cilët merren me politikë janë shumë të moralshëm ndërsa, ata të cilët merren me ekonomi janë drejtues shtëpiak dhe kursimtarë të zellshëm, sepse nocionet na thonë kështu. Pikërisht këtu qëndron problemi, domethënia e nocioneve dhe praktika me nocionet. Sidoqoftë, në kohën bashkëkohore këta dy nocione përdoren si metaforë, si shumica që është bërë metaforë këtu në vendin tonë, ndryshe mendojmë, ndryshe flasim, ndryshe punojmë dhe ndryshe ndryshojmë, po ashtu edhe ndryshe i kemi punët prej vendeve të zhvilluara.

Në vendin tonë, pra në "oazën e paqes" shumëçka është politizuar për të mos thënë gjithçka, por nuk është ekonomizuar asgjë për të mos thënë diçka, sepse ekonomia është bërë shërbëtore e nënçmuar e politikës, e cila me veprimet e veta të pamëshirshme në masë të madhe po e dëmton dukurinë kryesore dhe vendimtare të një shtetit. Dihet mirëfilli ekonomistë dhe studiues, se shtylla kryesore e shtetit është ekonomia, kurse shtylla kryesore e ekonomisë është prodhimi, këtu pra, nuk po ceket se shtylla kryesore e shtetit, është politika, e pse pra të sundoj politika ekonominë? Tash ndokush mund të thotë po shteti është bërë prej politikave (gjë që edhe unë pjesërisht pajtohem, por prej politikave të shëndosha). Nëse është ashtu, pse atëherë shqiptarët kanë mbetur kaq shumë të copëtuar, të nëpërkëmbur, të viktimizuar, të torturuar, pa status të zgjidhur, "fabrikë konfliktesh", e të ngjashme? Ndërsa në anët tjetër ShBA-ja, Gjermania, Franca e shumë shtete të tjera, të cilët e kanë zotëruar dhe aktualisht po e zotërojnë botën me anë të ekonomisë, dukshëm dallojnë prej neve. **Siç dihet, Gjermania në dy luftërat e mëdha botërore doli humbëse, sepse shteti i Gjermanisë udhëhiqej nga një doktrinë politike që në vete ngërthente urrejtje dhe, nga një politikan nazist i përbetuar. Por, falë dhënies rëndësi pas luftërave ekonomisë dhe zhvillimit të industrisë, sot aktualisht shteti i Gjermanisë gjendet mes superfuqive botërore ekonomike.**

Shtetet me ekonomi në rritje dhe stabilitet pozitiv ekonomik, janë gjeneratorë stabilizues të politikës në shtet. Edhe ne si shqiptarë kemi pasur dhe kemi politikan të zgjuar, prijës të shkathtë që i kanë zotëruar nga katërmbëdhjetë gjuhë të huaj. Kemi pasur mbretër, historianë, prijës fetarë, diplomatë, luftëtar, por asnjëherë nuk kemi pasur dhe mësuar nëpër shkolla për veprimtarinë dhe biografinë e ndonjë ekonomisti shqiptarë, përpos të huajave - F.W. Taylor, H. Fayol, Adam Smith, Rikardo, e shumë të tjerë.

Kësisoj, në botën e fantazmës kemi fluturuar duke u krenuar me legjendat tona. Me të lindur ndonjë fëmijë, ne shqiptarët menjëherë do të fillonim të bënim politikë me të duke i thënë se, Shqipëria është vend i pasur me resurse të shumta me lisa dhe male të gjata, krenohemi me dhuntitë që na i ka dhënë Zoti, duke harruar të turpërohemi për mos-shfrytëzimin e këtyre dhuntive. Prindërit në Japoni i thonë djalit apo vajzës së tyre të porsalindur, vendi ynë është i varfër, ndaj ne duhet të punojmë shumë (edhe përkundër se dihet se çfarë ekonomie ka Japonia). Shumica e qytetarëve në perëndim nuk e dinë se kush është kryetari i shtetit të tyre, sepse atje politika i shërben ekonomisë, e jo ekonomia politikës. Tek ne nëse e pyet një të mitur, lëre se e dinë kush është kryetarë, por edhe përkatësinë partiake të deputetëve. I gjithë ky diskurs i komplikuar dhe i bërë lëmsh, është si rrjedhojë e partizimit dhe politizimit të çdo gjëje, ku partitë politike udhëheqin me ekonominë, duke mos ditur apo dashur të menaxhojnë siç duhet. Sepse, në strukturat partiake politike kemi historian, mjekë, biologë, sportist, artistë, dirigjentë dhe këta qeverisin me ekonominë. Në kohën e komunizmit në Shqipëri ka pasur disa fabrika që kanë prodhuar nga pak. Por, me ardhjen e demokratëve në pushtet janë mbyllur të gjitha! Janë mbyllur, sepse aty ka vendosur politika pa u konsultuar fare me ekonominë. Nëse dëshirojmë shtet progresiv, duhet flakur ideologjitë e mbrapshta. Kësisoj, përparimi dhe zhvillimi nuk pyesin se kush dhe kur i kanë ndërtuar ato fabrika, por ato njohin vetëm investim, punësim dhe zgjerim të plasmanit.

Siç e ceka, edhe në fillim se, politika dhe ekonomia janë të ndërlidhura ngushtë ndërmjet veti, njëra pa tjetrën nuk bën dhe nuk mundë të ekzistoj. Përherë, çdonjëra duhet të qëndroj në vendin e vetë dhe ta luaj rolin e vet. Është në natyrshmërinë e politikës që t'i shërbej ekonomisë. Sepse, ekonomia përmes mekanizmave politikë mund të arrij në një zhvillim të arsyeshëm. Gjithashtu, ekonomia si shenjë respekti e mirënjohje duhet t'ia kthejë shërbimin politikës me një stabilitet politik shtetërorë të qëndrueshëm. Fatkeqësisht, te ne kjo nuk po ndodhë dhe pasojat nga dita në ditë vetëm sa shtohen, sepse timonin e sundimit (qeverisjen) e ka marrë në dorë njeriu që ndoshta nuk meriton, as të qeveriset.

Fuqia e parasë

Në të kaluarën e largët, në mungesë të parave transaksionet janë kryer në këmbim të një malli me një mall tjetër, përafërsisht në vlera të barabarta. Si rrjedhojë e zhvillimit të tregtisë dhe prodhimit, nevoja për të ndërmjetësuar me diçka u rrit edhe më shumë, gjë që me kalimin e kohës lindi ideja për përdorimin e parasë metalike dhe të arit si mjet pagese.

Gjatë etapave të zhvillimit paraja primitive u shndërrua në para të sofistikuar, e pranueshme për ndërmjetësin e pagesave, e konvertueshme në valuta të tjera, e mbrojtur nga falsifikimet, si dhe në kohët e tashme në para elektronike. Fuqia e parasë në jetën e përditshme është fuqi e pakrahasuar, është indikatori pothuajse kryesorë për lëvizjet progresive dhe regresive në jetë. Edhe pse, shikuar paranë ajo është vetëm një letër apo copëz metalike, fuqia e saj është aq e madhe, sa që kush e posedon atë, e ka në dorë timonin e shteteve të botës.

Miliona njerëz në botë janë të preokupuar se si fitohen paratë dhe, miliona të tjerë janë të paralizuar me frikën nga varfëria. Se ç'mund t'i bëjë kjo frikë njeriut, më së miri e përshkroi Vestbruk Pegller: **"Paratë nuk janë gjë tjetër pos disqe të metalta ose copëza letre, ndërsa ekzistojnë pasuri të zemrës e të shpirtit të cilat paraja nuk mund t'i blejë"**[1]. Shumica e njerëzve kur të mbeten pa asnjë para në xhep, nuk janë në gjendje që ta kuptojnë se paraja nuk është gjithçka dhe t'u kujtohet që t'i këndellin shpirtrat, me diçka tjetër. Misteri i fuqisë së parasë qëndron në atë se, të gjitha të mirat materiale në botë duken si

[1] Napoleon Hill, "Mendo dhe pasurohu", Prishtinë, 2004 fq. 246

para, në mungesë të tyre jemi më të humburit në rruzullin tokësor dhe kështu harrohet pasurimi i shpirtit! Megjithatë duhet ditur se paraja nuk është gjithçka, por nuk mund ta mohojmë se është shumëçka.

Paraja si e tillë fitohet dhe humbet në mënyra dhe rrugë të ndryshme, varësisht prej udhëheqjes së njeriut me paratë. Për disa shtete apo individë me rëndësi është arritja deri tek paraja, pa marrë parasysh rrugën apo mjetin e arritjes deri tek ajo. Faktori para ka qenë si shkak i shumë nxitjeve të luftërave, degradime të shoqërisë, shkatërrues i shumë ekonomive, por gjithashtu po i njëjti faktor ka qenë dhe është si shkak i shumë zbulimeve, përparimeve, stimulimeve për punë, vlerësim i sendeve materiale, si dhe ecjen përpara drejt të panjohurës.

Fatkeqësisht, kemi asi lloj njerëzish që kanë shkuar aq larg sa që thonë: Nëse të pyet ndokush se çka është jeta, thuaj nënë e baba është kuleta!

Pra, parasë vazhdon t'i jepet një epërsi aq e madhe, duke e krahasuar atë me krijesat më të ëmbla, pra me prindërit! Paraja në vete përmban; vlerën e kursimit, vlerën matëse, kursin e këmbimit dhe vlerën a parasë.

Vlera e kursimit; paraja mundëson përbrenda një qarku ekonomik, që të ardhurat e marra nga ai qarkullim të kursehen për këmbim në një kohë të ardhshme. Kështu shoqëritë si bankat, kursimet i japin në forma të kredive për qëllime *konsumative* (për shpenzues) dhe *investive* (për përdorime produktive).

Vlera matëse; me ndihmën e parasë bëhet i mundshëm vlerësimi i produkteve dhe shërbimeve të ndryshme. Me këtë edhe krahasimi i shpenzimeve për prodhim, hyrja dhe fitimit nga ai prodhim dhe me automatizëm dalja është e mundshme. Kjo e bën paranë si njësi themelore matëse e çdo dege ekonomike. Në botën perëndimore për termet ekonomike hyrja dhe dalja përdoret termi në anglisht **input,** gjegjësisht **output**.

Kursi i këmbimit; kurset e këmbimit nuk janë gjë tjetër veçse çmimi i një monedhe, shprehur me një tjetër. Si të tilla këto

i binden mekanizmit kërkesë - ofertë. Rritja e kërkesës çon në vlerësim të monedhave, e kundërta shpie në zhvlerësim.

Vlera e parasë; Në teorinë mbi paranë, problemi kryesor është vlera dhe ndryshimi i vlerës së parasë. Vlera e parasë është identike me fuqinë blerëse të saj dhe llogaritet si vlera reciproke e nivelit të çmimit. Me ngritjen e nivelit të çmimit zvogëlohet vlera e parasë dhe anasjelltas[2].

Parasë prej kohësh i është dhënë një rëndësi e madhe. Edhe përkundër që paraja ka kaluar nëpër shumë procese të mundimshme dhe të vështira, prapë ajo ka arritur të mbijetojë dhe evoluoj prej një forme në formën tjetër, e të qëndroj si bazë kryesore e shteteve. Edhe vlera e parasë si shumë sende të tjera, ballafaqohet me kundër vlerën e saj. Kundër vlera e parasë, apo zhvlerësimi i parasë është inflacioni. Me fjalën inflacion nënkuptojmë, pavarësisht nga arsyet, rritjen e nivelit të çmimit, zhvlerësimin e parasë. E kundërta e inflacionit është deflacioni, i cili është shërues i inflacionit, si dhe bënë zbritjen çmimeve.

Pra, paraja është ajo e cila i ndihmon njerëzit që të jenë të lumtur, por nuk është faktori kryesori për lumturinë e njerëzimit, sepse lumturia nuk blihet me para, edhe pse, pa para vështirë arrihet.

[2] http://sq.wikipedia.org/wiki/Paraja

Korrupsioni - faktor destabilizues ekonomiko-social dhe i sigurisë

Në mjedisin, rrethanat dhe gjendjen tonë të sotshme, ose shoqërinë në të cilën ekzistojmë, ndeshemi me dukuri të caktuara të cilët janë të gabueshme dhe të prishura. Varfëria, ndryshimet e sistemeve të rregullimeve shoqërore, rrjedhat e vështira sociale, globalizimi dhe shumë faktorë të tjera të pashmangshëm, përveç dukurive të cilat i bartin me vete, shkaktojnë forma të ndryshme negative dhe regresive. Në çdo kohë apo periudhë në të cilën ka jetuar dhe vepruar njerëzimi i ka pasur mjetet dhe metodat për përmirësimin dhe mirëqenien e kushteve për jetesë, por gjithmonë përballë tyre kanë ekzistuar faktorë të cilët i kanë dëmtuar, apo luftuar këto dukuri progresive.

Faktorët destabilizues të organeve vitale shtetërore janë të shumta. Por, një ndër faktorët destabilizues, virus vdekjeprurës për shtetin në përgjithësi, e për ekonominë dhe sigurinë në veçanti, është virusi i ashtuquajtur **KORRUPSION.**

Në të shumtën e rasteve, kur flitet dhe shkruhet për korrupsionin, automatikisht do të kuptojmë së bëhet fjalë për vendet në tranzicion. Edhe pse, nuk duhet përjashtuar rastet e aferave korruptive edhe në vende të zhvilluara, të cilat paraqiten në mënyrë sporadike dhe nuk janë të qëndrueshme krahasuar me vendet në zhvillim.

Korrupsioni si fenomen kriminogjen, në masë të madhe po i shkatërron vlerat më vitale të shteteve në zhvillim, po ashtu zhvillimin e shoqërisë e ka stagnuar kundrejt përparimit, si dhe përballë kësaj dukurie famëkeqe i është rrezikuar dinjiteti

njerëzor. Fjala korrupsion ka prejardhje latine dhe kuptim të gjerë. Në jetën e përditshme ajo po përdoret aq shumë sa që tash tingëllon gati si emërtim simpatik, edhe pse kuptimi i saj i mirëfilltë në thelb do të thotë prishje, ndyrje, fëlliqje, qelbim,...etj. Korrupsioni është aq shumë i vjetër, sa është e vjetër historia e zhvillimit njerëzor. Në të kaluarën e largët format dhe mënyrat e korrupsionit kanë qenë të ndryshme krahasuar me të sotshmet, por esenca ka qenë, është dhe do të jetë e njëjtë, d.m.th, shkatërron gjithçka progresive dhe morale. Atë e gjen në të gjitha mjediset, në të gjitha sistemet dhe regjimet e mundshme. Ai u përshtatet të gjitha situatave dhe mbijeton edhe gjatë fushatave më të organizuara kundër tij. Korrupsioni në vete ngërthen veprimtari të mbështetur në suaza joligjore, pasurim brenda natës, posedim të pasurisë jo të ligjshme pa mbështetje financiare, kryerjen e çdo pune me ndërmjetësim të parave pa qenë meritor i asaj pune, shfrytëzimi i funksionit, autorizimi publik i detyrës zyrtare dhe pozitës për realizimin e çfarë do qoftë dobie për vete ose për dikë tjetër.

Korrupsioni i ngjan një virusit ngjitës, i cili ka depërtuar së pari në institutet ku bëhet kurimi i sëmundjeve virusale, e që më pastaj merret vendimi që veprimtarinë "shëruese" ta zgjerojnë, edhe në institucionet tjera dhe më pas në shoqërinë civile. Ky lloj kurimi është e kundërta e efektit, sepse ata që dëshirojnë ta zhdukin këtë virus, vetë ata janë të infektuar nga ky virus, si dhe më pas kjo sëmundje ngjitëse depërton edhe tek institucionet tjera dhe te shoqëria civile. Pra, parandalimi i shfaqjes së korrupsionit duhet filluar nga organet përgjegjëse të cilat i miratojnë dhe i aprovojnë ligjet për luftimin dhe parandalimin e korrupsionit.

Shkaqet e paraqitjes së korrupsionit: Faktorët dhe shkaqet e paraqitjes së korrupsionit janë nga më të ndryshmet. Edhe pse është bërë përpjekje nga shumë autorë eminentë për t'i paraqitur shkaqet e shfaqjes së korrupsionit, prapë nuk kanë mundur të gjitha t'i specifikojnë. Dihet mirëfilli se, nëse i konstatojmë

shkaqet, atëherë shumë lehtë mund të vijmë deri te eliminimi i pasojës.

Në jetën praktike shumë shkaqe janë zbuluar, por siç po shihet shkaqet janë aq shumë të komplikuara, sa që është vështirë të bëhet identifikimi i tyre dhe pasojat mbetën të shikohen dhe përjetohen. Për t'i ndriçuar shkaqet e dukurisë së korrupsionit në shumë vende organizohen tubime shkencore dhe profesionale të ekspertëve të lëmive të ndryshme, si ekonomike dhe kriminologjike. Në një konferencë ndërkombëtare të mbajtur në Amsterdam, në vitin 1992, lidhur me korrupsionin është konstatuar përveç tjerash se "...në shoqëritë bashkëkohore vërehet një tolerancë, një pajtim i theksuar me këtë dukuri, thuajse kjo është diçka e zakonshme dhe normale[3]. Sidoqoftë ne do të përpiqemi t'i paraqesim disa shkaqe që e ndihmojnë korrupsionin të lulëzojë. Si një ndër to janë: mos funksionimi i ligjit, gjendja e rëndë ekonomiko-sociale, morali i dobët, vendet në tranzicion, vende të sapo dala nga lufta, e shumë shkaqe të tjera.

Mosfunksionimi i ligjit: Në shtetet ku nuk funksionon ligji, korrupsioni është mjaft prezent, apo thënë më ndryshe korrupsioni e ka zëvendësuar ligjin, ku me para kryhet çdo gjë. Çdo shtet me ligj e ka të ndaluar përdorimin e korrupsionit.

Por është paradoksale se pikërisht aty ku ndalohet korrupsioni do të thotë; në organe më të larta shtetërore, aty fillon edhe thyerja e këtij ligji. Korrupsioni si pjesë e krimit i deformon të gjitha ligjet, ndikon që i drejti të shpallët kriminel dhe krimineli i drejt, ndikon që lëndët të shtyhen pa qenë nevoja të shtyhen, përfitohet në kohë, e më pastaj ndërmjetësimi i parave e bënë të vetën. Në kësi lloj situatash, korrupsioni disi fillon të imponohet vetvetiu, personat e drejt të cilët nuk pajtohen me këtë gjendje anarkike, ata e kanë shumë vështirë, sidomos kur bëhet fjalë për zgjidhjen e ndonjë problemi përmes gjykatave.

[3] Ragip Halili, "Kriminologja" Prihtinë, 2007 fq. 201

Gjendja e rëndë ekonomike-sociale: Shtetet në zhvillim shërbejnë si truall, jashtëzakonisht i përshtatshëm për paraqitjen e krimit dhe korrupsionit. Korrupsioni, si fenomen negativ i cili ka hyrë në të gjitha poret e jetës, i cili me pasojat e vetë i bren dhe i shkatërron vlerat prej të cilave varet cilësia e jetës, organizimi i shtetit dhe zhvillimi ekonomik. Korrupsioni në gjendje të rëndë ekonomiko-sociale zë vend të veçantë, në resorë të rëndësishëm ku vendoset për fatin e zhvillimit ekonomik, ku projektohen planet për sigurinë kombëtare. Po ashtu këtu qëndron edhe një problem filozofik. Sepse, nëse korrupsioni shfaqet si pasojë e gjendjes së rëndë ekonomiko-sociale, atëherë shtrohet pyetja se si erdhi deri te kjo gjendje e rëndë ekonomiko-sociale? Pa dyshim që korrupsioni, bashkë me shumë faktorë tjerë kriminogjenë e kanë sjellë këtë gjendje të rëndë ekonomiko-sociale. Pra, korrupsioni është prezent në të gjitha fazat regresive. P.sh, aktualisht në pjesën veriore të Republikës së Kosovës zhvillohet tregti krejtësisht ilegale edhe atë me produktet strategjike të shtetit siç janë: nafta, alkooli dhe cigaret, e gjithë kjo ndodh me dijeni të policisë vendore dhe asaj ndërkombëtare. Kosova ka qenë e prekur edhe më herët nga ky virus, virus i cili e ka sjell këtë gjendje të rëndë ekonomiko-sociale, dhe menjëherë pas gjendjes së rëndë ekonomiko-sociale kanë filluar krimet ekonomike mjaft të rënda, çka në masë të madhe e kanë dëmtuar dhe po e dëmtojnë buxhetin shtetëror. Po ashtu, në kushte të rënda ekonomiko-sociale, shfaqet papunësia në masë të madhe, gjë që shërben si shtrat i ngrohtë për rritjen e kriminalitetit, sepse shtetet që me programet e tyre nuk ndikojnë që të ulet papunësia, ata në njëfarë mënyre indirekte ndikojnë në rritjen e krimit dhe korrupsionit.

Morali i dobët - Korrupsioni në vetvete është një fenomen abstrakt. Kur të kombinohet dhe bashkohet me njeriun përmes të cilit kryhet, bëhet fenomen real. Në të gjitha shtete qoftë të zhvilluara, qoftë në zhvillim, pothuajse çdo njeri sprovohet më këtë dukuri famëkeqe. Shumë njerëz të cilët në vetvete nuk kanë qenë të pajisur mirë moralisht, korrupsioni ka arritur t'i sfidoj. Dhe

më pas përmes njerëzve me moral të dobët, sprovimi është bërë edhe më i madh kundrejt atyre të cilët kanë qenë të pajisur moralisht, si dhe pa dashje përmes mashtrimeve të ndryshme, dhe imponimeve të patjetërsueshme janë prekur edhe personat e pastër. Gradualisht kjo dukuri disi fillon të pranohet si diçka normale pa të cilën nuk mund të kryhet asgjë, sidomos disa çështje me rëndësi jetike për njeriun dhe në masë të madhe rrezikohet epiteti njerëzor si njeri i ndershëm, i moralshëm, i drejt, sepse tashmë korrupsioni bëhet pjesë ndoshta e padukshme e përditshmërisë së tij.

Vendet në tranzicion – Pikërisht, vendet në tranzicion janë vende të preferuara dhe të duhura për zhvillimin e korrupsionit. Korrupsioni në mënyrë marramendëse filloi të lulëzojë me privatizimin e pronave shtetërore, në atë private. Personat autoritarë të cilët kanë shkelur mbi kodin etik të punës përmes tenderëve filluan në masë të madhe të pasurohen. Sepse tashmë ata të cilët janë në poste kyçe, maksimalisht e shfrytëzojnë këtë boshllëk nga ana e shtetit, sepse personat të korruptuar e dinë fort mirë se në një të ardhme të afërt më nuk do të jetë kështu, andaj duhet shfrytëzuar maksimalisht këtë gjendje anarkike. Po ashtu edhe në aspektin politik, d.m.th, kalimi nga sistemi njëpartiak në atë shumëpartiak është një situatë e volitshme e pasurimit të tepërt pa djersë. Këtë transformim politikanët e shfrytëzojnë në maksimum, duke bashkëpunuar me shoqëritë civile dhe më tregtarë të ndryshëm. Fjala bie, në Republikën e Maqedonisë privatizimi u bë në formë të qartë korruptive. "Tregtarët" maqedonas në bashkëpunim me politikanët fituan shuma të mëdha parash në këtë proces. Duke ia dhënë tenderët atyre tregtarëve, që pasurinë e tyre e kishin fituar në formë krejtësisht jashtëligjore. Pra, këta tregtarë dhe politikanë ishin të prekur nga korrupsioni edhe para fillimit të privatizimit, tashmë ishin gati dhe të perfeksionuar në këtë veprimtari kriminale. Tregtarëve dhe politikanëve shqiptarë fare pak pjesë i mbeti në gjithë këtë transformim. Por, ajo çka është më e rëndësishmja, është se i gjithë ky krim doli

shumë shpejt në pah. Duke u pasuruar për së tepërmi politikanët dhe tregtarët maqedonas, filluan në masë të madhe ta ndjejnë vetën superior ndaj etnitetit shqiptar. Çka ishte ky një sinjali i qartë për destabilizimin e sigurisë së shtetit. Meqë diskriminimi arriti në kulminacion, siguria e shtetit filloj të prishet. I gjithë ky diskriminim u shoqërua me konfliktin e armatosur të vitit 2001. Pra, shoqëritë në tranzacion janë shumë afër konflikteve ndëretnike, sepse aspekti politik, ekonomik, dhe juridik, nuk e kryejnë funksionin si duhet dhe në këmbim të mos kryerjes së funksionit si duhet janë në gjendje të kryejnë punë, të cilët bien ndesh me vetë aspektet e lartcekura, si dhe të krijojnë kriza. Sepse krizat janë momente dhe raste të volitshme për pastrim parash. Sidoqoftë, vendet në tranzicion këtë anarki po e paguajnë mjaft shtrenjtë. E gjithë kjo anarki politike, ekonomike, juridike është e shoqëruar me mbetjen shekullore, si shtete në tranzicion.

Vendet e sapo dala nga lufta - Vendet të cilat kanë dalë prej luftës, janë në një gjendje të rëndë sociale dhe psikike. Menjëherë pas mbarimit të luftës shumë organizata joqeveritare janë të interesuara të ofrojnë ndihma në forma të ndryshme. Në luftë kemi përleshje të armatosura në mes njerëzve, rrënim të objekteve, shkatërrim total të pasurisë etj. Pra, pas mbarimit të luftës është e nevojshme ndihma për t'i kompensuar sa do pak dëmet e luftës. Dhe për çudi këtu fillon tragjedia tjetër, këtu zë vend të veçantë korrupsioni, sepse ata të cilët nuk i japin ryshfet personave kompetent që e bëjnë transformimin e ndihmat te qytetarët, ata mbetet pa ndihma, sepse nuk kanë çka të japin, për t`u pajisur me diçka më shumë. Po ashtu kemi benificione të shumta nga shtetet dhe institucionet tjera për rindërtimin e vendeve të dala nga lufta, dhe deri te destinimi final fare pak mbërrijnë. Dhe në këtë rast ka gjasa që kushtet sociale dhe mentale të thellohen edhe më tepër në krizë, çka më pas mund të prodhohen, edhe më shumë kriza të natyrave të ndryshme.

1. 1. Korrupsioni-shkaktar i sigurisë jostabile dhe i ngecjeve ekonomike

Siguria e një vendi është kusht që organet tjera të funksionojnë si duhet. Pa siguri në shtet, nuk kemi fare progres, sepse siguria i prin proceseve tjera përpara. Po që siguria është jo stabile, atëherë i gjithë mekanizmi zinxhiror do të jetë në ngecje dhe vendi do të shërbej si eksperiment krizash. Siguria është kusht, nevojë dhe qëllim i çdo bashkësie shoqërore. Zhvillimi i përgjithshëm në shtet, së pari varet nga siguria dhe më pas vazhdojnë sprovat në segmente të tjera. Korrupsioni në destabilizimin e sigurisë vepron në mënyrë indirekte, gjegjësisht përmes organeve tjera. Njëri prej elementeve që çon drejt destabilitetit të sigurisë është ekonomia joformale, e cila përfundon me trazira apo me luftëra. Duke u bazuar në rrethanat aktuale, korrupsioni po shfaqet në vende dhe forma të ndryshme, duke filluar nga organi më i lartë i shtetit e deri te organi më i ulët lokal.

Pasurimi marramendës i pushtetarëve, në një vend të varfër është lajmërues i saktë i prezencës së korrupsionit. Me anë të privatizimit të pronave dhe ndërmarrjeve shtetërore, filloi të shfaqet me të madhe korrupsioni, i cili e dëmtoi tej mase zhvillimin ekonomik të mëtutjeshëm. Në Shqipëri, Maqedoni, Kosovë pronat dhe ndërmarrjet u privatizuan, por buxheti shtetëror mbeti ashtu si ishte më parë, apo paratë u depozituan në banka të huaja me afatizim të pacaktuar! E dihet kjo është një mënyrë intelektuale e plaçkitjes, sepse për 25 vjet populli do të harrojë se çka është bërë me paratë e privatizimit. Pra, shkaktar kryesor i ngecjeve ekonomike është korrupsioni, si dhe pasojat e tij janë të shumëfishta. Pse janë të shumëfishta? Sepse interesimi i investitorëve të huaj është shumë i ulët, çdo investitor që dëshiron të investoj në ndonjë vend pyetja e parë është: a ka korrupsion në atë shtet dhe sa është toleranca ndaj korrupsionit? Me të hetuar se ka korrupsion në një masë të madhe, po edhe pak qoftë, menjëherë në mënyrë spontane e kupton se në atë vend edhe siguria është

jostabile. Paramendoni një shtet pa investime nga jashtë! Si mund të jetë gjendja ekonomiko-sociale e atij shteti? Për ta ilustruar këtë fenomen të rrezikshëm po i marrim shembull shtetet tona: Shqipërinë, Maqedoninë dhe Kosovën. Investitorët nga jashtë në këto vende janë shumë pak të interesuar dhe ato kryesisht të orientuar drejtë shërbimeve gjë që nuk mund të jetë edhe aq profitabile për shtetin tonë krahasuar me prodhimin.

Shtetet që janë të përfshira nga korrupsioni nuk guxojnë dhe nuk kanë të drejt të ëndërrojnë integrimin në Unionin Evropian, sepse siç dihet kushti kryesor për tu futur në familjen evropiane është, ***"TOLERANCË ZERO NDAJ KORRUPSIONIT"***.

E drejta e tyre për të ëndërruar dhe synuar UE-në fuqizohet vetëm atëherë kur ata e zhdukin korrupsionin në: administrata publike, në organe gjyqësore, në universitete dhe në shumë institucione tjera me ndikim të madh në shtet.

Korrupsioni si pjesë e krimit, vazhdon të jetë prezent në çdo pore të jetës, vazhdon t'i demoralizojë njerëzit për të punuar, vazhdon ta pengojë zhvillimin e mëtutjeshëm. Korrupsioni është një sëmundje vdekjeprurëse, një virus i pashëruar por me diagnozë të zbuluar dhe me barna shërues. Korrupsioni i ka kapluar personat autoritarë të jakës së bardhë, të cilët fenomenin e korrupsionit po e bëjnë mjaft të komplikuar për ta luftuar dhe parandaluar.

Pra, korrupsioni është ai nga i cili vuajnë shumë njerëz, shumë shtete, ekonomitë kombëtare dhe ndërkombëtare po i sjell në një gjendje kaotike dhe në një të ardhme mjaft të pasigurt. Në përgjithësi faturën e kësaj dukurie famëkeqe po e paguajnë shtetet në zhvillim, si dhe ekonomia kombëtare që pretendon në një të ardhme të afërt të kaloj në ekonomi ndërkombëtare.

Liberalizimi i tregtisë, e pengon apo e ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës?

Sot ekonomia e një vendi, qoftë edhe ajo më e zhvilluara nuk mund të imagjinohet si ekonomi kombëtare, dhe të mbijetojë e izoluar prej ekonomive të vendeve tjera, qofshin ato edhe të vendeve më të pazhvilluara.

Ekonomia botërore gjithnjë e më tepër po shndërrohet në një "fshat ekonomik" ku gjithsecili blen dhe i shet gjithsecilit tepricat e resurseve të tij pavarësisht se a i'a ka falë natyra (Zoti), i ka krijuar në proces të prodhimit ose i ka "okupuar" në mënyrën e vet. Liberalizimi i tregtisë e ndihmon zhvillimin ekonomik të Kosovës, por nuk duhet përjashtuar, edhe disa ngecje që rrjedhin nga liberalizimi i tregtisë. Kosova si shtet, tashmë i pavarur duhet që synimet t'i drejtojë kah Unioni Evropian, sidomos në aspektin ekonomik. Dihet mirëfilli se një ndër kushtet kryesore që një shtet të futet në UE, duhet që patjetër t'iu nënshtrohet liberalizimit të tregut. Me anë të liberalizimit Kosova mund t'i promovojë produktet vendore në tregun e jashtëm.

Kosova është nënshkruese e marrëveshjes CEFTA, e cila i rregullon çështjet që të mos ketë probleme gjatë eksportimit apo qarkullimit të mallrave. Në këtë marrëveshje ekziston klauzola për mbrojtjen e prodhimit vendor, e po ashtu edhe klauzola për zgjidhjen e kontesteve eventuale në rast të mosrespektimit të marrëveshjes nga ndonjë palë nënshkruese. Deri më tani në përgjithësi respektohet kjo marrëveshje!

Një ndër arsyet apo dëshmitë për progresin ekonomik në Kosovë në aspektin e liberalizimit është nënshkrimi i marrëveshjes së tregtisë së lirë me katër shtete, Shqipërinë, Maqedoninë, Bosnjë e Hercegovinën dhe Kroacinë. Këto marrëveshje janë të

dobishme dhe deri më tani kemi një zhvillim progresiv të ndërsjellë. Por, si në çdo rast tjetër që kemi anë pozitive dhe negative për ndonjë dukuri të caktuar, edhe këtu e kemi edhe njërën edhe tjetrën, por jo në masë të barabartë.

Për Kosovën një Marrëveshje e Tregtisë së Lirë do të thoshte negocim për arritjen e objektivave progresive, duke mbrojtur ekonominë kombëtare. Në përgjithësi liberalizimi i tregut në Kosovë ka efekte pozitive, e më pak negative. Pozitive janë:

a) Influenca e mundshme në uljen e çmimeve
b) Rritja e konkurrencës
c) Nxitje e investimeve të huaja në përgjithësi dhe teknologjive të reja në veçanti
d) Përmirësim i bilancit tregtar nëpërmjet nxitjes së eksporteve
e) Plotësim më i mirë i nevojave të konsumatorit

Por duhet të shmang efektet negative që janë të lidhura me:

a) Shfaqje të kontrabandës në formën e abuzimit me rregullat e origjinës
b) Ulje e prodhimit vendas si pasojë e konkurrencës nga produktet e huaja
c) Ulja e nivelit të të ardhurave të buxhetit si pasojë e uljes së tarifave të importit

Siç po shihet mund të kemi, edhe ngecje në prodhimin e produkteve bujqësore. Sepse, me anë të tregtisë së lirë shtetet fqinje po sjellin produktet e tyre këtu në Kosovë me një çmim shumë të lirë, çka po ndikon në destimulimin e atyre që dëshirojnë të merren me kultivimin e prodhimeve bujqësore në vendin e vet. Shikuar gjendjen e tanishme, Republika e Kosovës duhet patjetër t'i ndaloj përmes tarifave doganore disa produkte bujqësore që vijnë nga jashtë, sidomos nga vendet fqinje. **Sidomos këtë duhet**

urgjentisht ta bëjë me Serbinë, e cila përmes varshmërisë ekonomike dëshiron që prapë Kosovën ta ketë në duart e veta. Plasimi i produkteve serbe në Kosovë, do të thotë okupim ekonomik i tregut kosovar. Shikuar historikisht shtetet okupuese fillimisht kanë depërtuar përmes veprimtarisë ekonomike (me këtë nuk dua të them se të ndërpriten raportet ndërfqinjësore me Serbinë, por bashkëpunimi valid në të gjitha sferat duhet filluar tek atëherë kur Serbia ta pranojë Kosovën si shtet të pavarur). Pse të konsumojmë disa produkte bujqësore të importuara (pemë, perime, qumësht dhe produkte tjera që prodhohen nga qumështi)? Duke qenë në gjendje që ne vetë t'i kultivojmë. Sepse një mundësi të tillë e kemi.

Kosova aktualisht 80 përqind konsumon produkte të importuara. Qeveria duhet të bëjë subvencionimin e prodhimit vendor, se përndryshe për shkak të importimit të shumtë, do të jemi të varur nga shtetet tjera, si në aspektin: politik, ekonomik, po ashtu edhe në atë juridik. Ana tjetër e medaljes është se aktualisht Republika e Kosovës në aspektin industrial është ende shumë larg, pra patjetër duhet importuar produkte nga jashtë, produkte të cilat nuk kanë gjasa të prodhohen (përkundër posedimit të lëndës së parë). Në këtë rast shumë të rëndësishëm, Kosovën e ndihmon shumë liberalizimi i tregtisë, sepse përmes importimit të teknologjive, e makinave, Republika e Kosovës shumë shpejt mund të konkurrojë në tregun Evropian, duke përdorur si lëndë të parë produktet vendore.

Kësisoj, duhet bërë një kombinim apo seleksionim se çka duhet të importohet dhe çka të pengohet për ta stimuluar prodhimin vendor. Aktualisht Republika e Kosovës më shumë duhet të importojë se sa të eksportojë, pra duhet shkuar drejt liberalizimit të tregut i cili është një vlerë evropiane, e që i paraprin integrimit në Unionin Evropian.

Prapambeturia ndër shqiptarët

Është shkruar dhe folur shumë për prapambeturin, për vendet e prapambetura, për ideologjitë, apo sistemet që e kanë sjellë prapambeturin. Në të shumtën e rasteve prapambeturit janë shikuar nga një kënd i vetëm. Prapambeturia është e definuar si ngecje, apo ecje më ngadalë se të tjerët në punën për plotësimin e një diçkaje, që nuk përparon krahas me të tjerët, që ka mbetur prapa të tjerëve, përgjithësisht shtetet që janë karakterizuar me regres ekonomik, kulturor, kombëtar, juridik dhe politik.

Shkaku i prapambeturisë ndër shqiptarët është shikuar dhe shikohet më së shumti nga këndi historik. Është e udhës që defekti i ndonjë gjëje, fillimisht të shikohet nga gjeneza apo nga burimi i problemit. Shikuar historikisht, populli shqiptar i është nënshtruar pandërprerë diskriminimit, persekutimit, dëbimit dhe gjenocidit, e që ky avaz në dozë pak më të lehtë vazhdon ende. Trojet shqiptare u pushtuan nga Perandoritë e fuqishme, por kohezioni kombëtar gjithmonë ishte i paluhatshëm. Gjatë mbretërisë ilire, Dardania pushtohet nga Perandoria Romake, e cila e përhap fenë e krishterë. Pastaj në vitin 476 në shumë principata shqiptare shtrihet pushtimi i Perandorisë Bizantine dhe me dhunë ushtarake përhapet feja ortodokse. Në vitin 1463 Ballkanit i vërsulet rrebeshi i ushtrisë së Perandorisë Osmane, ku tash më, me të madhe fillon të përhapet feja islame[4]. Pas tërheqjes së Perandorisë Osmane një pjesë e kombi shqiptar mbeti e copëtuar dhe një pjesë bukur e madhe mbeti nën sundimin e Jugosllavisë (çetnikëve serb). Finalizimi i padrejtësive u rrumbullakua, tashmë diplomatikisht në

[4] Hysen H. Terziu, "Gjenocidi serb 1912-1956, Prishtinë 2005, fq.

Konferencën e Ambasadorëve në Londër (1913), ngase zyrtarisht u bë copëtimi i Shqipërisë. Këto procese historike të dhembshme për shqiptarët janë një shkak prej shumë shkaqeve të tjera që shqiptarët janë të prapambetur dhe të përbuzur. Sepse, e drejta për t'u bërë zot në shtëpinë e vet është humbur qysh në mbretërinë ilire.

Fillimi i ngecjeve ishte si rrjedhojë e ngjarjeve historike, kurse evoluimi është ekonomiko-politik. Sepse, pas bërjes shtet Shqipëria, kishte mundësinë e përparimit, zhvillimit ekonomik, mirëpo prej vitit 1912 e këndej ende e mban epitetin si vend në zhvillim, shtet në tranzicion, vend i botës së dytë, etj,.

Nga neglizhenca dhe regresi i Shqipërisë, në aspektin ekonomik pësuam të gjithë shqiptarët anekënd trevave shqiptare. Pas një izolimi shumëvjeçar, pas një përjetimi të tmerrshëm, Shqipërisë iu hapë dera e liberalizimit dhe e komunikimit me botën e jashtme. Liberalizmi i papritur u shoqërua me efekte të kundërta, sepse ishte një befasi, goditje dhe një ndryshim i përnjëhershëm, i cili ndryshim u shoqërua me imazh të keq nga të tjerët dhe u desh kohë që imazhi ndërkombëtarë, gradualisht të ndryshojë për të mirë. Por, posa fillon Shqipëria t'i marrë hapat e para drejtë progresit, ballafaqohet me trazirat e vitit 1997, ku së pari u viktimizua populli shqiptar, pastaj u vërtetua se shteti shqiptar, i sapo kishte dalë nga kthetrat e komunizmit, vazhdonte të përballet me pasojat e së kaluarës dhe me mungesën e vizionit për të ardhmen.

Shumë analistë, e publicistë shkakun e prapambetjes e lidhin me pushtimin e Perandorisë Osmane, duke harruar të gjorët se prej se ekziston gjeneza e popullit shqiptar, populli ynë ishte nën qeverisjen e shumë pushtuesve të ndryshme (aq më keq kur dëshirojnë t'i amnestojnë edhe dëmet që na i solli pushtimi serb).

Pra, analizat e këtyre ekspertëve pa ekspertizë, janë vetëm një manifestim i hapur i turkofobisë, e fshehur nën vellon e islamofobisë (me këtë konkluzion, nuk dëshirojmë të theksojmë se kjo Perandori nuk na ka sjellë dëme). Këta kanë shkuar edhe më

larg duke shprehur një patriotizëm fals dhe duke i bindur përkohësisht edhe të tjerët, duke pohuar me mburrje se "feja e shqiptarit është shqiptaria". Pse atëherë shkakun e prapambetjes nuk e kërkuan te feja "shqiptaria"? Çfarë i solli feja e shqiptarit "shqiptaria", Shqipërisë në kohën e izolimit 50 vjeçar? Sepse, në atë kohë nuk kishim fe tjetër!

I kemi harruar me qëllim dëmet që na i solli komunizmi, por nuk e kemi harruar nostalgjinë për Rusinë, Stalinin dhe Leninin. Shqipëria edhe pak vite do të festoj 100 vjetorin e pavarësisë së saj, do të këndojë e vallëzojë, por një gjë sikur të paktën një herë t'ju kujtohet, një kalkulim shumë i thjesht, popujt tjerë për 100 vjet çka bërën, ku shkuan? Sa tokë pjellore mbeti vetëm pjellore me mbeturina përmbi, bregdeti prej krijimit të tij nuk përjetoi ndryshime, pos disa ndërtesave buzë detit duke i`a humbur hijeshinë e natyrshmërisë dhe duke mos qenë fare atraktiv për vizitorët! Sa qeveri u ndërruan, duke mos sjellë asgjë, pos retorikës dhe përçarjes, e cila retorikë kurrë nuk pati fat të jetësohet në praktik dhe e cila përçarje pati fatin e menjëhershëm të jetësohet në praktikë!

Kosova u bë Republikë! Urime Kosovë. Lugina e Preshevës vazhdon ta përjetojë ende pushtimin dhe diskriminimin, turp Shqipëri, e Kosovë! Për Malin e Zi dhe Çamërinë gradualisht po humbin edhe bisedat! Statusi i shqiptarëve në Maqedoni, edhe përkundër konfliktit të armatosur, është tmerr dhe pa perspektivë.

Se sa, ne shqiptarët duhemi mes veti, i shohim të rrahurat që ndodhin në kuvendin (shëmbëlltyra e popullit) shqiptar, i shohim pushtetarët në të gjitha trevat shqiptare se sa të pasur janë, e pastaj se si lozin me dinjitetin e popullit të vet. Se sa ne shqiptarët kujdesemi për familjet e atyre që dhanë jetën për këtë komb, e atdhe, dëshmi i kemi shtëpitë e tyre të ndërtuara në kohën e neolitit dhe në shenjë "respekti" për dëshmorët i vëmë lule mbi varr. (Ah sikur të kemi mundësi t’i dëgjojmë se ç’thonë dëshmorët për neve!) U vranë shqiptarë në Brodec nga etniteti tjetër, kurse

shqiptari nuk hezitoi fare të thotë se operacioni ishte i suksesshëm. Menjëherë pas tragjedisë në Gërdec, pa menduar dhe ndërmarr diçka për shpëtimin e jetëve njerëzore, opozita kërkon dorëheqjen e pushtetit (kjo është një shenjë modeste se sa pushteti dhe opozita brengosen për jetën e njerëzve).

Derisa, shqiptari nuk ia mbron interesin shqiptarit, nuk e flijon interesin individual për atë të përgjithshëm, nuk i shfrytëzon begatitë që i`a ka dhuruar Zoti, e lejon të bëhet vegël e joshqiptarit për post dhe para, nuk e kuptojnë se shteti duhet ndërtuar me ekonomi, pa mëdyshje se punët do t'i kemi edhe më keq se sa i kemi aktualisht. Mos të merremi me gjepura, mos të harxhojmë kohë kot duke u "brengosur" aq shumë se pse myslimanët na qenkan të prapambetur. Mos të mundohemi ta arsyetojmë gjendjen faktike, me arsyetimin e myktë se neve Islami na paska lënë mbrapa, nuk duhet harruar faktin, se feja islame është fe e progresit. Asnjëri prej prijësve tanë politik, përpos emrit nuk kishin asgjë të përbashkët me Islamin dhe myslimanët.

Askush nuk na detyron të korruptohemi, të ikim prej tatimit, të mos punojmë, mos të zbulojmë, të votojmë për njerëz me moral të prishur dhe të paditur! Sepse faji për regresin multidimensionalë, nuk është vetëm te qeverisësit (që nuk meritojnë as të qeverisen) por një pjesë të fajit e kemi, edhe ne vet populli.

Kriza financiare gjunjëzon ekonominë globale
(Përkitazi me krizën financiare, viti 2008)

Globi tokësor, në kohë dhe në hapësirë të ndryshme, disa herë është përfshirë me kriza të mëdha, të ashtuquajtura globale. Sinjali i krizës financiare është rritja e kërkesës për para në mënyrë të shpejtë. Në të kaluarën kriza financiare ishte ekuivalente me krizat e bankave. Në kohën e sotme krizat financiare nuk janë të lidhura vetëm me bankat, por me gjithë institucionet dhe kompanitë financiare (bursat, kompanitë e sigurimeve, korporatat, ndërmarrjet, etj,.) Shteti më i fuqishëm në botë, u godit nga cunami financiar, që ishte më i rrezikshëm se cunami natyror, sepse pasojat e kësaj krize po reflektojnë në tërë botën e zhvilluar, e cila pasojë shumë shpejt mundë të jetë vdekje për vendet në zhvillim.

Menjëherë pas sulmeve të 11 shtatorit, ShBA-ja hartoi një politikë të sigurisë të përbashkët me shtetet e tjera, për luftimin e terrorizmit. Siç dihet, lufta përpos humbjeve dhe shpenzimeve tjera, ka edhe koston e vet të shprehur në para. Marrja e kredive kolosale për luftë, apo thënë ndryshe për sjelljen e "demokracisë" në botën arabe, ShBA-të i solli në një pozitë financiare mjaft të pavolitshme. FMN-ja, prej disa muajsh paralajmëroi ditë të këqija për ekonominë botërore, ku temë diskutimi ishte luftimi i varfërisë, kërcënimi i sigurisë dhe krizat e kredive të patundshmërisë. Parashikimet e FMN-së u bënë realitet. **Falimentimi i njërës prej bankave më të vjetra dhe më me reputacion në ShBA, siç ishte "Lehman Brother's", tregon qartë rrezikshmërinë e mëtutjeshme të krizës financiare, apo krizës së kredive të këqija në ShBA.** Përpos këtij tmerri gjatë muajve të fundit, në tregjet financiare amerikane, pati edhe disa falimentime të tjera.

Falimentuan disa bankat investive, kreditore dhe shoqëri të sigurimeve, si dhe shoqërimi i kësaj krize u pasua me disa vetëvrasje. Çmimet e aksioneve nëpër bursat amerikane dhe evropiane po bien në mënyrë drastike të paparashikueshme. **Shumë analistë, e specialistë vlerësojnë dhe e ndërlidhin këtë gjendje me situatën e Depresionit të Madh të viteve 1929-1932.**
Kjo krizë financiare reflektoi, edhe në institucionet financiare evropiane. Më e ekspozuar nga të gjitha vendet evropiane mbetet Mbretëria e Bashkuar, Anglia. Kjo, sepse qendra e dytë financiare pas ShBA-së, vjen Anglia. Rrezikshmëria e bankave evropiane është e lidhur direkt me falimentimin e bankës amerikane "Lehman Brother's". Nëse bankat evropiane i kanë dhënë hua kësaj banke, atëherë pa mëdyshje këtë krizë do ta ndjejnë, edhe institucionet bankare evropiane. Kontinenti evropian do të jetë i ballafaquar me mungesën e likuiditetit dhe si rrjedhojë do të këtë mungesë të dollarit në treg. Kjo pastaj do të sjellë rritjen e normës së interesit në dollar. Paralelisht kur Evropa po ballafaqohet me krizën financiare, monedha euro po ashtu i ka problemet e veta. Prej nivelit të lartë ndaj dollarit amerikan, që e kishte arritur në korrik të këtij viti, që këmbehej me 1.60 dollar, aktualisht ka rënë nën raportin 1.37. Prej fundit të muajit korrik e deri tash, euroja ka rënë në krahasim me dollarin amerikan për afro 14 %. Këtij procesi famëkeq, është duke i ndihmuar dhe përshpejtuar, stuhia financiare amerikane. Sa herë që bankat evropiane janë ballafaquar me probleme, me automatizëm është dobësuar euroja. Evropa nëse ballafaqohet me krizën financiare, sikurse ShBA-ja, atëherë do ta ketë shumë më vështirë ta tejkalojë këtë krize, sepse tashmë është e shoqëruar, edhe me rënien e vlerës së euros dhe me rritjen e deficitit buxhetor të shteteve anëtare të unionit monetar. **Ballkani në përgjithësi, e Shqipëria, Kosova dhe Maqedonia në veçanti, nuk do të jenë të prekur në mënyrë direkte nga kriza globale financiare, sepse nuk janë të integruara në sistemet bankare evropiane, apo ndërkombëtare.** Por përkundër kësaj duhet pasur një dozë frike. Sepse bankat amerikane

falimentuan për shkak të moskthimit të kredive. Ndërkohë të njëjtat procese në masë pak më të vogël janë prezente edhe në vendet tona. Pra, fenomeni i dështimit është i njëjtë. Edhe pse bankat tona mundë të mos kenë lidhje fare me bankat ndërkombëtare, ne prapë jemi të kërcënuar nga kolapsi global financiar, sepse edhe ashtu siç jemi ekonomikisht mjaft të dobët, tashti mund t'i humbasim mundësitë për ndihmë financiare nga shtetet amerikane dhe evropiane (mendoj se është e kotë ta përshkruaj gjendjen e vendeve ballkanike pa ndihma nga jashtë. Menjëherë pas paraqitjes së krizës financiare, presidenti Xhorxh Bush, shprehu optimizëm para opinionit se kjo gjendje shumë shpejt do të tejkalohet, duke siguruar një shumë prej 700 miliard dollarësh për ndihmë financiare, si zgjidhje të drejtë dhe efikase. Por, fatkeqësisht edhe pas kësaj ndihme gjendja vazhdon të jetë alarmante. Shtetet pa reshtur individualisht po vazhdojnë në gjetjen e një zgjidhje. Shtetet më të industrializuar në botë (G 7-ta), pritet të ndërhyjnë në institucionet më të mëdha financiare, duke siguruar kapital nga burimet shtetërore dhe private.

Banka Botërore do të përdor një borxh nga Rusia, për fuqizimin e rezervave për shkëmbim me jashtë. "Meqë problemi është global atëherë, luftimi, ndihma dhe qasja duhet të jetë globale", ky është plani i përbashkët, i presidentit amerikan Xhorxh Bush, FMN-së, Bankës Botërore, G 7-ës, Ministrave të Financës, i BE-së, dhe mobilizimi i gjithë personelit profesional botëror.

Krimi ekonomik dhe indiferenca e shoqërisë ndaj këtij krimi

Njeriu si pjesë përbërëse e shoqërisë, prej kohësh është ballafaquar me dukuri të ndryshme dhe të shumta, që e tangojnë dhe e pengojnë zhvillimin normal të tyre. Ky pengim dhe brengosje ndaj njeriut në veçanti dhe shoqërisë në përgjithësi, është bërë nga vet njeriu, apo nga një grup njerëzisht. Po ashtu, luftimi dhe studimi i këtij fenomeni famëkeq bëhet nga njeriu, apo nga një grup shkencëtarësh.

Pra, të gjithë ciklet, pozitive dhe negative në këtë proces kryhen dhe i përkasin njeriut. Në kohërat e sotshme krimi ekonomik është bërë problem global dhe i pranishëm në të gjitha poret e jetës. Me krimin ekonomik nënkuptojmë; të gjitha ato veprime dhe sjellje kundërligjore të personave fizik dhe juridik të cilët janë të inkuadruar në afarizmin dhe veprimtarinë ekonomike. Në përgjithësi, shoqëria nuk i jep edhe aq rëndësi këtij krimi dhe manifeston një indiferencë ndaj tij, duke e konsideruar si të parëndësishëm dhe jo ndikues për zhvillimin shoqëror. Ndërsa, krim të vërtet dhe me pasoja të rënda e konsiderojnë kriminalitetin njerëzor, duke harruar se krimi ekonomik, i përket dhe kryhet nga faktori njeri. Pra, fenomeni i këtij krimi është njerëzor! Nëse i analizojmë dhe, mbështetemi në statistikat kriminologjike shohim se dëmet që i ka sjellë shoqërisë ky lloj krimi janë shumë më të dëmshme se krimet tjera.

Krizat sociale, varfëria, regreset ekonomike, anarkitë dhe, trazirat tjera ekonomike, që në të shumtën e rasteve përfundojnë me luftëra, janë produkte të kriminalitetit ekonomik. Kriminaliteti ekonomik, për herë të parë është përmendur nga Sociologu Edwin

Sutherland në vitin 1949, i cili e përkufizon atë si; "një krim të kryer nga persona me reputacion të lartë shoqëror të cilët kanë role drejtuese të larta dhe i kryejnë këto krime gjatë ushtrimit të detyrës"[5]. Esenca edhe sot e kësaj dite është e njëjtë. Nga ky lloj krimi, më së shumti janë të prekur promotorët e drejtësisë dhe më pas po të njëjtit drejtues këtë krim, e luftojnë duke filluar prej hierarkisë së poshtme, (d.m.th, nëse një polic korruptohet për tetë euro, me automatizëm suspendohet nga puna).

Krimi ekonomik manifestohet në forma të ndryshme dhe të shumta. Shumica e autorëve format e kriminalitetit ekonomik i kanë specifikuar në: "deliktet e kartelave të mëdha, aktet e mashtrimit dhe keqpërdorimit të gjendjeve ekonomike të kompanive multinacionale, mashtrimet në përfaqësime dhe keqpërdorimi i lejeve ndërkombëtare për tregti dhe afarizëm, veprim fiktiv i firmave dhe ndërmarrjeve të ndryshme, falsifikimi i librave financiare, konkurrenca jolojale, favorizimi i firmave, marrja e provizioneve gjatë tenderëve, keqpërdorimi i fondeve dhe donacioneve, deliktet bankare dhe transaksionet e ndaluara në bursë, larja e parave, marrja e mitos, ikja nga tatimi, korrupsioni dhe forma të tjera kriminale".

Në Republikën e Maqedonisë këto forma janë të pranishme në masë të madhe, në përjashtim të formave, të cilat i përkasin teknologjisë së avancuar. Ikja nga tatimet duke filluar nga ndërmarrjet në fshatra, e deri te ndërmarrjet në qytete është tejet e madhe. Kemi ndërmarrje të mëdha që paguajnë një shumë simbolike për tatim dhe pjesën tjetër kryesore të tatimit, kontributet, ndërsa sigurimin e punëtorëve e mbajnë për vete. Defekti nuk qëndron vetëm tek ndërmarrjet, por kjo vepër kriminale është e lidhur direkt me qeverisësit dhe inspektorët financiarë. Afaristët në Republikën e Maqedonisë (pavarësisht përkatësisë nacionale) pohojnë se, "për ikje nga tatimi kemi ofertë edhe nga vet inspektorët dhe kontabilistët financiarë, po ashtu mësimin e evazionit

[5] Revista, "Zeri i shqiptarit" Prishtinë, 2009 fq. 11

fiskal e kemi marrë nga ata dhe ne një veprim të tillë fatkeqësisht po e mirëpresim". Po ashtu larja e parave dhe korrupsioni janë drejtpërdrejt të lidhura me organet më të larta shtetërore dhe për t'i treguar botës se ne e luftojmë krimin ekonomik, sipërfaqësisht i padisin disa nëpunës të gjorë.

Fondet dhe donacionet që vijnë nga jashtë, janë të keqpërdorura në masë të madhe nga etniteti maqedonas. Donacionet që lëshohen nga jashtë fare pak, apo aspak nuk mbërrijnë deri te etniteti shqiptar, apo te etnitetet tjera. Shumë qartë dhe lehtë shihet dallimi infrastrukturor, ndërmjet komunave maqedonase dhe asaj shqiptare. Mjafton t'i shikojmë rrugët antike, në pjesën ku jetojnë shqiptarët dhe komunitetet tjera, përpos atij maqedonas. Ky lloj kriminaliteti kryhet nga shteti ndaj popullatës civile, të cilët natyralisht nuk i përkasin kombësisë maqedonase.

Kemi afarist që pasurinë e tyre e kanë fituar duke i përdorur të gjitha rrugët joligjore, e pastaj me investim të kapitalit (jashtëligjor) në një ndërmarrje të madhe, me punësimin e shumë punëtorëve, me automatizëm si nga shteti ashtu edhe prej popullatës civile, ky person njihet si person i ndershëm, bamirës, kontribues për zhvillimin ekonomik lokal, i respektuar, i jepet përparësi në biseda, duke "harruar" shteti dhe popullata civile se personi në fjalë është një kriminel i kamufluar dhe shumë i rrezikshëm. Kryerësit e krimeve ekonomike, në dukje fiziologjike aspak nuk i ngjajnë kriminaleve të tjerë. Ata janë të pashëm, tipa social, flasin rrjedhshëm, i kundërshtojnë dukuritë negative që e pengojnë zhvillimin shoqëror, janë të buzëqeshur, të përshëndeturit e kanë mjaft mbresëlënëse, të ftojnë për kafe, interesohen për gjendjen sociale familjare dhe shumë virtyte artificiale tjera. Pra, te njerëzit tjerë këta kriminelë lënë përshtypjen si njerëz të mirë dhe në kuadër të këtij besimi, këta kriminelë ushtrimin e mëtutjeshëm të veprimtarisë e kanë më të lehtë.

Pra, për aq sa, krimi ekonomik është prezent në qarqet vendimmarrëse shtetërore dhe i ka kapluar personat autoritarë të

jakës së bardhë, parandalimi dhe luftimi i këtij fenomeni shkatërrues do të jetë i pamundur.

Administrata publike dhe korrupsioni

Dukuritë dhe fenomenet negative në kohërat e kaluara ishin të pamundura të evitohen, ngase nuk ka pasur institucione që janë marrë me problemet përkatëse, si dhe në mungesë të këtyre institucioneve problemet e shumta vetëm se janë zgjeruar. Me krijimin e problemeve të shumta dhe të paevitueshme është krijuar shteti si lokalizues dhe parandalues i problemeve, kurse me krijimin e shtetit është paraqitur domosdoshmëria për krijimin e administratës publike.

Me administratën publike takohemi çdo ditë, bie fjala, polici rrugor kur jep urdhra në trafik, ku pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen rregullave, ngase polici është nën autoritetin e pushtetit. Administrata publike pa pushtet nuk mundë të jetë jetike dhe funksionale dhe anasjelltas. Roli i administratës publike në shoqëri është mjaftë i theksuar. Administrata publike në njërën anë ka rëndësi të veçantë për qytetarët e saj të cilët paraqiten si palë e drejtpërdrejt me të dhe në anën tjetër ka rëndësi të posaçme për vetë organin e pushtetit. Administrata publike është një veprimtari pa të cilën nuk mund të paramendohet veprimtaria e shtetit si organizëm i së drejtës. Pra, rregullimet ligjore, kushtetuese, mbledhja e tatimit, dënimet, këshillat, përdorimi i forcës në rast nevoje, shërbimet e qytetarëve dhe shumë obligime të tjera i përkasin dhe kryhen nga shteti me ndihmën e administratës publike. Sepse, përpos që administrata publike është organ i shtetit, ajo paraqitet edhe si palë për qytetarët e saj.

Në jetën bashkëkohore do të ishte i pamundur funksioni normal i shtetit, pa ndihmën dhe ndërmjetësimin e administratës

publike. Aq më shumë, kur nevojat e shtetit dhe qytetarit janë bërë mjaft të larta. Kuptohet, administrata publike është e ndarë dhe e seleksionuar nëpër sektorë të veçantë, në mënyrë që puna t'i lehtësohet nëpunësve shtetërorë dhe qytetarëve. Si çdo gjë që ka anën e mirë dhe jo të mirë të saj, po ashtu edhe administrata publike nuk ka shpëtuar dot nga ky koncept real. Me zhvillimin e veprimtarisë së administratës publike është instaluar i ashtuquajturi virus vdekjeprurës "korrupsion".

Në të shumtën e rasteve, kur flitet dhe shkruhet për administratën publike dhe korrupsionin në mënyrë spontane do ta kuptojmë së bëhet fjalën për vendet në tranzicion. Fundja administrata publike dhe korrupsioni nuk duken edhe si një duet i ri dhe befasues, sepse korrupsioni zanafillën dhe evoluimin e tij, e ka prej këtij institucioni mjaft vital dhe në rast dërrmimi, atëherë ky institucion kalon në të ashtuquajturën institucion fatal për shoqërinë dhe shtetin në përgjithësi.

Korrupsioni administrativ ka të bëjë me administratën publike. Ky lloj i korrupsionit kryhet me anë të shfrytëzimit të kompetencave të nëpunësve në administratë, prej asaj lokale deri te ajo qendrore, merret mito, ryshfet, d.m.th, bëhet korruptimi duke u dhënë leje, çertifikata, dokumente dhe akte tjera individëve, grupeve dhe firmave për realizimin e interesave të ndryshme materiale dhe financiare, për grumbullimin e pasurisë që shpesh herë nuk u takon.

Pothuajse çdonjëri prej nesh është ballafaquar me këtë formë të korrupsionit. Pikërisht ne të cilët jetojmë në vende me ekonomi regresive dhe tranzicionale, i kemi parë për së afërmi se si shkelen normat ligjore, apo thënë më mirë edhe ne vetë i kemi ndihmuar korrupsionit me anë të ryshfetit, sepse në këto rrethana, apo turbullira në mënyrë spontane mentaliteti na është mësuar që për të na kryer ndokush ndonjë punë administrative, duhet në fillim t'i japim diçka dhe pasi të na ketë kryer punën prapë jemi të gatshëm t'i japim diçka, por tashmë në formë të "dhuratës".

Administrata publike në Republikën e Maqedonisë ende përballet me shumë anomali të natyrave të ndryshme, duke filluar nga shërbimet burokratike e gjer tek ato korruptive. Administrata publike këtu është mjaft e ngadaltë në kryerjen e shërbimeve. Për shembull, do të ishte një kob i madh për ndonjë qytetar, nëse do të bëhej fjalë për realizimin e ndonjë pune të caktuar në administratë publike, sepse që në hyrje të institucionit përkatës ballafaqohemi dhe përballemi me një sjellje mjaft joetike dhe flagrante nga ana e nëpunësit shtetëror, e të mos flasim se si na presin nëpër instancat më të larta. Shpeshherë mos pagimi i tatimeve dhe i kontributeve tjera vjen, edhe si rezultat i mosefikasitetit të administratës publike. Mjafton të përballesh me çështjet juridike gjyqësore dhe të shikosh se si kryhen detyrat dhe obligimet të cilat i përkasin qytetarit dhe gjykatës. Tek ne është krijuar një bindje dhe përshtypje fikse mjaft negative për ballafaqimin e qytetarit me administratën publike. Në këtë rast nuk kanë shpëtuar dot as universitet publike nga shërbimet mjaft burokratike, duke gjeneruar kështu një varg problemesh të natyrave të ndryshme në tërë institucionet shtetërore.

Pra, lloji tjetër i korrupsionit, i cili është në vazhdimësi i vendosur edhe nëpër administratën e universiteteve shtetërore dhe në ato private, është duke e penguar në mënyrë mjaft serioze elitën më vitale të shoqërisë, pra studentët. Porse në universitet private korrupsioni bëhet në mënyrë mjaft të kamufluar (moderne) dhe jo aq i vërejtur nga studentët dhe organet tjera përgjegjëse. Sepse siç dihet, konkurrenca nëpër universitet shtetërore është tejet e madhe, po ashtu duke qenë semestri mjaft i lirë krahasuar me universitet private, personeli përgjegjës për pranim të studentëve është i prirë për pranim të ryshfetit, mitos, dërgimit të ndonjë personi të njohur me ta dhe shumë metoda tjera. Dhe në fund të studimeve, për t'i kryer punët përfundimtare, (mbrojtjen e temës së diplomës), prapë në administratë pa dhënien e ryshfetit, mitos, do të ngelnin shumë mbrapa. Pra, siç po shihet edhe këtu në institucionet edukativo-arsimore kemi shkelje të normave ligjore.

Pra, administrata publike si njëra ndër instrumentet shtetërore më të rëndësishme nuk shpëtoi dot nga virusi kancerogjen, i ashtuquajtur korrupsion. Mungesa e parandalimit prej këtij virusi kancerogjen i ka bërë mjaft shtete të dyshimtë në ekzistimin dhe funksionalizimin e mëtutjeshëm. Burokracia nëpër administratë publike i ka bërë vendet mjaft të përshtatshme për përdorimin dhe rritjen e korrupsionit. Fatkeqësisht emri i institucionit të administratës shtetërore është i lidhur direkt me korrupsionin.

Pra, gjithherë kur të bëhet fjalë për administratën shtetërore në mënyrë spontane na kujtohet edhe korrupsioni, apo kur të bëjmë fjalë për korrupsionin në mënyrë spontane do të na kujtohet administrata publike. Kjo me të vërtetë është një fatkeqësi për shtetin dhe shoqërinë në përgjithësi. Sepse, siç dihet administrata publike është promotori i parë dhe realizuesja e ligjeve në praktikë, të cilët urdhërojnë parandalimin dhe luftimin e korrupsionit.

Rasti i korrupsionit në administratën publike i ngjan mjekut, i cili e kuron një sëmundje të caktuar, por qëllimisht mjeku harron se ai personalisht është i prekur nga kjo sëmundje, e cila është ngjitëse dhe kurimi në këtë rast do të ishte paradoksal dhe fatal për pacientët. Sepse, së pari do të duhej mjeku të shërohet, e tek pastaj t'i jepet e drejta mjekut për ta mjekuar ndokënd.

Faktorët ekonomiko-politik dhe cenimi i sigurisë në Ballkan

Prej kohësh, e deri në ditët e sotshme Ballkani ende vazhdon të mbetët si vatër e konflikteve të natyrave të ndryshme (ideologjike, ekonomike, politike, kushtetuese etj).

Në këtë pjesë të globit kanë mbisunduar rryma mendore të ndryshme, antagonizma politike, si dhe joformalitete ekonomike të pamëshirshme.

Shpeshherë jemi mësuar të dëgjojmë dhe shohim për Ballkanin si një zonë konsumuese të sigurisë. Në përgjithësi Ballkani, ka prodhuar aq shumë kriza dhe konflikte, saqë nuk ka qenë në gjendje as vet t'i konsumojë të gjitha, e po ashtu edhe në aspektin e eksportimit të krizave ka qenë mjaft i mangët dhe më pas në pamundësi të plasimit dhe asgjësimit është përballur me çrregullim total të tregut dhe politikës së brendshme. Është kjo trashëgimi e përvojës së vështirë nga fillimi i viteve nëntëdhjeta e deri në vitet e para të këtij shekulli: luftërat jugosllave, kriza në Shqipëri, konflikti i brendshëm në Maqedoni, si dhe krizat ekonomiko-politike të njëpasnjëshme në tërë territorin e Ballkanit.

Për çfarëdo lloj ngecje a regresi gjithmonë kanë ekzistuar dhe ekzistojnë faktorët apo aktorët e sjelljes së këtyre regreseve. Dihet mirëfilli se këta dy faktorë kanë role të rëndësishme, si për progres, ashtu edhe për regres. Meqë këta dy faktor prej kohësh janë përdorur dhe akoma përdoren fatkeqësisht për destabilitet, atëherë ne do t'i qasemi shtjellimit tonë vetëm nga ky kënd.

Jugosllavia në të kaluarën e largët mënyrën e jetesës në rajon nuk e zhvillonte mbi baza direkte të dhunës etnike.

Jugosllavia gjatë Luftës së Ftohte ishte një shtet shumetnik në të cilin popujt e grupeve të ndryshme etnike jetuan në paqe të plotë. Në bazë të kësaj mund të aludojmë se, përveç ndikimit të rrënjëve të vjetra të konfliktit, në copëtimin e Jugosllavisë ndikuan edhe rënia e bipolaritetit dhe kriza ekonomike që filloi të shfaqet në vitet e tetëdhjeta.

Aktualisht papunësia në Ballkan është jashtëzakonisht e lartë dhe po dëmton shanset e rajonit për stabilizim ekonomik. Kjo është si rezultat i së kaluarës së zymtë ekonomiko-politike. Këto probleme filluan me të madhe të shfaqen me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë. Ndarjes së federatave, ish-Jugosllavia u përgjigjej me dhunë duke e izoluar ekonominë e tyre, duke i vënë lloj-lloj sanksionesh ekonomike dhe më në fund nga përdorimi i sanksioneve të shumta ekonomike ndaj ish-federatave, pati fatin edhe vetë t`a shijojë një anarki totale ekonomike, politike dhe juridike, duke u përballuar me norma mjaft të larta të inflacionit, çka me të vërtetë ishte një dëmtim i tërë ekonomisë së ish- Jugosllavisë.

Proceset politike në këtë gadishull kanë qenë mjaft të dhembshme, mjaft diskriminues ndaj komuniteteve pakicë, është përdorur politikë pushtuese, siç ishte politika e ish-Jugosllavisë ndaj Kosovës, si dhe platformat politike në përgjithësi ishin kryesisht të mbështetura në interesat klanore- individuale. Dhe, si rrjedhojë e këtyre proceseve pasojat ende ndihen dhe praktikisht përjetohen.

Epërsia e posedimit të resurseve natyrore, disa vende në Ballkan i ka bërë më të favorshme dhe i ka vënë në shënjestër për pushtim (në të kaluarën) dhe për mos heqjen dorë nga pushtimi i provincave të caktuara. Njëri prej shumë faktorëve (duke mos e anashkaluar, edhe atë gjenocidial), se përse ish-Jugosllavia nuk hiqte dorë nga Kosova, ishte edhe resursi mjaft frytdhënës me xehe të plumbit dhe zinkut "Trepça" ku një kohë të gjatë qarqet jugosllave këtë burim natyror maksimalisht e shfrytëzonin për interesat e veta shtetërore. Çka ishte edhe më keq, se Kosova shërbente vetëm si vegël për të nxjerrë pasuri dhe investimi u

bënte, krejt diku tjetër, pra në Beograd, ndërsa një pjesë e të ardhurave shfrytëzoheshin për ushtri dhe armatim, për ta mbajtur Kosovën sa më shumë peng. Edhe pse Republika e Kosovës është e shquar për pasuri nëntokësore, ku rezervat e thëngjillit në Republikën e Kosovës vlerësohen të jenë 11 deri 15 miliardë tonelata. Pellgjet kryesore janë: pellgu i Kosovës, i Dukagjinit dhe i Drenicës[6].

Por, absurditeti qëndron në atë, se ky vend ka lëndën e parë të gatshme, pasuri të begatshme natyrore dhe ende ballafaqohet me problemet e rrymës! Në këtë rast destabilizimi i rajonit mund të vijë nga brenda, sepse populli fare mirë e di se shteti i tyre ka resurse natyrore dhe shfrytëzimi i tyre nuk bëhet. Disa thonë për arsye politike, disa thonë se këtë proces qëllimisht (vetëm ata e din pse) e kanë ndërprerë ndërkombëtarët, etj,. Sidoqoftë, Kosova në mosshfrytëzimin e kësaj begatie do të përballet me trazira sociale, dëmet e së cilës do të jenë fatale për ardhmërinë e vendit

Shqipëria ishte dhe është e pasur me resurse natyrore, ku dominuese janë resursi detar dhe nafta. Në të kaluarën burimet e naftës dhe të gazit në Shqipëri janë shfrytëzuar dhe gjer më vitin 1940 ka qenë i vetmi burim natyror që është shfrytëzuar. Por, më vonë mungesa e ideve (ndikimi i sistemit monist) dhe mosdashja e vendit për zhvillim të mëtutjeshëm e bëri të veten, e cila e la shumë mbrapa Shqipërinë. Izolimi 50 vjeçar i Shqipërisë nga regjimi komunist e bëri Shqipërinë vend mjaft të varfër me shfrytëzim zero të resurseve. Si rrjedhojë e kësaj mendësie më pas Shqipëria u përball me kriza të ndryshme, kriza të cilat ishin produkt i ekonomisë mjaft të dobët dhe joformale, si dhe mosshfrytëzimi i resurseve të cilët i posedon pa pasur nevojë që të pushtoj ndonjë vend tjetër dhe të sjellë trazira jashtë shtetit të vet. Por trazirat e 97-ës në Shqipëri ndodhën si rezultat i mungesës së

[6] Rifat Blakaj, "EKONOMI E RESURSEVE", Prishtinë, 2005 fq.

madhe për ushqim, nevojës së madhe për përparim. Dhe, disa firma fiktive të huaja në bashkëpunim me krerët vendas e shfrytëzuan maksimalisht këtë gjendje anarkie. Dhe, të gjorët shqiptarë, të mashtruar pas fitimit të madh dhe të shpejtë, pa djersë, i investuan shtëpitë e tyre (në formë të hipotekave) duke menduar se pas një kohe shumë të shkurtër prej një shtëpie, si shkëmbim do t'i bëjnë dy shtëpi. Ky ishte një mashtrim i qartë dhe për pasojë përjetuam trazirat e 97-ës, trazira që u shoqëruan me imazhin mjaft të keq para ndërkombëtarëve.

Maqedonia nuk është e shquar për ndonjë resurs të veçantë, siç ishte rasti me Shqipërinë dhe Kosovën. Në fakt Republika e Maqedonisë nuk ka dalje në det dhe ky është një limit gjeografik i saj[7]. Por, Maqedonia ka një epërsi mjaft të çmueshme. Posedon një tokë mjaft pjellore, ku mund të kultivohen me të madhe pemë dhe perime. Fatkeqësisht, edhe në këtë rast, duke qëndruar mbi begati bujqësore, kemi konflikte të cilat rrjedhin si pasojë e mosshfrytëzimit adekuat, apo e shfrytëzimit vetëm nga njëra anë të resurseve. Është i çuditshëm fakti se, duke i pasur resurset e gatshme, nuk bëhet fare përpjekje për shfrytëzim. Shtetet tjera eksploatimin e lëndës së parë, apo gjetjen e burimeve natyrore bujqësore e kërkojnë jashtë vendit të tyre, edhe atë në mënyrën më mizore të mundshme. Migracioni në Republikën e Maqedonisë është tejet i madh (sidomos i etnitetit shqiptar). Mungesa e subvencioneve për bujqësi, pasoi me një demoralizim të paparë, i cili demoralizim akoma po e përcjell etnitetin shqiptar. Me reformat bujqësore që janë bërë në Republikën e Maqedonisë rezultuan mjaft qartë anime teorike dhe praktike ndaj komunitetit maqedonas. Si dhe si pasojë e diskriminimit të shumanshëm politik, ekonomik dhe juridik, shpërtheu konflikti i armatosur i vitit 2001. Edhe këtu njëri prej shumë shkaqeve të shpërthimit ishte faktori ekonomiko-politik, sepse, sikur t'i jepej e drejta për punësim të barabartë, shfrytëzim të subvencioneve, si dhe

[7]Shaban Prevalla, revista "Universitas" Vjenë 2004 fq. 247

përfaqësim të drejtë, gjithë komuniteteve nëpër institucionet shtetërore, atëherë fare nuk do të bëhej as fjalë për konflikt, e të mos flasim për konflikt të armatosur.

Pra, ligji i shkakut dhe i pasojës, gjithmonë është i pakontestueshëm, sepse vet jeta reale, e përditshme është e pakontestueshme. Faktorët dhe ndikimet e shumtë, janë prognozues për një situatë të caktuar. Një situatë që të jetë e mirë, është kusht që ndikimet për një fenomen të caktuar të jenë pozitive. Nëse e pranojmë maksimën, "ta ndërtojmë të ardhmen duke mos e harruar të kaluarën" atëherë, Ballkani gjendet ndërmjet dy alternativave, njëra pozitive dhe tjetra negative: Pozitivja është, që të mësojmë nga e kaluara e hidhur, t'i shikojmë pasojat nga veprimtaria e kaluar dhe të merret mësim që këto vendime të mos i përsërisim, sepse ato vendime e sollën Ballkanin në gjendjen e mjerueshme të sotshme. Dhe, e dyta, negativja është se nëse shikojmë nga e kaluara, atëherë pa dashje do të rigjallërohet urrejtja ndaj okupatorëve dhe do të dëmtohet sendërtimi i vlerave të përbashkëta progresive për të ardhmen. Pra, nga kjo del se është më mirë të imponohet tërësisht një rregull apo maksimë e re që do të ishte e përbashkët për të dyja. Formula e përbashkët do të ishte "faktorët ekonomikë duhet përdorur për atë qëllim, për të cilin janë të krijuar" Pra, begatitë natyrore t'i përdorim për mirëqenien e kushteve për jetë, eliminimin e kushteve të rënda sociale, sepse kjo tokë në të cilën jetojmë është e mbushur me pasuri natyrore të shumta dhe të shumëllojta, e kjo mund të arrihet vetëm me anë të politikave të drejta, jodiskriminuese ndaj komuniteteve që jetojnë në këtë glob tokësor. Sepse, me të vërtet është paradoksale që faktorët ekonomiko-politik të përdoren për mbrapsht, e që deri më tani në vendet Ballanike përdorimi i tyre ka qenë i tillë, për regres, për gjenerim të krizave, trazirave dhe të konflikteve lokale.

Republika e Maqedonisë, prej krizës në kriza

Alarmimi për përfshirjen e Maqedonisë në krizë, nuk na habiti dhe brengosi edhe aq shumë. Ajo çka na habiti dhe njëkohësisht që na gëzoi në këtë rast, ishte se, ne qytetarët e Republikës së Maqedonisë u njoftuam për herë të parë zyrtarisht nga organet më të larta shtetërore për një krizë financiare në Maqedoni. Sepse, fare mirë prej kohësh, apo thënë më mirë prej formimit të saj si shtet e dinim dhe e përjetuam krizën ekonomike-sociale që ishte dhe është prezente, na përcjell në çdo hap të jetës sonë. Sa bukur, të paktën e paskemi një fenomen abstrakt dhe real që po na përcjellka në çdo cep të jetës sonë!

Pra, në Republikën e Maqedonisë nuk është diçka e re kriza, nuk do habitemi sikur popullsia e vendeve të zhvilluara për kaplimin dhe zhytjen e vendeve të tyre në një krizë financiare globale (për ata kjo është një risi). Në deklaratat e mëhershme në lidhje me krizën financiare globale krerët politik të Republikës së Maqedonisë, me gjakftohtësi na rehabilitonin se ky shtet nuk do të jetë i prekur nga kriza financiare, sepse nuk është i integruar në sistemet e huaja financiare dhe bankare. Ne qytetarët e këtij shteti menduam dhe ramë në dilemë, se vallë Republika e Maqedonisë është pjesë e globit, apo është një shtet jashtë globit dhe qytetarët e saj janë jashtëtokësorë. Pse ne menduam kështu? Ne menduam kështu sepse, fare mirë e dinim se edhe ky shtet gjeografikisht është pjesë e këtij nënqielli. Është e pamundur të mos jetë e prekur Maqedonia prej ndryshimeve që rrjedhin në këtë rruzull tokësorë, aq më pak kur kemi ndryshime negative ndërkombëtare. Si për shembull, terrorizmi, ngrohja globale dhe kriza financiare.

Pra, Republika e Maqedonisë si pjesë e këtij globi tokësor tash së fundi është prekur seriozisht nga kjo krizë globale financiare. Një gjë të tillë edhe Presidenti i Maqedonisë, Branko Cërvenkovski e shprehu në samitin ekonomik të Ohrit, ku e vuri theksin e veçantë tek vështirësitë e Maqedonisë. Me këtë rast ai u shpreh: "Gjendja në ekonominë vendore është shqetësuese, sektori real ekonomik në Maqedoni tashmë po i ndjen pasojat negative nga kriza financiare botërore. Më të goditur janë sektorët e eksportit, metalurgjia, ndërtimtaria dhe industria e tekstilit. Rezultati është negativ dhe eksporti po zvogëlohet". Sasia apo përqindja e eksportit në një shtet është njëri prej indikatorëve sinjalizues se një shtet i përket ekonomisë së fortë, apo ekonomisë së dobët. Maqedonia në masë të madhe është e varur nga importet, i cili veprim nuk është i dëshirueshëm për bilancin pozitiv të buxhetit, sepse duke importuar në sasi të mëdha produkte nga jashtë, atëherë buxheti ka gjasa reale të bjerë dhe mbetet në deficit. E dihet mirëfilli se deficiti në buxhet në një kohë afatgjate do të thotë shkatërrim për ekonominë vendore apo kombëtare. **Tregu i Republikës së Maqedonisë, edhe pak ato eksporte çka i ka pasur, tash, në kohën e krizës financiare botërore ka gjasa t'i humbas. Pastaj e tërë ekonomia e Maqedonisë detyrimisht do të mbështetet në importe.**

Meqë kjo krizë në vendin tonë është si rrjedhojë e rënies ekonomike botërore, atëherë edhe mbështetja në importim të produkteve nuk është edhe aq e sigurtë. Sepse nga një sëmundje e tillë, aktualisht po vuajnë edhe vendet më të zhvilluara të botës (kjo është sikur një i verbër të kërkojë sy nga një i verbër tjetër). Përballimi dhe eliminimi i këtij shteti me pasojat që rrodhën nga kjo krizë, do të jenë shumë të vështira për tejkalim të suksesshëm dhe të lehtë, duke i marrë për bazë kapacitetet dhe mekanizmat zgjidhës jo aq të forta, për të mos thënë mjaft të dobëta. Edhe ndihma që u nda nga Qeveria e Maqedonisë për përballje më të lehtë me krizën financiare dhe recesionin në kuadër të parandalimit në vlerë prej 330 milion euro për katër vitet e ardhshme, si

duket nuk do të jetë e mjaftueshme për shpëtimin e ekonomisë kombëtare. Mirë bëri që Qeveria shpalli pakon prej 10 pikash për t'i ndihmuar sektorët real që ta marrin vetën apo të paktën të përdorin masa parandaluese gjatë këtyre katër viteve. Por, ana tjetër e medaljes jo aq e mirë është se Qeveria në këtë rast bëri një kosto oportune në buxhet. Pra, në vend së Qeveria të investojë në diçka frytdhënëse/progresive, ajo u detyrua të lëshojë mjete financiare për t`u mbrojtur nga kriza, e cila edhe më parë ishte në krizë. Në kohën, kur të gjithë po prisnim të ndodhë diçka progresive në këtë shtet, njoftohemi me të kundërtën e saj. A thua është fat i këtij shteti, që asnjëherë në jetën e tij të mos e shoh gjallërimin e vet, qoftë të paktën edhe njëherë në jetë. **Maqedonia, aktualisht i ngjan njeriut të sëmurë, të cilin e kanë vërshuar të gjitha sëmundjet, e që kurimi i sëmundjeve prej fillimit mbështetej në barna të shtrenjta dhe papritmas e sheh vetën dhe të tjerët se më, nuk ka mjete financiare për të blerë barna.** Paraprakisht e kemi idenë se si do të shkojë puna tutje me këtë njeri! Në këtë rast manifestimi i një krize tjetër ndaj opinionit të gjerë dhe të gjorë, do të jetë një transferim i vëmendjes në një krizë të re. Kjo në aspektin psikologjik ndoshta do të jetë mirë, sepse të paktën në një periudhë të shkurtër kohore, nuk do flitej për krizën e identitetit maqedonas, analizat për pasojat e mospranimit në NATO, si dhe për diskriminimin e shqiptarëve (i cili diskriminim fatkeqësisht ende vazhdon të jetë permanent).

Papunësia në këtë kohë krize do të jetë e "arsyeshme" nga shteti. Edhe ata të papunët në këtë kohë nuk do ta ngushtojnë shtetin për një gjë të tillë.

Sidoqoftë, Republika e Maqedonisë përskaj mallëngjimit të saj do të ndjehet edhe e gëzuar, sepse të paktën një herë në historinë e saj është e lidhur direkt me zhvillimet dhe proceset ndërkombëtare.

Mjetet e luftës ekonomike

Duke qenë se instrumentet ekonomike të veprimit janë shumë të rëndësishme, që në kohët e lashta ato janë përdorur për të penguar palën kundërshtare në zhvillimin e vet. Lidhur me këtë çështje Clausevitz shprehej: **"Në qoftë se dëshirohet të arrihet fitorja në fushën e betejës, kundërshtari së pari duhet të çarmatoset në kohë paqeje me anë të diplomacisë dhe tregtisë"**[8]. Pra, nga kjo thënie, mund të konstatojmë se, si në të kaluarën ashtu edhe në të tashmen luftë mjaft efikase dhe me rezultate dobiprurëse për shoqërinë në përgjithësi, është lufta ekonomike, pushtimi i tregjeve me anë të produkteve cilësore, si dhe konkurrenca jolojale nga jashtë (në rast dëmtimi të qëllimshëm të shtetit tjetër). Vendet në zhvillim siç janë vendet Ballkanike, të cilët në masë të madhe janë të varura nga tregjet Evropiane dhe Amerikane dhe më pastaj kjo varshmëri ka ndikim edhe në vendimmarrjet politike, duke qenë vendimet në favor të shteteve zhvillimore. Sepse i mjafton shteteve të Ballkanit një embargo nga jashtë dhe kjo do të cilësohej si një bombë atomike për vendet në zhvillim.

Po ashtu edhe shtetet brenda Ballkanit bëjnë kësi lloj kalkulimesh, si p.sh, Kosova me rastin e pavarësimit, me automatizëm u kërcënua me embargo nga Serbia. Kjo ishte edhe një dobësi e radhës e ekonomisë kosovare, sepse në pamundësi të stimulimit të prodhimit të brendshëm u desh që furnizimin me produkte ta kërkojë nga një shtet, i cili deri dje, apo edhe sot ishte

[8] Clausevitz, cituar sipas: N.J Pedelford, G.Lincol, The Dynamic…,v.cit., fq.370

dhe është armiku i hapur dhe i përbetuar. Ana tjetër e medaljes shpresëdhënëse është se kjo formë e luftës nuk është edhe aq e rrezikshme krahasuar me luftërat botërore, nukleare, sepse kjo propagandë mbështetet në interesa të përkohshme, apo thënë më mirë bëhet tentim i arritjes së një qëllimi të caktuar politik. Po ashtu kjo luftë është një shtytës përpara drejt progresit ekonomik, një mënyrë që të iket nga varshmëria ekonomike, sepse më pas përballja me pasojat dhe direktivat e shtetit tjetër do të jenë të rënda për t'i përballuar.

Në këtë mënyrë lufta mund të shihet si mënyrë për të gjetur tregje të reja, burime dhe pasuri[9]. Pra, në kohërat e informatizimit kjo luftë në njëfarë mënyre është e mirëseardhur (e kam fjalën, më e mirë krahasuar me luftërat e armatosura, frontale, guerile, etj).

Ngase, mund të sjellë më shumë produktivitet, angazhim më të madh, miratim të politikave monetare dhe fiskale në mënyrë të saktë, me kohë dhe të zbatueshme në praktikë. Në këtë rast mund të themi se faktori ekonomik është një indikator shuarës i konflikteve, por përballë këtij faktori qëndron edhe ai politik, i cili në këtë rast është kundërthënës më atë ekonomik. Sepse nëse një shtet i ka pushtuar tregjet vendase dhe të huaja, ai shtet është i prirë që nëpërmjet politikës qëllimisht dhe gjatë t'i mbajë të varur, duke përdorur politika diskriminuese ndaj shteteve në zhvillim. Dhe për pasojë kjo mund të irritojë institucionet dhe popullin e shtetit të varur, e që më pastaj mund të përfundojë me trazira. Mjafton t`a përmendim rastin e Maqedonisë dhe të ish-Jugosllavisë ndaj etnitetit shqiptar dhe etniteteve tjera që jetonin nën ombrellën Jugosllave. Prej vitit 1912 deri në vitin 1998 ish-Jugosllavia kishte pushtet "absolut" ndaj etniteteve që jetonin në këtë shtet. **Por, diskriminimi ekonomiko-politik arriti në fazën hiper-diskriminuese dhe popullata përballë kushteve sociale mjaft të**

[9] Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, "Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike, Prishtinë, 2008 fq.115

vështira u detyrua gjer në fund të përdorë edhe mjete ushtarake, që të ndahej nga ky shtet, që të mirat ekonomike i mbante vetëm për popullin e vet, ku në Kosovë-Trepçë bëheshte eksploatimi i resurseve, ndërsa të mirat e begative të truallit shqiptarë i shijonte dhe i korrte Beogradi, dhe në tërësi të gjithë banorët e ish Jugosllavisë, përpos shqiptarëve. Si dhe rasti në Republikën e Maqedonisë, ku përfaqësimi i shqiptarëve në çdo institucion ishte simbolik për të mos thënë fare. Shkaqet e konflikteve ishin të qarta dhe të parashikueshme. Fenomeni i destabilizimit ishte ekonomiko-politik dhe përfundimi i këtyre aktorëve, pa dyshim ishte dhe do të jetë gjithmonë për çdo kënd fatal. Pa marrë parasysh problemet politike, ndërlidhja e fortë ekonomike e vendeve të Ballkanit do të ishte në dobi të këtyre vendeve veç e veç, si dhe të rajonit në përgjithësi, gjë që pa mëdyshje do të ndikon në uljen e tensioneve.

Dihet mirëfilli se kushtet e vështira sociale janë gjeneruese të krizave të natyrave të ndryshme dhe me përmasa të paparashikueshme dhe si një ndihmesë na paraqitet themelimi i politikave ekonomike, që çojnë drejt integrimit ekonomik dhe shkëmbimit ekonomik me vendet tjera të zhvilluara.

Pra, begatitë natyrore duhet përdorur për mirëqenien e kushteve për jetë, eliminimin e kushteve të rënda sociale, sepse kjo tokë në të cilën jetojmë është e mbushur me pasuri natyrore të shumta dhe të shumëllojta, e kjo mund të arrihet vetëm me anë të politikave të drejta, jo diskriminuese ndaj komuniteteve që jetojnë në këtë glob tokësor. Sepse, me të vërtet është paradoksale që faktorët ekonomiko-politik të përdoren për mbrapsht, e që deri më tani në vendet Ballanike përdorimi i tyre ka qenë i tillë, për regres, për gjenerim të krizave, trazirave dhe të konflikteve lokale, rajonale e deri te ato botërore.

Neomerkantilizmi dhe investimofobia në Maqedoni

Synimi i shumicës së njerëzve është që me sjelljet e tyre të krijojnë përshtypje ndaj të tjerëve si njerëz të mirë, dhe të besueshëm. Kjo bëhet me qëllim të ikjes dhe parandalimit të shfaqjes së fobisë ndaj tyre. Sepse, lirshëm mund të themi se përshtypja e ndonjë vendi, ndaj ndonjë vendi tjetër, është gjenerator absolut i sukseseve apo i mossukseseve për të ardhmen.

Politikat shtetërorë kanë për qëllim rregullimin, nxitjen, drejtimin, gjetjen e alternativave dhe mbrojtjen e veprimtarisë kombëtare. Ushtrimi dhe legjitimiteti i këtyre politikave, bëhet i mundur dhe mbështetet në sovranitetin kombëtarë. Kjo bëhet me qëllim që të mbrohen qytetarët, të ruhen nga çdo lloj manipulimit që mund të vij nga jashtë. Me këtë lloj mbrojtje nuk është për qëllim mbrojtja absolute e qytetarëve nga importet dhe investimet e jashtme. Sepse, ka ikur viti 1800, ku modelet e tregtisë ishin kryesisht rezultat i filozofisë ekonomiko-politike, të njohura me emrin merkantilizëm. Sipas kësaj teorie, fuqia dhe pasuria e kombeve varet nga thesari që ato janë në gjendje të grumbullojnë, vetëm brenda vendit të tyre. Objektivi merkantilist është maksimizimi i suficitit tregtar, pra nxitja dhe stimulimi i eksportit, izolimi i vendit nga investimet e jashtme, akumulimi dhe investimi i mjeteve brenda vendit, etj. Edhe pse për një kohë të gjatë kjo teori ishte në funksion të shteteve që e pëlqenin izolimin dhe mbështetjen ekonomike vetëm në forcat shtetërore, erdhi koha kur perëndoi edhe ky sistem. Por fatkeqësia tjetër, është se disa shtete në shekullin XXI, tentojnë t`a përdorin një sistem të tillë, tashmë me emrin neomerkantilizëm. Ndoshta këtë përdorim dhe jetësim të

këtij sistemi e bëjnë pa dijeninë e tyre, por ne nga këndvështrimi tjetër po e shohim se kemi të bëjmë me një zhvillim të politikës ekonomike neomerkantiliste (kuptohet me ca ndryshime të cilat detyrimisht i përkasin kohës dhe kushteve moderne), edhe atë në një vend demokratik, i cilësuar si oazë e paqes, emri i të cilit përkohësisht është Maqedoni. Edhe nëse kjo teori do të ishte e suksesshme, prapë Maqedonia do të ngecte, sepse vizioni i politikave zhvillimore ekonomike në këtë shtet, përbëhet nga një konglomerat sistemesh. Në këtë vend, të gjitha teoritë e tregtisë janë prezente. Duke filluar prej këmbimit mall me mall (ju shitni qumësht, pastaj nga qumështorja merrni djathë), neomerkantilizmit, teorisë klasike të tregtisë, teorisë së liberalizmit, si dhe teorisë së globalizmit, por të gjitha këto sisteme, rrumbullakohen me sistemin e ashtuquajtur miksmerkantilizëm.

Nëse e analizojmë nga këndi joqeveritar kursin ekonomik të këtij shteti, mund të vijmë në përfundim se ministritë përgjegjëse për zhvillimin ekonomik, dukshëm kanë problem me përcaktimin e modelit të përdorimit, për zhvillim të mëtutjeshëm. Sa i përket kësaj çështje, qeveria na paraqitet me shumë fytyra. Para mediumeve e përkrah modelin liberal të funksionimit, në praktikë modelin merkantilist, në penalizime modelin sovjetik, ndërsa sa u përket përdorimit të shkollave të mendimit gjendet në polemikë, e në kundërthënie të vazhdueshme, ndërmjet shkollës neoklasike dhe kejnesiane.

Detyra e Qeverisë dhe ministrive është që të krijojnë klimë të përshtatshme për zhvillim të tregtisë dhe të ofrojnë lehtësime të mëdha për investime të jashtme, por ja që fatkeqësisht dhe qëllimisht Qeveria dhe organet kompetente një gjë të tillë nuk janë duke e bërë.

Edhe në kohën e merkantilizmit, një shumë (zakonisht ar) e (i) tubuar nga veprimtaria ekonomike brendashtetërore, ka qenë e dedikuar në idealizimin e heronjve, të cilët me përkushtimin më të madh të mundshëm, e kishin dhënë jetën duke e mbrojtur sistemin në fjalë, ndaj atyre që pretendonin të vijnë nga jashtë për të

eksploatuar. Diçka prej atyre vendeve përdorte një politikë shfarosëse, si dhe për dallim prej sistemit ekonomik të Maqedonisë, ata e stimulonin në maksimum eksportin. **Dy kompanitë mjaft të mëdha, SWEDMILK dhe EVN dëshmuan praktikisht dhe para organeve të drejtësisë ndërkombëtare se, Maqedonia është një vend mjaft i papërshtatshëm për investime direkte të huaja, e të mos flasim për investime portofol.** Ky lloj i arrogancës së Qeverisë ndaj kompanive të huaja, bëhet me qëllim, sepse kryeministri dhe ministrat pasojat nga të qenit pa investitorë të jashtëm dhe krijim të fobisë ndaj të tjerëve, i dinë shumë më mirë se ne. Ata ndonëse e kanë harruar, se shteti pa investime nga jashtë, asnjëherë nuk mund t`a shohë dritën e gjallërimit, shtet pa investime nga jashtë, do të thotë; anarki totale në të gjitha segmentet institucionale, subvencionet do t`a humbasin rrugën për tek ai shtet, si dhe në vazhdimësi vendi në fjalë, të vetmen epërsi që do t`a ketë, është prodhimi i krizave dhe i konflikteve. Qeveria me moskrijim të klimës së përshtatshme për investime të jashtme, është duke e treguar më në fund fytyrën dhe orientimin e saj të vërtetë. Nuk është edhe aq humbje e madhe, përzërja dhe padija e këtyre dy kompanive, sa është i madh dëmi në krijimin e imazhit të përgjithshëm shtetëror. Ky shtet, apo thënë më mirë, kjo lagje mjaftë e vogël ***e Kinës***, detyrimisht dhe përfundimisht e ka zgjedhur rrugën e vet të izolimit dhe vetëshkatërrimit. Kokëfortësia në mosndryshimin e emrit pavarësisht çmimit, si dhe tash së fundi tentimi dhe penalizimi i dy kompanive mjaft të mëdha dhe frytdhënëse për këtë shtet, e ka vënë Maqedoninë në dilemën hamletiane; të jesh, apo të mos jesh. Pas këtyre skandaleve, vallë Maqedonia do të ketë fytyrë të kërkojë investitorë të jashtëm, do të ketë fytyrë të kërkojë anëtarësimin në UE, duke i dëbuar nga vendi i tij kompanitë që vijnë, po nga UE-ja! Pra, ky shtet veç më e ka krijuar investimofobinë! Kurimi i kësaj sëmundje bëhet vetëm atëherë kur të vdesë pacienti, sepse ilaç për frikë nuk kemi, bile as që do të kemi ndonjëherë. Republika e Maqedonisë në vend që të shuaj probleme, ajo po pjell probleme, edhe atë, këtë

pjellje në mungesë të demit po e bënë nëpërmjet të veterinerit. E, pra, tash ju e keni të qartë se kush është demi, e kush veterineri!?

Ndikimi i faktorëve ekonomik dhe politik në destabilizimin e Ballkanit

Prej kohësh Ballkani është dhe vazhdon të mbetët si vatër konfliktesh të natyrave të ndryshme. Në këtë pjesë të globit kanë mbisunduar rryma mendore të ndryshme, antagonizma politike, si dhe joformalitete ekonomike të pamëshirshme. Shpeshherë jemi mësuar të dëgjojmë dhe t`a shohim Ballkanin si një zonë konsumuese të sigurisë. Në përgjithësi, Ballkani ka prodhuar aq shumë kriza dhe konflikte sa që nuk ka qenë në gjendje as vet të gjitha t'i konsumojë, po ashtu edhe në aspektin e eksportimit të krizave ka qenë mjaft i mangët, dhe më pas në pamundësi të plasimit dhe asgjësimit të krizave është përballur me çrregullim total të tregut dhe politikës së brendshme. **Është kjo trashëgimi e përvojës së vështirë nga fillimi i viteve nëntëdhjeta e deri në vitet e para të këtij shekulli: luftërat jugosllave, kriza në Shqipëri, konflikti i brendshëm në Maqedoni, si dhe krizat ekonomiko-politike të njëpasnjëshme në tërë territorin e Ballkanit.** Duke e ditur rëndësinë e kësaj teme, si dhe problemet me të cilat do të ballafaqohet familja e madhe e UE-së në rast mosintervenimi për përmirësimin e gjendjes faktike dhe gjeneruese të mëtutjeshme të krizave, atëherë ne në kuadër të këtij studimi do e shtjellojmë këtë fenomen dhe problematikë mjaft ndikuese dhe jetike për të tashmen dhe të ardhmen e këtyre vendeve, që akoma vazhdojnë të jenë jashtë Unionit Evropian. Po ashtu në këtë studim do t'i paraqesim, edhe faktorët e kësaj gjendje kaotike, edhe atë duke përdorur metoda të ndryshme për të ardhur deri te një studim i frytshëm. Për çfarëdo lloj ngecje a regresi gjithmonë kanë

ekzistuar dhe ekzistojnë faktorët, apo aktorët e sjelljes së këtyre regreseve. Pra, shtjellimi ynë do të mbështetet vetëm në dy faktorë mjaft të rendësishëm, në atë ekonomik dhe politik. Dihet mirëfilli se këta dy faktorë kanë role të rëndësishme, si për progres, ashtu edhe për regres. Meqë këta dy faktorë prej kohësh janë përdorur dhe akoma përdoren fatkeqësisht për destabilitet, atëherë ne do t'i qasemi shtjellimit tonë vetëm nga ky kënd.

1.1. PROCESET EKONOMIKE DHE POLITIKE NË BALLKAN

Gadishulli Ballkanik është një gadishull në Evropën juglindore, i cili kufizohet në lindje me Detin e Zi dhe Egje, në jug me Detin Mesdhe dhe në perëndim me Detin Adriatik dhe Jon[10] .

Jugosllavia në të kaluarën e largët mënyrën e jetesës në rajon nuk e zhvillonte mbi baza direkte të dhunës etnike. Jugosllavia gjate Luftës së Ftohte ishte një shtet shumetnik dhe multinacional në të cilin popujt, e grupeve të ndryshme etnike jetuan në paqe të plote. Kjo na çon në prodhimin e argumenteve se, përveç ndikimit të rrënjëve të vjetra të konfliktit, në copëtimin e Jugosllavisë ndikuan edhe rënia e bipolaritetit dhe kriza ekonomike që filloi të shfaqet në vitin1980.

Me rënien e bipolaritetit, ish-komunistët kërkuan mbështetje duke i bërë thirrje nacionalizmit. Ata e panë nacionalizmin si një mundësi për të mbajtur pushtetin politik nën rregullat e reja që kërkonin zgjedhje pluraliste konkurruese. Krizat ekonomike krijuan një terren "të shëndoshë" për zgjimin dhe fuqizimin e nacionalizmit. Aktualisht papunësia në Ballkan është jashtëzakonisht e lartë dhe po i dëmton shanset e rajonit për stabilizim ekonomik. Kjo është si rezultat i së kaluarës së zymtë ekonomiko-politike. Këto probleme filluan me të madhe të shfaqen menjëherë pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Ndarjes së shteteve federative,

[10] Gazeta lajm, e enjte 05. qershor, 2008, fq. 14

Jugosllavia u përgjigjej me dhunë duke e izoluar ekonominë e tyre, duke i vënë lloj-lloj sanksionesh ekonomike dhe më në fund, duke përdorur sanksione të shumta ekonomike ndaj ish-federatave, pati fatin edhe vet ta shijoj një anarki totale ekonomike, politike dhe juridike duke u përballuar me norma mjaft të larta të inflacionit, çka me të vërtet ishte një dëmtim i tërë ekonomisë së ish-Jugosllavisë. Proceset politike në këtë gadishull kanë qenë mjaft të dhimbshme, mjaft diskriminuese. Ndaj komuniteteve pakicë është përdorur politika pushtuese, sikurse siç ishte politika e ish-Jugosllavisë ndaj Kosovës, si dhe platformat politike në përgjithësi ishin kryesisht të mbështetura në interesat klanore individuale. Dhe si rrjedhojë e këtyre proceseve pasojat ende po ndihen dhe praktikisht po përjetohen! Deri sa historia në shumë rajone dhe vende të botës mund, edhe të mos ndryshojë me shekuj të tërë, kjo nuk mund të thuhet edhe për Ballkanin. Me pozitën e vet gjeografike, atë kulturore, demografike dhe politike, e pse jo edhe atë strategjike Ballkani gati çdo gjysmë shekulli i ngjan një vullkani aktiv, i cili herë pas here befason me fuqinë përvëluese të llavës së vet. Edhe pse të gjithë tani më janë të njohur me ketë fenomen, prapë se prapë nuk mund të ndryshojnë rrjedhat, mbase për ballkanasit edhe mund të ekzistojë dëshira për këtë, por kjo nuk mund të thuhet edhe për të tjerët jashtë Ballkanit (të paktën në të kaluarën).

Pas shpërbërjes së Traktatit të Varshavës në vitet e nëntëdhjeta dhe përhapjes së demokracisë si rend politiko-shoqëror në lindje, edhe Ballkanit i erdhi radha që të ballafaqohet me sfida të reja. Nën ombrellën e rendit të ri botëror, të një bote njëpolare, Ballkani u bë një terren i përshtatshëm për ballafaqime të ndryshme të qendrave të vendosjes në botë. Në ketë konstelacion edhe ekzistenca e Jugosllavisë, si një shtet i formuar për baraspeshë në mes të blloqeve, ishte pa ndonjë rëndësi të madhe. Se sa i brishtë ishte ky shtet dhe se sa i paqëndrueshëm ishte i tërë Ballkani, më së miri është parë në rastin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë. Si pasojë, kjo paqëndrueshmëri pati edhe reflektime

në tërë botën, ku me të madhe filloi gara në mes të shteteve të fuqishme për të ndikuar apo kontrolluar këtë pjesë të botës[11]. Roli i fuqive të mëdha politike në ndikimin e proceseve politike ishte tejet i madh. Kjo pa dyshim ishte e mbështetur në interesat e shteteve në aspektin strategjik. Synimi i fuqive të mëdha ishte izolimi i Bashkimit Sovjetik me mjete graduale politike. Me një varg trazirash Ballkani u shoqërua gjatë viteve, të cilat ishin si rrjedhojë e proceseve politike dhe me një vendimmarrje të papër-gjegjshme. Me shpërbërjen e ish-Jugosllavisë filloi dalja në shesh, e të gjithë atyre veprimeve politike të favorshme për shtetin e quajtur "Jugosllavi" dhe të disfavorshme për ish- federatat e tjera. Në fillim të vitit 1991, shpallja e pavarësisë së dy republikave, Sllovenisë dhe Kroacisë ishte një shenjë paralajmëruese për fillimin e një konflikti të përgjakshëm në lidhje me çështjen se si do të ripërcaktoheshin kufijtë e Jugosllavisë. Kaosi në tokat dhe popujt që dikur njiheshin si Jugosllavi ekspozoi evidenca shokuese deri në ato përmasa sa që evropianët shpresonin se ajo që po ndodhte ishte vetëm një iluzion. Eksperimenti i shumë kulturave dhe shumë kombeve nuk ishte thjesht një dështim. Më pas, me rënien e bipolaritetit, ish-komunistët kërkuan mbështetje duke i bërë thirrje nacionalizmit. Ata e panë nacionalizmin si një mundësi për të mbajtur pushtetin politik nën rregullat e reja që kërkonin zgjedhje pluraliste konkurruese.

1.2. Rënia ekonomike dhe nacionalizmi

Shkalla e papunësisë vitet e fundit ka qëndruar në mënyrë të vazhdueshme në rreth 40 % në Bosnjë-Hercegovinë, ndërmjet 30 dhe 32 % në Serbi dhe Maqedoni, ndërmjet 16 dhe 18 % dhe madje më e lartë në Shqipëri, Bullgari dhe Kroaci. Në Kosovë, kjo shkallë ka shumë të ngjarë të ketë shkuar në mënyrë të

[11]Revista, "Drejtësia", e martë 10.prill. 2007 fq.11

konsiderueshme përtej nivelit të ndeshur (Nga Daniel Daianu për Balkan Times në Bukuresht - 24/08/06). Kategorizimi i vendeve Ballkanike bazuar në pikat e përbashkëta të modeleve ekonomike të zhvillimit gjatë Luftës së Ftohte, i ndan ato në dy grupe: Së pari, Shqipëria, Bullgaria dhe Rumania. Gjatë Luftës së Ftohtë, këto vende udhëhiqeshin nga diktatura të ashpra dhe me një ekonomi shume të centralizuar. Kjo do të thotë se elita intelektuale kishte mungesë të njohurive për funksionimin e ekonomisë së tregut. Shteti si përfaqësues i interesave të përbashkëta ishte i dobët, ndërkohë që strukturat ekonomike ishin të paqarta.

Dhe së dyti, ish-Jugosllavia, një vend socialist, që devijoi dhe u përpoq të zbatojë një model të ndryshëm ekonomik. Ky model konsistonte në të ashtuquajturën ekonomi socialiste (market socialism), e mbështetur në vet administrimin e kapitaleve prej punëtorëve. Ky model nuk funksionoi mirë, pasi ai ishte bazuar në koalicionin midis ndërmarrjeve dhe autoriteteve të cilat shpesh ndanin të njëjtat interesa. Për pasojë, ky model pengoi prirjet konkurruese midis ndërmarrjeve. Në rastet e Bullgarisë, Shqipërisë dhe Rumanisë, me rënien e komunizmit në fund të viteve 1990, krizat ekonomike u manifestuan nëpërmjet rënies së treguesve kryesore makroekonomikë. Këto ishin rrjedhojat e një procesi të thellë transformimi shoqëror, ekonomik dhe politik që shprehin fenomenin e tranzicionit. Padyshim ekziston një shumëllojshmëri e madhe kushtesh në tregjet e punës të vendeve, të treguar nga gama e shkallës së papunësisë. Por, një fakt është i padiskutueshëm, intensiteti i fenomenit është mjaft i pazakontë sipas standardeve Evropiane. Shkalla jashtëzakonisht e lartë e papunësisë mund të shndërrojë dinamikën sociale dhe ekonomike në mënyra kryeneçe, të cilat mund të pengojnë punën e vendeve të Ballkanit për të pasur zhvillim ekonomik të qëndrueshëm. Papunësia mjaft e lartë zhvleftëson shkallën e lartë të njohurisë dhe nivelet e larta të arsimimit të këtyre vendeve. Nëse ulet papunësia, këta faktorë do t'u lejojnë këtyre vendeve të kërkojnë zhvillimin e shpejtë ekonomik, për shkak të shfaqjes së ekonomisë bazuar mbi njohurinë.

Përveç kësaj, shkalla e papunësisë shkakton konflikte sociale, duke shtuar prirjen e disa individëve dhe grupeve për t'u përfshirë në veprimtari të paligjshme dhe kriminale dhe favorizon përhapjen e kërcënimeve jo të zakonshme. Papunësia nuk mund të ulet duke inkuadruar punëtorë nëpër shërbimet joprofitabile, siç janë: shkollat, administrata shtetërore, kazermat ushtarake, institucionet sportive etj., edhe pse kjo është pjesë e pandashme e zhvillimit. Papunësia dukshëm mund të ulet kur në një shtet fillon të funksionojë prodhimi. Fillimi i eksportimit të produkteve vendore edhe jashtë. Shumë i janë drejtuar ekonomisë së fshehtë (ato sipërmarrje që i shmangen pagimit të taksave), gjë që jo domosdoshmërish është e përfshirë në veprimtari shoqërisht të rrezikshme; ekonomia e fshehtë në fund të fundit ndihmon që njerëzit të sigurojnë jetesën.

Megjithatë, të ardhurat e ulëta nga taksat dëmtojnë aftësinë e shtetit për të siguruar të mira publike, gjë që dëmton më tej strukturën shoqërore dhe stabilitetin e përgjithshëm. Trajtimi i shkallës së lartë të papunësisë nuk është i thjeshtë. Ekonomitë e Ballkanit duhet të jenë në gjendje të zhvillohen mbi një bazë të qëndrueshme dhe receta për zhvillimin e shpejtë nuk është menjëherë e disponueshme. Ka nevojë për shumë më tepër: rregulla të qarta të lojës, imponimi i ligjeve dhe rregulloreve, imponimi i të drejtave të pronësisë dhe më pak burokraci e harmonizuar me aftësinë e shtetit për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve. Ekonomitë vendore gjithashtu do të kenë nevojë për vërshim të madh të kapitalit nga jashtë, veçanërisht investimet e drejtpërdrejta të huaja, të cilat duhet të krijojnë vende të reja pune. Marrëveshjet e Stabilizimit dhe Asocimit, të cilat janë nënshkruar nga shumica e vendeve të Ballkanit me BE-në, si dhe Pakti i Stabilitetit, duhet të luajnë një rol kryesor në përcaktimin e politikave publike. Banka Botërore, e cila është më e vëmendshme ndaj nxitjes së "rritjes së mirë ekonomike", gjithashtu duhet të luajë një rol thelbësor. Shkalla e papunësisë në Ballkan pasqyron shumë pakënaqësi dhe

zhgënjim social dhe ajo duhet të bëhet shqetësimi kryesor për ata, të cilët hartojnë politikat publike dhe ekonomike.

1.2. FITIMI I RESURSEVE EKONOMIKE

Ky është njëri ndër shkaqet të cilin shumica e konsiderojnë si shkakun më të rëndësishëm, i cili shpie në ndezjen e luftërave[12]. Gadishulli Ballkanik është i pasur me resurse të shumta natyrore, nëntokësore, tokësore, detare dhe malore. Fitimi i resurseve akumuluese është një shprehje shkencore precize, të cilën e përdorin strategët për të shprehur shkakun ekonomik në ndezjen e luftërave. Resurset akumuluese janë, pra ato resurse të cilat, kur shteti i posedon, nëpërmjet tyre i lehtësohet që të fitojë resurse tjera[13].

1.2.1 Kosova në aspektin e posedimit të resurseve natyrore

Njëri prej shumë faktorëve, se përse ish-Jugosllavia nuk hiqte dorë nga Kosova, ishte edhe resursi mjaft frytdhënës me xehe të plumbit dhe zinkut "Trepça" ku një kohë të gjatë, qarqet jugosllave këtë burim natyror maksimalisht e shfrytëzonin për interesat e veta shtetërore. Çka ishte edhe më keq, se Kosova shërbente vetëm si vegël për të nxjerrë në të pasuri dhe investimi bëhej, krejt diku tjetër, pra në Beograd dhe një pjesë e të ardhurave shfrytëzoheshin për ushtri dhe armatim, pra për ta mbajtur Kosovën sa më shumë peng. Edhe pse Republika e Kosovës ka, dhe është e shquar për pasuri nëntokësore, ku rezervat e thëngjillit në Republikën e Kosovës vlerësohen të jenë 11 deri 15 miliardë ton. Pellgjet kryesore janë: pellgu i Kosovës, Dukagjinit, dhe i

[12] Xhemal RUZHDI, "Konfliktet Botërore" Kajro, 2002, fq. 103
[13] Po aty

Drenicës[14], por paradoksale është se në një vend ku lënda e parë është e gatshme, të ballafaqohet me problemet e rrymës, është më shumë se absurditet! Në këtë rast destabilizimi i rajonit mund të vijë nga brenda, sepse populli fare mirë e di se shteti i tyre ka resurse natyrore dhe shfrytëzimi i tyre nuk bëhet, disa thonë për arsye politike, disa thonë se këtë proces qëllimisht (vetëm ata e din pse) e kanë ndërprerë ndërkombëtarët. Sidoqoftë, Kosova në mosshfrytëzimin e kësaj begatie do të përballet me trazira sociale, dëmet e së cilës do të jenë fatale për ardhmërinë e vendit.

1.2.2 Shqipëria në aspektin e posedimit të resurseve natyrore

Shqipëria ishte dhe është e pasur me resurse natyrore, ku dominuese janë resursi detar dhe nafta. Vendburimet më të mëdha të naftës janë: zona e Kuçovës, Patosit, gëlqerorët e Patosit (Visoka) dhe Marina. Në të kaluarën burimet e naftës dhe të gazit në Shqipëri janë shfrytëzuar dhe gjer më vitin 1940 ka qenë i vetmi burim natyror që është shfrytëzuar. Por, më vonë mungesa e ideve (ndikimi i sistemit monist) dhe mosdashja e vendit për zhvillim të mëtutjeshëm e bëri të vetën, e cila e la shumë mbrapa Shqipërinë. Izolimi 50 vjeçar i Shqipërisë nga regjimi komunist e bëri Shqipërinë vend mjaft të varfër me shfrytëzim zero të resurse-ve. Siç e thamë edhe më lartë, se vendet pushtojnë padrejtësisht vende tjera për shkak të posedimit të resurseve natyrore, kurse Shqipëria e zgjodhi të kundërtën, pra nuk ishte në gjendje as veten ta pushtojë në aspektin ekonomik. Shqipëria edhe katër vjet do t`a festojë 100 vjetorin e pavarësisë, do të festoj e vallëzoj, por sikur një kalkulim të vogël ta bëjë: a thua popujt tjerë për 100 vjet ku shkuan dhe sa u zhvilluan? Si rrjedhojë e kësaj mendësie Shqipëria u përball me kriza të ndryshme, kriza të cilat ishin

[14] Rifat Blakaj, " EKONOMI E RESURSEVE", Prishtinë, 2005 fq.158

produkt i ekonomisë mjaftë të dobët, joformale, si dhe mos-shfrytëzimi i resurseve, të cilët i posedon pa pasur nevojë që të pushtoj ndonjë vend tjetër dhe të sjellë trazira jashtë shtetit të vet. Por, trazirat e 1997 në Shqipëri ndodhën si rezultat i mungesës së madhe për ushqim, nevojës së madhe për përparim. Dhe disa firma fiktive të huaja në bashkëpunim me krerët vendas e shfrytëzuan maksimalisht këtë gjendje anarkie. Dhe të gjorët shqiptarë, të mashtruar pas fitimit të madh dhe të shpejtë pa djersë, i investuan shtëpitë e tyre (në formë të hipotekave) duke menduar se pas një kohe shumë të shkurtër prej një shtëpie, si shkëmbim do t'i bëjnë dy shtëpi. Kjo ishte një mashtrim i qartë dhe për pasojë përjetuam trazirat e 97-ës, trazira që u shoqëruan me imazhin mjaft të ulët dhe të keq ndërkombëtar.

1.2.3 Maqedonia në aspektin e posedimit të resurseve

Maqedonia nuk është e shquar për ndonjë resurs të veçantë, siç ishte rasti me Shqipërinë dhe Kosovën. Në fakt Republika e Maqedonisë nuk ka dalje në det dhe ky është një limit gjeografik i saj[15]. Por, Maqedonia ka një epërsi mjaft të çmueshme! Posedon një tokë mjaft pjellore, ku mund të kultivohen me të madhe pemë dhe perime. Fatkeqësisht edhe në këtë rast, duke qëndruar mbi begati bujqësore, kemi konflikte të cilat rrjedhin si pasojë e mosshfrytëzimit adekuat, apo e shfrytëzimit vetëm nga njëra anë. Është i çuditshëm fakti se, duke i pasur resurset e gatshme, nuk bëhet fare përpjekje për shfrytëzim. Nëse këtë gjendje e krahasojmë me thëniet e Hitleri, atëherë do të vijmë në një rezultat mjaft dëshpërues, citoj " Dëshiroj ta fitoj Ukrainën e cila ka resurse të mëdha, deri sa të mos kenë mundësi të na bëjnë të uritur, sikurse në luftën e kaluar". Pra, shtetet tjera eksploatimin e lëndës së parë, apo gjetjen e burimeve natyrore bujqësore e kërkojnë jashtë vendit të tyre, edhe atë në mënyrën më mizore të

[15] Shaban Prevalla, revista "Universitas" Vjenë 2004 fq. 247

mundshme. Migracioni për jashtë në Republikën e Maqedonisë është tejet i madh (sidomos i etnitetit shqiptar). Mungesa e subvencioneve për bujqësi, pasoi me një demoralizim të paparë, i cili demoralizim akoma po e përcjell etnitetin shqiptar. Me reformat bujqësore që janë bërë në Republikën e Maqedonisë rezultoi mjaft qartë animi teorik dhe praktik ndaj komunitetit maqedonas. Për pasojë nga diskriminimi i shumanshëm, si ai politik, ekonomik dhe juridik, shpërtheu konflikti i armatosur në vitin 2001. Edhe këtu shkaqet e shpërthimit ishin ekonomiko-politike, sepse, sikur t'i jepej e drejta për punësim të barabartë, shfrytëzim të subvencioneve, si dhe përfaqësim i drejtë i të gjithë komuniteteve nëpër institucionet shtetërore, atëherë fare nuk do të bëhej as fjalë për konflikt, e të mos flasim për veprime të armatosura.

1.3. NISMAT E INTEGRIMEVE EKONOMIKE TË BALLKANIT

Ballkani, si në të kaluarën, ashtu edhe sot, vazhdon të jetë një hapësirë gjeopolitike jostabile dhe nën influencën e Fuqive të Mëdha. Ky jostabilitet është rrjedhim i pozicionit gjeostrategjik dhe politik të disa vendeve të Fuqive të Mëdha (sidomos Rusisë) në një anë dhe i interesit dhe i pozicionimit hegjemonist të disa vendeve ballkanike (veçmas i Serbisë dhe i Greqisë) në anën tjetër. Historia e Ballkanit është e mbushur me antagonizma dhe me luftëra. Kuptimi "ballkanizëm", shikuar historikisht dhe në fjalorin diplomatik të marrëdhënieve ndërkombëtare bashkëkohore paraqet sinonimin e antagonizmave, luftërave ndarjeve territoriale të brendshme, spastrimeve territoriale etj[16].

Nga kjo mund të konstatojmë se edhe përkundër luftërave në ish-RSF të Jugosllavisë, që rezultuan me dëme të mëdha materiale si dhe viktima në njerëz, prapë u desh që të mbizotërojë

[16] Musa Limani, "INTEGRIMET EKONOMIKE EVROPIANE" Prishtinë, 2004 fq. 47

paqja dhe marrëveshjet tjera të arbitruara ndërkombëtare. Duke e parë këtë dëshmi se pas çfarëdo lufte, apo tmerri fundi do të jetë në tavolinë dhe nga tavolina do të jetë marrëveshja, paqja dhe stabiliteti i rajonit, atëherë vendet e Ballkanit edhe pse vonë, e kuptuan se problemet e krijuara historikisht mes tyre nuk mund të zgjidheshin me luftëra, por me marrëveshje dhe integrime ekonomike. Këto vende e kuptuan se është momenti historik që Ballkani të mos ndërtohet dhe sundohet vetëm nga politika, por sendërtimi efikas, tashmë duhet të jetë nga integrimi ekonomik, e jo sikur deri më tash ekonomia të jetë shërbëtore e politikës. Nisma e parë drejt këtij procesi progresiv ka filluar në vitin 1979, me Greqinë. Kjo nismë vazhdon akoma, dhe është cilësuar mjaft e dobishme për flakjen e luftërave dhe në të shumtën e rasteve imponimin e "harrimeve" të dëmeve që kanë ndodhur në të kaluarën.

Pra, pa marrë parasysh problemet politike, ndërlidhja e fortë ekonomike e vendeve të Ballkanit do të ishte në dobi të këtyre vendeve veç e veç, si dhe të rajonit në përgjithësi, gjë që pa mëdyshje do të ndikonte në uljen e tensioneve. Dihet mirëfilli se kushtet e vështira sociale janë gjeneruese të krizave të natyrave të ndryshme dhe me përmasa të paparashikueshme, dhe si një ndihmës na paraqitet themelimi i politikave ekonomike që çojnë drejt integrimit ekonomik dhe shkëmbimit ekonomik me vendet tjera të zhvilluara.

1.4. PËRFUNDIMI

Ligji i shkakut dhe pasojës, gjithmonë është i pakontestueshëm, sepse vetë jeta reale, e përditshme është e pakontestueshme. Faktorët dhe ndikimet e shumta, janë prognozuese për një situatë të caktuar. Një situatë që të jetë e mirë, është kusht që ndikimet për një fenomen të caktuar të jenë pozitive, dhe më pas me automatizëm gjendja na paraqitet shpresëdhënëse dhe rezultative. Nëse e pranojmë maksimën, "ta ndërtojmë të ardhmen

duke mos e harruar të kaluarën" atëherë, Ballkani gjendet ndërmjet dy alternativave, njëra pozitive dhe tjetra negative. Pozitivja është, që të mësojmë nga e kaluara e hidhur, t'i shikojmë pasojat nga veprimtaria e kaluar dhe të merret mësim që këto gjëra të mos i përsërisim, sepse e sollën Ballkanin në gjendjen e mjerueshme të sotshme. Dhe e dyta negativja është, se nëse shikojmë nga e kaluara atëherë pa dashje do të rigjallërohet urrejtja ndaj okupatorëve, do të dëmtohet sendërtimi i vlerave të përbashkëta progresive për të ardhmen. Nga kjo del se është më mirë të imponohet tërësisht një rregull, apo maksimë e re që do të ishte e përbashkët për të dyja. Formula e përbashkët do të ishte "faktorët ekonomik duhet përdorur për atë qëllim për të cilin janë krijuar" Pra, begatitë natyrore t'i përdorim për mirëqenien e kushteve për jetë, eliminimin e kushteve të rënda sociale, sepse kjo tokë në të cilën jetojmë është e mbushur me pasuri natyrore të shumta dhe të shumëllojta, e kjo mund të arrihet vetëm me anë të politikave të drejta, jo diskriminuese ndaj komuniteteve. **Sepse, me të vërtet është paradoksale që faktorët ekonomiko-politik të përdoren për mbrapsht, e që deri më tani në vendet ballkanike përdorimi i tyre ka qenë i tillë, për regres, për gjenerim të krizave, trazirave dhe të konflikteve lokale, rajonale e deri te ato botërore dhe për pasojë vetëm në shekullin e XX kemi humbjen e 167 miliona jetëve njerëzore.**

Maqedonia ndërmjet krizës financiare dhe krizës së identitetit

Prej se është themeluar Maqedonia si shtet, në vazhdimësi ka qenë e shoqëruar me kriza të ndryshme. Natyrat e krizave në këtë shtet kanë qenë të llojllojshme, duke u krijuar kështu një laramani anarkish. Anarkia në këtë shtet filloi të troket prej atëherë, kur në mënyrë institucionale u anashkaluan dhe u diskriminuan shqiptarët. Sinjalet e krizave të njëpasnjëshme, ishin; shpërndarja e mjeteve buxhetore (të grumbulluara bashkërisht) vetëm në institucionet që qeveriseshin absolutisht nga funksionarët maqedonas, investimi në armatim nga tatimpaguesit e përbashkët për maltretimin dhe vrasjen e tatimpaguesve shqiptarë, investimi marramendës në mënyrë të fshehur për promovimin e identitetit maqedonas, financimi i spiunëve shumetnik nga tatimpaguesit po ashtu shumetnik, ndarja e mjeteve buxhetore për bursa të cilat i "takonin" vetëm studentëve maqedonas, financimi i botimeve nga Ministria e Kulturës vetëm e botuesve dhe librave maqedonas, kujdes dhe tretman të veçantë u jepeshin atyre të cilët gënjenin në mënyrë perfide mbi identitetin kombëtar maqedonas, si dhe një pjesë goxha e madhe e buxhetit shkonte në një vend të errët e të ngushtë që po i thoshin, "xhep personal". Por, i gjithë ky diskurs dhe mobilizim diskriminues, nuk i mjaftoi dot që gjendja e qytetarëve maqedonas të përmirësohet. Përkundrazi, nëna qeveri që dikur nga ajo rronin si pashallarë, i futi në një hendek, ku vështirë se mund të dalin ndonjëherë. Ndoshta i zuri haku i shqiptarëve. Ndoshta!

Jo, jo, sepse po t'i zinte haku jonë, atëherë as Afrika nuk do i priste, nga padrejtësitë që na i kanë bërë dhe të cilët aktualisht janë duke na i bërë. Ne si tatimpagues, asnjëherë nuk kemi pasur të drejtë të thirremi në të drejtën buxhetore, e drejtë e garantuar me kushtetutë. **Ja, që fatmirësisht, erdhi koha kur gjithçka doli në shesh! Maqedonia në të njëjtën kohë, në mënyrë publike u kaplua nga dy kriza tejet të rënda, prej dy dukurive kryesore të cilët e mbajnë gjallë një shtet, pra me krizën e identitetit kombëtar dhe krizën financiare.** Kriza e identitetit maqedonas dhe kriza financiare, nuk janë të reja, ashtu siç pandehin ta paraqesin disa dashamirë të këtij shteti. Identiteti kombëtar dhe fetar i maqedonasve të kësaj Maqedonie, u kontestua nga shumë shtete. Bullgaria i`a kontestoi gjuhën, Greqia emrin, Serbia kishën ortodokse, si dhe të gjorët shqiptarë harruan t'i kontestojnë diçka, ngase vet ishin apo lejuan të kontestohen si faktor nga maqedonasit e kësaj Maqedonie. Para disa muajve ky shtet, gjegjësisht Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Financave, e shpallën zyrtarisht krizën financiare në vend, që rrodhi nga kriza globale financiare. Kjo për opinionin e gjerë nuk paraqiste ndonjë risi, sepse ne fare mirë e dinim që ky shtet prej themelimit të tij, ishte në një krizë sociale, përveç atyre oligarkëve të cilët prej kohësh e përjetuan të qenit në New York, duke qëndruar në Maqedoni. Por, çudia dhe paradoksi i radhës i këtij shteti, është përballja kontradiktore me këto dy kriza tejet serioze. Asnjë vend në botë, i cili u përfshi nga kriza globale financiare nuk investoi në diçka të vdekur.

Por, Maqedonia si duket e zgjodhi rrugën e kundërt. Në këtë kohë krizash, ajo mëton të investojë miliona nga buxheti i përbashkët shtetëror, në ndërtimin e skulpturave antike, në mobilizimin e elitës intelektuale maqedonase për promovimin e identitetit antik maqedonas (këta intelektual kërkojnë shuma të mëdha parash dhe një gjë e tillë, po u sigurohej prej buxhetit shtetëror), humbjen e investimeve të mëdha në telekomunikacion vetëm për shkak të emërtimit të aeroportit, "Aleksandër Veliki", shpenzimet

marramendëse deleguese për negociata me përfaqësuesit e Greqisë rreth kontestit të emrit, si dhe ftohja e investitorëve të jashtëm nga anarkia dhe kundërthëniet e këtilla për identitetin. Ministritë në fjalë, harrojnë qëllimisht se buxheti shtetërorë rreth 70 për qind mblidhet nga konsumi potencial. Kurse konsumatorë potencial jemi të gjithë ne, qytetarët e këtij shteti. Konsumatorë potencial janë, edhe mërgimtarët shqiptarë që vijnë në vendlindje për pushime verore, ku minimumi i shpenzimeve i secilës familje është nga 7.000 euro, kurse 18 për qind në kuadër të TVSH-së, me automatizëm shkojnë për buxhetin e shtetit. Ndërsa të gjorët mërgimtarë, presin me orë të tëra nëpër sportele të ndryshme, për një çertifikatë të thjeshtë.

Tash së fundi dëgjuam nga ministri i financave se, në vitin vijues nuk do të kemi rritje në paga për 10 për qind (rritje e paralajmëruar) për të gjithë nëpunësit shtetëror, sepse në vendin tonë paskemi krizë financiare dhe një pjesë bukur e madhe e buxhetit shtetëror qenka ndarë për mekanizmat të cilat do të merren me përballimin dhe eliminimin e pasojave, që rrodhën prej krizës globale financiare. Ai harroi të thotë, apo tha mes rreshtave se milionët e buxhetit janë të dedikuar për ndërtimin e skulpturave, kishave, kryqeve dhe përvetësimin e gjuhës maqedonase, gjë që etniteti shqiptarë me identitet të pastër, këto shpenzime të kota, i shikon si lojë të radhës me zjarr.

Pra, për hir të identitet kombëtar të rrejshëm maqedonas, po pësojmë ne shqiptarët. Ne në vend që sot të ishim në NATO, bashkë me mëmëdheun Shqipëri, po merremi me gjepura dhe humbje kohe rreth mitit antik maqedonas. Ky shtet në vend që të merret dhe mobilizohet për tejkalimin e krizës financiare, merret dhe mobilizohet për mbrojtjen dhe tjetërsimin e figurave historike që kurrë nuk kishin qenë të tyre. Por, as me njërën, as me tjetrën nuk do të ketë sukses, ngase adresat e duhura kuruese që moti i ka humbur.

Rasti i përfshirjes së Maqedonisë me dy kriza serioze i ngjan, njeriut të cilin e kanë vërshuar morrat në kokë, dhe për

momentin nuk i gjinden para, për të blerë një ilaç për morra, por morracaku në fjalë krenohet se, në pjesën e përparme të kapelës së tij i shkruan, “BOSS”.

Kur, edhe korrupsioni korruptohet!!!

Shpeshherë habitemi dhe mbesim pa fjalë, kur dëgjojmë se institucionet dhe njerëzit që e luftojnë korrupsionin, mu ata na qenkan të korruptuarit e vërtetë. Ata e luftojnë dhe i dinë metodat korruptuese, jo që janë ekspertë të mirëfilltë të fenomenit të korrupsionit, por janë pragmatistë tejet të shkathtë të metodave korruptuese.

Kemi profesor të specializuar dhe të certifikuar për njohjen dhe parandalimin e këtij fenomeni famëkeq, por fatkeqësia tek këta intelektualë profesionistë rreth problemit në fjalë, qëndron në atë se, ata historikisht, gjeografikisht, ekonomikisht dhe aktualisht mbeten si njerëz me moral tejet të dobët, pra të korruptuar gjer në fyt.

Kemi institucione ku merret leja e vozitjes dhe drejtësia juridike lypset vetëm te ata të drejtit (të cilët nuk kanë para ekstra për të dhënë në formë të ryshfetit), ata të cilët e kanë zgjedhur rrugën e drejtë, rrugën e mundimshme, si dhe rrugën e cila të shpie në vozitje stabile, pa budallallëqe në rrugë. Kurse, ata të cilët lejen e vozitjes e marrin me një letër me vlerë në dorë dhe për një orë, do të jeni penguesit dhe "marrësit në qafë" të njerëzve të pafajshëm, të njerëzve të cilët me mund dhe mend arritën ta marrin lejen e vozitjes apo patentë shoferin. **Kemi njerëz sot, kuptohet pranues, ndërmjetësues dhe dërgues të korrupsionit, të cilët brenda ditës janë bërë të diplomuar, magjistra dhe doktorë (jo mjek, por e kundërta e mjekut të mirëfilltë), dhe në mbrëmje femrave apo bashkëshorteve i ligjërojnë rreth profesionit dhe epërsisë përkatëse.** Pastaj, "profesionalistët" në fjalë, befasisht i shohim nëpër mediume duke

dhënë "fetva" dhe analiza të ndryshme rreth situatave dhe rasteve të vështira në vend, gjoja se brengosen për përfshirjen e vendit nga korrupsioni. Ata harrojnë se ne, nuk kemi harruar se analistët fare pa analiza i shoqëron një biografi mjaft e pistë. Gjithmonë dhe gjithherë do ta kenë bishtin e zënë me derë! Pastaj atje ku bëhet kurimi i sëmundjeve kronike (në spital), njëkohësisht bëhet edhe zhvillimi i një sëmundje tjetër, pra të sëmundjes virusale të korrupsionit. Njerëzit e shkretë, gëzohen se u shëruan, por pastaj dëshpërohen se u ngarkuan dhe u njollosën me një sëmundje tjetër vdekjeprurëse.

Po ashtu, dëgjojmë nga nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, se për mësimin dhe "perfeksionimin" e ndonjë lënde të caktuar, p.sh, gjuhë angleze dhe matematikë, janë të obliguar të ndjekin kurse dhe trajnime shtesë, duke e zbehë kështu vlerën e orës mësimorë. Kjo zbehje dhe venitje bëhet e mundur nga shoqërimi dhe përcjellja në vazhdimësi e shokut dhe shoqes korrupsion dhe korrupsione.

Për punësimet aktuale s'kemi çka të flasim!

Korrupsionin, dikush e sheh si shteg të vetëm për të arritur deri tek pasuria. Por, këtë vlerësim e pohojnë dhe e përkrahin vetëm ata të cilët, në masë të madhe ia ka ëndja të korruptohen dhe pastaj të flasin për të këqijat e korrupsionit.

Si dhe korrupsioni kulminant shkatërrues, e dëbues i të mirave materiale dhe jo materiale që vijnë nga jashtë, është i ashtuquajturi korrupsion shtetëror. Por, ky lloj i korrupsionit është tejet i kamufluar, këtë e shohin vetëm qytetarët e ndershëm të cilët gjërat nuk i shohin përmes syrit korruptiv dhe përmes pohimit se, "pa u korruptuar nuk jetohet", por përmes dioptrisë realiste, e cila ndonjëherë është shumë e dhembshme.

Ne pa një analizë, apo revizion financiar të brendshëm dhe të jashtëm institucional, lirshëm mund të aludojmë se filan kryetari, ministri apo pushtetari është i korruptuar. Për këtë nuk dëshmojnë ata, por shtëpitë, veturat dhe deponimet marramendëse financiare nëpër banka, të cilët pastaj presin po ashtu norma

kamatore marramendëse të larta. Prej fitimit pa djersë në fitim më të madh, pa mund dhe pa djersë! **Por, një duhet ta kemi të qartë se ata të cilët nuk djersiten, mund të vuajnë prej mbi peshës, dhe shumë shpejt do të përjetojnë sulm në zemër dhe sulme të tjera trupore. Kujdes pra, nga mosdjersitja!**

Ne nuk mund të flasim për ndonjë shifër të saktë të të korruptuarve pushtetar, sepse mund të gjobitemi dhe akuzohemi në mungesë të fakteve. Fundja në dorë të pushtetarëve të korruptuar, janë statistikat e nivelit të korrupsionit. Në dorë të pushtetarëve janë aktpaditë dhe kompensimet e veprave penale të korrupsionit, ndaj kujdes o ti brengosës i korrupsionit, sepse mund të burgosesh nga brengosja e të pa brengosurve.

Si është e mundur që të arrish deri te këto informata, të cilat mbahen, nga po ata të cilët kanë qenë dhe janë të korruptuar, por tashmë institucionalisht.

Është e udhës që përskaj tërë kësaj trajtese t`a potencojmë, edhe nocionin e korrupsionit, të cilin e kam formuluar vetë, frikohem t'i potencoj nocionet e atyre profesorëve të cilët korrupsionin e trajtojnë mbi baza të egos së tyre të korruptuar.

Pra, korrupsioni në vete ngërthen veprimtari të mbështetur në suaza joligjore, pasurim brenda natës, posedim të pasurisë jo të ligjshme pa mbështetje financiare, kryerjen e çdo pune me ndërmjetësim të parave pa qenë meritor i asaj pune, shfrytëzimi i funksionit, autorizimi publik i detyrës zyrtare dhe pozitës për realizim të çfarë do qoftë dobie për vete ose për dikë tjetër.

Është koha të merremi, edhe me ata të cilët këtë temë e trajtojnë si dukuri shkatërruese për shoqërinë! Kujdes, mu ata mund të jenë të korruptuarit modern, por njëkohësisht më të rrezikshmit. Pra, korrupsionin si fenomen shkatërrues, urgjentisht duhet pastruar dhe larguar prej korrupsionit real.

Disa veçori të kryerësve të krimit ekonomik

Kryerësit e krimeve ekonomik dhe krimeve të organizuar në ekonomi, në shoqëritë bashkëkohore rëndom nuk janë tipa asocial, ose nuk duken si të tillë. Ata nuk përdorin dhunën fizike, siç veprojnë rëndom kriminelët e nëntokës dhe të dhunës klasike[17].

Kriminelët ekonomik në dukje fiziologjike aspak nuk i ngjajnë kriminelëve të tjerë. **Ata janë të pashëm, flasin rrjedhshëm, i kundërshtojnë dukuritë që e pengojnë zhvillimin normal shoqëror, janë të buzëqeshur, të përshëndeturit e kanë mjaft mbresëlënëse, të ftojnë për kafe, interesohen për gjendjen sociale familjare dhe shumë virtyte tjera artificiale.** Te njerëzit tjerë këta kriminel lënë përshtypjen si njerëz të mirë, dhe në rast se ndokush i përqesh, të tjerët ata të padijshmit, të painformuarit do të reagonin dhe do të ishin në gjendje ta flijonin edhe veten, vetëm për të treguar se filani (realisht kriminel) është burrë i mirë dhe i ndershëm. **Sot, nëpër shumë qytete të rajonit tonë, kriminelët ekonomik me pamje të bukur, me vetura dhe shtëpi luksoze, i kemi të regjistruar nëpër shumë kinse organizata bamirëse.** Nëse shkojmë në lokalet ku ata punojnë do ta shohim murin e qepur dhe të ngjeshur me mirënjohje të ndryshme. Paralelisht me mirënjohjet e renditura, në lokalet e këtyre kriminelëve i kemi edhe punëtorët e shkretë, ku paga e tyre mujore është vetëm 100 euro, pa asnjë kontribut juridik që natyrshëm i takon, kurse qarkullimi mujorë të cilin e nxjerrin "bamirësit"në fjalë, kalon në mbi 30.000 euro (të mos keqkuptohemi, ngase në rajonet tona kemi edhe tregtarë të ndershëm, por fatkeqësisht janë

[17] Ragip Halili, "Kriminologjia", Prishtinë, 2008 fq.199

pak). Për këtë arsye askush mos të habitet, kur të sheh ndërtesa të mëdha, dhe pastaj ta pyet vetën pse more unë si mërgimtarë që punova me vite të tëra në mërgim, nuk po arrij dot të kem pasuri sa një tregtarë i thjeshtë në këtë vend. Këtë veprim kundër-logjik e vërejnë vetëm ata të cilët shohin përtej hundës së tyre dhe me dioptrinë realiste! Të mos keqkuptohemi, ne nuk jemi kundër ndërtimit të ndërtesave shumëkatëshe dhe zgjerimin e lokalëve, as nuk jemi mbrojtës të përbetuar të këtij shteti të korruptuar, por jemi brengosës për punëtorët që asnjë ligj njerëzor nuk i mbron. Jemi brengosës për studentët që diplomojnë dhe shkojnë e ju nënshtrohen këtyre të pamëshirshmëve, jemi brengosës kur dëgjojmë se buxheti shtetërore mezi e arrin shumën 2.5 miliardë euro, ku dihet mirëfilli se rreth 70 për qind e buxhetit mblidhet prej konsumit, pra prej TVSH-së. Sikur të paguhen me rregull kontributet e punëtorëve dhe kontributet tjera shtetërore, atëherë edhe pagat mujore në këto rajone do të ishin më të larta, ngase më pastaj buxheti do të numëronte shuma më të mëdha monetare. Për këtë arsye ky lloj krimi është shumë i rrezikshëm, sepse zbulimi i tyre është shumë i vështirë dhe në kuadër të besimit, ata veprojnë mizorisht kundër shoqërisë në përgjithësi. Sot në epokën e globalizimit është shumë vështirë ta vjedhësh një buke, e cila kushton vetëm 25 cent, se sa shitja e aksioneve të rrejshme, evazioni fiskalë, larja e parave të fituara nga trafiku ilegal, shuma e të cilave arrin prej miliarda dollarësh.

Në shoqëritë tona është shumë lehtë të dallohen këta tipa kriminel. Mjafton vetëm një vështrim i shkurtër, sipërfaqësor i pasurisë dhe periudha kohore e grumbullimit të asaj pasurie (përkundër se mund të jenë njerëz të pashëm, "bamirës", orator të shkëlqyer). Sikur t'i kërkohej burimi i të ardhurave nga organet kompetente, atëherë do të shohim një përfundim dhe sqarim tejet të dhembshëm. Sa të varfër ishin pushtetarët, atëherë kur nuk e kishin pushtetin në dorë, por për një kohë shumë të shkurtër, sikur në kohërat inflacioniste, shumë shpejt u bën të pasur. Nga kjo anarki ligjore përfituan tregtarët mizorë! Nëse u

kërkohet burimi i financave, do e lajmërojnë vetëm një banesë me vlerë prej 35.000 euro, një veturë me vlerë prej 4.600 euro dhe kaq. Sa të mjerë, qenkan bërë për ndihma sociale! Ne nuk thamë rastësisht, "sikur t'i kërkohej burimi i të ardhurave", ngase asnjëherë në mënyrë të plotë nuk u është kërkuar një pasqyrë e tillë financiare.

Në literaturën kriminologjike bashkëkohore, kryerësit e krimit ekonomik, shpeshherë ndahen në disa shtresa. Shtresën e parë e përbejnë të ashtuquajturit kriminel ose "njerëz afarist të mirë". Qëllimi i tyre është sigurimi i një ekzistence të domosdoshme jetësore, e jo grumbullimi i parave dhe kapitalit të madh. Kjo është shtresa e ashtuquajtura shtresa e ulët e krimit ekonomik.

Shtresa e dytë ose e mesme e kriminelëve ekonomik, përfshin kategorinë e personave që janë të motivuar të grumbullojnë pasuri, të arrijnë një status materiale më të lartë, e me këtë të realizojnë edhe disa privilegje politike dhe ndikimi tjera ne botën afariste. Këta kriminel, zakonisht lëshohen edhe në manipulime, transaksione dhe spekulime të llojllojshme, në bursë, tregti, banka dhe mashtrime tjera, të cilat sipas logjikës së tyre paguhen. Shtresën më të lart të kryerësve të krimit ekonomik e përbejnë perona që zënë pozita të larta ekonomike dhe politike. Shpesh këta persona kanë pozita të rëndësishme në partitë politike, ministrave të ndryshme, në sektorët ekonomik, bankave, marrëdhënie tregtare me botën e jashtme, ose gjendet vetë në segmentet ku bëhen investime të mëdha ose i kanë njerëzit e vetë[18]. Ky lloj krimi është i lidhur më së shumti me ata njerëz që janë në pushtet. Është prej krimeve të rënda, të cilat krime e dëmtojnë në tërësi shtetin, e pengojnë gjallërimin e mëtutjeshëm të shtetit dhe e viktimizojnë qytetarin e thjeshtë. Pra, është koha që edhe opinioni i gjerë të merret me studimin e krimit ekonomik, sepse më pas detyrimisht opinioni i gjerë dhe i gjorë po e paguan faturën e kësaj dukurie shkatërruese, duke iu cenuar kështu edhe ardhmëria e shëndoshë.

[18] Po aty (Ragip Halili)

Menaxhmenti në rrafshin kulturor dhe religjioz

Menaxhmenti është i ngritur në nivel të shkencave të organizimit, ndonëse këtu më tepër mësohet për përvojën praktike, për organizimin dhe udhëheqjen e grupeve shoqërore në ndërmarrje dhe jashtë ndërmarrjes.

Kuptimi i thjeshtësuar, **menage** (menixh) shpreh zotimin që të organizosh, rregullosh, mbikëqyrësh, planifikosh, udhëheqësh dhe kontrollosh veprimtarinë e një institucioni, korporate, ndërmarrje, përkatësisht involvimi në tërësi në kuadër të drejtimit të punës përkatëse. Nocioni **Menagement** (Menaxhment) nënkupton njerëzit e angazhuar në administrimin e biznesit, institucioneve publike etj[19].

Përshtypja që bën menaxheri në komunikim, pasqyron bindjet e të tjerëve që krijohen për të dhe ndërmarrjen apo veprimtarinë biznesore të tij. Menaxheri me sjelljet e tij tregon kulturën elementare dhe imazhin e tij, përballë të tjerëve. Në çdo veprimtari, menaxheri duhet të jetë i edukuar dhe i kulturuar në frymën e identitet të vet kombëtar dhe fetar, pra të jetë natyral në tërësinë e tij (më mirë një i keq natyral, sesa një kopje e bukur dhe artificial). Në kohën moderne menaxheri duhet të jetë me kulturë universale, apo thënë më mirë të jetë i përshtatshëm në mjedisin ku vepron (edhe pse universalizmi, paksa ta zbehë identitetin!).

A thua si do të veprojë një menaxher mysliman në menaxhimin e prodhimit dhe shitjen e alkoolit? A thua si do të veprojë një menaxher mysliman në menaxhimin e bankave ku afarizmi i

[19] Zeki Bejtullahu, "Bazat e Biznesit" Prishtinë, 1998, fq 64

tyre kryhet nëpërmjet kredisë me kamatë (edhe pse aktualisht, kuptimësia e nocionit kamatë nuk mund të jetë edhe aq e plotë, kjo pra është një dilemë tejet e vështirë në kohën e tanishme)? Këto dhe shumë pyetje të tjera në kohën moderne janë bërë objekt debati për menaxherin dhe konceptin e menaxhimit Islam. Ata që nuk kanë njohuri për fenë Islame mendojnë se kjo fe, qenka një fe e prapambetur, sepse po bie ndesh me natyrën e menaxherit, si dhe me përparimin e shoqërisë. Por, mos të harrojmë se menaxhment nuk do të thotë vetëm të fitosh dhe të përparosh, pa e zgjedhur mjetin për të arritur deri te qëllimi. Pra, menaxhment nuk do të thotë udhëheqje në dëm të tjetrit.

Dihet mirëfilli se, udhëheqja është e lidhur ngushtësisht me etikën e njeriut që do të thotë: rregullim, kontrollim, planifikim, veprim. Si është e mundur që një menaxher të rregulloj, kur në anën tjetër çrregullon tërë shoqërinë me anë të prodhimit dhe shitjes së alkoolit?!

Kultura e një menaxheri duhet të jetë e lidhur fort me ndjenjën e solidaritetit. Për ta shtjelluar më mirë, pamundësinë e zhvillimit normal të ekonomive me konceptet ekonomike aktuale, të cilat bien ndesh me parimet e shëndosha Islame, do të ndalemi pak, te zhvillimi i menaxhimit të bankave konvencionale. Sistemi i bankave konvencionale, në kontinentin Evropian e më gjerë, prej kohësh përdoret si alternativë (huadhënie-huamarrje) për njerëzit, qofshin mysliman, e të krishterë. Gradualisht ky sistem jete, me këtë sistem financiar u mishërua dhe kaloi në normalizim. T'ju them të drejtën edhe unë personalisht (teoritikisht) përmes një shkrimi, nga domosdoshmëria faktike, tërthorazi e përkraha sistemin aktual bankar-kreditor. Ngase, vështirësitë e ndryshme, nganjëherë edhe të ndaluarat t'i bëjnë t'i shikosh me syrin dyshues. Shtrëngimi i zemrave dhe i duarve të myslimanëve, këtë tezë nga dita në ditë m`a forconte. Tek sa njëri prej myslimanëve po e shpjegonte urtësinë e ndalimit të kamatës dhe mosmarrjen kategorikisht të kredive, po ashtu lënien e kamatës punonjësve të bankës, e që ata ishin pa dyshim maqedonas e serbë, më bëri t'i

rrekem një shkrimi që të sqaroja se në këtë kohë është e pamundur, të mos prekemi nga kamata, bile në ndonjë mënyrë. Ligjëruesi ciceron, nuk kishte të ndalur së shpjeguari, urtësinë e ndalimit të kamatës. Por, vlera e këtij ligjërimi, që ishte koncentruar vetëm në thurjen e fjalive të bukura, filloi të zbehet me një kërkesë dhe pyetje, prej një të pranishmit. Ai e pyeti: i nderuari "shpjegues" unë gjendem skajshmërisht në vështirësi sociale, ndaj meqë marrja kredi në banka është e ndaluar, atëherë do të më sigurosh ca të holla, sa të dal prej kësaj gjendjeje të mjerueshme, e pastaj sigurisht që do t'i kthejë ato para. Dhe, për çudi prej këtij momenti tërësisht ndryshoi kursi i bisedës, filluan arsyetimet e njëpasnjëshme, kuptohet fare të pabaza! E pra, ky rast ishte inspirimi im, në atë kohë që ta shkruaja shkrimin, titulli i të cilit ishte, "Keqkuptimet dhe keqinterpretimet e nocionit kamatë".

Por, sikurse çdo gjë që evoluon, edhe mendja dhe bindjet e njeriut nuk shpëtuan dot nga ky evolucion mental dhe intelektual. Kriza globale financiare, edhe njëherë e dëshmoi qartë dhe saktë, se sistemi financiar islam, është stoik për të gjitha kohërat, sikurse libri ynë i shenjtë. Analistët e njërës prej bankave të mëdha botërore, në Frankfurt publikisht e pranuan se sistemin bankar islam duhej instaluar në masë të madhe edhe në vendet evropiane, si dhe në çdo vend, ku dëshirohet të arrihet qëndrueshmëria dhe gjallëria ekonomike e sociale, ku esenca e kësaj veprimtarie, kryesisht mbështetet në partneritet, ku fitimi dhe humbja janë të njëllojta si për bankën, po ashtu edhe për klientët. Pra, ne jemi krenarë (sikur që turpërohemi prej anomalive tona, të shumta) që gradualisht urtësitë islame po vihen në praktikë, po integrohen në vendet e zhvilluara, në vendet ku me vendosjen edhe të disa rregullave Islame, do të bëhen vende të mirëfillta Islame (në kuptimin e funksionimit të drejtë dhe dhënies përparësi anës morale e shpirtërore).

1.1. Raporti kulturor dhe religjioz

Bashkëpunimi dhe këmbimi i përvojave në kohën moderne është bërë i domosdoshëm. Një amerikan nëse dëshiron të investojë në botën arabe me shumicë myslimane, ai patjetër duhet t'i përshtatet mjedisit ku vepron. Menaxheri që vepron në botën arabe duhet të jetë i kujdesshëm mbi atë se në çka do të investojë. Do të ishte paradoksale, që të mendohet të investohet në ndonjë prodhimtari për pije alkoolike! Por, duhet bërë përpjekje që produktet e prodhuara të jenë në përputhje me natyrshmërinë e tyre kombëtare dhe fetare. Gjithashtu edhe menaxheri mysliman (pa marr parasysh përkatësinë nacionale) duhet t'i respektojë traditat e huaja, por, për aq sa nuk i rrezikohet identiteti i vet.

Në vende të ndryshme të globit tokësor, njerëzit sillen ndryshe, edhe pse në situata të ngjashme. Për shembull, në SHBA në mënyrë automatike ndalojnë te semafori me shenjën e kuqe, ndërsa në mjaft vende të botës së tretë ndalojnë vetëm po që se ka trafik në drejtimin e kundërt. Kur presidenti mban një fjalim në Meksikë të gjithë e shohin televizionin, ndërsa në SHBA e kthejnë në një stacion tjetër, duke e parë më vonë në emisionin e lajmeve, nëse duan. Në Francë takimet fillojnë me kohë, në Peru shpesh fillojnë me vonesë[20]. Në Turqi, librat dhe gazetat lexohen shumë, ndërsa në Maqedoni shumë më pak. Në SHBA, është e zakonshme të dëgjosh njerëzit që flasin për etikën protestante të punës. Në vendet aziatike ku konfuçianizimi është i fortë, ky qëndrim është i njohur si etika konfuçiane e punës. Në botën Arabe ku Islami është i fortë, puna është e shenjtë dhe punohet shumë, sepse në bazë të atyre, neglizhenca ndaj punës do të shoqërohet me ndëshkim në këtë botë dhe në botën tjetër, e shumë tipare dhe virtyte tjera që e karakterizojnë imazhin e shteteve!

Andaj, menaxherit i duhet një trajnim, apo njoftim për kulturën dhe religjionin e atij vendi ku do të shkojë për të punuar.

[20] Ilia Kristo, "Biznesi Ndërkombëtar", Tiranë, 2004, fq. 206

Për disa menaxherë, adaptimi në vende të huaja paksa është i vështirë. Kompanitë multinacionale hasin probleme në lidhje me përzgjedhjen e menaxherëve jashtë vendit amë. Një menaxher që shkon jashtë vendit për të punuar duhet të jetë i informuar hollësisht për kombin, popullin, gjuhën, kulturën dhe fetë e atij shteti.

Posa të shkojë menaxheri në vendin përkatës për të punuar, ai duhet të ketë raporte të përshtatshme me banorët e atij shteti, nuk duhet të sillet me mendjemadhësi, si dhe nuk duhet shfrytëzuar postin për qëllime misionare klanore, e famëkeqe. Duhet respektuar identitetin e tyre kombëtar dhe fetar!

Shpeshherë kompanitë multinacionale veprimtarinë e tyre e kanë shfrytëzuar, edhe si mision për imponimin e traditave të tyre tek të tjerët. Sidomos, kjo ndodhë në vendet në zhvillim ku varfëria është në një nivel të lartë dhe ku çështja e identitetit është e luhatshme. Rastin më të freskët e kemi në Kosovë, ku disa misione kinse, institute për zhvillim, apo organizata joqeveritare "humanitare" bënin trajnime falas, por gjithherë duke përdorur një taktikë indoktrinuese konvertuese, ku në shumicën e rasteve si gjë normale për të ngrënë diçka së pari duheshka puthur kryqin, e pastaj fillon ngrënia e ushqimit. Kinse këta "institute zhvillimore" nuk paskan qenë të informuara se në Kosovë 95% janë të besimit mysliman!

Pra, kultura dhe religjioni, si dy fenomene të pandashme, ndikojnë në mënyra të ndryshme në veprimtarinë e njeriut. Menaxheri pa kulturë dhe religjion të mirëfilltë është i mangët në shumë pore dhe veprimtari të jetës. Po ashtu, edhe lënda e menaxhmentit, nëse është e ndarë nga këto dy fenomene të begatshme ajo lëndë është materie e vdekur dhe gënjeshtër.

Kontradiktat ekonomike

Kur njeriu ndaj vetvetes krijon bindje se është i gjithëdijshëm dhe të njëjtën gjë mundohet t'ia plasoj edhe të tjerëve, praktikisht shihet dhe vërehet një kontradiktë me mendimet dhe bindjet e veta. Ngase një njeri të tillë, kjo botë ende nuk e ka parë dhe as që do e shoh ndonjëherë! Pastaj i tërë talenti dhe dituria e tij, shndërrohen dhe manifestojnë sindromën e të pazëvendësueshmit.

Të infektuarit me këtë virus, e kundërshtojnë autokracinë duke qenë njëkohësisht autokrat, dështimin e ndërmarrjes gjithmonë e lidhin me mosprezencën e tyre, ngase këta janë të gjithëdijshëm, ngecjen ekonomike në shtet gjithmonë e lidhin me mosmarrjen parasysh të ideve të tyre, por njëkohësisht duke mos pasur dhe ofruar fare ide. Ja, kjo është sëmundja e kontradiktores me sindromën e të pazëvendësueshmit! Po që se e kemi diagnostifikuar si duhet këtë problem, atëherë qartësisht do e shohim se, edhe vendi ynë dhe udhëheqësit tanë qenkan të infektuar nga një sëmundje e tillë. Edhe, atë jo sot, por që moti! Sepse, të trumbetosh dhe të flasësh në Maqedoni për ekonominë e tregut, me automatizëm ke ra në grackën e kontradiktores dhe je infektuar me sindromën e të pazëvendësueshmit. Dihet mirëfilli se ekonomia e tregut, ajo pra në vete ngërthen: dërgim apo plasim të mjeteve (vendore) kapitale dhe jokapitale në shtetet e jashtme, pranim dhe lojalitet të mjeteve kapitale dhe jokapitale nga jashtë, liberalizim tregtar për lehtësime doganore me vendet fqinje (këtu e kam fjalën edhe respektim të kësaj marrëveshje), pranimi i monedhës së përbashkët (euros), këmbim valutor me botën e jashtme, krijimi i klimës politike për bizneset private, si dhe më kryesorja është pranimi dhe zbatimi i standardeve që vijnë prej

Bashkimit Evropian. Nëse pak largohemi prej renditjes teorike në letër, dhe e vëzhgojmë praktikën reale ekonomike në Maqedoni, do të përfundojmë me një rezultat tejet rrënqethës. Kushtet në letër që i ofroi Maqedonia për investitorë të jashtëm i joshi mirë këta investitorë!

Kompania austriake EVN është futur me investime në sektorin e energjetikës, pasi Maqedonia kishte fituar statusin e kandidates për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Por, kjo kompani, shumë shpejt u zhgënjye nga mosrealizimi i premtimeve të dhëna nga Qeveria. Palët kontestuese, ende vazhdojnë t`a kërkojnë drejtësinë nëpër gjykata ndërkombëtare. Si rrjedhojë e krizës financiare në botë, Maqedonia u përball me anulim të investimeve të huaja në vlerë të përgjithshme prej rreth 350 milionë eurosh, shumë deri diku e arsyeshme. Investimin e paralajmëruar prej kohësh në Maqedoni nga kompanitë e huaja siç janë TAV-it turke, "Montipe"-së franceze, "Agrokor"-it kroate, do të anulohen, si rrjedhojë e klimës së ftohtë tregtare dhe juridike në vend. Ndërkaq sa i përket ndërtimit të "Qytetit të diellit" nuk ka asgjë. Dështuan, edhe planet investuese të kompanisë sllovene "Iskra" dhe asaj turke "Buroteknik otomotiv". Këto paralajmërime për investime, ishin si rezultat i fushatës qeveritare me moton, "Maqedonia, porta hyrëse në Ballkan" apo "Investo në Maqedoni: parajsa e re për biznesin tënd në Evropë", slogane të cilët e paraqitën vendin si parajsë afariste në Evropë.

Kurse, kompania e mirënjohur kroate "Agrokor" bëri thirrje që të mos investohet në Maqedoni, pas obstruksioneve qeveritare që i`u bënë kësaj kompanie, e cila kishte planifikuar investime prej 40 milion eurosh në sferën e grumbullimit të prodhimeve bujqësore. "Agrokor", e profilizuar si kompani për prodhime ushqimore dhe pije dhe e cila merret me grumbullimin e prodhimeve bujqësore, kishte planifikuar hapjen e dy qendrave të grumbullimit për prodhimet vendore në Maqedoni dhe plasimin e tyre në tregun evropian. Kompania kroate, edhe pse kishte nënshkruar marrëveshje me Qeverinë për realizimin e investimeve të

saja, më pas ka dështuar gjithçka dhe fajet i janë adresuar krerëve qeveritarë maqedonas.

Menaxhimi i brendshëm i dobët dhe indiferenca e qëllimshme e Qeverisë ndaj Swedmilk, bëri që të falimentoj edhe kjo kompani multinacionale. Bashkë me këtë bankrotuan, edhe shumë fermerë, shpresa ekonomike e të cilëve me ardhjen e kësaj kompanie në vend filloi të gjallërohet, si dhe shkuarja apo transferimi i kësaj kompanie në duar të oligarkëve, rezultoi me shuarjen totale të shpresave të fermerëve për ndonjë rigjallërim të ardhshëm. **Pas gjykimeve të pambaruara nëpër gjykata vendore dhe ndërkombëtare të Qeverisë me kompanitë e huaja, tash së fundi edhe operatori mobil VIP, ka vendosur ta padisë Qeverinë për mosrespektim të konkurrencës ndërmjet kompanive operatore. Shihet qartë një anim i Qeverisë për ndonjë kompani tjetër, kurse çdo anim e ka koston e vetë korruptuese të shprehur në para!** Pra, përfaqësuesit e kompanive të huaja në Maqedoni vlerësojnë se problemi kryesor i investitorëve janë procedurat burokratike, gjyqësori i pareformuar, mosrespektimi i rregullave tregtare, çështjet pronësoro-juridike, ndryshimet e shpeshta ligjore dhe administrata joefikase.

Aktualisht dëgjojmë për një kaos në fabrikën e sheqerit, pikërisht në kohën kur për shkaqe natyrore në Brazil dhe në disa shtete tjera bie në mënyrë drastike prodhimi i sheqerit. Ndoshta mund që t'i humb pak ëmbëlsia këtij shteti prej mungesës së sheqerit, por nuk ka edhe aq rëndësi kur e dimë se shteti në fjalë vuan nga sëmundja e diabetit. Pra, pritet që shumë shpejtë në vendin tonë, të ngrihet çmimi i këtij produkti elementar. Mashtrimi dhe kontradikta qëndron në atë se, me rënien e produkteve me origjinë nga jashtë, nuk bien menjëherë çmimet e produkteve, kurse me ngritjen e çmimeve të produkteve me origjinë nga jashtë, menjëherë ngrihen çmimet në vend, ndoshta edhe më shpejtë se atje! Sikurse siç ishte rasti me ngritjen e çmimeve të karburanteve në nivel botëror. Në bursat amerikane dhe evropiane binte çmimi i karburanteve për barel, kurse këtu vazhdonte të qëndrojë çmimi i

karburanteve si më parë. Ky ishte një rast i mirë, për hajdutët zyrtar apo për kriminelët ekonomik! Krejt papritur, në fillim të këtij viti në media dëgjojmë se, papunësia e cila ishte 34 % do të ulet në 31.5 %, si dhe sivjet do të rritet dukshëm investimi i kompanive multinacionale në vend. Ky ishte vetëm një paralajmërim dhe asgjë tjetër. **Kësisoj, "zona e lirë ekonomike" mbeti me të vërtet zonë e lirë me plot kuptimin e fjalës!** Sepse, me rebalanc të buxhetit është e pamundur të kemi rritje reale ekonomike. Përkundër gjithë këtyre pakuptimësive, për hir të identitetit kombëtar, Qeveria nga buxheti i shtetit ka vendosur t'i dërgoj 500 tifoz maqedonas në Poloni, në ndeshjen e basketbollit që zhvillohet ndërmjet Maqedonisë dhe Greqisë. Vaj halli, edhe nëse humb! Ekonomia botërore ka filluar të del nga recesioni financiar, kurse në Maqedoni ka zëra se së shpejti shteti ynë do të futet në recesion zyrtar. Siç duket menaxherët e këtij shteti i paska kapluar sindroma e të pazëvendësueshmit, kur mendojnë se gjithçka është në rregull si rrjedhojë e qeverisjes së tyre. Kjo pra, na qenka kontradikta ekonomike! Por të merremi vesh, ne bëmë fjalë vetëm për një pjesë të kontradiktave ekonomike, për tjerat shëndosh herëve tjera...

Pisllëku i lartë, mundësi e mirë për larje të parave

Si rrjedhojë e vështirësive gjatë realizmit të transaksioneve të komplikuara, lindi nevoja për një ndërmjetësues, i cili do të tregonte vlerën e vërtetë dhe momentale të mallrave, ngase përmes këmbimit të thjeshtë, i njohur si këmbimi i mallit me mall, ishte shumë vështirë të realizohet një tregti në përmasa përafërsisht të barabarta ndërmjet shitblerësve. Nevoja e këtij kursi të atëhershëm tregtar lindi paranë!

Sikurse çdo lindje dhe zbulim tjetër, që shoqërohet menjëherë me të kundërtën apo me armikun e saj, edhe paraja si fenomen shoqëror e ekonomik nuk shpëtoi dot nga një shoqërim i tillë. Edhe njeriu si krijesë shoqërore, me rastin e daljes në këtë botë nuk shpëtoi dot nga djajtë shoqërues, që i tërë misioni i tyre përthekohet me pengimin, shkatërrimin, degradimin dhe humbjen e tij.

Armiqtë apo veprat penale të parasë janë të shumta, ndaj në pamundësi kohore dha hapësinore për paraqitjen e të gjithëve, kursin e studimit tonë do e orientojmë në fenomenin e pastrimit të parave të pista. **Pastrimi apo larja e parave është kthimi i të ardhurave të realizuara ndër vite apo muaj, me mjete jashtëligjore në pasuri, të cilave është vështirë tu gjendet origjina apo burimi i grumbullimit të të ardhurave**. Shtetet e preferuara dhe të përshtatshme për larje të parave janë ato shtete të cilat janë të zhytura në pisllëqe juridike, ekonomike, politike dhe shoqërore. **Është pak paradoksale që paratë e pista të pastrohen në një vend me nivel të lartë të pisllëkut!**

Por, nuk duket edhe aq e tillë kur mendojmë se në këtë afarizëm kemi të bëjmë me palë dhe njerëz të pistë. Paralelisht me larjen e parave të pista, lahen edhe njerëzit e ndytë në një vend po ashtu të ndytë, ngase amnistia nga një vepër penale e tillë, bëhet prej fundërrinave të cilët qeverisin me pushtetin.

I kemi të njohura rastet nga jeta e përditshme, kur një afarist me veprimtarinë e tij kundërligjore dhe kundërnjerëzore bën grumbullimin e pasurisë në vend apo jashtë vendit, investon në ndonjë ndërmarrje apo në ndonjë objekt kombëtar dhe fetar, pastaj si nga pushteti ashtu edhe nga populli, njeriu në fjalë njihet si njeri i ndershëm, bamirës apo i devotshëm, kurse në të vërtet ky njeri kriminel është në fazën evolucionare të pastrimit. Shumë shtete me ekonomi të zhvilluar dhe me sistem të shëndoshë juridik, prej kohësh janë duke grumbulluar para vetës masa për parandalimin e këtij fenomeni rrënues. Shtetet me sisteme të mirëfillta në aspektin e përgjithshëm, e preferojnë më shumë parandalimin, sesa luftimin. Ndërkaq, shteti i Maqedonisë, i cili deri në fyt është i zhytur dhe i përfshirë prej një sëmundje të këtillë, mekanizmat shtetërore të dobëta të përgjithshme e preferojnë më shumë luftimin, sesa parandalimin e larjes së parave (në teori paraqiten për parandalimin, kurse në jetën reale e manifestojnë luftimin gjysmak dhe sipërfaqësor). Këta më shumë e preferojnë që të sëmurin ta shërojnë, sesa të shëndoshin ta ruajnë që të mos sëmuret!

Pse ky shtet e pëlqen më shumë luftimin, sesa parandalimin e këtij fenomeni shkatërrues. Sepse, përmes luftimit bumi medial, besueshmëria dhe ngritja e rejtingut partiak do të jenë në qendër të vëmendjes, kurse përmes parandalimit shteti duhet t`a ulë papunësinë, të ofrojë shërbime administrative të shpejta dhe efikase, të ndajë mjete buxhetore për trajnime të qytetarëve rreth larjes së parave, t'i kërkoj burimin financiar të gjithë bankave dhe firmave, t'i dënojë ashpër punëdhënësit që asnjë kontribut juridik nuk ia realizojnë punëtorëve, si dhe përmes parandalimit urgjentisht pushtetarët duhen të flijohen nga të jetuarit super-luksoz. **Të gjithë këto masa parandaluese për qytetarin e thjeshtë, nuk**

janë të vërejtura edhe aq shumë (edhe pse shumë të dobishme për ta), kurse arrestimi i një biznesmeni malazez, si i dyshuar për larje të parave, përmes firmës së tij në Shkup, i cili ka larë rreth 30 milion dollar të lëshuara kryesisht nga firmat e huaja, u vërejt goxha shumë. Kështu pra, shteti ynë përballet me larjen e parave të pista, në cilësinë e luftimit, e assesi të parandalimit. Ky rast i rrallë në Maqedoni, u vlerësua si një e arritur e madhe e drejtorisë për pengim të larjes së parave! Rasti në fjalë, njëkohësisht ishte edhe një dalje nga anonimiteti i kësaj drejtorie, ngase ne si qytetarë edhe pse çdo ditë shihnim dhe shohim, sesi njerëzit pasurohen dhe ndërtojnë objekte, që as vet nuk e dinë burimin e të ardhurave, e në të njëjtën kohë drejtorisë në fjalë, nuk i`a kemi dëgjuar zërin. Me të drejtë konstaton një profesor ekonomist kur thotë: "angazhimi i agjencive për larjen e parave në aspektin financiar është vetëm formal, kemi drejtorinë për këtë çështje, por realisht në praktik ata s'kanë aftësi dhe kapacitet për ta ndjekur këtë proces".

Larje të parave në këtë shtet kemi kudo. Mjafton një retrospektivë katërvjeçare rreth gjendjes sociale dhe financiare të ministrave apo të deputetëve, si dhe një dallim prej gjendjes së atëhershme në këtë të sotshmes, ku do të mbesim pa fjalë dhe pa pasthirrma, kur do t`ia shohim shtëpitë, banesat, veturat dhe bizneset tjera, të cilët mbijnë sikur kërpudhat pas shiu. A nuk janë këto larje të parave me mjete të qytetarëve? Kjo nuk është vetëm larje e parave prej mjeteve monetare të qytetarëve, porse kjo është larja e trurit të qytetarëve në mënyrë institucionale, ngase po këta qyqarë, më falni qytetarë tashmë të pastruar në tru, po i shkojnë mbrapa oligarkëve financiarë, të cilët përpos interesave postare dhe materiale nuk njohin asgjë tjetër.

Në këtë shtet, ndodhi diçka e çuditshme dhe tejet kontradiktore në lidhje me luftimin e krimit ekonomik. Policia në kufirin e Tabanocit dhe të Qafë Thanës, i arrestoi ca policë për ryshfet dhe korrupsion, kurse pastaj policia arrestoi një biznesmen të Malit të Zi për larje të parave, ndërkaq të dy palët do gjykohen

nga njerëzit e infektuar që moti me këtë virus! Ky shtet, tashmë pretendon të paraqitet si lule përballë të tjerëve, ku do t'i josh mirë fluturat vëzhguese, por harron se lulet improvizuese janë të stërmbushura me baktere të ndryshme. Kësisoj pra, në vendet me nivel të lartë të pisllëkut, është vështirë apo e pamundur parandalimi dhe luftimi i pastrimit të parave të pista, sepse pisllëku e tërheq mikrobin, kurse mikrobi është i rehabilituar dhe i kënaqur në pisllëk!

Krizë sociale, edhe për të punësuarit

Fillimisht përmes këtij shkrimi i kërkojmë falje atyre njerëzve (të cilët fatkeqësisht janë të shumtë në numër) që ende janë të papunë, por të aftë dhe të gatshëm për punë. Ndoshta, deri diku do të mishërohemi me ta! Dëshirojmë t'i themi se, nuk janë vetëm ata në krizë sociale. Dallimi qëndron në atë se, të papunësuarit shpresojnë për një punë të ardhshme të mundshme, ndërkaq të punësuarit ëndërrojnë një pagë, ku të paktën mund t'ia dalin në sigurimin e gjërave elementare deri në fund të muajit. Por, fenomeni i cili i bashkon të dytë, është ankimi për gjendjen e mjerueshme sociale dhe mospasja mundësi për të bërë diçka të dobishme dhe dobiprurëse, për veten dhe për familjet e tyre. Mjafton një shëtitje me autobus, prej fshatit në qytet apo prej qytetit në kryeqytet dhe anasjelltas dhe do kesh mundësi praktikisht t'i dëgjosh klithmat dhe psherëtimat e të punësuarve në lidhje me pagat e ulëta dhe simbolike. Pastaj i gjithë ky diskurs ankues, pa dyshim dhe me automatizëm do shoqërohet me uljen e efikasitetit në punë, apo rritjen e kërkesës dhe "arsyeshmërinë" për t'u korruptuar. Ngase, me pagë mujore në vlerë maksimale prej 300 euro, mundësia për mbijetesë qenka shumë e vogël, të mos flasim për mundësinë e jetesës!

Ndoshta, kjo krizë nuk ekziston te pala tjetër, ku dihet mirëfilli numri i vogël i anëtarëve në familje, si dhe njëkohësisht (përpos fëmijëve) të gjithë të punësuar apo të pensionuar. Kurse te etniteti shqiptarë, puna qëndron më ndryshe! Duke filluar prej numrit të madh të anëtarëve në familje (mos të harrojmë se, edhe kjo është një begati), e deri tek njëshi i të punësuarve. E gjithë

familja sytë i drejton tek ai, kurse i punësuari nga nevojat e mëdha në familje, hutohet aq shumë saqë nuk di nga ti drejtojë sytë, duke u krijuar kështu një rrëmujë prioritetesh në familje. Vetëm për gjëra të domosdoshme një familje në muaj harxhon, përafërsisht 250 euro, të mos flasim nëse eventualisht e ke ndonjë fëmijë të regjistruar në fakultet, apo mos dhashë Zoti që ndonjëri prej anëtarëve të familjes të vuaj prej ndonjë sëmundje. Tek sa po i bëj kalkulimet rreth të ardhurave dhe shpenzimeve mujore, vërdallë kokës po më sillen mendime, rreth atyre personave në moshë të shtyrë, e me bollëk të anëtareve mbrapa vetës, njëkohësisht me probleme shëndetësore të rënda e të vazhdueshme, e që i presin vetëm 50 euro në muaj, si ndihmë sociale. Kurse, ne më lartë thamë se minimumi i shpenzimeve të domosdoshme në një familje është 250 euro. Tmerr, paradoks, mizori, kundërthënie, përvëlim, por para se gjithash mjerim social i vërtetë dhe përjetues!

Është më se e qartë se me punësime sporadike dhe sipërfaqësore nuk zbutet papunësia dhe nuk përmirësohet mirëqenia ekonomike! Këtë teori e dëshmon, edhe shkenca e mirëfilltë ekonomike. Nëse mëtohet se me punësime sporadike dhe tendencioze do ulet papunësia dhe do rritet mirëqenia familjare dhe shtetërore, atëherë pohimi apo teoria në fjalë ka ra në grackën e kontradiktores dhe në vorbullën e gënjeshtrës. Sepse, nëse punon vetëm një anëtar i familjes dhe shtatë të tjerë presin prej tij, atëherë krizat dhe konfliktet sociale në familje kanë gjasa dukshëm të rriten. Njëkohësisht, rritet kërkesa apo nevoja për të mira materiale elementare (dikush pra, po punon, ndaj gradualisht ndihet nevoja e injorimit të të mirave), ndërkaq mundësia financiare nuk përputhet me nevojat e familjes. Kësisoj, prej konflikteve në familje nuk ka mundësi të qëndrojë rehat, edhe komuna përgjegjëse e atij vendi, apo shteti në përgjithësi. Nëse dëshirojmë ta dimë zhvillimin ekonomik të shtetit, është mirë të nisemi prej këtyre parametrave mikroekonomik. Janë gjepura dhe gënjeshtra të radhës, pohimet dhe prezantimet e politik-bërësve dhe ekonomik-bërësve para faktorit ndërkombëtare, gjoja se shteti ynë nuk është edhe aq keq.

Është fakt se ata i`a paraqesin gjendjen ekonomiko-sociale të volitshme dhe progresive, sepse zhvillimin dhe mirëqenien e shikojnë, vetëm prej këndit të vet. Një llomotitje e shkurtër dhe e kotë e atyre kushton 50 euro, aq sa merr në muaj prej ndihmës sociale një i papunësuar. Po këta politik-bërës dhe ekonomik-bërës, nuk reagojnë fare për çmimet astronomike të semestrave nëpër universitete, e sidomos nëpër universitetet private, edhe këtë e bëjnë gjoja se në emër të ekonomisë së tregut. Po mirë, nëse për kushtet dhe standardet e jetesës nuk kujdesen këta njerëz kompetent dhe të diturit e kësaj shkence humane, atëherë kush duhet të kujdeset? Kalkulimet e shpenzimeve dhe të ardhurave për kokë banori kush duhet t'i bëjë? Si ka mundësi që me të ardhura mujore në vlerë prej 300 euro (duke i marrë për bazë, edhe shpenzimet e tjera të domosdoshme), të regjistrohesh në fakultet ku viti kushton 1200 euro, kurse në këtë kohë vështirë është bërë pa fakultet. Udhëheqësit financiarë, që me profesion janë ekonomistë të specializuar, vallë i ka shkuar ndonjëherë ndërmend ky fakt, apo në tema të ngjashme kanë magjistruar e doktoruar. **Si mund të flasim në këtë shtet për shportat e kursimit, ku të ardhurat mujore nuk mjaftojnë as për shpenzimet e domosdoshme!** Edhe, përkundër këtyre të ardhurave simbolike, shteti me politikat kinse të shëndosha makroekonomike, ka vendosur që konsumatorit t'ia marr 18 % në kuadër të TVSH-së. Për këtë arsye në këtë shtet, apo në kësi lloj shtetesh qenka i vështirë dhe i pamundur luftimi i krimit ekonomik të organizuar. Ata që nuk po mundkan t`a durojnë mjerimin social, spontanisht qenkan të prirë që të ardhurat t'i sigurojnë nëpërmjet rrugëve tjera të paligjshme. Kurse ata, të cilët i paska mundur bollëku financiar po e vendoskan rendin ekonomik, duke i ngritur çmimet e produkteve sikur në Zvicër, por me paga sikur në Zimbabve.

Pra, me kësi lloj politikash ekonomike, shtetet në fjalë i ngjajnë peshëngritësve të cilët urdhërohen t'i ngritin 300 kilogram, por me vite të tëra duke ngrënë buke e krip e zemër, ku dihet mirëfilli se momenti i peshëngritjes nuk kërkon bujari, por kalori!

Zgjohu qytetar, e mos e shiko korrupsionin si qyqar!!!

Ndër shekuj roli i shoqërisë civile, kundrejt problemeve të shumta dhe të ndryshme shtetërore ka qenë i pashmangshëm. Revolucionet e njohura, shpërbërja e sistemit monist, ngritja e vetëdijes kombëtare e morale, pikërisht rrënjët i ka te nisma qytetare. Qytetari, qoftë i thjeshtë apo me autoritet profesional, është ai i cili e zgjedh udhëheqësin, por edhe pikërisht është ai i cili mund t`a dënojë të zgjedhurin e vet, kuptohet përmes votës së ardhshme dhe angazhimit si grup shoqëror.

Fatkeqësisht, deri më tani një mendësi e tillë eksploduese dhe protestuese përballë të zgjedhurve për dukuri negative që e dërmojnë shoqërinë dhe shtetin, dukshëm i ka munguar truallit shqiptar. Jo pse qytetarët shqiptarë ishin frikacakë, jo pse vuanin prej sindromës së përtacisë, por heshtjen e tyre të zëshme dhe pragmatike e jetësuan duke pritur një punësim të thjeshtë prej partive politike. Shumica e qytetarëve shqiptarë në Kosovë, viruset që shkaktuan vdekjen e tyre, siç ishte krimi ekonomik dhe korrupsioni, e shikuan si obligim dhe detyrë të huaj. **Këtë pikë të vështirë e kritike të ndërgjegjes së korruptuar politike e rrahu dhe i priu dinjitetshëm lëvizja Vetëvendosja, ku pati disa përkrahje edhe prej pjesës së personelit intelektual, por të pamjaftueshëm që të përballen me këtë kancer të shoqërisë.** Ndër vite, shqiptarëve të Kosovës u ishte mbjellur një mentalitet nënshtrues ndaj të huajve, duke kaluar në skajshmëri në urdhrat dhe deklaratat e faktorit ndërkombëtarë, duke menduar se çdo gjë që vjen prej jashtë është e përkryer, ndërsa e përkryera e vërtet prej brenda shikohej me dyshim.

Por, gjatë këtyre javëve prej të huajve dëgjuam diçka interesante, çka nuk kishim dëgjuar më parë. Ata na bërën me dije se, në dorë të qytetarëve është çelësi dhe barna kuruese e virusit vdekjeprurës i cili quhet Korrupsion, ndonëse thirrje e vonuar, sepse tashmë "liridashësit" e dikurshëm mbërritën në katin e tetë të ndërtesës dhe në kompleksin e dhjetë të shitoreve. Por, populli thotë më mirë vonë se kurrë!

Ne ende nuk e kemi të qartë, se sa do të jetë e vlefshme kjo maksimë për ata që janë mishëruar me këtë fenomen dashakeq, fjala bie funksionarët e Kosovës, sa janë të gatshëm t`a realizojnë një iniciativë të tillë prej qytetarëve, qytetarë që u varfëruan si qyqarë prej të pamëshirshmëve!?

1.1. Çfarë veprimesh duhet të ndërmarrin qytetarët për parandalimin dhe luftimin e korrupsionit?

Kusht që një dukuri e keqe të mund të largohet, fillimisht është urrejtja e saj kur i merr parasysh dëmet e shkaktuara ndër shekuj, pra me këtë rast ngritja e vetëdijes së qytetarëve për dëmet që i shkaktoi korrupsioni dhe urrejtja në mënyrë permanente e këtij virusi që është i vendosur që moti në Kosovë, me këtë edhe sensibilizimi i korrupsionit nëpër mediat e shkruara dhe elektronike, bashkëpunimi i qytetarëve me institucionin për anti-korrupsion, kërkesa me ngulm ndaj funksionarëve për bërjen publike të pasurisë, parandalimi dhe luftimi individual, në ndonjë rast të thjeshtë, siç është rasti i nxjerrjes së ndonjë dokumenti; certifikata, letërnjoftim, pasaporta e të ngjashme, prononcimi i guximshëm dhe i hapur në cilësinë e dëshmitarit në rast akuze për korrupsion, etj.

Në Kosovë, vazhdojnë të zhvillohen dhe mbillen kundërthënie të hapura, kur kemi të bëjmë me akuzat për korrupsion. Bie fjala, z. Haradinaj e akuzon z. Thaçin për infiltrim të Qeverisë, e me këtë edhe të tij në korrupsion. Ky rast mua më shtyn ta pyes vetën se, vallë korrupsioni me

korrupsion mund të zhduket, apo në këtë rast të ndërsjellë paskemi korruptim të korrupsionit!!! Si rrjedhojë e këtyre kundërthënieve zyrtare, Kosova është vlerësuar negativisht në luftën kundër korrupsionit, edhe nga një organizatë ndërkombëtare. Kosova ka marrë 67 pikë, që konsiderohet notë e dobët, në raportin e organizatës ndërkombëtare me seli në SHBA, "Global Integrity". Ky vlerësim e radhit Kosovën në listën e vendeve që kanë integritet të dobët, dhe që janë të ndikuara nga korrupsioni, papërgjegjësia dhe jo-llogaridhënia.

Të parët tanë thoshin se gjarpri mbytet në kokë, me këtë tashme ne themi se korrupsioni për t`u parandaluar, është mirë që të fillojë prej lart, por kjo tashmë duhet të luftohet prej ushtarëve (lexo: qytetarëve) prej poshtë drejtë hierarkisë vertikale.

Pra, edhe pse vonë zgjohu qytetarë, në luftë kundër korrupsionit, ju ishit ata që i rezistuat demonstratave të tmerrshme përballë bishave të egra, ju ishit ata që e bëtë luftën, ju jeni ata që më shumë se askush tjetër po i paguani faturat e korrupsionit, ju pra do të duhet të jeni ata që në vazhdimësi jeni të obliguar t`a çrrënjosni dhe luftoni korrupsionin, qoftë edhe nëse armiku i quajtur korrupsion është më i fortë dhe më i armatosur se ju, por mos e harroni se edhe serbët me sloganin "fitorja gjithherë qenka me masën dhe forcën", në realitet edhe pse ishin me armatim shumë më të fortë se sa ne, si dhe me epërsinë në njerëz, prapë u dogjën, sepse ata ishin sikurse shkuma e detit, apo e koka-kolës, ndërsa vet ne ishim deti, pra edhe në këtë rast, vet NE qytetarët jemi deti pa bregdet.

"Falë" kërkesës për azil ekonomik, doli në shesh një pjesë e krimit ekonomik

Sot, mund të gjobitesh shumë rëndë vetëm për një bukë të vjedhur, apo mund të gjobitesh me një pagë të tërë, vetëm pse e ke harruar jelekun e gjelbër për veturë në shtëpi, por sot vështirë është të dënohesh, nëse eventualisht i ke harruar milionat e vjedhura në shtëpi. Pastaj si rrjedhojë e këtyre kontradiktave, mbetëm të hutuar kur e pamë duke mbirë ndërtesa shumëkatëshe, duke mbirë komplekse shitoresh dhe duke pikur nga qielli limuzina(t). Besa, po të njëjtët individë në cilësinë e solidaritetit dhe popullaritetit, i pamë duke i ndihmuar me shuma simbolike organizimet e ndryshme që bëheshin në dobi të shoqërisë, i ushqenin të varfrit dhe në ditë vikendi i ushqenin mirë edhe zagarët e tyre për gjah, e gjithë kjo me një prapavijë dashakeqe, ku me anë të fitimit pa djersë dhe në kurriz të popullit, kinse po i ndihmojnë popullit, popull i cili vuan për kushte më të mira ekonomike dhe sociale, kushte të cenuara po nga këta që po bëhen sikur po ndihmojnë.

Kështu që, i gjithë ky konglomerat pisllëqesh dhe shumë pisllëqe të tjera i pagoi populli i gjorë dhe i pafajshëm, duke përjetuar protesta të ndryshme me pasoja të dhimbshme, burgosje për shkollim në gjuhën shqipe, helmime të nxënësve shqiptarë, vrasje të montuar për arsye se nuk qe në gjendje të dashurohen dot në këtë shtet, ndërsa kupa vullkanike e padrejtësive që menduam se njëherë e përgjithmonë i thamë lamtumirë ishte lufta e 2001-shit, për të cilën inteligjenca shqiptare as për së largu nuk e ka ndërmend të merret me ndonjë studim të veçantë në vështrimet se, pse ndodhi kjo luftë, ishte luftë apo konflikt, si u zhvillua, si

përfundoi dhe pse përfundoi në këtë mënyrë, pse edhe kësaj radhe tabori politik shqiptarë mbeti i ndarë dhe kush fitoi në këtë luftë, apo pse humbën që të dyja palët gjatë kësaj luftë, pyetje këto që në përgjigjet shkencore të tyre më së lehti mund t'i gjesh shkaqet dhe faktorët e braktisjes së vendit.

Si pasojë e mospërgjigjeve në ndonjë studim të veçantë nga ana e inteligjencës shqiptarë, të cilët kishin themeluar edhe institute speciale për studime, por realiteti dhe përditshmëria po flet se këto institute nuk janë gjë tjetër, pos koncerte që shërbejnë për mbulesë të dobësive të tyre intelektuale dhe morale, viruset në rajonet tona sa vijnë e rriten, që tashmë mund t'i shohim edhe me sy dhe me teleskop, pra nuk na vyen më mikroskopi.

Kësisoj, ne u mashtruam në mendime dhe vlerësime se kishte përfunduar epoka e arritjes së kushteve më të mira ekonomike, përmes metodave të zhurmshme dhe të dhunshme. **Menduam se mbollëm mjaft, sa për t'i përballuar me vite të tëra thatësira të ndryshme, edhe pse nuk e prisnim ndonjë thatësirë eventuale**. Por, neve nuk na kishte shkuar fare ndër mend se, edhe pas nëntë viteve prej kohës kur mbollëm, dikush do ta braktiste vendlindjen për arsye të kushteve sociale dhe ekonomike mizore. Shtrohet pyetja, se si qe e mundur që një rajon i tërë me shqiptarë, ta merr guximin që ta braktisë vendin për arsye të kushteve të rënda ekonomike dhe sociale, duke qenë njëkohësisht të udhëhequra të dy dikasteret me ministra shqiptarë. Si është e mundur që për vite të tëra të mos investohet asgjë në rajonin e Likovës - Kumanovës (në pjesën shqiptare)?

Si rezultat i këtyre të mundurave, pasoi edhe eksodi i tmerrshëm në këtë rajon. Por, eksod që u kthye në një flijim të madh, në një turpërim të hapur të udhëheqësve tanë.

Kur dëgjuam për herë të parë për eksodin e dhembshëm shqiptar, përpos dhimbjeve dhe dëshpërimit që e ndjenim, e pyesnim vetën se, vallë këta që shkojnë i përkasin kombit shqiptar, apo tashmë nuk kanë kohë të dëgjojnë për kombin dhe e kanë në plan që të asimilohen atje, do të kthehen si vizitorë ndonjë

herë këtu, apo në atë kohë të lirë do të ikin larg e më larg, vetëm mos të dëgjojnë fare për neve këtu, ne që dikur i dëshpëruam!? Por, edhe njëra edhe tjetra nuk ishin të vërteta, sepse po këta njerëz që e braktisën vendin prej hallit të madh, shumë shpejt u kthyen në vendlindje në mënyrë vullnetare. Tashmë këta, lirshëm mund të konsiderohen si kontribuues të vërtetë të atdheut të tyre. Sepse, në këtë kohë të mjegullt po këta njerëz protestuan në mënyrë praktike e paqësore në Belgjikë e gjetiu, ku thirrën në ndërgjegjen e botës, duke i thënë se në vendin prej nga vijmë, kemi njerëz shumë të pasur dhe shumë të varfër, për të qenë tmerri dhe kontradikta edhe më e madhe, shtresa e shumë të pasurve janë të zgjedhurit tanë me karvanin e tyre prej biznesmenëve, që shumica e tyre ishin shumë të pandershëm dhe fare s'kishin mëshirë për punonjësit e vetë. Po këta, që para ca javëve e braktisën vendin i detyruan autoritetet belge që ta vizitojnë komunën e Likovës, i angazhuan edhe inspektorët financiarë për disa kontrolle dhe revizione kundrejt agjencive turistike, po këta patriotë në mënyrë praktike i thanë ministrave dhe deputetëve shqiptare, se ju nuk vleni as sa një qindarkë, qoftë edhe nëse jeni milionerë, po këta i treguan Bashkimit Evropian se fondet të cilët ju i dërgoni për në Maqedoni as ashklat (mbeturinat) e tyre në rajonin tonë nuk mbërrijnë, në këtë rast duke mos i akuzuar vetëm autoritet maqedonase, por edhe ato shqiptare, si dhe po këta tashmë të cilësuar si protestues botërorë, i`a bërën me dije edhe ndërmarrësve të pandershëm, ose kriminelëve ekonomik, se ne si punëtorë duam kushte dhe paga më të mira, duke na i paguar të gjitha kontributet që na takojnë me ligj. Kjo ngase, desh u trenuan punëdhënësit, duke u ankuar nëpër gazeta se po na ikin punëtorët prej ndërmarrjeve.

Për t`i kuptuar më mirë këta ndërmarrës se pse punëtorët i ikën prej ndërmarrjeve, do t'ia bëjmë një pyetje shumë të thjeshtë. Pse vallë ju dhe fëmijët e juaj nuk i braktisët shtëpitë dhe ndërmarrjet apo e njëjta pyetje i drejtohet edhe të zgjedhurve të popullit, që as që i shkoi ndërmend të kërkojnë azil ekonomik

diku në Evropë. Përgjigjja ime është: “Ju dhe ata, nuk kërkuat azil ekonomik, për arsye se ju nuk e vodhët as edhe një bukë, as nuk e kishit harruar jelekun e gjelbër në shtëpi, por ju kishit harruar diçka tjetër në shtëpi, pra “BUKËN”!!!

Sikur kryetari, kryeministri, ministrat dhe deputetët t`a kenë rrogën nga 320 euro!!!

Titulli i këtij artikulli, padyshim që dikujt i duket paradoksal dhe tejet i pakuptimtë. Mund të mendoni se autori në fjalë po jetuaka diku në kontinentin e tetë që nuk ekziston, mund të mendoni se si është e mundur i tërë ky angazhim të shoqërohet me një pagë simbolike, dikush tjetër mund të konstatojë se në bazë të kësaj teze të plasuar, autori qenka dukshëm i ndikuar prej ideve rreth zhdukjes së klasave dhe krijimit të një shteti social që dikur na ftonte Migjeni, si nuk ju duket kjo mendësi dhe tezë kundër-produktive, madje kjo njëkohësisht është edhe turp përballë funksionarëve të shteteve tjera dhe përgjithësisht, shkruesi i këtij artikulli qenka larg realitetit ekonomik.

Si rrjedhojë e kësaj largësie ekonomike, do të jemi në vazhdimësi të prirë të hapim debate dhe dilema të reja që shpesh-herë janë të habitshme, por që askush prej shoqërisë civile nuk do të ketë faj për absorbimin e këtyre ideve "qesharake", ndaj ne po mundohemi të hedhim dritë mbi problemet, qofshin paradoksale dhe qesharake për dikë jashtë Ballkanit, duke e ditur realitetin se po jetojmë në një vend të tillë qesharak dhe humoristik, humor fare pakripë, ndërsa i prezantuar prej funksionarëve si i ëmbël, por askush asnjëherë nuk e pa këtë shtet duke konsumuar sheqer dhe mjaltë.

Mund të ketë të drejtë lexuesi i nderuar, por para se të privilegjohet me një të drejtë dhe konstatim të tillë, unë pyes, vallë ju duket realitet ekonomik financimi në objekte të vdekura edhe atë në kohën e krizës financiare, financimi i kompanisë së Pasko

Kuzmanit për zbulimin e nëntokës, që i përkasin duke menduar rreth të kaluarës e cila patjetër atyre duhet t'i përket, financimi i enciklopedisë qëllimi i së cilës ishte fyerja e shqiptarëve, mirëmbajtja e kryqeve dhe kishave, pastaj në kuadër të mbulesës së këtyre shpenzimeve të pakuptimta, pasuan dënimet astronomike, ku nëse pështyn në ndonjë funksionar, më falni në rrugë do të dënohesh me 50 euro, nëse e hedh ndonjë mbeturinë në Qeveri, më falni në tokë do të dënohesh po ashtu 50 euro, qoftë edhe nëse nuk gjeni shporta dot, patjetër duhet ta mbani mbeturinën apo letrën në dorë me orë të tëra deri sa ta gjeni ndonjë shportë dhe nëse eventualisht ke harruar ndonjë pajisje të veturës në shtëpi do të dënohesh me 300 euro e më lartë.

Papritmas duke ecur rrugës i zhgënjyer se pse rroga e muajit mars asnjëherë nuk po takohet me rrogën e muajit prill, i dëgjon sirenat dhe alarmin e veturave të funksionarëve të rrethuar me roje, veprim i cili të shtyn të mendosh se, vallë funksionarin në fjalë e ka zgjedhur populli, apo pritet që ta dënoj populli, nëse kjo nuk është e vërtet, pse atëherë ruhet prej popullit aq shumë. **Kështu gjithherë kishte ndodhur, kur vozitësit, të voziturit, veturat dhe sirenat kishin energji dhe kalori të tepruara. Nuk është thënë kotë se, njeriu me barkun plot dhe i rrethuar me gjitha të mirat e Zotit, nuk do të ketë kohë të mendoj edhe për pjesën tjetër shumicë, zorrët e të cilëve prodhojnë muzika të zhanreve të ndryshme dhe kolazhe, muzikë e krijuar si rrjedhojë e barkut të tejzbrazur**. Ata gjendjen e shtetit e shohin vetëm prej prizmit të vet, ata fëmijët e tjerë mundohen t'i kuptojnë përmes fëmijëve të vetë, me një fjalë, ata jetësimin e gjitha të mirave materiale i shohin përmes të mirave të tyre, por nëse me të vërtet mendojnë kështu, atëherë moralisht janë të detyruar që mos t'i besojnë rrogës mesatare në vend, kësisoj ata duhet që për rrogë mesatare në vend ta marrin rrogën e tyre, ngase kështu po ua ka ëndja t`a shohin shtetin dhe funksionimin e familjeve të tyre.

Që të realizohet një kuptim real rreth gjendjes aktuale të popullit dhe për t'ia ditur hallet reale popullit, këta të zgjedhur për

momentin duhet t`a shoqërojnë popullin edhe me rroga, mjaft më vetëm me premtime, tek pastaj mund t`a dinë se sa keq qenkan qytetarët e vendit, që shpresat i kanë varë te ata që goja prej haresë në vazhdimësi po i bën vetëm muzikë. Funksionarët në fjalë, lëre që rrogën e kanë sa katërfishi i rrogës mesatare, por edhe një rrogë tjetër e nxjerrin prej mëditjeve, duke qenë të angazhuar nëpër komisione të shumta dhe të ndryshme, vlera e të cilave sillet e pështillet vetëm brenda katër mureve të objektit ku mbahet mbledhja dhe diskutimi, krejt në fund në mungesë të oksigjenit politik, diskutimi dhe frytet e mbledhjes vdesin, varrimi bëhet pas mandatit të tyre!

Tragjikja qëndron në atë se, po të njëjtët funksionarë harruan se dikur edhe ata ishin në po të njëjtin hall dhe mjerim, mjerim i cili i bëri të mendojnë natë e ditë se si të vijnë në pushtet, për t'i treguar paraardhësve të tyre pushtetarë, se edhe ne dimë të bëjmë sikurse ju, do të vijë koha kur edhe ne do të pendohemi, pastaj mund të bëhemi analistë të privilegjuar ku do t'i kundër-shtojmë dukuritë negative që po e sjellin në humnerë shoqërinë.

Pra, nëse trumbetohet të dilet nga kjo krizë financiare dhe morale, urgjentisht duhet venduar në plan afatmesëm shtetëror, që rrogat e funksionarëve të puqen e të bëjnë dashuri të barabartë me rrogat e pjesës së popullit të (pa)punësuar.

Meqë dolëm prej recesionit, pse nuk e ndërtojmë një teleferik për në Hënë?!

Njëri po i mban paratë, tjetri kuletën, njëri po vozitet me limuzinë, tjetri nuk po mund dot t'i tubojë paratë për t`a blerë një biçikletë, njëri po rren sa të mundet, tjetri po i beson përtej mundësive të tij, njëri po flet dhe krenohet me shifra, tjetri vetëm po i imagjinon ato shifra. Kështu njëherë, babai e kishte mashtruar fëmijën e tij se, kuletën e ka plot, gjë që ashtu edhe ishte, por me kalimin e kohës dhe rritjen e nevojave të fëmijës, doli sheshit se kuleta e babait kishte qenë plot, por vetëm me kartëvizita dhe letra të thjeshta, ku në mungesë të parave, fëmija i gjorë as në ekskursion me shkollën nuk arriti të shkojë.

Kështu, gjatë këtyre ditëve ministri i financave e ndezi një kandil, ku tregoi se vendi jonë e kaloi suksesshëm krizën financiare. Ai dhe elita e tij, harruan se në shtetin e ashtuquajtur Maqedoni, kemi pasur vetëm hyrje në krizë ekonomike, financiare, politike, kombëtare dhe sociale, e assesi dalje prej kthetrave të këtyre krizave. Ministri në fjalë si tregues dhe argument se shteti e kaloi recesionin, që me automatizëm kuptohet hyrja e shtetit në ekspansion, i përdori disa shifra që vetëm ata e dinë se prej ku i morën. Në momentin kur, Ministri i Financave e lajmëroi këtë të arritur teorike, në mënyrë magjike të varfërve që janë shumicë në këtë shtet, i`u mbushën pjatat me ushqim të bollshëm dhe vitaminoz, vetvetiu rrugët antike filluan t`a humbin natyrshmërinë e tyre, duke kaluar kështu në rrugë post-moderne, standardi jetësor filloi të lulëzojë më shpejt se gjelbërimi që sinjalizon fillimin e pranverës, dëshpërimi i qytetarëve u kthye në buzëqeshje, filluam të largohemi prej politikës ditore, filluam të flasim për ecurinë e

bursave, për politikën monetare dhe fiskale në vend, tanimë po e njohim vetëm Ministrin e Ekonomisë dhe të Financave, pra të gjithë ministrat tjerë i harruam, por fatkeqësisht kjo kronologji ishte një ëndërr e bukur, por e pabesueshme edhe në ëndërr, ëndërr që dje ma rrëfeu shoku im shumë i dashur.

Kjo ëndërr e bukur na shpalosi një fakt shumë të arsyeshëm, ku për tregues financiar dhe ekonomik domosdoshmërish duhen të merren qytetarët dhe se çdo tregues tjetër i shprehur në shifra, qartë dhe saktë tregon përfshirjen e tyre në (hiper)inflacion. Si është e mundur që ky vend të del prej recesionit, në kohën kur shumë ndërmarrje po mbyllen, siç ishte rasti me të falimentuarit e Kumanovës, të cilët përpara Qeverisë protestuan duke gjuajtur me vezë, por pa asnjë efekt, përpos që, tashmë mbetën edhe pa vezë. Për rajonet tjera shqiptare, çdo fjalë është e kotë, ku dihet mirëfilli se ata që moti i kishin harxhuar vezët. Ata nuk e gjuajtën Qeverinë me vezë, por në shenjë dëshpërimi dhe sinjali treguan se dikush nuk ka gjëra elementare për të ngrënë.

Ndoshta personeli që është në Qeveri, si argument dhe fakt për dalje të vendit nga kthetrat e recesionit, e marrin fillimin e realizimit të "Projektit Shkupi 2014", duke pohuar se me këtë rast do të angazhohen disa kompani ndërtimore, e të ngjashme. Por, ta pohosh këtë si argument të shëndoshë, me të vërtetë duhesh të jesh një historian i çmendur pa asnjë këshilltarë ekonomik. Sepse, angazhimi për realizimin e një objekti të vdekur, vlera e të cilit do të jetë vetëm aroma e qelbur, nuk është gjë tjetër pos plaçkitje legale e qytetarëve. Në ekonomi dhe historikisht, ky investim asnjëherë nuk quhet dhe nuk është quajtur si investim i frytshëm dhe rrjedhës, por investimin në fjalë e hasim vetëm atëherë kur është përkryer shteti në të gjitha aspektet e tij dhe tek pastaj vjen faza përfundimtare që quhet stilizim i shtetit me figura "interesante" historike, ndërsa objektet që tregojnë vjetërsinë dhe kulturën e një populli të lashtë nuk ndërtohen, por mirëmbahen brez pas brezi. **Është shumë paradoksale që në vitin 2010 e këndej të ndërtosh objekte, me**

paratë e popullit të tanishëm, vetëm e vetëm që t'i tregosh botës se edhe ne jemi të lashtë, lashtësi e shprehur me objekte të reja, punëtor të rinj, financues të rinj dhe gënjeshtarë të rinj. Pse unë si qytetarë i tanishëm të paguaj për ndërtimin e vendbanimit të X personave që nuk i njoh!? Piramida e Egjiptit nuk është ndërtuar prej qytetarëve të kësaj kohe, por ajo daton qysh prej kohës së faraonëve, ndërsa qytetarët e kësaj kohe mund të paguajnë vetëm për vizitën e atyre vendeve atraktive, por jo edhe për ndërtimin e atyre piramidave.

Nuk është sinjal i lulëzimit ekonomik as ndërtimi i teleferikut, që të shpie në kryqin grandioz e provokues, teleferik i cili kushton 6.5 milion euro, një shifër e bërë publike, ndërsa ne nuk po hyjmë në pjesën konspirative të shpenzimeve, që pastaj mund të dalim edhe më të shastisur. Në këtë rast, natyrat e shifrave për investime të kota dhe të vdekura, dallojnë dukshëm prej shifrave ku tregohet progresi i shtetit, shifra e parë është e mbërthyer me (hiper)deflacion dhe shifra e dytë është e përqafuar me (hiper)inflacion.

Pra, nëse ndërtimi i objekteve që tregojnë vjetërsinë e këtij shteti, nëse ndërtimi i teleferikut që maqedonasit ortodoks i dërgon për ritual fetar dhe kafe laike në kryqin grandioz e provokues, si dhe nëse luksin e funksionarëve e marrin si tregues të vërtetë ekonomik, atëherë në kuadër të këtyre mashtrimeve dhe ëndrrave, pse vallë Qeveria e këtij shteti nuk po e ndërton, edhe një teleferik që do të shpie në hënë, duke dëshmuar kështu para botes se, maqedonasit kanë hise edhe në Hënë dhe se e kanë prejardhjen prej Hënës. Por, këtë vështirë se do ta bëjnë ndonjëherë, nga shkaku se kur ta shohin vetëm gjysmën e hënës, e njëjta i duket gjysmëhënë, simbol ky i myslimanëve. **Por, mos të habitemi, nëse një ditë këta i dëgjojmë duke thënë se, edhe gjysmëhëna paska qenë kryq, ashtu siç dëgjuam se, edhe nën thundrën e Burmali Xhamisë paska qenë një kishë.**

Kapitulli
2
SFIDA SHOQËRORE

●○●○●○● ● ● ○●○●○●

■ Fati i një studenti
■ Shkolla, “institucion edukativo-arsimor”
■ Ndikimi i shkollës dhe mësuesit në psikologjinë e nxënësve
■ Njeriu, përballë rreziqeve madhore
■ ”Shëmbëlltyra”?!
■ Sikur të dua
■ Promotori i ndryshimeve
■ Sporti dhe intelektuali
■ Pranë shtetit pa pushtet
■ Një metaforë reale dhe rrëqethëse për Ushtritë Çlirimtare
■ Roli dhe këndvështrimi i Televizionit Privat A1, ndaj tezave të liderëve shqiptar për ndryshimin e kushtetutës në Republikën e Maqedonisë
■ Kujdes! Dëshmorët dëgjojnë dhe flasin
■ Pse i gjithë ky sulm ndaj nacionalizmit

■ Klithmat që (nuk) i dëgjoj shumë(as)kush
■ Nuse për shkijet e Shumadisë
■ Familja e shëndoshë – garanci e së ardhmes
■ Mishmashet e dhembshme me UÇK-në
■ Mjaft u flijuam për të tjerët
■ Përse, oj nëna ime Shqipëri, ke kaq shumë frikë prej Islamit në Shqipërinë Lindore!?
■ Durimi dhe Gënjeshtari

Fati i një studenti

Kryesisht, profilizimi i nxënësve fillon menjëherë pas mbarimit të shkollës së mesme, bashkë me profilizimin fillojnë edhe brengat për të ardhmen. Preokupimi kryesor i nxënësve në vitin e fundit është përcaktimi për profesionin e ardhshëm. Bëhen shumë konsultime me njerëz të ndryshëm, mbi atë se çka duhet vazhduar tutje, apo ndokush që në fillim deklarohet se nuk do të vazhdoj më shkollimin, ndokush vetën e sheh në mërgim, e dikush në tregti etj,. Ata që vendosin të vazhdojnë shkollimin nëpër Universitet Shtetërore, ende pa u regjistruar përballen me problemin e të regjistruarit. Andaj këtu edhe është nisma e padrejtësive. Me padurim priten rezultatet dhe me të marrë vesh se është regjistruar fillon një gëzim i papërshkruar dhe me vete ai (ajo) student(e) mendon se e largon një brengë, duke harruar se vetëm e ka hapë derën e brengave të pambarimta.

Kur fillon viti i parë, studenti përballet me shumë të papritura, sepse ajo çka e ka menduar më parë, tashmë nuk i del ashtu, por disi ambientohet tashmë si student, fillon të bëjë ndryshime graduale, të mendoj ndryshe, të ketë një rreth ndryshe, përgjithësisht i nënshtrohet ndryshimeve. Synimi kryesor është që t`a kryeje fakultetin, por brenda për brenda studimeve i ka edhe shumë nën qëllime të tjera si për shembull; të pasurohet me dituri, të ndjek kurse të gjuhëve të huaja, të ndjek trajnime të ndryshme, të jetë i rregullt në ligjërata, të jetë i sinqertë me kolegët, e shumë të tjera dhe në fund ta bëjë rrumbullakimin e tërë asaj që e ka studiuar. Ai gjatë studimeve bën shpenzime të mëdha, prindërit e tij bëjnë çmos vetëm që djali i tyre ta kryej fakultetin dhe të punësohet në ndonjë vend të mirë të punës. Po ashtu edhe djali i

ka parasysh shpenzimet e bëra dhe nuk dëshiron që prindi i tij më në fund të zhgënjehet, andaj studenti bënë të pamundurën që të dalë një student i ditur, i formuar të ketë një rivalitet me të diturin! Tashmë gjatë studimeve brenga e tij fillon të evoluojë dhe shpresat të pasurohen. **Me anë të përpjekjeve të shumta, dhe angazhimit të madh, studimeve i ofrohet fundi, fillon përgatitja e tezës së diplomës dhe arrin të diplomoj. Ashtu i gëzuar, bëhet manifestimi, vijnë miq, e përgëzojnë për diplomimin dhe sikur në fillim të regjistrimit me vete thotë e largova edhe një brengë të madhe, duke harruar i gjori se pikërisht tash fillojnë brengat serioze.**

Pas mbarimit të fakultetit familja dhe i diplomuari mendojnë tashmë për punë. Shkojnë në një institucion për t'u lajmëruar se e ka kryer fakultetin, por për çudi, tash prej këtu fillojnë problemet kryesore me përgjigje negative për punësim. Ajo çka më së shumti i brengos prindërit dhe të diplomuarin është se çdo natë në edicionin e lajmeve ministra të ndryshëm thonë se kemi nevojë shumë për kuadro me fakultet! Vendos që të mos dorëzohet së kërkuari punë dhe shkon tek një institucion tjetër dhe, aty pritet shumë mirë. I tregon se për çka ka ardhur, por pyetja fillestare në atë institucion është se cilës parti i takon? Ai nga kjo pyetje tronditet dhe nuk gjen dot përgjigje, ata i thonë të bëjë një CV dhe që gjoja do t`a thërrasin (është një mënyrë për ta larguar nga të kërkuarit punë). Ashtu i mallëngjyer, e sheh një shok të tij, shok i shkollës së mesme dhe u ndalen të bisedojnë në lokalin e tij, në ndërkohë i diplomuari i tregon për rastin dhe, kinse në shenjë të solidarizimit me posa të dëshpëruarin, shoku i thotë nëse nuk gjen dot punë eja tek unë mund të punosh si shitës dhe të marrish rrogë me vlerë prej 120 euro. Këto fjalë janë për të një goditje e radhës dhe tejet e rëndë ! Ashtu heshtazi largohet dhe shkon për në shtëpi.

I vetmuar në dhomë, fillojë të mendojë mbi atë se çka po i ndodhë, dhe ia parashtron një varg pyetje vetës ku qëndron problemi që nuk mund të kyçet në punë? **Ndonëse potenciali i tij**

intelektual është i paralizuar, ndoshta ka imituar e nuk ka studiuar, ndoshta ka kopjuar e nuk ka logjikuar, a po ndoshta notat e tij nuk përputhen me realitetin, e një varg pyetje dhe dyshime rreth problemeve të sapo shfaqura. Ajo e cila më shumë e shqetësonte ishte se pse nuk po mundet dot t'i përgjigjet pyetjeve që i vinin vërdallë kokës, përkundër që shumë pyetjeve gjatë studimeve i ishte përgjigjur! Shqetësimet sa vinin e rriteshin, asgjë nuk ndryshonte përpos brengave që tashmë lindën edhe demoralizimin, nuk i kishte mbetur skutë pa kërkuar për punë, nuk i kishte mbetur njeri që nuk ia kishte qarë hallin, e në anën tjetër universitetet private sa vinin e shumoheshin dhe në hapjet solemne, rektorët thoshin se kanë nevojë për kuadro, Kryeministri del me premtime për vende të reja pune, a në praktik nuk bëhet asgjë, përpos disa punësime sporadike, edhe atë me lidhje shumë të forta partiake. Sidoqoftë, kur të luaj universiteti dhe shteti me kokat intelektuale, atëherë dëmi do të jetë në vetë universitetet dhe shtetin.

Fat, ky i shumë studentëve të cilët kanë diplomuar nëpër drejtime të ndryshme. Është fakt real apo jo ?! Por rasti në fjalë është veç se një inkurajim për të ardhmen. Sepse, timoni i ndryshimeve vitale në shtet është në duart e studentëve. Pra, studentët janë ata të cilët bëjnë ndryshime radikale, ata të cilët e ngritin zërin për të vërtetën, ata të cilët politikbërësit i lënë pa fjalë. Studentët janë e tashmja e popullit. Mjaft më, me gënjeshtrat e politikanëve gjoja se, "studentët na qenkan e ardhmja e popullit". Ky pohim i tyre nuk është gjë tjetër veç se një gënjeshtër, që ata në mënyrë perfide ta shfrytëzojnë të tashmen, duke i mashtruar studentët dhe të diplomuarit se "ju nuk duhet të brengoseni për të tashmen (ne jemi ata të cilët brengosemi), sepse ju jeni e "ardhmja e popullit"

Studentët janë truri i shoqërisë, lokomotiva e shoqërisë, sepse ata në vete ngërthejnë dy çështje kryesore: rininë dhe formimin intelektual.

Pra, të nderuar studentë, t`a shfrytëzojmë kohën maksimalisht gjatë studimeve dhe në fund, mos ta festojmë mbarimin e studimeve me alkool, e nëpër restorante të ndryshme duke i`u nënshtruar këngëtarëve injorantë, por t`a falënderojmë Zotin i cili na bëri të mundur të dalim prej një oaze të diturisë dhe të kërkojmë një mundësi për t'i praktikuar e shumëzuar dituritë në të tashmen dhe në të ardhmen. Zoti na ndihmoftë!

Shkolla, “institucion edukativo-arsimor”?!

Kur shkruajmë dhe lexojmë për shkollën, si një institucion arsimor ku mësohen dhe edukohen në mënyrë të organizuar brezat e rinj, pa dyshim se ndjehemi të emocionuar, aq më keq kur nga domosdoshmëria detyrohemi të kritikojmë veprime që ndodhin brenda shkollës. **Ndjehemi të emocionuar, sepse me ndihmën e shkollës dhe mësuesve unë dhe ju lexues kemi arritur të shkruajmë dhe lexojmë.** Prej kohësh, sidomos ne shqiptarët kemi qenë të diskriminuar për ta shijuar oazën ku merret dituria dhe ku promovohen vlerat morale. U flijuan shumë shqiptarë për krijim e mundësive për shkollim, për mësim në gjuhën shqipe dhe pastaj për kushte infrastrukturore më të mira në objektet ku mbahet mësimi. Stërgjyshërit, gjyshërit, baballarët tanë e arritën me mund e sakrificë këtë jetësim, apo ëndërr të kamotshme duke e dhënë edhe jetën si shkëmbim të kësaj begatie, kurse ne pasardhësit e tyre, për një kohë shumë të shkurtër, fare pa përgjegjësi filluam t`a rrënojmë këtë begati, por këtë rrënim e bënim me të "dëshpë-ruarit" nga rrogat mjaft të ulëta.

Epiteti i shkollës si institucion edukativo-arsimor, ka filluar të zbehet dhe t`a humb kuptimin natyral të saj. Rrënimi i këtij institucioni ka filluar prej themeleve. Pra, ata të ashtuquajtur “mësues të rinj”, të cilët, që e marrin mësimin prej fakulteteve të dyshimta, sidomos studentët e Fakultetit Pedagogjik në Shkup, "Shën Kliment Ohridski", i ngjajnë periudhës inflacioniste, ku prodhimi është i koncentruar vetëm në kuantitet.

Të ashtuquajturit "mësuesit e vjetër" shprehin një brengë serioze dhe një dyshim për edukimin e gjeneratave të ardhshme nga produkti i këtij “Fakulteti”, i cili në kompozicionin e tij manifeston një helmim të shqiptarëve, por kësaj radhe me metoda

mjaft të spikatura konspirative dhe efiçiente. Pse e përmenda konkretisht, Fakultetit Pedagogjik? Sepse, fati i gjeneratave të mëtutjeshme varet pikërisht nga këta. **Fëmija, si letër e bardhë, gërvishtjet, ngjyrosjet dhe mbushjet e para do t'i përjetojë nga mësuesit.** Aktualisht nuk bën të habitemi, se përse një nxënës i klasës së tetë ende nuk e ka të qartë se kush është kryeqyteti i Shqipërisë dhe me kënd kufizohet Maqedonia! Fatkeqësisht edhe më keq, aktualisht dëgjojmë nga prindërit fjalë mjaft dëshpëruese. Ja njëri prej prindërve çka na rrëfen: "Djali im ishte mjaft i edukuar dhe i kulturuar, kjo zgjati derisa nuk doli në klasë të pestë, në shkollë filloi të çoroditet, t`a marrë të mbrapshtën dhe me daljen në shkollë të mesme përfundimisht më nuk mbeti djalë i imi, por djalë i kafeneve, i bandave, i duhanit, e i të gjitha veseve të këqija, të cilat nuk i takojnë një njeriut të thjesht e të mos flasim një nxënësit". Me të vërtet ky rrëfim është tejet rrënqethës, tejet dëshpërues është rrëfim vaji, është rrëfim absurditeti, fëmija në vend që në shkollë të edukohet dhe arsimohet, këtu tek ne po ndodh e kundërta (e kam fjalën nëpër disa- shumë shkolla të Maqedonisë). Në shkollat e mesme shqipe në Kumanovë shohim një anarki totale. Në njërën anë problemi i objektit, në anën tjetër arroganca e nxënësve, e tjetra anë jo aq e dukshme, dëshpërimi i profesorëve i fshehur nën vellon e kualifikimit dhe përgatitjes mjaft të dobët (të disa profesorëve). Problemi i shkollave të mesme shqipe, tashmë ka hyrë në vitin e gjashte dhe pa asnjë zgjidhje konkrete, aq më keq asnjë studim dhe qasje nga profesorët dhe drejtorët e këtyre shkollave nuk e kemi pasur deri më tani nëpër gazeta, revista apo në ndonjë debat televiziv për problemin në fjalë. Paraprakisht mund t`a kuptoj një përgjumësi të tillë, në njërën anë profesorët janë të zëne me qarje të hallit tek të tjerët për rrogat e dobëta (kjo qarje bëhet kryesisht nëpër kafene) dhe në anën tjetër angazhimi i drejtorëve për punësimin e profesorëve në shkolla me anë të direktivave partiake (e kuptoj është një angazhim i stërngarkuar).

Pra, një gjeneratë e tërë doli nga kjo shkollë me problemet e sipërthëna dhe e dyta është afër daljes. Kjo gjeneratë njërën (ndoshta edhe të vetmen) prej epërsive shkencore e posedon, atë të protestuesve dhe të mbajtjes grevë në mënyrë profesionale. Diskutimet vazhdojnë për zgjidhjen e problemit përkatës, paralelisht me diskutimet vazhdojnë edhe degradimet e nxënësve. Ministri i Arsimit Pero Stojanovski ndihet i rehabilituar dhe i arsyetuar nga ky problem, sepse sikur dëshiron të na thotë: "po ju shqiptarë të gjorë i patët dy ministra të arsimit që ishin shqiptar"! Por, tash ne sikur dëshirojmë t'i themi këtij ministri, dy ministrat shqiptarë veç sa e thelluan problemin, sepse zgjidhja e problemit mbështetej në formula partiake. Kurse ju shiheni qartë, se zgjidhjen e këtij problemi të trashëguar dëshironi ta zgjidhni me anë të formulave nacionaliste dhe shoviniste (edhe më keq se ato partiake). Dëmtimi i interesave vitale nga ana e shtetit ende vazhdon. Në të kaluarën, shteti u kundërvihej me dhunë atyre të cilët kërkonin shkolla shqipe. Kurse tash për hir të epitetit "shtet demokratik" këtë dëmtim po e bën në mënyrë demokratike në bashkëpunim me disa përgjegjës shqiptar, duke i lënë nxënësit shqiptar, tashmë të "përdhosur" në mëshirë të kohës, buzë asfaltit, në konflikte ndërmjet veti, në mosintervenim të policisë në rast përleshjeje, përzierjen e partive politike nëpër shkolla, si dhe gjithçka tjetër regresive, përpos mësimit dhe edukimit. Në kohën kur tentohet digjitalizimi i tërësishëm i shkollave, shkollat shqipe konkretisht ajo e Kumanovës, përballet ende me kërkesat për objekte të shkollave. Paradoks!

Për aq sa, vazhdon të mbretërojë kjo gjendje kaotike nëpër këto institucione, atëherë ky institucion nuk do të quhet institucion edukativo-arsimore, por institucion prishës i brezit të ri në mënyrë institucionale.

Ndikimi i shkollës dhe i mësuesit në psikologjinë e nxënësve

Para fillimit të vitit të parë shkollor, është e rëndësishme një përgatitje psikike e fëmijës në lidhje me shkollën. Mendohet se më shumë vështirësi të përshtatjes në shkollë, kanë fëmijët që në periudhën parashkollore nuk kanë shprehur dëshirë dhe shprehi të mendojnë për detyra, që nuk kanë pasur aq lidhje me lojërat ose ngjarjet interesante nga jeta, pra fëmijë intelektualisht pasiv.

Kur fëmijët fillojnë të shkojnë në shkollë, rekomandohet që prindërit t'u flasin për përvojën e tyre, për mësuesin, shokët që kanë pasur, të evokojnë momente të mira dhe interesante nga ajo kohë, edhe nëse nuk ndjejnë nostalgji për të kaluarën shkollore, të paktën për hir të suksesit të fëmijës, të bëhet kinse ndjejnë mall për vitet e kaluara në shkollë. Mësuesi dhe shkolla nuk duhet të idealizohen në sy të fëmijëve. Është shumë keq që të përçmohet dhe kërcënohet në emër të tyre. Preferohet që së bashku me fëmijët të vizitohen shkollat, para fillimit të vitit shkollor, t'i ndihmohet fëmijës që t`a mësoj rrugën deri atje[21].

Shkolla është një familje e zgjeruar. **Nëse të gjithë prindërit do të ishin të aftë të merrnin përsipër edukimin e fëmijëve të tyre dhe t'i pajisnin ata siç duhet në zgjidhjen e problemeve të jetës, atëherë pa dyshim që shkolla nuk do të jetë e nevojshme. Në të kaluarën pothuajse tërësisht përgatiteshin brenda familjes. Një zanatçi i edukonte djemtë në zanatin e tij dhe u mësonte atyre aftësi që kishte mësuar vetë nga babai dhe nga eksperienca praktike**[22]. Megjithatë, kultura jonë e

[21] Alfred Adler, "Ç'kuptim mund të ketë jeta" fq. 125
[22] Po aty

tanishme ushtron kërkesë më komplekse mbi ne, duke i bërë shkollat të domosdoshme për t`ua lehtësuar punën prindërve dhe për të vazhduar atë çka ata kanë filluar. Integrimi shoqëror kërkon një nivel më të lartë, të edukimit për të rinjtë nga ai që mund t'u jepet në shtëpi.

Është interesant, pothuajse psikologjia e çdo fëmije kur të filloj të kyçet në shkollë për herë të pari ai në vetvete ndien njëfarë frike, emocioni dhe ndihet shumë pesimist për ndryshimin e gjendjes së tij apo integrimin në një rreth tjetër. Ai tashmë nuk mund të luaj sa dëshiron, nuk mund të shkoj te daja kur të dojë dhe ky ndryshim në vet fëmijën reflekton disi aspekte negative, por me kalimin e kohës intelekti i tij përshtatet, sidomos kur fillon të shoqërohet me shok dhe shoqe. Në kohën aktuale me futjen e reformave arsimore po bëhet një lehtësim edhe për fëmijët, sepse tashmë mësuesi nuk po shikohet nga ana e nxënësve si komandant ushtrie apo si diktator. Tashmë nuk iket prej mësuesit kur të shihet rastësisht në rrugë, por bëhet një bashkë-mësim, raportet janë shumë të lira dhe të afërta, e gjithsesi se kjo metodë i ndihmon fëmijët, gjë që bën ndryshim psikologjik te nxënësi, shkolla shikohet si diçka e këndshme, atraktive dhe pa dyshim se, edhe nxënësit do të jenë më atraktivë.

Që shkolla të funksionojë ashtu siç duhet, patjetër duhet që, edhe personeli brenda shkollës të jetë i shëndoshë dhe funksional. Dihet mirëfilli, se reflektimet frytdhënëse nga mësuesit, padyshim me automatizëm manifestohen tek nxënësit. Pra, roli i mësuesit në edukimin e brezave të ri është tejet ndikues, për mirë apo për keq! Nëse mësuesi nuk ka arritur ta kuptojë se e tërë ardhmëria e fëmijës varet nga ai, mësuesi ka bërë një gafë të madh i cila do të paguhet nga vet mësuesi, si dhe nga vet nxënësit. Nëse mësuesi në aspektin psikologjik është i papërgatitur, apo nëse të paktën nuk ka njohuri themelori mbi psikologjinë, ai në vete pranon një dobësi të paparë, sepse mësuesi përmes metodave psikologjike mund t'i afrohet nxënësit më lehtë, mandej ai duhet të kuptojë, edhe psikologjinë e nxënësit, sepse psiqika e mësuesit

dhe e nxënësit dallojnë shumë, p.sh., nëse një nxënës e kemi ngarkuar me disa detyra të një të rrituri, ai mund në vetvete të ndjen një dështim dhe zhgënjim total, apo nëse e kemi shtyrë në gara në biologji një nxënës dhe një student të biologjisë pa dyshim që nxënësi, edhe përkundër zgjuarsisë së vet do të humb. Prandaj duhet pasur parasysh intelektin dhe kapacitet e nxënësve! Edukimi, angazhimi, notimi duhet t'i përgjigjen natyrshmërisë së nxënësve. "**Një mësues i mirë, 30 nxënës të mirë dhe 30 nxënës të mirë një botë e shkëlqyer"**.

Mësuesit në vazhdimësi, duhet të ndjekin trajnime psikologjike (por të mësojnë metoda të shumta, moderne të mësimdhënies dhe mësim-nxënies), e sidomos pedagogët, sepse dihet shkolla është një institucion ku bëhet gërshetimi mes të njohurës dhe të panjohurës. Shkolla si institucion edukativo-arsimor duhet të luaj një rol të veçantë, sa i përket psikologjisë së nxënësve. Nxënësi si në fillim, ashtu edhe gjatë procesit arsimor duhet ta shikoj shkollën si diçka të këndshme, të familjarizohet me shkollën, të ambientohet në shkollë, intelekti i tij psiko-fizik duhet të përgatitet për sfidat e të ardhmes, të paktën një herë në muaj të mbahen seminare nëpër shkolla mbi shumë tema që i preokupojnë nxënësit si p.sh., si të mësojnë, si ta forcojnë mbamendjen, si të dëgjojnë kur mësuesi flet, në çfarë kohe mund të kuptojnë më shumë, me çfarë intensiteti të mësojnë, çfarë ngjyre duhet të përmbaj dhoma që mësojnë, si duhet të jetë tavolina për të mësuar, kur duhet dhe çka duhet të mësohet përmendësh, e çka logjikisht, si t'i largojnë emocionet para ndonjë recitimi apo përgjigje, si t'i dallojnë gjërat çka na paraqiten në përditshmëri, e shumë tema të tjera çka me të vërtet e begatojnë intelektin e nxënësit. Fatkeqësisht në shkollat tona një gjë e tillë nuk po bëhet, po u kushtohet më shumë kujdes shëtitjeve, sesa përgatitjes së nxënësve në aspektin psikologjik. Sidoqoftë edhe shëtitja është pjesë e zhvillimit, por jo edhe kryesorja. Këtu në shkollat tona mungon një platformë e veçantë, mbi atë se çka dhe si duhet mësuar, e cila

dukuri po vërehet në të ardhëm dukshëm, ndërsa si rrjedhojë po ka pasoja të rënda.

Në vendet Perëndimore, ka një statut dhe klasifikim të veçantë për nxënësit, atje bëhet ndarja qysh në fillim edhe atë: të dobët, të mesëm, dhe të shkëlqyeshëm dhe ekziston një shkollë e veçantë për ata të cilët janë me aftësi të kufizuara. Mandej, brenda këtyre ndarjeve bëhet profilizimi për të ardhmen e nxënësve, ku me anë të metodave psikologjike gjithsecili përcaktohet për profesionin e ardhshëm. E gjithë kjo kryhet me anë të mbikëqyrjes, e sidomos këtë mbikëqyrje e bëjnë sociologët dhe psikologët. Nëse fëmija është i prirur dhe ka dëshirë të madhe të luaj futboll, gjasat e tij në të ardhmen janë që ai të bëhet një futbollist i zellshëm, por nëse ndonjëri ka tipare të theksuara për rregullime të gjërave teknike si p.sh., orë, shtëpi prej druri, vetura të metalta etj., gjasat e tij në të ardhmen janë që ai mund të bëhet një mjeshtër i shkëlqyer, nëse ndonjë nxënës interesohet se kush i ka bërë detyrat, bisedon për atë se çka ka lexuar në shtëpi, është i rregullt në gara, ai pa dyshim se do të bëhet një i shkolluar dhe dijetar në të ardhmen. Të gjithë këto të lartcekura fatkeqësisht te ne mungojnë, e kësisoj nuk kemi një ditar mbi prirjet e nxënësve.

Pra, ndikimi i shkollës në psikologjinë e nxënësve ndikon në mënyra të ndryshme, në përgjithësi shkolla dhe mësuesi në psikologjinë e nxënësve ndikojnë pozitivisht, me të shkuar fëmijët në shkollë dhe ballafaqimi i tyre me mësuesit, fillojnë shumë gjëra të evoluojnë, apo të ndryshojnë për të mirë. Shkrim leximi aty mësohet, truri i pastër e i bardhë aty pasurohet dhe më nuk mbetet një fletushkë e bardhë, por bëhet një fletushkë me shumë shkronja, piktura dhe shumëçka tjetër në dobi të nxënësve. Edhe pse sistem pas sistemi është praktikuar nëpër shkolla, prapë esenca asnjëherë nuk ka ndryshuar. Shkolla si institucion ka luajtur, po luan si dhe do të luaj një rol mjaft të rëndësishëm për shoqërinë në përgjithësi. Shkolla është ajo, e cila ka ndikim në ndryshimin e shumë gjërave, shkolla e ka bërë njeriun të mendojë

ndryshe, të kuptoj se si duhet punuar, se si duhet zgjidhur mosmarrëveshjet, shkolla është ajo e cila shumë nxënësve i`a ka tregua rrugën e ardhmërisë dhe të lumturisë. Këtë shkrim, po e përmbylli me një fjali të urtë " mësuesi është jeta dhe shpirti i shkollës"(***Thering***).

Njeriu, përballë rreziqeve madhore

Përgjatë tërë historisë së tij njerëzimi ka qenë i kërcënuar dhe i rrezikuar me zhdukjen e tij për shkaqe të ndryshme dhe të shumta. Disa prej tyre ishin: **epidemitë, luftërat, tërmetet dhe varfëria.** Para se të bëheshin shtetet, janë bërë mjaft luftëra për zgjerim të territoreve, pushtim të vendeve të huaja, pushtim për shkaqe të resurseve, si dhe pushtime për shkaqe të dominimit dhe udhëheqjes me botën. Njeriu në vazhdimësi është gjendur përballë kanosjes dhe rrezikut, si dhe në kuadër të parandalimit të tij, e ka pranuar luftën ndaj rrezikut si gjë normale dhe të domosdoshme. Disa shtete me mundime të shumta, duke mos e zgjedhur rrugën deri te caku final, kanë arritur të bëhen lider ndaj shteteve tjera. Kjo ishte thjesht një vetëmbrojtje prej kërcënimeve të mëtutjeshme. Një logjikë të tillë lashtësie të njerëzve dhe shteteve, e hasim edhe në kohërat e sotshme. Në kohërat e sotshme shohim veprimet dhe garimet e shteteve, për arritjen e pozitës "sundues i botës". Por, krahasuar me kohërat e kaluara, sot kjo arritje madhore nuk bëhet më me anë të luftërave shtetërore, për ndryshim të kufijve, për pushtim të shteteve të pranuara ndërkombëtarisht, por përmes të arriturave diplomatike, ekonomike, shkencore dhe teknologjike. Me automatizëm me këto të arritura kuptojmë edhe sofistikim të armëve, participim në ushtri, tërheqje të kokave intelektuale në vendet e zhvilluara, si dhe një e arritur madhore është formimi i organizatës politike-ushtarake, e NATO-s.

Por, paralelisht me zhvillimin e teknologjisë, janë rritur kanosjet dhe rreziqet ndaj njeriut. Me zhvillimin e shkencës e cila ishte shume e dobishme për njerëzimin në përgjithësi, u zbulua edhe atomi, ku fillimisht patë një huti rreth përdorimit së tij (bile edhe nga vet zbuluesi i atomit).

Bota dhe njeriu përballë këtij zbulimi gjigant, sot gjenden në rrezik, apo kanoset me zhdukjen e tij. Mjafton një kryetar gjysmë i çmendur i shteteve poseduese të atomit, që e tërë bota organike dhe inorganike të merr fund. Një kërcënim dhe rrezik serioz ndaj njeriut është terrorizmi. Fillet e terrorizmit janë të hershme, ku njeriu, apo një grup njerëzish kryenin krime ndaj një individi, një grup individësh civilë, apo ndaj caqeve ushtarake të pafajshme. Terrori i 2001-shit, ndaj Kullave Binjake dhe Pentagonit në SHBA, e arriti kulmin e tij. **Por, pas vitit 2001, nën pretekstin e luftimit dhe çrrënjosjes së terrorizmit, filloi me të madhe të rritet dhe zgjerohet terrorizmi.** Paradoks! Sepse, parandalimi i terrorizmit tentohej të bëhej me anë të terrorit shtetëror ndaj popullatës civile në Lindjen e Mesme. Sot është e pamundur, t'i dëgjojmë lajmet, apo t'i shfletojmë gazetat, e të mos shohim ngjarje të tmerrshme, vrasje, masakrime dhe përdhunime. Pra, nga ky fenomen famëkeq, njeriu bashkëkohor në përgjithësi është i shoqëruar me pasiguri totale dhe është i privuar ta jetojë një jetë të dinjitetshme.

Njëri prej problemeve dhe rreziqeve kryesor të njerëzimit në të ardhmen, është ngrohja globale e tokës. Ky fenomen shkaktohet për shkak të dëmtimit permanent të shtresës mbështjellëse të ozonit që e përshkon globin tokësor. Ky rrezik global për njeriun, po bëhet nga vet dora e tij, gjegjësisht përmes prodhimit dhe përdorimit enorm në industri të dioksidit karbonik dhe metanit, të cilat shpërndahen në ajër përmes tubave të ndryshme të përdorimit ditor, si: ngjyra, parfume dhe mbushje tjera. Rrezikun në fjalë, tashmë e kemi të njohur. Shumë vise me klimë të ndryshueshme kontinentale, veçse kanë filluar të ballafaqohen me temperatura mjaft të larta. Në disa regjione të botës, stinët nga viti në vit kanë filluar të ndryshojnë. Po ashtu këtu kemi edhe një rivalitet mes dy ish-superfuqive të botës. Pra, në njërën anë Rusia ka tendenca t'i jap zgjidhje shkencore këtij problemi dhe në anën tjetër qëndron ShBA-ja me plan- programet e veta për zgjidhjen e problemit

kërcënues dhe global. Besimi i opinionit demokratik për një zgjidhje efikase mbështetet në ShBA-në.

Problemi tjetër global për njeriun është, paraqitja e krizave ekonomike. **Pas krizës së madhe financiare, e ashtuquajtur "Depresion i madh i viteve 30-ta", njerëzimi dhe ekonomitë shtetërore u përballen me krizë financiare globale.** Shkaqet e paraqitjes së kësaj krizë ishin të ndryshme dhe të shumta. Një ndër to ishte: falimentimi i bankave nga moskthimi i kredive afatsh-kurtra dhe afatgjata, normat e larta të kamatës, lufta në Lindjen e Mesme, kriminaliteti ekonomikë, konkurrenca jolojale e Kinës në tregun ndërkombëtar dhe shumë shkaqe të tjera. Pra, dihet mirëfilli, se nga kushtet e vështira sociale janë të pritura kriza të ndryshme, të cilat më pastaj mund ta humbin kuptimin ekonomik dhe të marrin kuptimin tjetër, atë ushtarak. Pra, edhe krizat e njëpasnjëshme financiare dhe mosefikasiteti i politikave shtetërore përbëjnë një kërcënim dhe rrezik serioz për shoqërinë njerëzore në përgjithësi.

Krijesa e quajtur njeri, gjendet edhe përballë shumë kërcënimeve tjera. Në një të ardhme jo fort të largët në bazë të parashikimeve të shkencëtarëve njeriu do të ballafaqohet me problemin e ujit të pijshëm. Krizat për ushqim, Botën e Tretë prej kohësh e kanë kapluar. Po ashtu sëmundjet nga marrëdhëniet seksuale të jashtëligjshme vazhdojnë akoma të jenë preokupim dhe problem serioz për njeriun. Këto dhe shumë rreziqe tjera ndaj krijesës më të bukur në rruzullin tokësor paraqiten për një arsye të vetme. Pra, si rezultat i humbjes së vlerave të mirëfillta morale. Pothuajse nuk ka vend apo truall në botë, ku nuk kanë humbur vlerat morale njerëzore. Sot i shohim shtetet e zhvilluar me një progresivitet tekniko-teknologjikë marramendës, por në anën tjetër këto vende i shohim me një regresivitet moralo-shpirtëror marramendës.

Pra, zhvillimi dhe përparimi urgjentisht duhet të njoftohen mes veti dhe të bashkëveprojnë me normat morale dhe shpirtërore.

”Shëmbëlltyra”?!

Është në natyrën njerëzore që njeriu gjatë veprimtarisë dhe përditshmërisë së tij të gjendet përballë sfidave dhe sprovave të ndryshme dhe të shumta. Sfidat e myslimanit janë nga më të ndryshmet. Vështirësitë që i has një mysliman në botën Arabe, dallojnë prej neve këtu në Ballkan. A thua pse e gjithë kjo sprovë në vendet Islame? Ndonëse ne jemi besimtarë, e për ta fituar Parajsën duhet të sprovohemi me sprova mjaft të rënda, apo jo?! A thua ky është arsyetimi adekuat, apo për ta fituar parajsën njeriu duhet të jetë i varfër dhe në botën tjetër si kundërshpërblim i kësaj bote do të shpërblehet me parajsë! Të parët tanë shokët e Muhamedit (a.s) në krye me vet profetin janë sprovuar mjaft rëndë, por fitorja më në fund ka qenë e tyre, ata arritën ta sundojnë botën me shkencë, arritën Evropën ta nxjerrin nga injoranca, ushtarakisht dhe moralisht ishin mjaft të fortë, e ne sot pasardhësit e ummetit Islam jemi kopjuesit dhe konsumuesit më të mëdhenj të shteteve Perëndimore, jemi shërbëtorët më të mëdhenj, apo tash së fundi edhe ndjekësit e rrugës së tyre, por jo rrugës së punës, shkencës, përparimit, por rrugës së modës, veshjes, traditave që edhe ata vet po largohen, kurse ne jemi bërë shportë e traditave të tyre. Një i ri në Perëndim apo edhe këtu në Ballkan nëse është i veshur si gjerman, apo nëse martohet në bazë të traditave gjermane, mendon se është i përparuar, duke harruar se përparimi nuk shprehet me veshje, por me shkencë.

Ne myslimanët (pa marrë parasysh përkatësinë nacionale) po krenohemi me të kaluarën Islame, ne po krenohemi me prijësit fetar e shtetëror, me Omerin i cili e ka fikur qiririn e shtetit, kur ka pasur bisedë private, e në anën tjetër

pikërisht ata të cilët e tregojnë këtë rast shumë shpesh, janë promotorët e parë të prishjes së drejtësisë, ata të cilët na shesin mend me moton "blej e mos paguaj", (e kur të kesh blerë paguaj). Athua ku qëndron këtu problemi? Shumë mendimtarë dhe shkencëtarë islamikë kanë dhënë mendime të ndryshme në lidhje me këtë temë. Njëri prej tyre është edhe Dr. Jusuf el-KARDAVI i cili thotë: **"ne i zbukurojmë muret tona me ajete Kur'anore, kurse ne nuk e zbukurojmë jetën tonë duke vepruar me Kur'an, lexojmë për të vdekurit, ndërkaq nuk i zbatojmë për të gjallët"**.

Islami dhe myslimanët në jetën tonë të përditshme si duket janë bërë dy nocione mjaft të ndryshme për nga veprimi. Ndokush nga njohuria e paktë fetare mendon se t'i përkasësh fesë Islame duhet që pesë shtyllat e Islamit t'i praktikosh dhe mjafton për ta fituar parajsën, sepse kështu na mësuan disa prijës fetar. Si është e mundur që një fe e cila në 850 ajete Kur'anore e një sërë hadithesh të thërret për dituri, e ne pasuesit e kësaj feje progresive të jemi shëmbëlltyra më e dobët për nga dituria dhe shumë punë të tjera në këtë planet. Ndoshta na vjen inat ta paraqesim gjendjen reale, por për tu shëruar së pari i tregojmë mjekut se ku na dhemb, e pastaj fillon terapia e kurimit.

Problemi qëndron në atë se, ne shumë po krenohemi me të kaluarën duke harruar të turpërohemi me të tashmen. Sot, ummetin Islam e ke mjaft të përçarë, gjë që po i kushton shumë, edhe atë me jetë njerëzish, popullit të shumëvuajtur palestinez, sepse sikur shtetet arabe të ishin më produktiv prej kohësh, atëherë për aspektin e pushtimit dhe okupimit të popullit palestinez as që do të flitej, por do të diskutohej për përqindjen vjetore rritëse të GDP-së,dhe padyshim që gjendja e myslimanëve globalisht do të ishte më shpresuese. Sepse, në njëfarë mënyre ekonomitë e qëndrueshme botërore po e dirigjojnë botën, ndërrimi dhe komentimi i ligjeve ndërkombëtare po bëhet varësisht prej misioneve famëkeqe të tyre, po ashtu nocionin terrorizëm po e definojnë sipas tekave dhe interesit të tyre. Për këtë arsye ende

nuk kemi ndonjë definicion prej autorëve eminent dhe të saktë të nocionit ***terrorizëm***.

Paraprakisht e kemi të qartë këtë mosdefinim! Si është e mundur që për hir të vetëmbrojtjes të mbyten dhe masakrohen civilët dhe paradoksi tjetër qëndron në atë se, bota e cila kinse e vlerëson dinjitetin dhe jetën e njeriut, këto masakrime dhe gjenocide t'i pranojë me gjakftohtësi, dhe të potencojë se atje është duke u pastruar terreni nga terroristët. Çudi, terrorist në vendin e vet! Edhe neve shqiptarëve bota njëherë na quajti terroristë, por fatmirësisht shpejtë e kuptoi se nuk mund të jesh terrorist përballë terrorizmit të huaj shtetëror.

Fatkeqësisht këtë neglizhencë dhe vakum të popullit Islam, të tjerët mizorë po e shfrytëzojnë në maksimum, sepse sikur të përputheshin nocionet Islam dhe myslimanë ndërmjet veti, atëherë gjendja e myslimanëve në nivel botëror dukshëm do të ishte më e mirë dhe më progresive. A thua si do të bëhet bashkimi i Islamit me myslimanët dhe kur? Sigurisht që nuk mund të bashkohet asnjëherë përderisa ne jemi të përçarë, atë çka e flasim nuk e praktikojmë, për ndërtimin e një xhamie (faltore) përçahet i tërë fshati-qyteti. (P.sh, në Kosovën Lindore) i kemi dy apo edhe më shumë Bashkësi Islame, me koncepte kontradiktore njëra ndaj tjetrës, shumica e përfaqësuesve të popullit Islam janë politizuar e partizuar, jemi mjaft të kujdesshëm për lëshimin e mjekrës dhe nuk na bëhet vonë që të flasim për tërë ditën apo edhe natën, kur të tjerët në atë kohë janë dukë zbuluar, shpikur, mësuar. Flasim dhe shkruajmë për natyrën, planetët që i ka krijuar Zoti, ndërsa të tjerët bëjnë zbulimin e tyre dhe ne nga punimet e tyre po e vërtetojmë përputhshmërinë e ajeteve Kur'anore me shkencën.

Prandaj për ta fituar parajsën në këtë botë dhe në botën tjetër duhet flakur ideologjinë, se sa më i varfër, aq më mirë në botën tjetër. Por mësim, veprim, nëse është nevoja që prej të tjerëve të marrim diçka të mos hezitojmë, sepse edhe ata dikur prej të parëve tanë kanë marr shumë, të mos flasim shumë për histori, por për të tashmen dhe të ardhmen, ta pranojmë sprovën si

pjesë të natyrshmërisë sonë, sepse në ketë gjendje që jemi sot Zoti është i hidhëruar mjaft me neve. Me punët që jemi duke i bërë pa dyshim se jemi banorë të Ferrit të kësaj bote dhe të botës tjetër. Pesë shtyllat dhe gjashtë kushtet e besimit janë pjesë e asaj që të shpijnë në Parajsë, por duhet të futemi brenda tyre dhe të shohim se çka ngërthejnë në vete. Mysliman dhe injorant nuk shkojnë njëra me tjetrën. Rezultati i kësaj formule është mjaft dëshpëruese, padyshim që edhe nuk mund t'i takoj ummetit Islam, sepse pikërisht Islami erdhi që të na largojë nga errësira e që të na shpije në dritë, në përparim. Andaj fajin për neglizhencën tonë nuk e ka Islami, por vetë ne myslimanët, si dhe disa që na e (keq) interpretuan dhe na (keq)interpretojnë këtë fe.

Pra, në fund të këtij shkrimi në shenjë solidarizimi me popullin palestinez, i kisha lutur dhe këshilluar të gjithë prijësit fetarë, besimtarët dhe Bashkësitë Islame të pajtohen dhe bashkohen ndërmjet veti, në mënyrë që të dëshmohemi dhe të dëshmojmë si myslimanë se ne, me të vërtet brengosemi për këtë popull të shumëvuajtur.

Sikur të dua...

Ciklet e jetës gjithmonë dhe gjithherë kanë qenë të shoqëruara me fenomenin e dëshpërimit, ngashërimit dhe ngazëllimit. Gjithmonë përballë mbarështimit kanë ekzistuar; keqësimi dhe degradimi. Kësisoj, ngashërimi, dëshpërimi dhe ngazëllimi kanë qenë dhe janë në një vijë dhe rrugë të përbashkët, në një luftë mes veti, duke ngadhënjyer herë njëra, e herë tjetra, por asnjëra, asnjëherë duke mos qëndruar në pozitën absolute. Shpeshherë mendojmë dhe pyesim, pse vallë nuk mund ta bëjmë dhe nuk ia dalim dot ndonjë pune të caktuar! Shmangemi dhe shastisemi para qyteteve, shteteve të zhvilluara. Entuziazmohemi dhe dëshpërohemi kur të shohim njerëz me një koeficient të inteligjencës mjaft të lartë, dijetarë e veprimtarë me mendje mjaft të ndritur. Entuziazmohemi, ngase përballë këtyre njerëzve, edhe ne pjesa tjetër e popullit, mund të përfitojmë, sepse punët do të na lehtësohen prej punimeve dhe zbulimeve të këtyre të nderuarve. Dëshpërohemi, sepse ne me të njëjtin kualitet të mendjes prej lindjes, kemi ngecur nga shkaku i përtacisë. **Shohim konstruksione teknike të mahnitshme dhe ne nuk bëjmë tjetër përpos që, mahnitemi dhe mbetemi pa fjalë, bile edhe pa pasthirrma.** Shohim dhe lexojmë vëllime të pafundme të librave dhe neve nuk na mbetet tjetër, përpos që të habitemi dhe të harrojmë diçka mjaft thelbësore, pra ta pyesim vetën. Shohim koordinime mjaftë të spikatura të politikave shtetërore, në të gjitha sektorët e jetës. Si dhe shumëçka tjetër shohim, përballemi, këto të arritura i përjetojmë, por shpeshherë kemi harruar ta pyesim veten dhe të tjerët, se si u bënë të mundura gjithë këto të arritura epokale!

Njëra prej shume kushteve që një gjuhë e huaj të mësohet është; ta duash atë gjuhë. Nga zbulimet e shumta dhe të vlefshme

të shkencëtarëve mund të vijmë në përfundim se ai zbuluesi/shkencëtari, së pari, e ka dashur me shpirt atë rrugë (profesion). Autori i cili ka shkruar një sërë librash me vëllime ende të pambaruara, padyshim se aludojmë për atë si njeri i dashuruar pas veprimtarisë së tij (në këtë rast me veprimtari kuptojmë edhe familjen). **Konstruktori i cili ka bërë mrekulli në domenin e vet, nuk mund të mos vijmë në përfundim se aty ka ekzistuar dashuria për veprimtarin përkatëse.** Koordinimi i politikës shtetërore, nuk mund të bëhet pa shoqërimin e vazhdueshëm të dashurisë për një jetë më të mirë, më të begatshme edhe atë kjo marrëveshje frytdhënëse është e arritura ndërmjet shtetit dhe popullit. Ashtu siç e ceka në fillim se, përballë zbulimeve gjigante nga shkencëtarët kemi mbetur të mahnitur, po ashtu edhe përballë moszbulimeve dhe rëndimit të punës kemi mbetur të mahnitur, por për dallim nga e para në këtë rast nuk mungojnë psherëtimat dhe pasthirrmat.

Sikur ne shqiptarët ta duam shtetin tonë, sigurisht që punët do t'i kishim më mbarë, desh harrova, po ashtu sikur shteti ynë të na donte, punët dhe përditshmërinë do ta kishim edhe më mbarë. Shtetet- komb, janë të prirë më shumë për një dashuri të ndërsjellët. Por, jo gjithherë ndodhë kështu! Po e pyete një shqiptarë të Shqipërisë, pse nuk ia paguan shtetit tatimin, ai do të përgjigjet, po shteti ç'bëri për mua dhe popullin tim që unë të bëjë diçka për shtetin. Pra, që në fillim të bisedës shihet se personi në fjalë nuk e do shtetin dhe për veprimet e tija, arsyetohet duke u "brengosur" edhe për popullin e vet dhe fatkeqësisht apo qëllimisht harron ta pyet vetën, po mirë unë ç'bëra për shtetin që shteti të bëjë për mua diçka (edhe pse asnjë lëshim nuk i falet shtetit)! Sigurisht që personi në fjalë është njëri prej shumë muratorëve që një nga një tullat e murit të quajtur shtet, është duke i rrënuar, aq më keq kur kemi të bëjmë me një qytetar shqiptar të Shqipërisë, i cili në aspektin e identitetit kombëtar dhe shtetëror nuk ka fare problem. Kjo assesi, nuk na arsyeton vjedhjet, evazionin fiskal, mospagimin e rrymës dhe shumë maskara-

llëqe të tjera neve shqiptarëve që jetojmë në vendin tonë, por në shtetin e huaj artificial. Dihet mirëfilli, për ne do të ishte mjaft e vështirë të dashurohemi në mekanizmat diskriminuese shtetërore. Sepse, edhe ne nëse tentojmë ta bëjmë një gjë të tillë, kërkesën tonë mjaft të pastër po e nëpërkëmb dhe po e refuzoni muri i ashtuquajtur, shtet. Ne, që jetojmë në vendin autokton tonin dhe në shtetet e huaja artificiale, i ngjajmë muratorit i cili dëshiron të vendojë tulla për ta rritur dhe forcuar murin, por ja që përgjegjësit e murit, muratorin e refuzojnë duke i thënë se muri i ashtuquajtur shtet nuk i duron dot duart e juaja të papastra, kurse shqiptari i Shqipërisë këtë problem e ka larguar që moti, pra në këtë rast, fatkeqësisht në vend të ndërtimit e kanë zgjedhur rrugën e rrënimit. **Ishte një kohë në Kosovë, ku ikja nga tatimi konsiderohej patriotizëm, por pikërisht në atë kohë shteti e tubonte tatimin në mënyrë të plotë dhe shkëlqyeshëm në pjesën shqiptare.** Kurse tash, kur llogaritet patriotizëm pagimi i plotë i tatimit dhe kontributet tjera ndaj shtetit, bëhet ikja dhe fshehja e këtyre kontributeve shtetërore nëpër forma dhe rrugë mjaft mizore, e të ndryshme. Sikur ne ta duam shtetin, atëherë pa mëdyshje që edhe shteti do të na donte edhe më shumë. Por, ne më shumë jemi të prirë të dashurohemi në shtetin tonë natyral! Mos të kërkojmë dhe kërkoni përgjegjësi për mos dashjen e shtetit, qoftë edhe nëse jetojmë në atë shtet, qoftë edhe nëse trualli autoktonë është i yni. Sepse, do ta kemi mjaftë vështirë, apo të pa mundur të dashurohemi dhe bashkëjetojmë në një shtet artificial, i ndërtuar mbi bazat e diskriminimit.

Si mund që një shqiptar i Maqedonisë të dashurohet në shtetin e tij, kur shteti lutjen e përgjithshme shtetërore e bëri në gjuhën maqedonase dhe nga Zoti kërkohej që, t'i mbrojë dhe ndihmojë të gjithë banorët maqedonas që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, duke harruar lutësi se i Luturi nuk do t'ia pranojë lutjen asnjëherë, përderisa edhe në lutje diskriminohen shqiptarët dhe komunitetet tjera.

Promotori i ndryshimeve

Në të shumtën e rasteve, njerëzit dhe publicistët janë më shumë të prirë të shkruajnë dhe flasin për njerëzit dhe veprimet negative të tyre. Por, unë kësaj radhe do të kem një qasje ndryshe krahasuar me shkrimet e tjera, pra do të shkruaj për një dukuri dhe njeri i cili bëri ndryshime rrënjësore pozitive në institucionin më të rëndësishëm për shoqërinë, pra në spitalin e qytetit të Kumanovës dhe për udhëheqësin e këtij spitali, Selver Jasharin. Nuk mund të rrimë duarkryq dhe gojëmbyllur përballë gjithë këtyre të mirave, sikur se nuk kemi mundur të rrimë gojëmbyllur përballë dukurive famëkeqe që kanë ndodhur po në këtë spital.

Meqë tema jonë është për spitalin dhe fanarin e ndryshimeve, do të ishte e udhës së pari ta definojmë nocionin e spitalit. **Spitali është qendër e posaçme me mjek, me shtretër dhe me pajisjet e nevojshme, ku shtrohen dhe mjekohen ata që vuajnë nga sëmundje të ndryshme, nëpër ndërtesat e kësaj qendre.** Do ta kisha mjaft vështirë ta shpjegoja se çfarë janë reformat në spital, po të mos e kisha vizituar (në cilësinë e një vizitori kureshtar) spitalin e Kumanovës. Po ashtu do të ishte e pamundur të besoja në moskorruptimin e njerëzve në krye të detyrave madhore, po të mos isha njoftuar me veprimtarinë e Selver Jasharit, drejtor aktual (tashmë ish-drejtor i zhgënjyer prej padrejtësive të politikës shqiptare) spitalin e Kumanovës.

Në të kaluarën e largët dhe të afërt, ishte një kob i madh për çdo qytetar, nënshtrimi i terapive kuruese në spital. Sepse, pacientët përpos sëmundjeve kronike, në hyrje dhe dalje të spitali ballafaqoheshin me një sëmundje tjetër kancerogjene, pra të korrupsionit. Vajë halli për atë që nuk kishte para "ekstra" për t'i dhënë mjekëve dhe stafit udhëheqës të spitalit. Ndonjëherë

qytetarët, pa vetëdije jepnin kur e kishin ndonjë të sëmurë të shtrirë në spital, duke i bërë keq edhe atyre që nuk kishin asgjë për të dhënë, sepse mjekët dhe udhëheqësit e spitalit ishin mjaft të kujdesshëm për ata që japin, thënë shkurtë; **dhënia e mitos në hyrje dhe dalje të spitalit ishte bërë një domosdoshmëri vullnetare.**

Drejtorët e spitalit, nga viti në viti ndërroheshin, por mentaliteti dhe veprimtaria kriminele e tyre nuk ndërronte dhe nuk ndryshonte nga viti në viti, por veç sa u thellonte dhe u shtonte nga dita në ditë pasurimi marramendës i mjekëve dhe drejtorëve. Aq më keq, këta drejtorë para mediave e luftonin korrupsionin dhe brengoseshin për ecuritë negative në spital. Ndërsa, ne qytetarët e gjorë mendonim se me të drejtë e kishin këta drejtor. Sepse, nuk kishin çfarë të bënin drejtorët e "devotshëm".

Por, prej vitit 2008 bindja jonë e sëmurë filloi të ndryshojë dhe filluam të kuptojmë se ndryshimet qenkan të mundura të bëhen shumë shpejtë edhe atë për një kohë, prej katër muajsh. Nuk kishin thënë kot stërgjyshërit tanë se, **gjarpri mbytet në kokë**. Në këtë spital luftimi i anomalive filloi prej në krye. Për mjekët me traditë të lashte korruptive dhe shoviniste, ardhja e **Selver Jasharit** në krye të spitalit, ishte një tmerr i vërtet. Sidomos për ata mjek maqedonas, të cilët në vazhdimësi i nënçmonin shqiptarët dhe kujdesi i tyre i duhur ju bëhej vetëm atëherë kur i jepnin shuma të mëdha të parave. Po ashtu nga arroganca dhe anomalitë e shumta të drejtorëve, përfitonin edhe disa mjekë shqiptarë, të cilët mendonin maqedonisht, flitnin dhe shkruanin maqedonisht, visheshin maqedonisht dhe vepronin sllavisht.

Vitin që e lamë pas ishte një zhgënjim i madh për këta shqipfolës. Punonjësit e ndershëm dhe pacientët shqiptarë me ardhjen e Selver Jasharit, filluan të marrin frymë lirshëm. Por fryma e kriminelëve ekonomik, brenda dhe jashtë spitalit filloi të vështirësohet dhe gradualisht të shkojë drejt sosjes. Kësisoj, nga frymëmarrja e vështirësuar, këta mjekë urgjentisht duhet vendosur inhalatorin, ose përndryshe epoka e këtyre mjekëve do të marrë

fund shumë shpejtë (një këshillë nga ana ime). Fatkeqësia e këtyre mjekëve qëndron në atë se, këtë aparat dhe terapi e posedon drejtori i këtij spitali. Drejtori i spitalit për hir të veprimtarisë së tij mjaft të drejtë dhe personalitetit të tij mjaft të devotshëm, do të jetë në gjendje t'ia japë këtë terapi kuruese sa herë që ata dëshirojnë.

Disa mjekë, flokët e të cilëve ishin thinjur duke i shërbyer më shumë nacionalizmit se sa punës mjekësore profesionale, me rastin e festës së 28 nëntorit patën fatin në spital ta dëgjojnë himnin shqiptar dhe të qëndrojnë gatitu. Ata të cilët, nuk dëshironin të shikojnë shkronja dhe fjalë shqipe, po të njëjtët persona e përjetuan fatin që në etiketën e tyre, emri t'i shkruhet së pari në gjuhën shqipe me germa mjaft të mëdha. Ata të cilët ishin mësuar në ndërtesa të spitalit ta lexojnë me ëndje fjalën "Bollnica" shumë shpejtë kjo ëndje ju shua dhe tash nëpër ndërtesa të spitalit në daç me ëndje apo pa ëndje, mund ta lexojnë me të madhe **SPITALI**. Ata të cilët ishin mësuar t'i dëgjojnë ankesat e qytetarëve për mospërfilljen e tyre në shërbimet mjekësore, tash e tutje këto ankime do ta kenë rastin t'i dëgjojnë si lavdërime për funksionimin normal në këtë institucion. Ata të cilët pas ndonjë kurimi ishin mësuar të jepnin diçka mjekëve dhe udhëheqësisë së spitalit në formë të dhuratës, këtë gjë më nuk mund ta bëjnë, sepse dhurata dhe rroga nëpër institucione shtetërore jep vetëm shteti, pra ato dhurata mund lirshëm t'ia dërgojnë ndonjë të varfrit.

E pra, ju udhëheqës shqiptarë mendoni mirë, merrni mësim nga veprimtaria e këtij fanari ndriçues. Qenkan të mundura ndryshimet në favor të qytetarit. Qenka i mundur manifestimi i ndjenjave kombëtare (pa i hyrë në hak askujt), qoftë edhe nëpër institucionet shtetërore. Qenka e mundur moskorruptimi dhe mosshfrytëzimi i beneficioneve legjitime nga ana e drejtorit. Si dhe qenkan edhe shumë të mundura të tjera, porse qenka dhe është mjaft vështirë të luftosh kundër epshit të pangopur.

Nëse ende nuk e kemi të qarte ardhjen e meritokracisë në vendin dhe institucionet tona dhe dyshojmë në to, atëherë ky fenomen mjaft i shëndoshë, paska filluar t'i hedhë hapat e para prej këtij njeriu. Zoti ju ndihmoftë!

Sporti dhe intelektuali

Njeriu si banor i përkohshëm i këtij nënqielli, për sendërtimin e personalitetit të shumanshëm dhe begatimin e intelektit të tij, ka qenë dhe është i prirë dhe i detyruar t'i përdor të gjitha rrugët, me të vetmin qëllim tejet të pastër, e ky synim mjaft fisnik ka të bëjë me finalizimin e tërë asaj çka quhet shëndet dhe sukses. Shpeshherë për këto dy dukuri është studiuar dhe folur, si dy koncepte dhe profesione në vete, duke harruar apo dashur të harrohet qëllimisht që të trajtohen në një vijë të përbashkët.

Për ta shpjeguar dhe qartësuar më mirë njësimin e këtyre koncepteve, fillimisht ne pyesim. Vallë është i mundur fluturimi i shpezëve vetëm me njërin krah? Pa dyshim se jo! Po mirë, është e mundur që njeriu të jetë i ditur, apo profesionist i mirëfilltë në një lëmi të caktuar fare pa u marrë me aktivitete sportive? Pa dyshim që jo! Është e mundur që njeriu të jetë sportist i mirëfilltë pa lexuar fare libra? Po është e mundur, si shumë të mundura tjera në vendin tonë, por sa është e frytshme kjo e mundur!? Më mirë të mos kishim pyetur.

Dituria dhe sporti janë plotësuese njëra ndaj tjetrës, e jo zëvendësues. Po e imagjinoj një intelektual të trashë, i cili mezi merr frymë, por në shpjegimin e gjërave të ndryshme është i mrekullueshëm, po ashtu në imagjinatën time po më sillet rreth kokës, edhe një sportist, i cili ka një trup të mrekullueshëm e vital, por shpjegimi i tij në çdo fushë i përket rangut mjaftë të ulët. Kësi lloj absurditetesh ndodhin kur, mençuria dhe sporti nuk bashkëveprojnë njëra me tjetrën!

Formësimi i natyrshëm i njeriut, në vete ngërthen bashkimin e këtyre dy fenomeneve, në një ecuri të vetme, apo në një rrugë të përbashkët. **Shpeshherë shohim dhe dëgjojmë të ditur**

me një bagazh të madh të krijimtarisë shkencore, por shumë shpejtë e vërejmë, kuptohet fare pa qenë mjek se, intelektuali në fjalë vuan nga sëmundja e diabetit, ka yndyrë në gjak, në masë të madhe është nervoz, stomaku i tij i ngjan grave shtatzëna, intonacioni i zërit tingëllon jo aq i përshtatshëm tek dëgjuesit, gjestet shpjeguese të tij janë mjaft të ngadalshme, fizionomia e jashtme e tij të neverit, si dhe përgjithësisht personit në fjalë i mungon karizmi. Ne ua pranojmë dhe askush nuk ka të drejtë t'ia mohojë punimet e tyre shkencore, mundin e tyre për këtë shoqëri, por ne fare nuk pajtohemi që t'i jepet përparësi ekstreme vetëm zhvillimit të njërës pjesë të trupit, sepse përpos muskujve të cilët gjenden në kokë (e që këto muskuj manifestojnë forcë, e cila forcë është e shprehur në dituri) njeriu është i përbërë edhe prej pjesëve tjera. **Me gjithë veçantitë individuale, trupi i të gjithë qenieve njerëzore është i ngjashëm: Ai është i ndërtuar prej kokës, trupit dhe katër gjymtyrëve, dy të sipërme (duart) dhe dy të poshtme (këmbët) dhe prej shumë pjesëve dhe një mori qelizash tjera të brendshme.**

Të ju them të drejtën, unë personalisht në shkollë të mesme, në mënyrë të rregullt merresha me sport (duke mos i lënë anash edhe obligimet shkollore) dhe pas regjistrimit tim në fakultet, vëllai im i madh në mënyrë metaforike më këshilloi që tashmë, duhet të merrem më shumë me ngritjen e peshave (tegave) për kokë, sepse ai më tha: edhe koka ka muskuj, por nuk janë të ngjashme me muskujt tjerë truporë. Edhe pse këshillë e shkurtër, mua kjo më shërbeu shumë. Sepse, nga mosaktivizimi i muskujve si tërësi, do të kemi një sukses të mangët dhe me pasoja. Ç'na vyen një diapazon i gjerë i diturisë, kur në vazhdimësi kemi probleme me shëndetin! Po ashtu, ç'na vyen një trup i shëndoshë e muskulorë, por me kokë të zbrazët! Sikurse bashkësia e numrave të zbrazët, është e madhe, por në të nuk ka asgjë.

Nuk është thënë kotë, **"koka e shëndoshë në trupë të shëndoshë"**.

E pra, si mundë të jetë koka e shëndoshë në trup të delfinit, apo të balenës. Ndoshta te balena, apo delfini ky lloj ndërtimi përshtatet, sepse është në natyrshmërinë e tyre, por neve besoni që ky ndërtim nuk na shkon për shtati. Sigurisht që shumica e këtyre të diturve që vuajnë nga ky lloj i përtacisë (të mos keqkuptohemi, kemi edhe intelektual që në mënyrë të rregullt merren me sport) për mos marrjen të paktën në mënyrë sporadike me sport, arsyetohen me kohën e tyre të zënë. Por këtë arsyetim, disa shkencëtarë me renome botërore ia hedhin poshtë intelektualëve tanë këtë teori. Sepse ata, të paktën tri herë në jave merren me sport, kuptohet secili shkencëtar merret me llojin e sportit të cilin e dëshiron! Më kujtohet një profesorë i imi në Prishtinë, i cili ishte i përgatitur dhe mjaft i freskët në shumë fusha, e në veçanti ishte (kuptohen ende është) ekspert me ekspertizë në lëmin e vet dhe, ne studentët pa një analizë paraprake rreth fshehtësisë së suksesit, duke u mbështetur në dukjen e tij fiziologjike dhe në këndelljen mendore, e kuptuam se profesori në fjalë në mënyrë të rregull merret me aktivitete sportive.

Pra, aktivitetet sportive janë domosdoshmëri e përgjithshme e njerëzve, e posaçërisht e dijetarëve, sepse e tashmja dhe e ardhmja progresive dukshëm varen prej tyre. Efikasiteti dhe rezultatet suksesive, përveç trurit të shëndoshë, kërkojnë që edhe trupi i tyre të jetë i shëndoshë, sepse nga kjo neglizhencë pjesore shumë lehtë mundë të cenohet vitaliteti i trurit, e ky shëndet arrihet duke e konsideruar dhe vënë në praktik sportin si pjesë të domosdoshme të jetës sonë.

Ky shkrim iu referua konkretisht kokave të ndritura, por të cilat fatkeqësisht kanë një trup shumë pak funksional, arteriet e të cilëve në vazhdimësi protestojnë nga brenda, por ja që pronari i këtyre arterieve bëhet i shurdhët qëllimisht. Këtë shkrim si kështillë mund ta marrin edhe politikanët, edhe pse jo të gjitha janë të mençur, por para se gjithash bëjnë pjesë në grupin e qenieve njerëzore!

Pranë shtetit pa pushtet

Në të kaluarën, poetët recitonin vargje mjaft të dhembshme, vargje të cilat përputheshin me mjerimin e përditshëm të popullit shqiptar. Vargjet e tyre, në vete ngërthenin një realitet mjaft të hidhur. Shumica e popullit shqiptarë, para atyre vargjeve gjunjëzoheshin fizikisht, e shpirtërisht. **Sepse, të qëndrosh pranë detit i palarë, pranë dritës i paparë, pranë sofrës i pangrënë, pranë dijes i panxënë, pranë vatanit pa vatan, si dhe pranë çdo gjëje pa asgjë, është tmerr dhe gjenocid i vërtet!**

Shikuar dhe analizuar nga prizmi alegorik këto poezi, do arrish të kuptosh se nuk bëhet fjalë vetëm për mungesë larjesh, ngopjesh, nxëniesh, por mungesë pushteti brenda shtetit në të cilin jeton. Sepse, përmes pushtetit arrihet pothuajse gjithçka që dëshirohet qoftë për mirë, apo për keq. Por, duhet pasur parasysh se shfrytëzimi i pushtetit në shtetin që jeton, mund të bëhet, vetëm atëherë kur për momentin nuk ke gjasa ta fitosh shtetin tënd të qeverisur nga etniteti yt, apo thënë ndryshe, kur pajtohesh të jetosh në një shtet të përzier, pra shumetnik, ku pala tjetër mund të jetë pak më shumë në numër, apo ka përkrahje nga ndërkombëtarët pak më shumë, se sa etniteti yt. **Nëse e ke shtetin tënd, po ashtu nëse je dominues mbi komunitetet tjera pakicë, atëherë do të ishte e kotë të flasim, për shtetin pa pushtet, por në atë rast do të duhej të flasim, për shtetin pa qeverisës me mend, sikur një kohë që ishte në Shqipëri.**

Ne shqiptarët, të cilët jetojmë në Maqedoni, përfundimisht prej vitit 2001 vendosëm të jetojmë në këtë shtet, me të tjerët bashkëristh, si dhe me një marrëveshje për të drejta dhe përfaqësim të barabartë në të gjitha institucionet shtetërore. Meqë

ne vendosëm të jetojmë në këtë shtet, vallë a vendosëm të jetojmë në këtë shtet me pushtet të barabartë, apo me shtet të barabartë, e me shumë pak pushtet ose hiç pushtet??? Siç po shihet, realiteti i përditshëm mjaft qartë, si askush tjetër po na tregon se, ne shqiptarët edhe pas tetëmbëdhjetë vitesh ende jemi në shtetin tonë, por me pushtetin e pjesës tjetër, që jeton po në këtë shtet. Askush nuk ka të drejtë të pohoj, se ne shqiptarët në Maqedoni kemi pushtet pothuajse të barabartë me të tjerët, (kështu shkruan nëpër marrëveshje të ndryshme) ne, lëre që nuk jemi pothuajse të barabartë, por ne, në këtë shtet kemi pushtet, aq sa druri i thatë ka ujë. Këtë konstatim timin e argumenton, prej kohësh, indiferenca e Qeverisë ndaj etnitetit shqiptarë: Në kabinetin e Crvenkovskit ke pasur vetëm një shqiptarë, edhe atë kur e dimë ne se, kush e çka ka qenë, helmimi i herëpashershëm i nxënësve shqiptarë nga ana e pushtetit maqedonas, problemi i objekteve shkollore te shqiptarët, implementim shumë i ngadalshëm i Marrëveshjes së Ohrit, moszhvillimi ekonomik në pjesën shqiptarë, rrugët antike në pjesët tona, stimulimi i natalitet vetëm në pjesën lindore të Maqedonisë, subvencionimi i bujqve maqedonas, pengimi i librashitësve nga Tirana, mosftesa e Fatmir Sejdiut në inaugurimin e presidentit të sapo-zgjedhur, ndërtimi i kryqeve-kishave mu në zemër të Shkupit, degradimi i vendlindjes së humanistes shqiptare Nënë Terezës, mos lejimi i ndërtimit të Burmali Xhamisë, arrestimi i "kriminelëve" vetëm të etnisë shqiptare, shpallja dhe mbajtja e komunës së Likovës si zonë e krizës, eksploatimi i resurseve natyrore prej vendeve shqiptare dhe investimi i tyre në zonat maqedonase, mospërfillja e subjektit politik shqiptarë për zgjidhjen e kontestit të emrit, minimi i të drejtës për gjuhën shqipe, si dhe së fundi kulmi i të gjitha padrejtësive, të cilat padrejtësi dhe shantazhe nuk kam mundësi të gjitha t'i përmend, ishte edhe arrestimi i liderit gjithë-shqiptar, Albin Kurtit.

Po të kishim pushtet në këtë shtet nuk do e lejonim që vëllanë tonë, ta arrestojnë organet e sigurimit shtetëror pa dijeninë tonë, edhe atë ta marrin në pyetje dy maskarenj serbisht-folës. Pra,

ai i cili pretendon se ne kemi pushtet në këtë shtet, ai person do të ngarkohet me një përgjegjësi të madhe morale, e pa rrugëdalje para popullit shqiptarë. Menjëherë personin në fjalë do ta pyesim, si është e mundur që ju si pushtetarë në këtë shtet të na bënit kaq shumë të këqija, neve vëllezërve tuaj. Nëse, ndonjë ministër në këtë shtet supozon se unë si ministër kam pushtet mbi dikasterin tim që e drejtoj, atëherë ministri në fjalë, asnjëherë nuk do të gjej përgjigje, në lidhje me mosinteresimin e tij ndaj etnitetit të vetë. Ndoshta nuk e dimë se sa në hall janë ministrat shqiptarë në këtë shtet, ndoshta ata me të vërtet brengosen për mos-zhvillimin e rajoneve shqiptare, ndoshta disa deklarata çka ne i dëgjojmë prej tyre, janë deklarata të dhëna vetëm nga goja e tyre, duke mos pasur asnjë kontakt me zemrat e tyre, sepse ndoshta, zemrat e tyre e thonë të kundërtën prej asaj çka ne e dëgjojmë, por ne, përskaj shumë këtyre informacioneve e dimë, edhe atë se, ministri i lidhjeve dhe transportit në Japoni nga përgjegjësia e madhe që ndjen ndaj detyrës së tij, ka dhënë dorëheqje vetëm se është vonuar tetë minuta treni. Nëse ky ministër ka dhënë dorëheqje vetëm se qenka vonuar pak treni, atëherë ministrat tanë shqiptarë çfarë duhet të bëjnë, çfarë përgjegjësie duhet të manifestojnë përpara popullit të vet, kur dihet mirëfilli se treni me vite të tëra në pritje, ende nuk ka ardhur, e në vagonët e trenit gjenden shqiptarët e uritur për bukë e dritë, dhe fatkeqësisht në lokomotivën e trenit gjendet drejtuesi i etnisë maqedonase.

Pra, paralajmërimi analogjik i poetëve tanë me vargjet e tyre pranë detit i palarë, pranë dritës i paparë, pranë sofrës i pangrënë, pranë dijes i panxënë, na qenka fenomeni i shtetit pa pushtet, e ndoshta edhe më keq!

Një metaforë reale dhe rrëqethëse për Ushtritë Çlirimtare

Mbretëronte acari, ishin net të gjata, frynin erëra të ftohta, kur papritmas, dëgjohej një zë i turbullt që kërkonte ndihmë. Me të dëgjuar këtë zë, sa trishtues, aq edhe krenar, menjëherë disa persona që gjendeshin afër vendit prej nga vinte zëri, pa hezitim në bazë të mundësive të veta i ofruan ndihmë. Për çudi personat që gjendeshin afër vendit, aty ishin takuar rastësisht! Ata kishin dalë prej shtëpive të tyre për të vetmen arsye, që në mënyrë ilegale, nëpër male në mënyrë që t'u iknin kapjeve eventuale të policisë dhe dalëngadalë ta kalonin kufirin, e të shkojnë në mërgim për ta siguruar kafshatën e gojës për vete dhe për familjen e tyre. **Ishte një çudi tjetër, se ata në atë vend ishin ulur për të pushuar pas një rrugëtimi mjaft të gjatë dhe të gjithë ishin prej vendeve të ndryshme. Njëri ishte prej Çamërisë, tjetri prej Kosove, Maqedonisë, Shqipërisë, Kosovës Lindore, dhe Malit të Zi. Kur këta u afruan në vendin prej nga u vinte zëri, panë se aty ishte një nënë jo edhe e re, e cila mezi merrte frymë dhe panë se ajo është afër lindjes.** Këta persona ashtu të habitur me rastin e papritur nuk dinin se çka t'i bënin.

Koha nuk priste dhe ajo me mjaft mundime lindi një djalë, nën kushte mjaft të pavolitshme! Menjëherë pas lindjes, personat në fjalë iu gjenden afër për ndihmë, e më pas shëndeti iu keqësua, edhe më shumë nënës së dashur. Me të hetuar nëna se jetës së saj po iu afrohet fundi, me nxitim i thirri personat të cilët i kishin ndihmuar në lindje, që realisht ishin vëllezërit e kësaj nëne të shumëvuajtur dhe i luti që për pak çaste të dëgjojnë me vëmendje. Pa humbur kohë, nëna e dashur nisi të rrëfej: unë jam një nënë e

cili kam përjetuar raste mjaft të vështira në jetën time, burrin tim ma vranë padrejtësisht armiqtë sllav, i kemi pasur dy djem të cilët amanetin tim dhe të atit të tyre, nuk e dërguan plotësisht në vend dhe dalëngadalë disa virtyte të tyre u asimiluan, apo u pajtuan me gjendjen e cili u plasohet nga jashtë. Emri i djalit të madh ishte UÇK (Ushtria Çlirimtare e Kosovës), të cilin e linda në male të Drenicës, duke mu gjendur në ndihmë im shoq, kurse emri i djalit të dytë ishte UÇPMB (Ushtria Çlirimtare për Preshevë Medvegjë dhe Bujanoc) të cilin e linda në pjesën lindore të Kosovës, edhe pse kësaj radhe doja ta lindja në spital të Kosovës së çliruar, por në atë kohë si dëbues nuk i kishim sllavët, por disa të huaj të bardh, të zi, e të verdhë që thirreshin me sa më kujtohet UNMIK dhe KFOR. **Djalin që tash e linda me ndihmën e Zotit dhe ndihmën e juaj dëshiroj që ta emëroni UÇK (Ushtria Çlirimtare Kombëtare), sepse kjo dëshirë dhe amanet ishte, edhe e burrit tim. Sikur ta dinte e gjora se kjo luftë do të përfundojë me një marrëveshje, e cila në vete ngërthen; përfaqësim të drejtë dhe adekuat të shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore, atëherë amaneti i kësaj nëne fisnike do të ishte më ndryshe, pra, këtë djalë do ta urdhëronte që ta pagëzojnë me emrin, UÇD (Ushtria Çlirimtare për të Drejta)!**

Porosia e nënës dhe, e babait ishte: tash e tutje duhet shkuar me çlirime të përgjithshme, njëherë e përgjithmonë duhet ta çlirojmë kombit tonë të shenjtë shqiptar. Amaneti i nënës dhe urdhri i babait, paska qenë çlirimi i tërë kombit shqiptar!

Menjëherë pas përfundimit të këtyre fjalëve, nëna ashtu e përlotur dhe në dhënie të shpirtit e gëzuar vdiq, u drejtua për në botën e amshuar për të mos vdekur kurrë.

Pas varrosjes së nënës në mal, në mënyrë mjaft të fshehur, ata e morën djalin dhe e pagëzuan me emrin të cilin ua kishte lënë amanet nëna e tij. E emëruan UÇK (Ushtria Çlirimtare Kombëtare) dhe në krahë e kapi njeriu që ishte nga Maqedonia, duke e ndihmuar edhe të tjerët. Ata ishin nisur për në mërgim, por me lindjen e UÇK-së ata u angazhuan në rritjen e UÇK-së, duke mos

e lënë në asnjë moment vetëm. Djali i cili quhej UÇK, me hapa të shpejt dhe, të sigurt sa vinte e forcohej, çdo ditë gjymtyrët e tij sa vinin e rriteshin, sepse ushqehej nga vise të ndryshme shqiptare, nga Shqipëria, Çamëria, Mali i Zi, Maqedonia, Kosova Lindore dhe Kosova.

Me të arritur ky djalë moshën madhore, disi fillojë ta ndjej vetën si burrë, i cili në vetvete ndjente njëfarë përgjegjësie, se tashmë ka ardhur koha për të bërë diçka madhore, e ndjente se ishte i obliguar me një mision të shenjtë për këtë komb, çdo ditë i shihte padrejtësitë që u bëheshin shqiptarëve anekënd trojeve të veta, që në vend të tyre ishin shndërruar në minoritete dhe me të drejta mjaft të minuara.

Misionin e vetë njëherë e filloi me kërkesa (edhe pse e dinte se gjithçka paqësore ishte e kotë). Ishte dëshmitar i kohës, se kërkesat nga askush nuk përfilleshin, i shihte orvatjet e partive politike në pushtet për të bërë diçka, por edhe ato orvatje të tyre ishin të kota, sepse binin në veshë të shurdhër. Djali, tashmë burrë vendosi të del haptas me kumtesë të qartë, drejtuar qarqeve përgjegjëse, kjo ishte një tentativë e tij që problemet, padrejtësitë, dhe pushtimi i tokave shqiptare të zgjidheshin në mënyrë paqësore, sepse ishte një përvojë nga dy vëllezërit e tij (UÇK-së) dhe (UÇPMB-së). Por, prapë gjithçka ishte e kotë. Avazi i pushtuesve vazhdonte si më parë, tashmë edhe më keq. Posa doli UÇK-ja publikisht me kërkesa të qarta, menjëherë u shoqërua me kritika nga më të ndryshme. Disa që e kundërshtonin ishin njerëz të thjeshtë, disa intelektualë, disa poetë, e disa shkrimtarë. Por burri me plot kuptimin e fjalës, ishte i vendosur në veprimtarinë e vet. Ishte i mllefosur aq shumë kur mori vesh në likuidimin e babait, si dhe në vdekjen e nënës në mal. Gjithmonë me vete thoshte se e bart misionin e rëndë dhe emri i tij do të thoshte çlirim i gjithë trojeve shqiptare, sepse e thërrisnin, Ushtria Çlirimtare Kombëtare. **Vazhdova në rrugëtimin tim mjaft të gjatë, e të rëndë, luftova ashtu si është më së miri duke i respektuar të drejtat dhe rregullat e luftës, duke lënë gjymtyrë në Tetovë,**

Kumanovë, e Likovë, duke çmuar dinjitetin e njeriut, sepse pa marr parasysh, se a ishte armik apo jo, para se gjithash njeriu është vepër madhështore e Zotit. Dhe mjerë për atë, i cili e nënçmon veprën e Zotit. Gjatë gjithë luftës UÇK-ja, qëndronte në këtë maksimë. Armikun e konsideronte armik dhe i përgjigjej në mënyrë armiqësore. Pas një lufte të ashpër, fitues i shumë betejave ishte UÇK-ja. Si çdo gjë që ka fundin e vet edhe luftës i erdhi fundi. Por, fundi ishte disi në shikim të parë dëshpërues për UÇK-në, sepse posa i binin ndërmend fjalët e fundit të nënës së tij, menjëherë në vetvete ndiente njëfarë "tradhtie" sepse e ëma ia kishte lënë amanet djalit të vogël, që mos të veprojë sikurse dy të parët. Posa përfunduan betejat (kështu thoshte, neve pak ca na habiste pse nuk thoshte përfundova luftën, por betejat) nisi të kërkoj fatin e jetës së vet. Por, ai gjithmonë dëshironte të ketë një shoqe të jetës, e cila mund t'i ndihmonte në përfundimin, dhe finalizimin sa më të frytshëm të betejave që i kishte zhvilluar gjatë luftës. Disa politikan vendor, për ta qetësuar prej luftës, apo thënë më mire për ta kthyer në jetën normale, vendosën ta martonin me një vajzë shumë të bukur, e cila ishte nga Shkupi e që jetonte në një lagje të maqedonasve. Por, djaloshit burrë (ish-UÇK-së) nuk i pëlqente vetëm bukuria e një vajze, si dhe vendlindja dhe vendbanimi i saj nuk i pëlqente fare, ndaj e refuzoi ofertën e politikaneve multietnik. Ai dëshironte një vajzë të bukur nga Tetova, ose nga Kumanova. Ata dëshironin ta martonin me një vajzë të bukur dhe me kulturë të përzier, tipare të cilat djaloshin burrë do ta magjepsnin, e më pastaj do të mund të merrnin çfarëdo vendimi në favor të politikanëve dhe shtetit shumetnik. Kur e panë ndërkombëtarët se gjendja po acarohej dhe nuk shihej gjetja e ndonjë gjuhe të përbashkët, vendosën të ndërhynin duke e bërë një zgjidhje për të dyja palët në konflikt. Vendosën që nusen ta kërkojnë në ndonjë vend ku nuk ka pasur fare konflikt, si dhe të jetë e përshtatshme për djaloshin burrë, të ketë njohje legjitime nga ana e shtetit. Pas një përpjekjeje të mundimshme djaloshit burrë (ish-UÇK-së), ia

gjetën një nuse nga Ohri, e cila ishte mesatarisht e bukur, si dhe nuk kishte ndjenja të theksuara patriotike.

Edhe pse me dëshirë jo të plot, vendosi të martohet, duke qenë herë pas herë i dëshpëruar për vendimin e marrë. Në kokën e tij iu silleshin vërdallë mendime të ndryshme, zëri i nënës i thoshte "bir, bir, bir ku mbeti dëshira jonë, dëshira e gjithë shqiptarëve".

Me vështirësi u adaptua dhe, me 13 gusht, të vitit 2001 u caktua ceremoniali i martesës. Djaloshi burrë në këtë datë, u kurorëzua me Marzanën nga Ohri, me të cilën e nënshkruan një marrëveshje për jetën e tyre bashkëshortore, në prani dhe, garanci të ndërkombëtareve. Në këtë rast, prapë pati kundërshtime nga ana e opinionit, disa thanë: "ah i gjori UÇK u kurorëzua me një lavire, ajo nuk do t'i mbahet marrëveshjes së nënshkruar, e në këtë edhe ndërkombëtarët do të bëjnë lëshim". Disa e përkrahën duke menduar se tash e tutje djaloshi burrë, nuk do të jetojë më nëpër male, por do ta bëj një jetë me një komoditet çka prindërit e tij më par nuk e kishin pasur. Sidoqoftë, pas tetë vjetësh djaloshi burrë, gjendet në një grindje të përditshme me këtë vajzë nga Ohri. Nuk duhet habitur nëse një ditë do të dëgjojmë për shkurorëzimin e djalit në fjalë me Marzanën nga Ohri, sepse që në fillim nuk kishte vullnet të plot për kurorëzim me këtë vajzë.

E pra, kësi lloj dështimesh dhe zhgënjimesh do të përjetojmë ne shqiptarët, nga të qenit jo korrekt ndaj realizimit të qëllimit. Në këtë rast, ne shqiptarët planifikuam një ndërtesë shumëkatëshe, por përfunduam në një tendë antike!

Roli dhe këndvështrimi i Televizionit Privat A1, ndaj tezave të liderëve shqiptar për ndryshimin e kushtetutës në Republikën e Maqedonisë

Në kohën bashkëkohore mediat janë bërë faktor i rëndësishëm për ndërtimin, informimin, zhvillimin e realitetit shoqëror. E them, kushtimisht njoftimin me realitetin shoqëror, sepse shpeshherë mediat dinë dhe duan ta luajnë rolin e një agjenti të dyfishtë, ku secila palë që është e varur nga veprimtaria e tyre, mund të përballet me një gënjeshtër tejet të kamufluar. Çdo anë pozitive, shoqërohet edhe me anën tjetër negative, ky është një rregull i pandryshuar! Edhe, mediat përgjithësisht janë të prekur nga ky problem. Mediat, sidomos mediat elektronike – vizuale, kanë ndikim të madh në shoqëri. Përmes tyre ne informohemi për ngjarjet të ndryshme, politike, ekonomike, shoqërore, etj., përmes tyre ne kemi mundësi që mendimet tona subjektive t'i artikulojmë në analiza dhe studime objektive. Media si institucion kryesisht i pavarur është një urë lidhëse ndërmjet shikuesit, ngjarjes dhe transmetuesit (TV, radio, interneti, gazeta, revista, etj). Përmes mediave botë është shndërruar në një fshat të vogël, ku gjithsecili ka mundësi të informohet prej gjithsecilit, përtej kontinenteve, përtej oqeaneve, sidomos këtë zhvillim të hovshëm teknologjik dhe informativ, e ka ndihmuar në masë të madhe zbulimi dhe zhvillimi i internetit.

Me fillimin e funksionimit të pluralizmit politiko-ekonomik, në vendin tonë filloi të lulëzojë edhe liria e shprehjes, filluan

gradualisht t'i hiqen censurat mediave, pra mediat filluan të pavarësohen, të lirohen nga dirigjimet politike (edhe pse disa media, edhe sot e kësaj dite janë nën dirigjime politike). Por, mediat në vendin tonë, në Republikën e Maqedonisë, kishin harruar se vendi i tyre gjendet në tranzicion, ku kalimi prej pronës shtetërore në atë private i ka të metat dhe anarkitë e shumta, ku detyrimisht ndonjëherë do duhej luajtur rolin e marionetës.

Pra, roli i mediave në Republikën e Maqedonisë, në shtjellimin dhe informimin e opinionit, përgjithësisht nuk ishin edhe aq objektiv, ngase siç e dimë, në vendet ku kemi transformime shoqërore dhe tranzicion ekonomiko-politik, vështirë është të mbetesh i paanshëm dhe objektiv. Në Republikën e Maqedonisë ekzistojnë shumë mediume private (të pavarura) dhe shtetërore. Por, ne në punimin tonë vijues, do të profilizohemi në shtjellimin e Televizionit të Privat A1, konkretisht roli dhe këndvështrimi i këtij mediumi në tezat e liderëve shqiptarë rreth ndryshimit të kushtetutës në Republikën e Maqedonisë.

2.1. Propozimi i liderëve shqiptarë për ndryshim të kushtetutës dhe marrëveshje të reja, nevojë apo marketing politik

Pakënaqësitë kulminante në lidhje me mostrajtimin dhe mospërfilljen e shqiptarëve në Republikën e Maqedonisë, shpërthyen në vitin 2001 me një konflikt të armatosur, ndërmjet kryengritësve shqiptarë dhe forcave shtetërore të sigurisë. Dhe, pas mbarimit të këtij konflikti, u nënshkrua një marrëveshje, që njihet si Marrëveshja e Ohrit, ku përfundimisht u tha se, Republika e Maqedonisë nuk është vetëm e maqedonasve, por është edhe e shqiptarëve dhe e komuniteteve tjera pakicë që jetojnë në këtë shtet. Kjo marrëveshje ishte me afat të caktuar të implementimit. Por, fatkeqësisht marrëveshja në fjalë nuk e përjetoi realizimin në tërësi, as në vitin 2009. Si rrjedhojë e këtyre boshllëqeve, lindi ideja nga disa lider tjerë, për përpilim të marrëveshjeve të reja mes

palës maqedonase dhe asaj shqiptarë. Pala tjetër me taktikat diplomatike jo të shëndosha, i përkrahte subjektet politike shqiptare në krijimin e sa më shumë marrëveshjeve.

Kështu, patëm marrëveshje të majit dhe të marsit. Por, kryeministri aktual i Maqedonisë, e përgënjeshtroi para mediave marrëveshjen e majit, duke e quajtur kështu liderin e BDI-së gënjeshtarë. Porse lideri i BDI-së, nuk u brengoste, sepse, ai thoshte marrëveshja kur është bërë, aty ka pasur mediume nga më të ndryshmet! Në të njëjtën kohë mediumet, sidomos ato maqedonase heshtnin përball këtij misteri. Sot, e kësaj dite ky fenomen vazhdon akoma të qëndrojë si enigmë, te një shumicë e popullatës shqiptare! Sidoqoftë, përfundimisht kryetari aktual i komunës së Gostivarit, Rufi Osmani propozoi ndryshimin e kushtetutës së Maqedonisë, ndërsa lideri i PDSH-së, Menduh Thaçi është në përpilim e sipër të një marrëveshjeje të re politike, ndërmjet shqiptarëve dhe maqedonasve, lideri i BDI-së, Ali Ahmeti të dyja propozimet i quan marketing politik, sepse këto nën-marrëveshje janë vetëm lecka që nuk i përballon dot, Marrëveshja e Ohrit, etj. Por, opinioni, shtresa më e drejtë e shoqërisë, edhe prej kësaj, edhe prej marrëveshjeve tjera të radhës, është i zhgënjyer tej mase, sepse në vend që të fillohet me punë konkrete, në të mirë të të gjithë qytetarëve, ata vijojnë me mashtrime të radhës, sa për ta kaluar kohën, si dhe, sa për t'i dhënë material mediave për transmetim. Por, mendimi ynë, për marrëveshjet e radhës është, se subjektet politike shqiptare janë duke e paraqitur një arsyetim fals për mosefikasitetin dhe paaftësinë e realizmit të Marrëveshjes së Ohrit. Përderisa nuk u realizua Marrëveshja e Ohrit, e cila ishte rezultat i kryengritjes së armatosur, asnjë marrëveshje tjetër, apo ndryshim i kushtetutës nuk do të jetë efikase, ndoshta do ta kenë fatin, edhe më të rëndë së Marrëveshja e Ohrit.

Në vijim do të shohim se si Televizioni A1 me gazetarët e saj komentet, e trajtojnë këtë kërkese dhe argument të liderëve

politik shqiptarë, apo përmes metodave konspirative gazetareske si e shfaqin mllefin dhe kobin e tyre ndaj kërkesave të dy liderëve.

2.2. Roli dhe këndvështrimi i Televizionit Privat A1, në tezat e liderëve shqiptar për ndryshimin e kushtetutës në Republikën e Maqedonisë

Është e udhës që kërkesat dhe pakënaqësitë e ndryshme, aq më shumë kur kemi të bëjmë me kërkesa dhe projekte madhore, të paraqiten në mediume dhe të kërkohet, edhe prej tyre mendimi, qoftë pozitiv apo negativ. Sepse, ka ikur koha kur platformat dhe kërkesat janë përpiluar në dhoma të ndejës, si dhe prezantimi i atyre kërkesave pastaj është bërë, po ashtu në dhomë të ndejës, duke e marrë kështu pëlqimin nga një grup i vogël personash, jo aq të autorizuar për të dhënë pëlqim apo mospëlqim, si dhe përgjithësisht ka munguar një shoshitje pak më e madhe e gjërave, që pastaj është dashur të jetësohen në jetën praktike reale.

Fatkeqësisht, për ne shqiptarët diskriminimi nuk ka qenë vetëm në një segment, por pothuajse në të gjitha segmentet institucionale nuk kemi qenë të trajtuar, sikurse palë e dorës së dytë, pra ndaj neve në vazhdimësi, ku më pak, e ku më shumë, është ushtruar një lloj diskriminimi.

Debatet që janë bërë dhe bëhen në TV-A1, konkretisht në emisionin "Studio 2", rreth problemeve të ndryshme, nuk kanë munguar edhe analistët shqiptarë. Por, nga pakujdesia e qëllimshme e redaksisë së këtij televizioni, kemi pasur kontradikta të herëpashershme me vet natyrën e programit. Gjoja se ky emision debativ, qenka objektiv në trajtesën e problemeve, duke e inkuadruar në paraqitje dhe analiza, edhe kuadrin shqiptarë.

Por, kuadri intelektual shqiptar fatkeqësisht në këtë emision debativ është i detyruar të flas maqedonisht, për dallim prej Televizionit Kombëtarë ALSAT-M, ku analistët maqedonas mund lirshëm të polemizojnë në gjuhën të cilën e dinë. Pra, ky akt

është një thyerje elementare e Marrëveshjes së Ohrit, ku gjuha zyrtare përskaj maqedonishtes është edhe gjuha shqipe. Por, ne me këtë paraqitje të kësaj të mete dhe anomalie të këtij televizioni, nuk mund t'ia anashkalojmë vlerësimet, ku TV-A1, radhitet si televizioni i parë, për nga shikueshmëria, paanshmëria dhe objektiviteti.

Gazetarja, Sekullovska nuk mund ta fshihte antipatinë e tezës së Rufi Osmanit në lidhje me ndryshimin e kushtetutës, shihej qartë një shpenzim i tërë potencialit profesional vetëm që ta gjunjëzojë një njeri të mirë-përgatitur profesionalisht. Kuptohet, detyra e çdo gazetari, është që bashkëbiseduesin ta sjell në situata mjaft të papërshtatshme. Gazetarët e Televizionit A1, propozimin e marrëveshjeve të tilla, përskaj asaj të Ohrit, e shihnin në kontekstin e lojërave, i shihnin dobësitë përpiluese dhe realizuese të marrëveshjeve, në mënyrë pragmatike e vërtetuan mos-unitetin e subjekteve politike shqiptare, ndaj ishin shumë të pa emocionuar në provokimet e liderëve shqiptarë. Sepse, këto marrëveshje spektri intelektual dhe politik maqedonas është duke i përdor si aventura të përshtatshme dhe efikase për të përfituar në kohë, si dhe një shkas për largimin e vëmendjes nga implementimi i Marrëveshjes së Ohrit. Në bazë të disa debateve të mbajtura në Televizionin A1, konkretisht në emisionin, "Studio 2", shihen dëshirat dhe përkrahjet e disa analistëve maqedonas për krijim të sa më shumë marrëveshjeve të reja me shqiptarët, sepse ata e dinin mirë se çfarëdo lloj marrëveshje tjetër që do të pasonte, do të jetë një labirinth i komplikuar i radhës. Por, ata kinse harronin se me kësi lloj lajthitjesh mund të rrezikohen me shuarjen e shtetit të tyre, e të mos flasim për integrimin e vendit në UE dhe NATO!

Pala tjetër, analistët që me të vërtet ia dëshironin të mirën këtij shteti, shprehin një brengë serioze për mos-implementimin në tërësi të Marrëveshjes së Ohrit. Sepse, dihet mirëfilli, përpos problemit rreth emrit për aderim të vendit në UE dhe në NATO, subjekti intelektual dhe politik maqedonas duhet të mendoj mirë, edhe për plotësimin e kërkesave të të gjithë komuniteteve që

jetojnë në Republikën e Maqedonisë. Propozimi i liderit të PDSH-së, për marrëveshje të re shqiptaro-maqedonase, ende hollësisht nuk është debatuar në këtë medium, por as në ndonjë medium tjetër shqiptar. Pra, ky lloj i debatit në të ardhmen pritet të jetë i nxehtë dhe deshifrues, për ata që mendojnë se kjo marrëveshje është tepër konfuze.

2.3. PËRFUNDIM

Roli dhe ndikimi i Televizionit Privat A1, në Republikën e Maqedonisë, është tejet influencues mbi rrjedhat informative dhe polemizuese në këtë shoqëri. Ky medium, nga krerët ndërkombëtarë dhe kombëtarë, llogaritet si mediumi më i shikuar dhe më i besuar në tërë Republikën e Maqedonisë. Me debatet e saja, shikuesi arrin të kuptojë shumë gjëra, ngase në të marrin pjesë shumë analistë të kalibrave të ndryshëm, po ashtu edhe moderatorët e këtyre emisioneve informative dhe polemizuese, janë tejet të përgatitur. Ashtu siç e thashë edhe më lartë, se ne shqiptarët nuk i kemi shpëtuar dot, asnjë segmenti institucional, privat apo shtetëror, e të mos jemi të anashkaluar, diku më shumë, e diku më pak, por sidoqoftë të injoruar edhe para mediave. Në këtë medium, fatmirësisht kemi të punësuar edhe gazetarë shqiptarë, por fatkeqësisht të njëjtët gazetarë asnjëherë nuk i kemi dëgjuar duke prezantuar diçka në gjuhën shqipe (përpos reklamimit të disa gazetave shqiptare). Nuk kemi shpëtuar, edhe prej injorimit të këtij mediumi, ndonjëherë kolektivisht kemi qenë të fyer, duke u kënaqur në propagandën mediatike për shqiptarët si, "kriminel", "vjedhës", etj., por nuk mund të mos i pohojmë edhe lëvdatat për disa informime dhe analiza tejet të shëndosha në lidhje me problemet aktuale me të cilat po ballafaqohet Republika e Maqedonisë.

Pra, Televizioni Privat A1, ua bëri të mundur liderëve shqiptar, propozimin e idesë për ndryshim të kushtetutës, e prej tyre mbetet që t'i mbrojnë idetë dhe tezat, përballë provokimeve të gazetarëve profesionist.

Kujdes! Dëshmorët dëgjojnë dhe flasin

Njëra prej shumë traditave të shkëlqyera të popullit shqiptarë është, edhe përkujtimi në mënyrë të organizuar i dëshmorëve të kombit. Sidomos, pas luftës së Kosovës kjo traditë e shkëlqyer filloi të praktikohet me të madhe, sepse kishim emocione të freskëta, realiteti ynë i përditshëm, dukshëm u përputhte me flijimin e shqiptarëve për liri dhe barazi. Pastaj, rrodhi lufta në Kosovën Lindore, dhe çështja e kryengritjeve u finalizua me luftën në Maqedoni. Pas mbarimit të këtyre kryengritjeve manifestimet, homazhet, përkujtimet, rivarrimet ishin bërë përditshmëri e popullit të sapodalë prej luftërave. Nëpër kujtime të përvjetorëve, merrnin pjesë shumë njerëz, kishte edhe prej atyre të cilit historikisht nuk qëndronin mirë me kauzën kombëtare shqiptare. Ata ishin njerëz të dyshimtë, dhe si justifikim të marrëzirave të mëhershme, e përdornin retorikën patriotike, e cila retorikë aspak nuk përputhej me realitetin që flitej dhe punohej. Ata për t'i bindur njerëzit e tjerë se realisht janë penduar, deklaroheshin si njerëz (a)partiak. Por, nuk duhet mohuar faktin se njerëz të dyshimtë kishte, edhe brenda vet partive. **Kurse, ish-ushtarët dhe invalidët e luftës, ata të dyshimtit i shikonin me syrin e zhgënjimit, kishin frikë t'i shikojnë me syrin e urrejtjes, sepse mund të pësonin keq e më keq.** Të gjorët, ish-ushtarë e invalidë të luftës, nuk kishin çfarë të bënin, të dyshimtit e posedonin shkathtësinë e maskimit! **Ndodhte që homazhe i bënin dëshmorëve, kurse po të njëjtën ditë, ish-ushtarët shkonin për në Slloveni, për ta siguruar kafshatën e gojës për vete dhe për familjet e tyre, kurse invalidët dhe jetimët gjatë rrugës për në shtëpi mendonin sesi të vijnë deri te një kafshatë e bukës.** Për njerëzit e retorikës nuk kemi çfarë të flasim, ata bisedonin rreth vendit

super-modern të restorantit dhe ushqimin vitaminoz që është duke i pritur.

Shpeshherë nëpër manifestime të dëshmorëve të kombit, iu dha fjalë rasti, edhe atyre të cilët nuk kishin asgjë të përbashkët me kauzën kombëtare shqiptare, apo thënë më mirë, në një kohë liridashësit, tashmë dëshmorët, ishin në zor prej tyre!

Por, shtresa më e zgjedhur e popullit dhe e Zotit, këto padrejtësi dhe maskime është duke i përcjellë për së afërmi. Ata që e dhanë më të shtrenjtën për këtë komb, pra jetën, janë të nderuar me një vend, brenda së cilës gjithçka është e shkëlqyer dhe e përkryer.

Dëshmorët e kombit prej atij vendi të përkryer, janë duke na parë se çka në të vërtet, ne jemi duke bërë për ata. Dëshmorët e kombit nëpër përkujtime të tyre, për së afërmi janë duke i dëgjuar bisedat e disa funksionarëve politik rreth bizneseve të tyre. Ata janë duke i parë, edhe familjet e tyre, të cilët janë në luftë të vazhdueshme me mjerimin dhe varfrin. Dëshmorët janë duke i parë, edhe burgosjet e shokëve të idealit të tyre. Dëshmorët e kombit, ata të cilët nuk e shijuan fare dhimbjen e plumbit, ata të cilët i nderoi Zoti me, më të mirën e përjetshme, janë duke na parë, dëgjuar dhe folur neve për tmerret që janë duke na pritur në këtë botë, dhe në botën tjetër. Por, fatkeqësisht ne të gjorët, të cilët kemi sy por nuk shohim, kemi vesh por nuk dëgjojmë, kemi mendje por nuk logjikojmë, kemi ndjenja por nuk ndjejmë, kemi shqisa por nuk shijojmë, vazhdojmë akoma të qëndrojmë përballë mallkimit dhe në një katastrofë serioze.

Edhe pse dëshmorët nuk mallkojnë, sepse siç thamë gjenden në një vend të përkryer, vend ky i mbushur përplot begati dhe paqe, por vepra e tyre, që dikush fatkeqësisht është duke e shfrytëzuar për biznes të kësaj bote, do të na mallkon të gjithëve një ditë, ndoshta shumë shpejtë, edhe neve të cilët pretendojmë se jemi të drejtë. Sepse, pjesa e shoqërisë së ndershme është duke heshtur përballë këtyre krimeve dhe nëpërkëmbjeve. Maskarenjtë (disa të infiltruar në parti të ndryshme, disa të vet-quajtur

(a)partiak) hapur janë duke shkelur mbi gjakun e dëshmorëve, kurse ne shoqëria e drejtë (pa sherr) nuk jemi duke reaguar fare, as fshehur, e as hapur.

Po më vjen keq që do e shpalosi një argument të hidhur, përpara juve të nderuar lexues! Një ditë, shkova në një fshat heroik, i pamposhtur në kohën e luftës, bëra homazhe dhe lutje pranë varrezave, përjetova një ndjenjë që kurrë në jetën time nuk e kisha përjetuar dhe prej atij vendi të bekuar dola tejet i mallëngjyer. **Posa dola prej vendit ku ishin varrezat, rastësisht i dëgjova disa klithma çiftesh. Hiq më pak se 50 metra, përball varrezave ishte mali i dendur përplot lisa e bredha.** Të pamoralshmit dhe të pamoralshmet, rrugën e cila të shpie deri tek varrezat e dëshmorëve të kombit, e kishin keqpërdorur në maksimum, e kishin shndërruar në vend takim partnerësh. Rruga e cila shpie në krenarinë e përjetshme, ishte shndërruar në një rrugë e cila të shpie në kënaqësinë e përkohshme dhe fatale. Çmenduri apo jo, por e vërtetë! Por, nuk kishte qenë ky i vetmi zhgënjim dhe dëshpërim për mua dhe gjithë-shqiptarët.

Mua më ra rasti të jem prezent edhe në një tubim, ku për së afërmi i pash lojërat që bëhen në emër të dëshmorëve të kombit. Këtë lojë e bënin, ata të cilët asgjë nuk kishin të përba-shkët me luftën, ata të cilët nuk e dinin se çka është të humbasësh ndonjë anëtarë të familjes në luftë, të kujdesesh për një jetim, apo invalid të luftës, bile disa shkuan aq larg sa që, dëshmorët, invalidët dhe jetimët i quajtën "të dëmtuarit dhe viktimat e konfliktit të 2001-shit".

Por, mos të mashtrohemi, të mos vet-lajthitemi, sepse dëshmorët e kombit këto maskarallëqe janë duke i parë, edhe atë shumë më mirë se ne. Shumë shpejtë do të vijë koha, kur materialistët e kësaj botë do të dalin para Zotit dhe para dëshmo-rëve të kombit. Nuk do të gjejnë fjalë për arsyetim, përkundër oratorisë së shkëlqyer në këtë botë, nuk do të gjejnë truproja për mbrojte, përkundër truprojave të shumta në këtë botë, si dhe nuk

do të gjejnë asgjë arsyetuese, përkundër arsyeve false të shumta në këtë botë.

Pra, kujdes sepse dëshmorët dëgjojnë dhe flasin, ata flasin përmes gjurmëve dhe porosive të tyre, por nëpërkëmbja e veprave të tyre, shumë shpejt do të kthehet në mallkim për ne.

Pse i gjithë ky sulm ndaj nacionalizmit?

Nacionalizmi si fenomen shoqëror e politik u zhvillua në shekullin XIX, përgjithësisht si rrjedhojë e kërkesave për liri, barazi dhe vëllazërim. Dikush nacionalizmin e sheh si fatkeqësi e dikush si shpëtim për popullin e vet, por njëkohësisht, gjithsecili është pjesëtarë i një kombësie të caktuar me apo pa dëshirën e tij. Edhe ai që e shan apo ndjell fatkeqësi për nacionalizmin e vet, është i detyruar të jetë pjesë i një nacionaliteti, njëjtë sikurse ai që e lavdëron dhe i është mirënjohës Zotit për përkatësinë e tij kombëtare! E shave apo e lavdërove nacionalizmin, ai është pjesë e pandashme e secilit prej nesh.

Nacionalizmi si nocion i përgjithshëm ndahet në, nacionalizëm pozitiv dhe në nacionalizëm negativ. Nacionalizmi pozitiv në vete ngërthen përpjekjen, veprimtarinë, luftën dhe flijimin e popullit autokton, kundër pushtuesve mizorë, kurse me nacionalizmin negativ nënkuptojmë etjen, masakrimin, eksploatimin dhe luftimin me çdo kusht për ta kolonizuar një vend apo një popull të caktuar.

Fatmirësisht dhe historikisht populli shqiptar, përthekohet me një nacionalizëm pozitiv, ku fatkeqësisht dhe historikisht ky popull bujar, qe i vërshuar tmerrësisht prej nacionalizmit negativ apo kolonizues. Për të qenë ironia fatkeqe edhe më e madhe, sot në mesin e këtij populli bujar kemi njerëz që ndjehen të dëshpëruar, nga shkaku se i takojnë këtij nacionaliteti, apo ndjehen të dëshpëruar për shkak se ata patën dëshirë të mos jenë fare pjesëtarë të ndonjë nacionaliteti të caktuar. Ata dëshirojnë që vetën e tyre ta identifikojnë vetëm në bazë të përkatësisë fetare. Është mirë të krenohesh me fenë tendë, sepse përmes fesë së

shëndoshë, të pastër dhe të arsyeshme do ta fitosh përjetësinë e këndshme, por njëkohësisht është tejet jonjerëzore dhe jo etike të hedhësh balt mbi nacionalitetin apo kombësinë tënde. Ngase pastaj në emër të fesë islame, do ta kundërshtosh po ashtu fenë islame. Sepse, Zoti në një ajet kur'anor thotë: ***"O ju njerëz, vërtetë Ne ju krijuam prej një mashkulli dhe një femre dhe ju bëmë fise e kombe (popuj apo nacionalitete) në mënyrë që të njiheni ndërmjet vete...".*** Pra, çështja e fiseve dhe e popujve qenka caktim i të **Plotfuqishmit**, si dhe çdo fyerje ndaj secilit fis apo komb është mëkat, kurse fyerja dhe hedhja balt mbi kombin që natyrshëm i takon është më shumë se mëkat, më shumë se mallkim, më shumë se fatkeqësi apo më shumë se padrejtësi! Këta njerëz që e sulmojnë nacionalitetin e vetë, me këtë edhe nacionalizmin si tërësi, nuk janë vagabond as të padijshëm, por njerëz të kalemit e të konferencave. Ata e sulmojnë dhe ndjehen tejet të dëshpëruar me nacionalitetin e vet, ngase dikush nacionalitetin shqiptar po e ndërlidhka me disa figura të cilët nuk po i takuakan besimit islam. Kësaj i thonë, **dhashë Zoti të më vdes djali për inat të resë**! Në këtë rast, edhe ata që trumbetojnë ta paraqesin identitetin kombëtar si identitet të krishterë, provokojnë dhe gabojnë rëndë, sikurse ata që i kontestojnë të gjitha figurat shqiptarë, vetëm që po i përkitkan fesë tjetër.

A është islame ta quash kudër, lavire, spiune humanisten shqiptare Nënë Terezën, vetëm nga shkaku se ajo paska qenë një e krishtere-murgeshë, si dhe shumë fyerje tjera që i takojnë një nivel tejet të ultë dhe adoleshent!? Fundja nëse nuk dëshiron të krenohesh me humanizmin e saj, atëherë mos e përmend fare (heshtja nganjëherë është ar). Besa rezil të bëjnë nëse shkon në xhami dhe gjatë rrugës, në ndonjë ndejë apo në ndonjë kafene, nëse nuk i përqesh dhe nuk i nënçmon këto figura të cilat i takojnë fesë monoteiste, pra fesë së krishtere, duke harruar apo dashur qëllimisht të harrojmë se jemi popull shëmbëlltyrë pranë të gjithëve, edhe pranë Zotit në tolerancën, bashkëveprim dhe mirëkuptimin ndërmjet feve. Kështu që, ta përbuzësh nacionalizmin

për shkak të fesë është demagogji. Ngase, feja islame një gjë të tillë nuk e toleron dot! Mos harroni ju që dëshironi t'i vëni njolla kësaj feje se, të jesh mysliman do të thotë t'i respektosh të tjetër, qofshin edhe të kombësisë, racës dhe fesë tjetër. Çfarë mund të themi për njeriun i cili në emër të fesë e nënçmon përkatësinë e tij kombëtare! Unë fare mirë e di se çfarë janë dhe kush janë, por ata është mirë ta etiketojnë vetën e tyre se kush janë në të vërtetë (dëshirojnë ta ndihmojnë dhe zgjerojnë fenë, duke e nënçmuar kombin, apo...) dhe çfarë dëshirojnë të thonë me njerëzit e helmuar nga nacionalizmi, sepse nuk është cilësi e shqiptarit mysliman t'i etiketoj njerëzit me lloj-lloj etiketash, edhe pse në këtë rast vështirë është të përmbahesh, por durim dhe kujdes se jemi njerëz, e mund te gabojmë në vlerësime dhe përkufizime.

Nacionalizmi shqiptarë nuk është helm i rrezikshëm i Perëndimit, por e kundërta! Ngase në konferencat që u mbajtën në Perëndim dhe me njerëzit e Perëndimit, u copëtuan shqiptarët, kurse nacionalizmi (që është gjithherë pozitiv), ka të bëjë me bashkimin e shqiptarëve në një shtet, ashtu pra siç duhet të jemi. **Po të mos ishin ndjenjat e larta kombëtare dhe fetare, ne sot do të flisnim greqisht, serbisht apo turqisht**. Po të mos ishin të aktivizuara dhe të manifestuara ndjenjat kombëtare dhe nacionale në kohën e pushtimit osman, atëherë ne sot do e flisnim gjuhën osmanishte. Edhe osmanët e panë se ndjenja kombëtare te ky popull është shumë e ngritur, ndaj u detyruan dhe e obliguan vetën (jo me forcë, por me mirëkuptim) që mos t'ia cenojnë këtij kombi gjuhën dhe kulturën. Për këtë arsye, edhe pas pesë shekujve pushtim, ne mbetëm shqiptarë me gjuhën shqipe të ndarë vetëm në dy dialekte. **Nacionalizmi ndër shqiptarët u institucionalizua në Lidhjen e Prizrenit.** Kurse kjo lidhje e cila në vetë ngërthente bashkimin e trojeve shqiptare në një territor të vetëm me autonomi të plotë nën Perandorinë Osmane, në bazë të disa studiuesve të kësaj periudhe, u mbajt në xhami. Pra, nacionalizmi të cilin dikush e quan helm të rrezikshëm të Evropës, fillet zyrtare i paska në shtëpinë e shenjtë të Zoti.

Po të mos ishin të ngritura ndjenjat e nacionalizmit pozitivë, atëherë në këto troje askush nuk do t`u ngritke për të luftuar kundër pushtuesve, që në vete përmbanin nacionalizëm fashizoid.

Myslimanin, të krishterin, ortodoksin, budistin, etj., i karakterizon feja apo besimi i tyre, ndërkaq turkun, arabin, francezin, gjermanin, shqiptarin, etj., i karakterizon nacionaliteti i tyre!

Klithmat që (nuk) i dëgjoj shumë(as)kush

(Shkrim, me rastin e festës së Fitër Bajramit, 2009)

Të ashtuquajturit të mëdhenj, shpeshherë rastet e mëdha, por në territore apo vende të vogla, nuk kanë kohë dhe vullnet t'i vizitojnë. Klithmat trishtuese të njerëzve nevojtarë për shumëçka, edhe pse dëgjoheshin larg e posaçërisht në muajin e shenjtë të Ramazanit, prapë se prapë krijesa e zgjedhur e quajtur njeri, i cili qe i sprovuar me pasuri dhe autoritet nuk mundi fare t'i dëgjojë këto psherëtima. Njëjtë sikurse në Xhenet, ku klithmat e gëzimit do të dëgjohen shumë larg, por prapë se prapë në mesin e njerëzve të përdhosur dhe të sprovuar me të mira materiale në këtë botë, do të ketë prej atyre që nuk do të mundin t'i dëgjojnë këto klithma ngazëlluese të njerëzve që kishin qenë të sprovuar me mundime dhe udhëzim në këtë botë.

Edhe, ky muaj i bekuar (Ramazani) shkoi sikurse muajt e tjerë! Ky epilog përsëritës dhe jo ndryshues është duke i shoqëruar në vazhdimësi fshatrat në përgjithësi. Kurse ne do të jemi të koncentruar, në studimin e një fshati në aspektin fetar dhe social, emri i të cilit ndoshta do më kujtohet ka fundi i këtij elaborati. Përkundër madhësisë së fshatit në të gjitha aspektet, prapë në fshatin në fjalë po përsëritet ligjërimi monoton, anashkalimi i të varfërve, si dhe respektimi vetëm i atyre që nuk kanë asgjë të përbashkët me njerëzinë, e të mos flasim me xhaminë. Të tjerë, ata të pa interesuarit në aspektin fetar dhe social, por përgjegjësit e kësaj çështje hyjnore dhe tokësore, këtë fshat e vizitonin vetëm kur dikush i thërriste për në iftar apo në tubime partiake, si dhe pas iftarit ashtu të ngopur, dilnin në xhami për në namaz (teravia), kalimthi i thoshin disa fjalë përmendësh dhe përgjumshëm në

lidhje me rëndësinë e këtij muaji dhe rëndësinë e lëmoshës, herë pas herëve i binte ndërmend se qenkemi në muajin e Ramazanit, dhe po duheshka uruar këtë muaj të shenjtë, apo pas tubimit partiak, ata të ngopurit me gënjeshtra, dilnin nëpër bare të ndryshme që akoma të gënjejnë, ngase gënjeshtari asnjëherë nuk po u ngopka me gënjeshtra dhe premtime boshe, kështu na thoshte mësuesi kur ishim të vegjël, me drejtë pra e kishte!

Por, ajo e cila neve vizitorëve të fshatit na habiti është, indiferenca e qëllimshme e prijësit të fshatit dhe e Bashkësisë Islame, dega e Kumanovës, ndaj skamnorëve të cilët jetonin në skajshmëri të varfërisë, dhe këtë neglizhencë, anashkalim dhe nënçmim nuk po e bënin për së koti, por nga shkaku se ata të varfëritë qenkan të varfët edhe në fe. Kështu pra, kishte ngadhënjyer fjala e prijësit fetar të fshatit, kundrejt atij lokal dhe qendror!

Një ditë të këtij muaj të bekuar, gjegjësisht në mes të Ramazanit, u takova me dy kolegët dhe shokët e mi të nderuar (Milazimin dhe Hamdiun), dhe unë ashtu spontanisht i tregova se një ditë isha në një fshat ku klithmat e mjerimit social, sikur me altoparlant po dëgjoheshin, por ja që qëllimisht askush nuk po ua varte veshin, bile as prijësi apo kleri fetar i atij fshati. Për shokët dhe kolegët e mi, kjo ngjarje nuk ishte e re, ngase ata si solidar të kamotshëm në kuadër të Forumit Rinor Islam, dega Kumanovë ishin mësuar me kësi lloj raste të mjerueshme. Tmerri i kësaj ngjarje apo ngjarje tjera të ngjashme, u dramatizonin kur merrnim vesh se, edhe hoxhallarët ia paskan kthyer shpinën këtyre të shkretëve, përmes së cilëve mund të sigurohej kënaqësia e përhershme në jetën e pambarimit.

Pasi që hollësisht i njoftova me gjendjen reale, ata pa hezituar fare i morën disa paketa me gjëra ushqimore dhe higjienike, që i kishin tubuar në vazhdën e aktiviteteve solidare, që njihet si, Shporta e Ramazanit! Për një kohë relativisht një orë mbërritëm në vendin, ku me bollëk kishte fëmijë, familje me nga dymbëdhjetë anëtarësh që jetonin në një shtëpi tredhomëshe, dhe ku vështirë ishte të gjesh ndonjë njeri që ishte i punësuar në

organet shtetërore apo private, përpos disa që po merreshin me ruajtjen e bagëtive të fshatit me një pagesë simbolike. **Kishte fëmijë që ia kishin harruar shijen çokollatës, pikërisht në kohën kur fëmijët e disa prijësve loznin me çokollata dhe i hidhnin ato rrugëve!** Ata nuk vuanin vetëm nga shijimi i kësaj ëmbëlsire, por ata në trupin e tyre kishin të veshur ca lecka, që ne agjëruesit apo "besimtarët solidar", me asi lloj rrobash e veshim vetëm çardakun për ruajtjen e shalqirit. Kur e hetuan se erdhi dikush t'i vizitonte, ata të hutuar shikonin dhe nga turpi (që secili besimtarë duhet ta ketë) nuk na u ofruan menjëherë, na shikonin si të huaj, normal si të huaj se ne të paktën i kishim të veshur një palë pantallona si duhet, por gradualisht duke i treguar kolegët e mi se kush janë (unë në atë ngjarje, isha një shkak i rastit) filluan të na ofrohen. Kur e panë se me vete kishin sjell ca ndihma simbolike, ata u gëzuan tej mase dhe shpejtazi i thirrën prindërit e tyre, për t'i treguar se pas një pauze jetësore, erdhi dikush e na hapi derën për ndihma. Për një kohë shumë të shkurt, vendi ku ishim u bë zi me pleq, burra, gra dhe fëmijë. Por, edhe ne u hutuam se nuk e kishim parashikuar se do të ndodhë kështu, ngase numri i pakove të cilët i kishim marrë me veti ishin tepër të pamjaftueshme (aq kishim mundësi). **Fëmijët kur i shikonin paketat, u gëzonin tej mase, ngase mendonin se në ato paketa mund të ketë ndonjë ëmbëlsirë (çokollatë), ndërkaq nënat u gëzonin, sepse mendonin se në ato paketa mund të ketë diçka për përgatitje të ndonjë iftari në familjen e vet të paktën njëherë si duhet, si dhe burrat e pleqtë u gëzonin, sepse mendonin se në ato paketa mund të ketë diçka higjienike për mirëmbajte të trupit, të paktën në ditën e Bajramit.** Por, edhe pse asnjëri nuk e dinte se ç'ka në të vërtet kishte në ato paketa, të gjithë me parandjenja dhe dëshira të drejta ia qëlluan, ngase Forumi Rinor Islam, dega në Kumanovë, kishte menduar gjatë kohë për nevojat e skamnorëve, ndoshta nga shkaku se një pjesë e aktivistëve nuk u dallonin, edhe aq prej kësaj shtrese. Sepse, po të ishte diferenca e madhe në shtresa, atëherë këta aktivistë nuk do ia

dinin vlerën dhe rëndësinë lëmoshës. Nuk është thënë kotë se, **"njeriu me bark të ngopur, nuk mund t'ia dijë atij i cili e ka barkun shterp apo ushqimi i të cilëve është i mjaftueshëm vetëm sa për ta mbajt gjallë shpirtin"**.

Ashtu të mallëngjyer, u larguam prej atij vendi, ku shumica e atyre mbetën të kënaqur, edhe pse kolegët e mi e dinin se kjo nuk mjaftonte dot, por aq ishin mundësitë momentale, me shpresë dhe lutje që sa më shpejt edhe këta skamnorë ta shohin dritën e përkrahjes për inkuadrim në sistemet e rregullta të punës. Pasi i përcolla këta mysafirë të ndershëm, mua mu kujtua fjala e prijësit ku, kishte thënë se, lëre që ata janë të varfër në aspektin material, por ata janë të varfër në fe. Me këtë prijësi i "nderuar" ia kishte bërë me dije xhematit dhe kalimtarëve të rastit se, ju mos u mundoni të jepni pasuri dhe lëmosh, atje ku feja është e varfër, por lëmosha dhe pasuria juaj zë vend të merituar atje ku feja është e pasur, me këtë i "nderuari" aludonte në veten. Kurse realiteti i mirëfilltë e tregonte të kundërtën! Skamnorët e atij fshati nuk kishin mbetur pa ndihmuar, nga shkaku se ishin fukara në fe, por nga shkaku se përgjegjësitë e këtyre ishin fukara në zemra. Ne praktikisht i pamë se sa ishin të pasur në fe dhe në zemër, njëjtë sikur këta të poshtmit që i pamë se sa ishin të varfër në fe dhe në zemër. Fundja, edhe nëse konstatohen se ata ishin të varfër në fe, obligimi i myslimanit, detyra e prijësit fetar dhe prijësit të fshatit (i cili fshat, nuk ishte i vogël) është që tek ata, të japin dhe të jenë shëmbëlltyra dhe modeli më sublim për t'i pasuruar të varfrit në fe, ngase neglizhenca e këtyre do e thellojë, edhe më shumë varfërinë fetare në aspekt më të gjerë. Realiteti e dëshmoi të kundërtën!

Nuk do të mërzitemi edhe aq shumë, kur mendojmë se kjo jetë është e shkurt dhe të gjithë do të përgjigjemi para Krijuesit për veprat e bëra në këtë jetë. I pasuri do të përgjigjet për neglizhencën e të varfërve, si dhe prijësit do të përgjigjen për të tjerët, po ashtu të dytë do të dënohen apo do të shpërblehen në jetën tjetër të përjetshme.

Mos të keqkuptohemi, nuk jam prej atyre që pandehin ta varfërojnë të pasurin duke e ndihmuar të varfrin dhe anasjelltas, por të kërkojmë dhe të japim lëmoshë dhe treg të punës për të varfrit, aq më shumë kjo iniciativë kishte me qenë tejet efikase dhe e ndihmuar në muajin e shenjtë të Ramazanit. Sepse, realiteti i përditshëm, të gjithë neve që sofrat i kemi të shtruara dhe të mbushura me gjëra të llojllojta ushqimore, na obligon dhe detyron të mendojmë, edhe për të tjerët që ndoshta përpos qumështit të dhisë nuk kanë tjetër çfarë të hanë. **Turpi bëhet, edhe më i madh kur i shohim disa prijës fetarë të ftuar në ndonjë iftar, ku hanë duke qenë të buzëqeshur e të gëzuar, por që njëkohësisht duke i harruar tërësisht ata që, edhe erën e bukës e kishin harruar që moti**. Kjo traditë dhe veprimtari nuk ndërlidhet fare me traditën e Profetit tonë të dashur, as me të shokëve besnik të tij, ndoshta ky veprim ndërlidhet me atë, i cili është përbetuar që ta dërgoj njeriun në humbje, e i cili u bë mendjemadh në kohën kur të gjithë iu përkulën Ademit (paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi të).

Vallë në ditën e Bajramit, që ndoshta të gjithë do të jemi të gëzuar, sepse për myslimanët kjo ditë është festë, do të kemi fytyra të lumtura dhe do ta hamë drekën e begatshme të Bajramit, në të njëjtën kohë, kur të tjerët apo fëmijët e të tjerëve, janë duke qarë që babai i tyre, katër bajrame radhazi nuk i ka blerë fare rroba për Bajram. Do të ngazëllehemi apo do të ngashërehemi, kur t'i shohim këta fëmijë duke ardhur nëpër shtëpitë tona për të kërkuar sheqerka? **Vallë, lutja "Zoti ua pranoftë agjërimin dhe të gjitha adhurimet e bëra në këtë muaj", do të jetë e plotë, përball të shkretëve dhe të harruarve?** Nuk kamë më forcë të shkruaj, edhe për jetimët skamnorë të cilët përpos mungesës së babait, atyre u mungon edhe përkujdesja e organeve kompetente dhe e përgjegjësve të tjera të gjakut dhe të fesë. Ne bëmë fjalë për një fshat, fatin e të cilit e kanë edhe shumë fshatra të tjerë, por më falni, emri i fshatit nuk më kujtohet dot, sepse jam tërësisht i mbërthyer dhe i pushtuar prej emocioneve!

Nuse për shkijet e Shumadisë

Nevojat e njeriut janë të shumta dhe të ndryshme. Njëra prej shumë nevojave të rëndësishme, padyshim është edhe martesa. Njeriu përmes martesës, mëton ta gjej dhe arrij lumturinë e përkohshme të kësaj bote, duke e siguruar kështu kënaqësinë e përjetshme të botës së pastajme. Shijimi i çerdhes së ngrohtë familjare dhe respekti i ndërsjellë, nuk mund të arrihet ndryshe, përpos se me anë të martesës. Kënaqësitë e papërshkruara që arrihen pas martesës janë pasardhësit e pastër (fëmijët), të cilët i japin shije dhe arsye këtij planeti. Por, si duket, prindërit dhe vajzat shqiptare të Shqipërisë Londineze, ngrohtësinë e këtij akti të begatshëm, mëtojnë ta arrijnë duke u martuar me serbë të Serbisë, që deri dje e sot, mjet komunikimi ndërmjet nesh kanë pasur dhe kanë vetëm tytën e pushkës. Pothuajse u shtangëm tërësisht, kur dëgjuam se në vazhdimësi, si dhe tash së fundi serbët kërkuan 8000 nuse shqiptare. Për të qenë tmerri edhe më i madh, një kërkesë e tillë barbare po miratohet prej prindërve pakurrizorë shqiptarë**. Serbët që nuk po mundkan të gjejnë vajza të etnisë dhe fesë së vet, ia mësynë Shqipërisë (mëmëdheut e atdheut tonë të dashur), njëkohësisht duke qenë tejet të vetëdijshëm për marrëdhëniet jetësore të brishta me ta.** Këta iu drejtuan vajzave shqiptare, sepse vajzat serbe tashmë paskan filluar ta marrin botën në sy, duke kërkuar djem më të pashëm dhe më të pasur se tepricat e "dhëndurëve tanë". Për ta nuk ishte kjo ndonjë risi, kur e dimë se, që moti atyre u ka perënduar morali. Por, t'i ngjajë një gjë e tillë mëmëdheut tonë nuk e besuam assesi, që të parët tanë me xhelozinë më të madhe të

mundshme e kishin ruajtur dhe kultivuar nderin dhe moralin, fare pa njolla.

Prindërit shqiptarë pakurrizorë me këtë akt barbar, kriminal dhe anormal do arrijnë t'ia hijeshojnë shëmtinë serbëve përmes vajzave të tyre shqiptare të bukura. Si do jetë, pastaj halli i pasardhëseve të cilët si të tillë lindin të pastër? Fatkeqësisht, ata nuk do të jenë as mish as peshk, padyshim që as shqiptar të kompletuar. A nuk na vjen fare inat, që pas pesë vitesh me "nipërit tanë", kuptohet me prejardhje shqiptare të komunikojmë në gjuhën serbe? **A nuk turpërohen fare, prindërit dhe vajzat shqiptarë që në vend të fjalisë, "Shpëtim, të dua" të thonë, "Spase, volim te".** Sigurisht që nuk i vjen turp, ngase siç po shihet turpi moti i paska humbur! Përpos rakisë në tavolinë dhe në disa raste të kryqit, këta shqiptarë tashmë të miqësuar me serbët ortodoks, nuk ndërlidhen me asnjë send tjetër. Me të drejtë Faik Konica kishte thënë se, "feja islame e kishte ruajtur kombin shqiptar prej shpërbërjes". Vlerën e këtij citati, fatkeqësisht po e shohim në praktikë! Paramendoni sikur vajzat shqiptare të ishin martuar me turq mysliman!? I gjithë opinioni jonë do të ishte ngritur në këmbë, se u bë kiameti, kurse tash ky akt i tillë, nuk gjykohet e dënohet, por përshëndetet e propagandohet nga disa media kryesisht të Shqipërisë. **Më vjen në dyshim kjo punë, ç'po kërkojnë këto vajza kur burrat shqiptarë akoma nuk i ka tradhtuar potenca burrërore?** Nga paramendimi në fjalë që nuk po më hiqet dot nga mendja, më dolën përpara debatet e stërmbushura në të gjitha kanalet televizive shqiptare me mysafir llomotitës të tipit Maks Velo, që fatkeqësisht ka shumë. **Më, more Maks Velo, dhe ju të cilët thirreni kinse në shqiptari, ku e keni mendjen, gjuhën dhe trupin në këtë rast tmerrues? Mos ndoshta, për herë të parë në jetën e juaj doni ta manifestoni një tolerancë njerëzore!?** Apo prej këtij rasti skandaloz, doni realisht të bëheni demokrat dhe ta sendërtoni një strategji afatgjate, ku nga nipërit "as mish as peshk", të prisni që ndonjëri prej tyre të bëhet kryeministër apo kryetar i Serbisë, e tek pastaj të

bëhet i mundur ndërtimi i marrëdhënieve të mira diplomatike me Kosovën dhe me gjithë shqiptarinë. Ju nëna që do ngelni vetëm me prejardhje shqiptare, ju vajza të bukura shqiptare që prisni të fejoheni me serb, ua rikujtoj se, simbioza shqiptaro-serbe pjell vetëm armiqësi dhe shkatërrim të ardhmërisë. Mos i merrni në qaf fëmijët të cilët nuk kanë asnjë faj që do bëhen më shumë serb, e me identitet të pështjelluar, mos veproni ashtu siç dëshirojnë të bëjnë prindërit e juaj me ju, ngase ata i ka mbuluar perdja e injorancës dhe përveç parave dhe ndjenjave të liga nuk njohin gjë tjetër, mos na e përdhunoni me bisha mëmëdheun tonë, mos e lejoni që të bëheni ara mbjellëse të sllavit i cili përpos urrejtjes dhe shovinizmit nuk di asgjë tjetër të mbjell. Ndoshta ju arsyetoheni se Qeveria shqiptare, gradualisht po u jep të drejta dhe përparësi homoseksualizmit, e pastaj frikoheni se do të mbeteni me gishta në gojë, pra me meshkuj pa potencë. Ju kujtojmë se ligji në fjalë është vetëm sa për t'ia bërë qejfin disa homoseksualëve evropian, ndërkaq realiteti është krejt ndryshe. Shqiptarët në aspektin e trajtimit dhe plotësimit të dëshirave ndaj bashkëshortëve në nivel ndërkombëtar kanë qenë dhe janë në rangje të larta.

Kujtoni përdhunimet dhe masakrimet e serbëve ndaj vajzave shqiptare të Kosovës. **Kini pak mëshirë ndaj motrave të gjakut tuaj. Kujdes! Bashkëshorti i juaj mund të jetë një ish-përdhunues i motrave tuaja! Pra, kujdes dhe zgjohu, edhe ti qeveritar, edhe ti intelektual, edhe ti ish-ushtar i luftërave çlirimtare, edhe ti hoxhë si dhe, edhe ti prift shqiptar.**

Familja e shëndoshë – garanci e së ardhmes

(Me rastin e shënimit të Vitit të Ri, Hixhri 1431 dhe konkursit për prozë, i organizuar prej Forumit Rinor Islam - Shkup)
-Ky punim u radhit në mesin e të përzgjedhurve dhe me rastin e manifestimit të Vitit të Ri, Hixhri u dekorua dhe u shpërblye publikisht-

Është fakt i pamohuar se, familja e shëndoshë është gjeneratori kryesor i një shoqëri të shëndoshë, i një të ardhme të sigurt, si dhe njëri prej faktorëve kryesor të ecurisë normale të shtetit. Familja është baza dhe bërthama e shoqërisë. Ndërkaq, shoqëria është themeli i sendërtimit të ndërtesës shumëngjyrëshe, brenda së cilës, shumëkush do të sorollatet poshtë e lart për një arsye të vetme, e arsyeja tejet objektive gjithmonë dhe gjithherë është, reflektimi i harmonisë familjare në shoqëri. Në pamundësi të harmonisë së përhershme familjare dhe reflektimin e dëshiruar në shoqëri, krijesa e quajtur njeri është i obliguar ta pranojë si pjesë të natyrshmërisë dhe përditshmërisë së tij, fenomenin e ngashërimit dhe ngazëllimit. Fundja, këto dy fenomene e bëjnë, edhe më atraktive jetën, ngase po të ishim gjithmonë vetëm të gëzuar nuk do t'ia dinim vlerën gëzimit. Sidoqoftë, njeriu më shumë është i prirë drejt ngazëllimit! Investimi i tij në gjëra që arsyeshëm të bëjnë të lumtur, me automatizëm, do të shoqërohet me garanci dhe siguri për ardhmëri më të dinjitetshme. Por, për ta përjetuar dhe shijuar një kënaqësi të tillë, do të duhej që paraprakisht, paraardhësit tanë ta kenë lëruar arën thellë, dhe të kenë hedhur farë të shëndoshë, që do ta arsyetonte shpresën e pritjes për korrje të begatshme. Kjo aludon në atë se, për të ekzistuar familja së pari si nocion, e pastaj si realitet, duhet që patjetër t'i

jepet rëndësia e duhur martesës. Sepse, martesa është garancia e saktë e vazhdimit të lozës së mëtutjeshme njerëzore. Fenomeni i martesës, pa më të voglin dyshim është esenca e familjes dhe shoqërisë, por nuk përjashtohet mundësia se, martesa mund të shërbejë, edhe për shkatërrimin e familjes, duke qenë njëkohësisht në numër të gjithë pjesëtarët që e përbejnë familjen. Në lidhje me formimin dhe mirëmbajtjen e familjes së shëndoshë, si përgjigje dhe sqarim më të qartë në tërë rruzullin tokësor, ishte dhe është porosia e Muhamedit a.s ku thotë se, njeriu edukohet njëzet vjet përpara lindjes së tij.

Me këtë, profeti ynë i dashur qartë dhe haptazi na thotë se, në dorë të prindërve është çelësi i lumturisë dhe i edukimit familjar. Fëmija në familje është hije e prindërve të tyre, ndërkaq jashtë familjes, është përfaqësues dhe demonstrues i veprave të familjes. Për këtë arsye, nuk është habi se pse, mësuesit i njohin shumë mirë familjet në vendin ku e ushtrojnë detyrën. Pra, fëmija është urë lidhëse e njoftimit të familjes me shoqërinë!

Fëmijët e shëndosh dhe të edukuar, me automatizëm tregojnë për prindërit e tyre të shëndoshë, si dhe prindërit e shëndoshë përbëjnë një shoqëri të shëndoshë, kësisoj shoqëria e shëndoshë është garanci e ardhmërisë së frytshme. Dikujt kjo radhitje e shkëlqyeshme, i duket utopi fantastike, ngase në të shumtën e rasteve, skeptikët në fjalë i shikojnë gjërat vetëm prej këndit të vet familjar. Por, kjo nuk është iluzion për ata që realisht e kuptojnë rëndësinë e kësaj tematike! Utopistët janë të tillë, ngase për model të edukimit në aspekt të përgjithshëm e kanë marrë, modelin e huaj, ku edhe ata kohëve të fundit janë duke ikur dhe u gërditur prej një organizimi të tillë, që seriozisht i rrezikohet ardhmëria e shëndosh. Edhe zhvillimi i hovshëm i teknologjisë nuk do të jetë në gjendja ta shpëtojë një pjesë të Evropës dhe disa pjesë të kontinenteve tjera të zhvilluara, prej shkatërrimit të familjes, me këtë edhe të shoqërisë në tërësi. Kësisoj, në këto kontinente të zhvilluara nuk do të kemi më, njerëz, familje dhe shoqëri me plot kuptimin e fjalës, sikurse nuk do të kemi robot,

familje robotësh dhe shoqëri të robotëve me plot kuptimin e fjalës. **Sa për ardhmërinë e këtyre shoqërive në shkatërrim, ku qeni e ka zëvendësuar bashkëshortin dhe anasjelltas, ku shpenzimet mujore të një maceje janë më të mëdha se të një kryefamiljari në Ballkan, në mënyrë metaforike, këto degradime njerëzore dhe familjare mund t'i kuptoni dhe shihni në cilësinë e një paralajmërimi për momentin i pabesueshëm, te filmi i "Terminator Katërshi-t", ku aludohet një e ardhme jo fort e largët, e robotizimit të njeriut dhe e njerizimit të robotit, duke i hyrë kështu në "hak" edhe robotëve.**

Kurse, disa shqiptar mysliman me një traditë të shkëlqyer në organizmin e familjes, kohëve të fundit i shohim në cilësinë e shportave, të cilët me kënaqësi i pranojnë traditat dhe modelet e huaja që kanë të bëjnë kinse me edukimin e fëmijëve dhe me udhëheqjen e familjes. Këta njerëz të tjetërsuar, qëllimisht harruan se, ai i cili di ta edukojë fëmijën di ta udhëheq familjen, ai i cili di ta udhëheq familjen di ta udhëheq komunën, ndërsa ai i cili di ta udhëheq komunën di ta udhëheq në mënyrë të shkëlqyer shtetin, me të gjitha pjesët përbërëse të tij. Tashti mos të habitemi dhe mos të pyesim se, pse anarkia ka filluar të troket edhe në vendet tona, kur dihet kronologjia së kaluarës së begatshme në këto treva. **Dikur në familjet tona, shkëlqyeshëm funksiononte hierarkia familjare, ku i zoti i shtëpisë në konsultim me gruan dhe anëtarët e tjerë të familjes e kishte fjalën përfundimtare, gruaja dhe vajzat ishin të nderuara me respekt të ndërsjellë, kuvendimet dhe këshillat që bëheshin nëpër oda të ndejës adoleshentët me kureshtjen më të madhe i dëgjonin, mysafirit i jepej respekti dhe nderi i veçantë, e shumë virtyte tjera familjare, që ndjej nostalgji të madhe për ato vlera që e mbanin gjallë atdheun e zemrave.** Si rrjedhojë e këtyre rrjedhave, përpara nesh qëndronte një ardhmëri e shëndoshë, që patëm rastin ta shijojmë, si dhe të tjerët me një krizë moralo-familjare në vazhdimësi na shikonin me syrin e xhelozisë. Ne populli shqiptar e mysliman, përkundër shumë padrejtësive tjera historike, të paktën në aspekt

të organizimit familjarë ishim shëmbëlltyrë! Fatkeqësisht, në Ballkan dhe në disa pjesë tjera të botës ku jetojnë myslimanët (pavarësisht përkatësisë së tyre kombëtare), ëmbëlsia dhe ngrohtësia e dikurshme familjare ka filluar paksa të zbehet, edhe atë si rrjedhojë e pasimit të atyre që nuk kanë familje, nuk e dinë se ç'është familja, dhe në shoqëri paraqiten si tipa asocial, ku botën e shohin vetëm prej këndit dhe syrit material. Këto çarje në familje, filluan prej atëherë kur, gruaja dhe burri si prijës në familje, i ndërruan vendet e natyrshme të tyre. Sot, nëpër shumë vende të botës, roli i burrit në familje është zbehur dukshëm, ku burri po e këndon këngën e vet, por me zë dhe tekst të gruas, sikurse gjeli i cili këndon, por me zë dhe melodi të pulës dhe, anasjelltas. Pasime të tilla, përpos greminës nuk do na dërgonin askund tjetër!

Këtë sëmundje patologjike jemi duke e parë të gjithë, por si duket dikujt po i konvenon të luhen lojëra të kësaj natyre. Simptomat e kësaj sëmundjeje vërehen dhe shihen prej larg. Disa prej shumë simptomave janë: injorimi i prindërve nga ana e fëmijëve, kureshtja dhe ballafaqimi në mënyrë permanente me botën virtuale, xhelozia e pabazë ndërmjet prindërve që pastaj artikulohet si bombë atomike te fëmijët, mënyrat dhe metodat e mbrapshta të martesave, mosmarrja parasysh e rrezikut të shkatërrimit të familjeve, tentimi i barazimit gjinor në mënyrë absolute pa e marrë për bazë natyrshmërinë e krijuar, tradicionalizmi i religjionit, kushtet socio-ekonomike, etj., por, simptomat e lartcekura nuk janë, edhe pa ilaç. **Ndër barnat kryesor kurues, është kthimi i jonë në praktikimin e fesë së shëndoshë islame dhe mbështetja jonë më e madhe në vlerat tona kulturore, për dallim nga ato që na vijnë prej jashtë, ngase të paktën në aspektin kulturor jemi mjaft të pastër dhe të pasur.** Jam shpresues në këtë drejtim, të paktën në dhjetëvjeçarin e fundin, pas një pauze disa vjeçare, e shoh një dritë në fund të tunelit, ku disa udhëtarë vendorë dhe të largët me sinqeritetin më të madh të mundshëm, çdo ditë e më tepër po i afrohen dritës ndriçuese.

Me ç'rast, duke mos e përjashtuar, edhe mundësinë e flijimit fizik dhe mendor për familje të shëndoshë, si dhe në kuadër të këtij mozaiku të begatshëm, mëtojnë që, shkëlqesinë e dikurshme të familjes ta kthejnë, që dikur tmerrësisht atij që ishte i paskrupullt ia morën.

Pra, familja e shëndoshë, pa më të voglin dyshim është garanci e së ardhmes, ndërkaq, garancia e së ardhmes në vazhdimësi do t'i jetë mirënjohës familjes së shëndoshë!

Mishmashet e dhembshme me UÇK-në

Në fillet e para të shfaqjes së ushtrive çlirimtare shumë politikanë, poetë e shkencëtarë shqiptarë, artikuluan një urrejtje poshtëruese dhe tejet manipuluese te opinioni i gjerë në lidhje me ushtarët dhe idealin e UÇK-së. Këtë e thoshin ata që u frikësoheshin se së shpejti do u rrezikohej rehatia në kolltukët e ngrohta. Sepse, në atë kohë (kuptohet edhe në këtë kohë) kolltuku në vete po ngërthente zhvillimin e tregtisë tejet frytdhënëse, shfrytëzimin e autoritetit publik dhe shëtitjen rreth botës duke qëndruar njëkohësisht në kolltuk. Pra, të gjitha punët me rëndësi jetikë individuale dhe shtetërore, paskan mundësi të kryhet duke të qëndruar kolltuku mbrapa. Hëm, pak i rrezikshëm ky fenomen!

Kështu që me ndihmën e këtij materiali të vdekshëm, u harruan dhe u nënçmuan dukshëm, ata të cilët përnjëmend kishin vendosur të vdesin, për lirinë dhe gjallërinë e këtij populli të shumëvuajtur. Por, nuk kaloi shumë kohë, kur disa që para dy javëve këtë ushtri e kishin quajtur ushtri terroriste, kriminele dhe të paguar prej jashtë, të njëjtit patëm rastin t'i dëgjojmë duke folur fjalë shumë mira dhe tejet të arsyeshme për këtë ushtri të lavdishme. Falja dhe pranimi i faljes është në natyrshmërinë njerëzore, dhe si e tillë me kënaqësi e gjitha popullata e pranoi! **Por, tmerri i vërtetë i këtyre ushtarëve filloi menjëherë pas betejave të fituara.** Konkretisht e kemi fjalën për Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare. Është tërësisht i pakapshëm fakti, që pas luftës së fituar të fillojë tmerri dhe terri i vërtetë për këta ushtarë. Në vend që pas luftës ushtarët në fjalë ta gëzonin lirinë dhe t'i vjelin frutat e fituara me gjak, këtyre u ndodhi e kundërta. Ata fillimisht nuk u mërziteshin, kur i shihnin komandantët e tyre

duke u inkuadruar nëpër vende të larta institucionale. Nuk mërziteshin nga shkaku se mendonin dhe besonin shumë në besnikërinë dhe burrërinë e komandantëve të tyre. Kjo shpresë zgjati deri atëherë kur, të besuarit e tyre i venduan dhe lëshuan rrënjë thellë në shtetin e tyre, tashmë të dashur. Pas shumë mishmasheve me ushtarët e UÇK-së, si duket i erdhi radha edhe mishmashit të fundit. Kësaj radhe ky mishmash apo lojë e fëlliqur, po bëhet direkt prej pushtetit të Gruevskit. Ai pohon se, me ligjet ekzistuese do e zgjidh statusin social dhe ekonomik të ish-ushtarëve. Me ligjet ekzistuese apo të tanishme, gjendja e ish-ushtarëve shqiptarë në aspektin ekonomiko-social do të jetë si e deritanishmja. Fare mirë e dimë gjendjen e deritanishme të ish-ushtarëve të UÇK-së, të invalidëve dhe të dëshmorëve. Një pjesë bukur e madhe sot bredhin rrugëve të vendit tonë dhe vendit të huaj, një pjesë tjetër është nëpër burgje, si dhe një pjesë tjetër që deri diku kishte qenë të themi me fat, është inkuadruar nëpër institucionet shtetërore, por në vazhdimësi duke mos qenë fare të kënaqur me ecurinë dhe produktin për të cilin dikur kishin luftuar. Nuk e mohoj dot, kontributin dhe përkrahjen sociale të organizatave të veteranëve të luftës. Por, më tingëllon tejet rëndë kur them në shumës, pra "të organizatave".

Ç'na duhet dy apo më tepër OVL-ja? Sidoqoftë, kjo është një metodë shumë e njohur dhe e vjetër e armikut, e cila me sukses po jetësohet! Nuk e thash rastësisht pak më lart se, kjo është loja përfundimtare që është duke i ndodhur ish-UÇK-së, nëse në ndërkohë (deri në fund të këtij viti) nuk ndodh diçka pozitive, apo të themi më mirë diçka që i përket mrekullisë. Sepse, ta diskriminosh hapur një ish-ushtri, e cila ndershmërisht, edhe atë me një marrëveshje të pranuar ndërkombëtarisht u çarmatos, është më shumë se lojë me vullkan! Të sjellësh ligje të veçanta për ish-"branitellat", e në të njëjtën kohë të pretendosh se statusi i ish-ushtrisë tjetër do të rregullohet me ligje ekzistuese, kjo është një poshtërsi dhe një tendencë dashakeqe e llojit të veçantë. Unë nuk jam që ish-"branitellat" dhe ish-UÇK-ja të barazohet, sepse

natyrshmëria e veprimtarisë së tyre dallon dukshëm. Të ashtuquajturit "branitella" në luftën e 2001-shit, vranë civil të pafajshëm shqiptarë, shpeshherë e prishën armëpushimin, paguheshin goxha mirë prej shtetit të tyre të dashur si dhe prej buxhetit të përbashkët, luftonin (kuptohet me urdhër prej lartë e me dëshirë prej poshtë) me armë dhe njerëz të Serbisë, Bullgarisë, Ukrainës, etj., kundër kryengritësve që ishin vetëm shqiptarë dhe asgjë tjetër. Pra, ish-ushtarët e UÇK-së nuk mund të trajtohen njëjtë me të ashtuquajturit branitella! Por, të paktën juridikisht, edhe atë në aspektin e të drejtave për privilegje ekonomike, do të duhej të trajtoheshin të barabartë.

Kryetari i këtij shteti, para se të flasë për kohën dhe momentin e ndërtimit të marrëdhënieve të mira ndër-fqinjësore me Greqinë, do të duhej të mendojë për raportet ndëretnike në shtetin të cilin e udhëheq. Si dhe këtë fillim dhe argument të fqinjësisë së mirë, e shtjelloi duke ligjëruar në temën e rëndësisë së rënies së murit të Berlinit. Ai me këtë, dëshiroi të thotë se ka ardhur koha që, edhe ndërmjet shteteve urgjentisht duhet të rrënohen muret e urrejtjes. Por, presidenti në fjalë qëllimisht e harroi murin e vet të ndërtuar, ndërmjet maqedonasve dhe shqiptarëve. Me vetëkrijim dhe pastaj me vetëshuarje të problemit, nuk do hiqen dhe shuhen dot problemet. Për neve shqiptarëve që jetojmë në këtë shtet, mohimi prej kohësh i të drejtave elementare, është dhe lexohet si vendosje e tullave në murin e quajtur "LAMTUMIRË".

Pra, jetëgjatësia e këtij shteti dhe burrëria e jonë, përfundimisht do të shihen në fund të këtij viti!

Mjaft u flijuam për të tjerët

Kontributi dhe flijimi i shqiptarëve në aspekt të përgjithshëm për të tjerët, që moti ishte i pranishëm në të katër anët e botës. Personalitetet shqiptare, të tjerëve u ndihmonin në momentin dhe kohën kur vendi i tyre më së shumti kishte nevojë për ndihmën e tyre. Kështu pastaj, neve na mbeti të krenohemi me legjendat shqiptare, që për nga historia ishin shqiptarë, por në realitet (në jetën reale praktike) ata ishin të huaj. **Kështu që, shqiptarëve u mbeti të krenohen me Mustafa Kemal Ataturkun që njihet si themeluesi i Turqisë moderne, i cili për nga origjina ishte shqiptar, por në jetën reale nuk ishte i tillë, me Gonxhe Bojaxhiun që njihet si humaniste botërore, e cila me origjinë ishte shqiptare, por nuk jetoi dhe veproi si e tillë, me Mehmet (Muhamed) Ali Pashën që njihet si themeluesi i Egjiptit modern, i cili për nga origjina ishte shqiptar, por në jetën reale nuk ishte i tillë, me Xhim Belushin që njihet si aktor me famë botërore, i cili për nga origjina është shqiptar, por në jetën reale nuk është i tillë, dhe me shumë personalitete dhe kolosë të tjerë me famë botërore që për nga historia ishin shqiptar, por që famën dhe autoritetin nuk e fituan si shqiptar.** Me këtë nuk dua të shpreh keqardhje që populli shqiptar nxori nga gjiri i vet, këso personalitetesh tejet të famshëm. Fundja, si rrjedhojë e këtyre kolosëve, sot përballë botës jemi më ballëhapur dhe më të arsyeshëm, kur janë në pyetje ndihmat reciproke! Por, fatkeqësia reale qëndron në atë se, ne duke u bërë të ndershëm ndaj gjithkujt, gradualisht kemi filluar të bëhemi të pandershëm ndaj vetës sonë.

Ne lëre që ndaj botës, ishin shumë flijues dhe të ndershëm, por ne aktualisht po mëtojmë të flijohemi dhe të bëhemi të ndershëm, edhe përballë popullit dhe Qeverisë maqedonase. Në vend që t'i sqarojmë qëndrimet tona ndaj qëndrimeve të tyre, ne po e bëjmë të kundërtën, pra po i biem në dert serioz këtij populli i cili kontestohet prej shumicës. Paralelisht me shqetësimet tona, dhe ndarjes së dhimbjes së përbashkët me maqedonasit, Qeveria aktuale po manifeston në vazhdimësi urrejtje dhe përbuzje ndaj neve, që detyrimisht kemi vendosur ta ndajmë dhimbjen e tyre së bashku. Ne po e ndajmë dhimbjen së bashku, duke qenë tërësisht të shëndosh në çdo aspekt, kurse pala tjetër po luan me neve, duke qenë të informuar fort mirë se pa shqiptarët që moti do kishin perënduar. Edhe çfarë argumenti dhe dëshmie duhet të artikulojë kjo Qeveri, që të na bind se, nuk na përfillë fare si faktor relevant në këtë shtet?! A nuk na mjafton fakti i prolongimi të realizimit të Marrëveshjes së Ohrit, edukimi militarist i qytetarëve shqiptarë, moszgjidhja e statusit të UÇK-së, harresa e qëllimshme e rajoneve shqiptare për ndërtim të infrastrukturës rrugore, përgënjeshtrimi i shumë marrëveshjeve shqiptaro-maqedonase nga ana e tyre, Enciklopedia maqedonase, ndarja e banesave sociale për të gjithë etnitetet përpos atij shqiptar, mospërfillja e faktorit politik shqiptar rreth zgjidhjes së emrit, alergjia fotografuese e kryeministrit me Skënder Hysenin, si dhe së fundi (ky fund nuk është i fundit) reklamimi nëpër shumë media vendore dhe ndërkombëtare i të arriturave të Qeverisë aktuale prej një këndi të vetëm, pra vetëm prej VMRO-DPMNE-së, duke e anashkaluar tërësisht prej agjendës zhvillimore partinë shqiptare në pushtet.

Ndërkaq, kur Greqia i paralajmëroi se, edhe me 7 dhjetor do të vendose veto, nëse eventualisht gjatë kësaj distance kohore nuk do e ndërrojnë emrin dhe identitetin kombëtar maqedonasit, kurse ne tashmë të ashtuquajturit shqiptarët e ndershëm, prapë nuk hezitojmë të ndajmë mëshirë me ta! Nëse me të vërtet Greqia vendos veto, ashtu siç kishte vepruar në samitin e Bukureshtit, atëherë ne shqiptarët që jetojmë po në këtë shtet, nuk duhet të

flijohemi dhe nuk kemi të drejtë morale ta bëjmë një gjë të tillë për maqedonasit, të cilët seriozisht kanë probleme me identitetin, jo vetëm me Greqinë, por edhe me disa shtete tjera. Dëgjojmë zëra prej etnitetit maqedonas dhe prej qeverisë aktuale se, do ta mbajmë shpirtin gjallë vetëm me bukë e krip, e nuk do ta ndërrojmë dot identitetin kombëtarë, ndërkaq Greqia në këtë aspekt është tejet e prerë, fundja asaj asgjë nuk i kushton nëse Maqedonia vazhdon të mbesë jashtë çdo mekanizmi ndërkombëtar. Nëse pra, maqedonasit janë në gjendje dhe të gatshëm të hanë bukë e krip e të izoluar, por me dogmën e identitetit të tyre antik, atëherë ne shqiptarët pa doreza do duhej t'i themi: "ju bëftë mirë buka me krip, por ne shqiptarët që jetojmë në këtë shtet, duhet që sa më shpejt t'i bashkangjitemi mëmëdheut tonë dhe fatit tonë gjallërues, ngase jemi ngopur qe 18 vite duke ngrënë bukë e krip e zemër, në të njëjtën kohë kur ju loznit me ushqime vitaminoze të llojllojta".

Përkitazi me këto mjegullina dhe me një të ardhme tejet të pasiguritë për këtë shtet, duhet që urgjentisht etniteti shqiptar ta plasoj në debat prapë tezën e Rafiz Halitit, ku thotë se shqiptarët me, apo pa maqedonasit duhet t'i bashkëngjiten karvanit evropian, apo si opsion tjetër ndërlidhës me të parin, do të ishte mirë të shfletohet dhe të hidhet në debat platforma e përpiluar nga Koço Dana dhe nga disa ideologë besnik të çështjes shqiptare, e cila në vete ngërthen, zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare, kuptohet edhe zgjidhjen e shumë çështjeve që e pengojnë zhvillimin tekniko-teknologjik dhe moral të shqiptarit.

Pra, mjaft u flijuam për të tjetër, të fillojmë të mendojmë pak për veten tonë, sepse kështu siç jemi duke flijuar dhe kontribuar në vazhdimësi për të tjerët, do na mallkojë vetja jonë!

Përse, oj nëna ime Shqipëri, ke kaq shumë frikë, prej Islamit në Shqipërinë Lindore!?

Shpeshherë, më rastis t'i përcjellë disa debate që zhvillohen në televizionet e Shqipërisë. Pjesa më e rëndësishme e joshjes në këto debate, përbëhet prej gjuhës së çiltër shqipe, por e mbushur përplot me neologjizma. Nuk ishte, edhe aq dëm dhe injorancë e madhe përdorimi i neologjizmave të shumta dhe mungesa e kulturës në debate, sa ishte artikulimi i tezave sllavo-ortodokse prej disa analistëve shqiptarë, në lidhje me fatkeqësinë e shqiptarëve të Shqipërisë Lindore (Maqedoni) rreth përhapjes dhe jetësimit të fesë islame.

Fillimisht unë i pyes, përse nuk i përmendni fare dhe nuk ju shqetëson dot, vendosja e kryqeve, ndërtimi i shumë kishave, qëndrimi i popit në prapavijë të politikës shoviniste dhe anti-shqiptare dhe inaugurimi i secilit objekt në prezencë të popëve???

Pra, si rrjedhojë e kësaj mendësie jonjerëzore dhe ortodokse, në cilësinë e solidarizimit me shqiptarët e Shqipërisë Lindore, po i dërgoj një letër nënës time të dashur, Shqipëri.

Nëna ime, edhe pse që moti je bërë gjyshe e plakë, ende mbështetem dhe shpresoj në vullnetin dhe vigjilencën tuaj, ndaj pranimit dhe materializimit të kërkesave tona.

Në fëmijërinë tonë të hershme, kur na u kumtua lajmi se, në këtë shtet jetojmë pa përkujdesjen e nënës tonë biologjike, u mallëngjyem aq shumë, sa që me të madhe filluam ta urrejmë njerkën, e cila bëhej sikur po kujdesej për neve. Me kalimin e kohës, disi u pajtuam dhe në vazhdimësi tentuam të adaptohemi me të keqen dhe të vështirën që na vinte si rezultat i njerkës tonë

tinëzare, e pastaj barbare, ndaj fëmijëve të nënës Shqipëri. Ashtu të drobitur deri në skajshmëri nga torturat e pandërprera, gradualisht filluam të mos e hetojmë heshtjen e nënës tonë biologjike. Pas shume përpjekjesh dhe si fëmijë të rritur pa nënë, po ashtu në të shumtën e rasteve, edhe pa ndihmën e saj nga jashtë, me shumë peripeci dhe mundime nga më të ndryshmet, arritëm të njoftohemi me nënën tonë të dashur Shqipëri. Por, nga ky njoftim i përafërt, dolëm edhe të shastisur dhe tejet të hutuar prej vëllezërve tanë të gjakut. Një pjesë dërmuese e tyre kishin dal farësh, po e vrisnim pa të drejtë njëri- tjetrin, po e fyenin, shanin dhe përgojonin njëri-tjetrin deri në skajshmëri, kishte filluar me të madhe të praktikohet jeta individuale, ishte harruar koncepti i ngrohtësisë familjare, alkooli ishte bërë pjesë e pandashme e përditshmërisë së tyre, neve këndej gardhit po na shikonin si primitiv, që ende po merreshim me fenë Islame dhe shumë dallueshmëri tjera, që realisht të bën të dyshosh rreth autenticitetit vëllazëror. **Ne përskaj shumë problemeve tjera me etnitetin tjetër, vëllezërit e gjakut nuk po hezitojnë dot, të na hapin edhe fronte tjera, me të cilat dëshirojnë që të na rraskapitin dhe gjobitin edhe më shumë.** Ata në vend që ta plasojnë ndonjë model për dalje nga kthetrat e këtyre krizave, që po mbretërojnë në vazhdimësi në Shqipërinë Lindore, ata ndjellin kob dhe hedhin baltë për fenë tonë të pastër islame, kështu që e hapin një problem joekzistent, ku i shkojnë pas sajesave të armiqve sllavo- ortodoks për luftë të pa kompromis kundër shqiptarëve.

Nëna ime e dashur, dëshironi ose nuk dëshironi ju, apo dikush tjetër të na pranojë kështu siç jemi, neve na vjen keq, por ne shqiptarët e kësaj ane, me shumicë i përkasim besimit Islam, e besoj që edhe tek ju është kështu. Ju mund të më thoni se kjo fe, është e Lindjes, e arabit, e afganit apo e turkut, por më fal nëna ime e dashur, një duhet ta kesh të qartë se, kjo fe është me prejardhje të pastër qiellore, dhe si rrjedhojë e kësaj, unë në fenë islame kam aq të drejtë, sa ka të drejtë edhe arabi, turku apo francezi. Ndërkaq, i vetmi element që na bën të dallohemi është

devotshmëria. Kurse, disa bij dhe bija, fare pa turp dhe fare pa argumente po vjellin vrer ndaj neve, nga shkaku se, tradicionalen kombëtare, si rezultat i fesë islame, më mire dhe më shëndosh e paskemi ruajtur. Ata këtë pjesë të fjalisë së fundit nuk e thonë dot, por neve na mjafton si dëshmi realiteti praktik!

Pothuajse në çdo debat që mbahet nëpër televizionet e juaja, paraqiten asi lloj analistësh që temë trajtimi me një kënaqësi të veçante, e kanë "dertin" tonë rreth gjallërimit të fesë Islame në shpirtrat dhe zemrat tona. Sikur të jetë pikërisht kështu, pastaj nëse ua ka ëndja dhe keni llogari, pëlcitni. Jo, jo prapë më dhimbseni, lus të Plotfuqishmin për mëshirë, sepse mund dhe ndodh që mos të dini!!!

Besa, kemi asi lloj bijash, që nga "brengosja" e madhe për këtë fatkeqësi jetësore dhe morale që na ka kapluar neve, nuk ngurojnë dot, që edhe të brendshmet të na tregojnë, kuptohet si rrjedhojë e minifundit të Tarzanit. Po ashtu, disa djem dhe nipa tuaj, gjoja nën emrin e kombit shqiptar, po na qortojnë haptazi për neglizhencën tonë ndaj atdheut shqiptar.

Nëna ime dashur, ato ose ata, harruan shumë shpejtë se, komb shqiptar dhe luftërat për kombin tonë ndodhën dhe u zhvilluan, pikërisht në vendin ku bijtë dhe bijat e juaja, po akuzohet për indiferencë të kombit shqiptar. Nëse këta djem e nipa, që tashmë janë bërë analista kanë harruar, atëherë nëna ime e dashur, përkujtoja atyre që mendojnë greqisht, vishen janullatosisht e jetojnë duke folur italisht se, bijat e tua këndej gardhit, kur i përcollën djemtë e tyre për në luftë, i thanë **"hallall ju qoftë qumështi i nënës, dhashë Zoti të takohemi në Parajsë"**. Mirë, unë i pyes këta patriotë, të cilët nuk i pengon dot vajtja dhe ardhja e Janullatosit dhe eksploatimi i Jugut të Shqipërisë prej grekëve, ma shpjegoni dhe na tregoni prejardhjen e fjalëve "hallall" dhe "xhenet". Kujdes! Këto dy nocione në vendin tonë, me të madhe u përdorën në kohën kur atdheu thërriste për shpëtim. Edhe atë, pikërisht në kohën kur, ata i rezervonin hotelet luksoze për pushime në Greqi apo Itali. Nëna ime e dashur, edhe pse na lave

në dëshpërimin e fëmijërisë së hershme, ju lutem mos na dëshpëroni në rininë tonë vitale, mos lejo që bijtë dhe bijat tuaja të brengosen për segmente, që ata në mungesë të kësaj, duhet aq shumë të brengosen, sa që, të mos gjejnë kohë as për gjëra të domosdoshme në këtë jetë. Kujtoja këtyre të gjorëve se, pikërisht ishte Islami, ai që i mbrojti shqiptarët prej asimilimit grek dhe serbo-sllav, ishte islami ai që i mbajti gjallë ndjenjat tona kombëtare. **Kësisoj, e ruajtëm kulturën tonë kombëtare dhe fetare, nga shkaku se ndasia ndërmjet neve dhe sllavëve ishte e dyfishtë (kombi dhe feja).**

Pra, ju të cilët nuk keni asgjë të përbashkët, së pari me njerëzoren e pastaj me kombëtaren, nuk keni fare të drejtë të brengoseni dhe shqetësoheni në jetësimin e Islamit nëpër zemrat dhe familjet tona. Lus të Mëshirshmin për mëshirë!

Durimi dhe Gënjeshtari

Kur ishim të vegjël, me thënien "rrena i ka këmbët e shkurta" aludonim në personat që realisht i kishin këmbët e shkurta dhe si të tillë i quanim rrenacak. Gradualisht ky kuptim i kësaj fjalie tejet madhështore filloi të evoluojë dhe arritëm ta kuptojmë se thënia në fjalë, nuk kishte fare lidhje me njerëzit këmbëshkurtër. Në kristalizimin e kësaj paqartësie, dukshëm na ndihmuan politikanët e asaj kohë, që ishin këmbëgjatë, por rrenacak deri në skajshmëri! Pasi që i pamë disa politikan dhe pasues të tyre që shumica e tyre ishin me këmbë lejlek, ne pa hezitim, një ditë për ta vërtetuar se vallë e kishim kuptuar, apo nuk e kishim kuptuar domethënien e kësaj fjalie, e pyetëm mësuesin tonë të dashur se ç'kuptim ka thënia "rrena i ka këmbët e shkurta"? Mësuesi jonë i dashur na e sqaroi këtë thënie gjerë e gjatë dhe, pasi e shpjegoi, disi mbeti i shokuar se si na kishte shkuar ndërmend që këtë thënie të thesarit tonë ta ndërlidhim me politikanët. Kuptohet, në atë kohë për gjestin sublim, mësuesi na kishte vlerësuar si nxënës të zhdërvjelltë dhe të talentuar. Por, ajo zhdërvjelltësi si duket nuk na hyri fare në rrugë, ngase ne prej atëherë, e gjer më sot, nëpër kokat dhe bisedat tona e trajtojmë të njëjtën temë. Edhe tani që në mënyrë të përkryer e kuptuam dhe e dimë shpjegimin dhe komentimin e kësaj thënie madhështore, ne prapë mbetëm të lajthitur, të përgënjeshtruar, të dezinformuar, të demoralizuar, të diskualifikuar, të margjinalizuar, të injoruar, të nënçmuar dhe të keqtrajtuar. Ky vagon diskriminimesh nuk na erdhi rastësisht! Normalisht, lokomotiva e këtyre vagonëve kishte qenë dhe është shteti që nuk na dëshironte, ndërkaq ne ende mundohemi dhe tentojmë që me çdo kusht të dashurohemi në të.

Me këtë rast, mu kujtua një shok i imi i cili tmerrësisht e dashuronte personazhin e Aminës në romanin, "Trëndafili i zemrës". Ai filloj të dashurohet në një krijesë të paqenë, ashtu sikurse ne, që trumbetojmë të dashurohemi në shtetin e Maqedonisë në një krijesë po ashtu e pa qenë dhe artificiale, kuptohet përpos emrit gjeografik, ashtu sikurse Amina e cila kishte një emër të dikujt dhe një ngjarje po ashtu të tjetërkujt, por nuk ishte ajo që shoku im e imagjinonte, sepse ajo fare nuk ekzistonte në këtë rruzull tokësor.

Ne pra, përkundër vlerësimit të mësuesit si nxënës të zhdërvjelltë dhe të talentuar, lejuam që e kaluara e hidhur në vazhdimësi të na përsëritet. Pas shumë vëzhgimeve spontane dhe praktikave të mirëkuptuara, prapë i dhamë mundësi dhe hapësirë absolute gënjeshtarëve të manipulojnë me fatin tonë. Tanimë shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni, si duket më në fund, Durimi filloi t'i ofrohet kufirit dhe haptas shprehi dëshirën që, edhe ai të bëhet pjesë lëvizëse e zonës Shengen, ngase edhe Durimi e kishte kuptuar se tashmë mund të udhëtohet lirshëm nëpër tërë kontinentin evropian andaj, çdo pengesë të shprehjes së vullnetit të lirë, kishte vendosur përfundimisht ta artikulonte duke u zhveshur prej natyrshmërisë së domethënies së tij. Durim do të thotë: aftësi e dikujt për të përballuar e për të duruar në vështirësi, fatkeqësi, shqetësime, vuajtje, etj., pa u ankuar e pa u ligështuar. Kuptim i shkëlqyer! Durimi shqiptar, në mos më shumë të gjitha këto peripeci të dhembshme i ka kaluar që moti, fatkeqësisht ende përballja vazhdon, si dhe në shenjë të mosdorëzimit dhe ligështimit, përfundimisht më, ka vendosur që të del haptazi të ballafaqohet me të gjitha mjetet e mundshme, të cilat mund t'i vijnë prej Gënjeshtarit, një idiot i kamotshëm që i`a shndërroj në ferr, jetën e kësaj bote. Pas shumë vuajtjeve, zhgënjimeve dhe mllefit plot vrer, ka vendosur që mendërisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë të përballet me Gënjeshtarin, duke shpresuar se kjo do të jetë hera e fundit e të diskutuarit dhe e të përballuarit me Gënjeshtarin. Mjaft më i pastruam faturat e gënjeshtarëve, kështu shprehet Durimi, që

të shtyn të mendosh se, vallë përputhet emri i tij me veprimtarinë që ka vendosur ta marrë, apo në këtë rast si në asnjë rast tjetër ka vendosur që emri t'i shërbejë vetëm si metaforë kundrejt veprave të mëtutjeshme. Duke e parë se dita ditës, me të madhe po t'i humb durimi Durimit, si dhe për mos të humbur në kohë, Gënjeshtari vendosi që t'ia japë grushtin përfundimtar, duke shpresuar dhe aluduar bindshëm në shkatërrimin e Durimit si tërësi vlerash shqiptare. Por, i gjori Gënjeshtar harroi se, edhe koha tashmë është duke punuar në favor të Durimit. Kështu që, pas një paragjykimi të gjatë e shekullor, erdhi dita që edhe këta dy frymorë me koncepte mendore dhe vepruese rrënjësisht të kundërta, të takohen dhe të polemizojnë gjerë e gjatë për tangimin e një sërë problemesh të trashëguara dhe të porsakrijuara.

Gënjeshtari: Me të vërtet shteti jonë, pra Republika e Maqedonisë pas konfliktit të 2001-shit i përdhosi pak si tepër shqiptarët. Unë nuk kam dëgjuar për ndonjë shtet në botë që, edhe nëse sulmohet, prapë i falet dhe i garantohet liria sulmuesve. Kjo pra, e bënë këtë shtet që të dallohet prej shumë shteteve tjera në botë. Maqedonia ka me çka krenohet!

Durimi: Fillimisht i nderuar Gënjeshtar, një duhet ta kemi të qartë! Konflikti i armatosur i 2001-shit ishte produkt i mendësisë dhe politikës sllavo-ortodokse. Ju habiteni se ky shtet pas këtij konflikti i përdhosi shqiptarët, ndërkaq unë habitem se si shqiptarët lejuan që pas këtij konflikti edhe më tej të nënçmohen, në vend që njëherë e përgjithmonë t'i sqarojnë çështjen e veta personale (lexo: të drejtat individuale) dhe ato ndëretnike. Sqarim i çështjeve ndëretnike do të thotë: ju andej e ne këndej, e assesi në këtu e ju këtu. I harxhuat të gjitha shanset dhe mundësitë për një shtet shumetnik! Neve shqiptarëve një ditë do të na dënoj çasti i humbur, sepse me juve i humbëm kot së koti dy dekada. Edhe në konfliktin e armatosur si duket nuk ishim të prerë, ngase po të ishim të tillë, nuk do e lejonim fare që prej juve të presim amnisti dhe falje, nuk do e lejonim që edhe pas dy dekadave të flasim për përdorim të lirë të gjuhës amtare dhe shumëçka tjetër elementare

që realisht i përket klasikes. Është e vërtetë se Maqedonia dallohet prej disa shteteve tjera, sepse unë ende nuk kam dëgjuar apo lexuar që një shtet me histori tjetër, pra në këtë rast sllave, të pretendon se i përket antikës së lashtë dhe kinse etniteti i sotshëm maqedonas qenka farë e Aleksandrit të Madh. Unë ende nuk kam dëgjuar dhe lexuar që një shtet i vogël dhe i dobët në të gjitha aspektet për hir të historisë së vjedhur ta flijon NATO-n dhe BE-n dhe njëkohësisht t'i mban peng shqiptarët, që asgjë nuk i lidh me kësi lloj historish të vjedhura. Ne pra, ishim shumë të butë dhe të mirëkuptueshëm që lejuam të kërkojmë falje dhe amnisti prej një shteti, i cili në këtë konflikt vrau civilë të pafajshëm, i shkatërroi vendbanimet civile shqiptare, në vend të atyre ushtarake dhe për habi askush nuk u dënua konkretisht për këto maskara, përpos disa shqiptarëve që me lloj- lloj preteksti, pushteti u mundua që t'i fus prapa grilave, që më pastaj t'i sqarojnë mospagimet e faturave të prapambetura të 2001-shit. Është e vërtetë se Maqedonia ka me çka të krenohet përpara botës, ajo pra krenohet me durimin dhe butësinë e shqiptarëve, ajo mund të krenohet edhe me nobelistët shqiptarë, pra me Ferid Muratin e Gonxhe Bojaxhiun, ajo mund të krenohet me shumëçka tjetër, përpos me vlera të saja autoktone!

Gënjeshtari: Ju shqiptarët me të vërtetë jeni keq të përdhosur. A nuk ju duket si e arritur tejet e madhe Marrëveshja e Ohrit, që në vete ngërthen përfaqësimin e drejtë të të gjithë komuniteteve që jetojnë në këtë shtet, e posaçërisht një privilegj i përfaqësimin në këtë shtet u jepet shqiptarëve?

Durimi: Po më vjen mirë që të paktën sipërfaqësisht po din se çka ngërthen Marrëveshja e Ohrit. Më trego pra, ku valon flamuri shqiptarë në këtë shtet, ku mund të flasësh shqip, në cilin institucion të shtetit, sa është përfaqësimi i shqiptarëve nëpër institucionet shtetërore, sa investohet në pjesën perëndimore ku jetojnë shqiptarët, në Ministrinë e Kulturës sa janë të integruar shqiptarët, po ministritë e tjera, sa libra të autorëve shqiptarë financohen prej buxhetit të përbashkët shtetëror, sa para prej buxhetit të përbashkët ndahen për kishat ortodokse, sa para

kushtoi kryqi në Vodno, po ashtu sa janë shpenzimet ditore për mirëmbajtjen e këtij kryqi? A e dini ju se kush udhëheq me buxhetin e shtetit. Nëse nuk e keni ditur unë pra u tregoj. Sipas disa të dhënave jozyrtare 93 për qind të buxhetit e kontrollojnë dhe e udhëheqin ministrat maqedonas, ndërkaq vetëm 7 për qind të mjeteve buxhetore sillet rreth duarve të ministrave shqiptarë. Ka edhe shumë anomali të tjera që realisht të vjen turp të mendosh dhe të flasësh për Marrëveshjen e Ohrit.

Gënjeshtari: Mua nuk më habit kronologjia e përmendur, ngase jemi mësuar të dëgjojmë dhe lexojmë kësi lloj ankesash prej publicistëve, të cilët në pamundësi të inkuadrimit në organet shtetërore, janë të prirë të flasin më shumë gjepura dhe me një retorik që ndërlidhet më shumë me poezinë se sa me realitetin. Ndërkaq, të njëjtën gjë prej kohësh nuk e thotë asnjëra parti politike shqiptare që ishin dhe janë pjesë përbërëse të Qeverisë.

Durimi: Unë realisht do të isha habitur, sikur ju të ishit habitur me këtë pjesë të vogël të kronologjisë sime. Që njeriu të brengoset për një gjë të tillë, paraprakisht lypset që edhe ai fizikisht dhe shpirtërisht të jetë pjesë përbërëse e këtyre vuajtjeve. Ç'farë ju mund të në flisni për padrejtësitë kombëtare dhe fetare, ku një gjë të tillë asnjëherë nuk e përjetuat. Ç'farë ju mund të na flisni për vuajtjet e kurbetit, kur asnjëherë asnjë anëtar të familjes suaj nuk ju iku në kurbet, i madh e i vogël tek ju ishin dhe akoma janë të vendosur nëpër sisteme të rregullta shtetërore. Ç'farë ju dini të na flisni për vuajtjet e atdheut, që shpeshherë ne shqiptarët këto vuajtje i shprehnim nëpër poezi dhe nëpër protesta paqësore me parulla mjaft domethënëse?!

Të them të drejtën, edhe pse emrin e ke Gënjeshtar, ndonjëherë po e flet edhe të vërtetën, edhe atë, të vërtetën e politikanëve, që heshtin dhe pohojnë se janë të kënaqur në bashkë-qeverisje. Ata nuk e thonë këtë realitet, ngase shumë shpejtë mund ta shohin vetën në rrugë, duke recituar poezi për rëndësinë e atdheut dhe duke brohoritur për liri dhe barazi. Pse të dalin në rrugë e të pëlcasin prej të ftohtit, duke qenë mjaft mirë brenda

nëpër ulëse të ngrohta. Ata jo tash, por që moti e kanë ditur se kusht që një parti politike të jetë pjesë e Qeverisë, është se ajo duhet të heshtë dhe ta pranojë fatin tragjik të shqiptarëve, të paktën edhe gjatë këtij mandati. Pastaj, pasi të ketë kaluar një mandat, ka pasuar mandati tjetër me të njëjtat kushte dhe marrëveshje. Pra, mandat pas mandati janë amortizuar dhe dëmtuar shqiptarët, që institucionet shtetërore i shikonte si të huajat dhe gllabëruese.

Gënjeshtari: Në bazë të pohimeve tuaja analogjike, sukseset e luftës antikrim nuk i vlerësoni fare, hapjen e muzeve shqiptare, lejimin e vendosjes së Skënderbeut mu në vendin ku të gjithë e shohin, lejimin e vendosjes së shumë statujave shqiptare, që u vranë duke e luftuar shtetin tonë të përbashkët.

Durimi: Krimi i përgjithshëm po "luftohet", por kini parasysh se krim dhe kriminel nuk ka vetëm në zonat shqiptare, por kjo metodë e luftës së kriminalitetit të përgjithshëm nuk është gjë tjetër, pos që t'i frikësojnë dhe t'u hakmerren shqiptarëve për betejat e humbura të vitit 2001. Poqë se shikon nga këndvështrimi studiues, metodat e luftës kundër kriminalitetit, atëherë përfundimi del se, edhe organizatat terroriste dhe përgatitjet për një film hollivudian, janë të përafërta dhe shumë të ngjashme me aksionet e forcave speciale të këtij shteti. Është e vërtet se Skënderbeu është i vendosur në një shesh të Shkupit, por ju nuk e kuptoni dot gjuhën e Skënderbeut, i cili çdo ditë të lume, e kërkon flamurin kombëtar shqiptar, këtë gjuhë lëre që ju nuk e kuptoni, por gjuhën të cilën e flet Skënderbeu nuk e kuptojnë edhe ca bashkëfolës të tij. Si është e mundur që Skënderbeu të vendoset aty pa flamur! Ju, vallë e dini se nga kush u financua derdhja e kësaj figure në bronz? Unë pra, ju tregoj. Këtë e financuan shqiptarët, edhe atë në masë të madhe kontribuoi mërgata shqiptare, po ashtu edhe figurat kombëtare që ranë në vitin 2001, i financuam ne, kurse ju për statujat e juaja na bëtë kontribuues fare pa dëshirën tonë, që asgjë nuk kemi të përbashkët me këta heronj antik, serb e bullgar që të gjithë këta të vjedhur!

Mos harroni se ju nuk jeni faktori që do na lejoni, apo nuk do na lejoni të ndërtojmë statuja të heronjve tanë. Ju me këtë dëshironi të na nënçmoni. Mendoni dhe trumbetoni të ndërhyni në një të drejtë natyrore dhe, si të tillë e merrni si meritë të juajën, ju bile edhe pak do të krenoheni se ne po u lejojmë shqiptarëve të thithin ajër fare pa problem, ndonëse edhe këtë meritë do t'ia atribuoni vetës suaj. Për mua asgjë nuk është lejimi i ndërtimit të statujave, ngase nën vellon e kësaj, statusi i ish-ushtarëve, dëshmorëve dhe invalidëve të luftës mbeti për vajtim. Ç'na vyejnë neve statujat, kur djemtë e këtyre dëshmorëve kanë mbetur në mëshirë të rrugës dhe të humanizmit, që tashme ky i fundit ka filluar të venitet. Ndërkaq, lerë që "mbrojtësit" e juaj fituan status special për financim, por edhe dëshmorët e antikës jeni duke i financuar, më fal jemi duke i financuar!

Gënjeshtari: Unë ika se kam shumë punë për të bërë, nuk do e lejoj vetën që të humbi më tepër kohë me ju, të cilët kur flitni bini nën ndikimin e emocioneve dhe, njëkohësisht kënaqeni e jetoni duke u ankuar, në vend që të punoni për të mirën e juaj dhe të mirën e këtij shteti.

Durimi: Është më se e vërtet se ju keni punë, sepse kështu vepruan edhe stërgjyshërit tuaj, edhe atë, në kohën kur stërgjyshi im nëpër male përmes tytës së pushkës e kërkonte lirinë dhe barazinë. Kështu vepronte, ngase ishin shterur të gjitha mjetet e gjuhës paqësore, për një zgjidhje të mundshme. Në atë kohë stërgjyshi im vuante për erën e bukës, ndërsa stërgjyshi yt lozte me bollëkun e bukës. Ne jemi të detyruar të flasim dhe shkruajmë për padrejtësitë që po na bëhen, kurse ju si dhelpër tërhiqeni prej debatit, me arsyetim reale se keni shumë punë. Ju pandehni se e keni zgjidhur çështjen kombëtare dhe tani ka ardhur koha për shumë punë, kurse ne shqiptarët primitiv, ende flasim për të drejta, edhe atë në shekullin e XXI, në kohën kur njerëzimi po pinë kafe në hënë. Po ashtu, më akuzoni se po flas me emocione, gjë që është e vërtetë! Ne flasim me emocione, ngase shtatë anëtarë të familjes presin prej një anëtari të punësuar, ju nuk flisni

me emocione, sepse brenda ku punoni dhe jetoni e keni ngrohtë, ndërkaq ne, edhe në njërën edhe në tjetrën, e kemi mjaft ftohtë. Ju flisni pa emocione sepse e shihni shtetin si tuajin dhe të mirë për juve, ndërkaq unë e shoh dhe ndjell kob për këtë shtet, ngase për mua dhe etnitetin tim, nuk qe asgjë në gjendje të bëjë. Ju flisni i rehabilituar, për arsye se, në ditën kur u hoqën zyrtarisht vizat ju bëtë turne në Francë dhe gjetiu, kurse ne, në shenjë të kësaj, udhëtuam deri në shtetin më të ri të botës, në Kosovë, sepse nuk patëm mundësi më tej të udhëtonim, aq na premtonte kaçiku! Tashmë jeni në përpilim e sipër, të ndërtimit të një teleferiku, kuptohet edhe me paratë tona, teleferik që të shpije te kryqi i madh, që ne shqiptarët në asnjë pikë nuk puqemi me këtë kryq politik e provokues. Ju e "harroni" faktin se, ende në shkollat shqiptare po pikon uji prej kulmit dhe minjtë janë bërë kolegë tanë në mësimdhënie. Ju na paralajmëruat se pas këtij viti, mësuesit dhe profesorët që nuk shkruajnë në ditarët e tyre, edhe në maqedonisht do të gjobiten me nga 2 mijë euro, nën kushtet kur, rrogat e mësimdhënësve nuk mjaftojnë as për një javë. Ju flisni i qetë dhe me vrap shkoni të kontribuoni për vetën dhe për shtetin, bëheni gati për festimin e Vitit të Ri, edhe atë jeni shumë të kënaqur që, Komuna e Shkupit ua ndau nga qesja e përbashkët 300 mijë euro për festimin e kësaj feste, edhe atë me këngëtarë serb dhe maqedonas, e assesi shqiptarë. Ju pra, pas të gjithë këtyre privilegjeve keni të drejt të flisni dhe të shkruani pa emocione! Ndërkaq, ne kur të shkruajmë dhe të flasim, jo që jemi vetëm të emocionuar, por realisht ndjenjat dhe shpirti jonë duhet të kum-bojë aq fort, sa që, edhe malet do duhej dridhur prej dhimbjeve tona. Ne duke punuar dhe kontribuar për këtë shtet, fituam kryqe, infrastrukturë të mirë në pjesën e juaj, i blemë disa helikopterë të Ukrainës dhe ca armatim prej shteteve tjera, që sa më mirë dhe sa më fortë të shkatërrohemi dhe të vdesim të tërë, financuam "mbrojtësit" e 2001-shit dhe bëmë e ç'bëmë çmos, por në asnjë rast nuk vendosëm që t'i themi mjaft përfundimisht këtyre idiotësirave, që na penguan dhe censuruan nga liritë e mendimit

për veten tonë dhe për shtetin tonë që natyrshëm na takon. Pra, edhe pse quhem Durim dhe në vazhdimësi kam punuar në suaza të domethënies së këtij emri, më duket se çdo çast i ardhshëm do më mallkojë, nëse ende vazhdoj të qëndroj kështu në letargji nën emrin e kësaj tolerance, si dhe i durueshëm përballë torturës së vazhdueshme. Besoj dhe shpresoj se këtë vit, do të largohem pak nga vetja ime e natyrshme, sepse tani përfundimisht e kuptova se të jesh i drejtë përball të padrejtëve të papërmirësueshëm qenka padrejtësi, e po ashtu të jesh durimtar përballë keqpërdoruesve të këtij koncepti mjaft sublim qenka naivitet.

Unë frikohem se pasardhësit tanë do të na mallkojnë për këtë neglizhencë dhe heshtje vrastare. Kush nuk beson në këto teori, atëherë le ta provojë të bëj gjumë një natë, në pyll edhe atë bashkë me luanin!

Kapitulli
3
PËRBALLË PROBLEMEVE AKTUALE

●○●○●○● ● ● ○●○●○●

■ Stimulim, apo nënçmim i natalitetit
■ Zgjedhjet dhe zgjidhja
■ "Ç'të mbjellësh do të korrësh"
■ Sfidat e sigurisë në Republikën e Maqedonisë
■ Festa e 28 nëntorit, ndërmjet gëzimit dhe pikëllimit
■ Tragjedia për shqiptarin dhe ndaj shqiptarëve, nuk ka të ndalur
■ Kambanat për Kosovën e Lindore
■ Aneksimi i gjymtyrëve dhe vuajtja e tërë trupit
■ Sërish vjen marsi
■ Presidenti i mundshëm shqiptarë dhe Obama
■ Vë bast për ardhmërinë
■ Urime Shqipëri, ngushëllime Maqedoni
■ Maqedonia ndërmjet të kaluarës dhe të "shkuarës"
■ Në ç'farë Maqedonie do jetojmë? Apo...

■ Kombëtar, i drejtë dhe në post shtetëror, aktualisht e pamundur
■ Edhe për sa marrëveshje kemi nevojë
■ Maqedonia ndërmjet Evropës dhe Ev(g)ropës
■ Mirupafshim mërgimtarë
■ "Dituria është forcë, dituria është fuqi"
■ Enciklopedia, si rrjedhojë e rrjedhave të deritanishme
■ Filloi të shkruhet enciklopedia e vërtetë
■ Dashuria dhe urrejtja e parë nuk harrohen dot
■ Ngjasimi i fushatave parazgjedhore
■ Nostalgjia për "vlerat" maqedonase
■ Bujanoci - vendi më i (pa)sigurt në Serbi
■ Viti 20(01)10, ndërmjet kërcënimeve dhe hipokrizisë
■ Kryearkitekti i arkitektëve rrënues
■ Sikur deputetët shqiptarë të kërkojnë azil politik
■ Për hir të së kaluarës maqedonase, po ikë e tanishmja shqiptare
■ Rrugëtimi nëpër mjegulla -**Përfundim**-

Stimulim, apo nënçmim i natalitetit

Qeveria e Republikës së Maqedonisë në media të ndryshme po bënë promovimin për stimulimin e natalitetit në rajone kryesisht maqedonase. Ky stimulim është siguruar nga ligji i ri i miratuar muajin e fundit nga parlamenti, ligj i cili në vete ngërthen stimulim për çiftet bashkëshortore dhe nënat për lindshmërinë në komunat ku nataliteti është vetëm 2,1 promilë. Absurditeti i këtij ligji qëndron në atë se, ky ligj apo aprovuesit e këtij ligji i kanë përjashtuar të gjitha komunat shqiptare.

Nuk e kam ndërmend t'i elaborojë ndihmat financiare, apo shumën e beneficioneve që do të marrin nënat maqedonase, për dy arsye: E para është se, frikësohem nga nervozizmi i opinionit shqiptar dhe e dyta është se, etniteti maqedonas nuk e merr dot vesh gjuhën në të cilën shkruhet ky artikull. Nuk e kuptoj se, pse bëhet afirmimi i këtij ligji në shqip, në mediat shqiptare duke e ditur se ky ligj është tejet diskriminues për etnitetin shqiptar dhe nuk vlen fare për shqiptarët. Pas Luftës së Dytë Botërore, shtetet perëndimore i kanë dhënë rëndësi të veçantë rritjes së natalitetit. Nën pretekstin se, rritja e popullsisë është faktor kryesor i zhvillimit ekonomik dhe ushtarak i një vendi. Po ashtu këto vende perëndimore propagandonin përmes tribunave, revistave, lajmeve uljen e natalitetit në vendet fqinjë, kinse vendet e rajonit në një të ardhme të afërt janë të kërcënuar nga varfëria dhe nga kriza për ushqim. Ky ishte një manipulim i hapur, ishte një mënyrë e luftës, një tentativë për gjunjëzimin e kundërshtarëve. Sepse, dihet nataliteti është forca kryesore e një shteti në të gjitha aspektet. Prandaj këtij fenomeni i kushtohet rëndësi e në veçanti, kjo dukuri

konspirative përcillet me një kujdes të veçantë nga qarqet kompetente shtetërore.

Kur thuhet se është bërë stimulimi i natalitete në një shtet shumetnik, apo të një etnie të vetme, automatikisht kuptohet se është bërë nënçmimi i natalitet, apo dëshira për mortalitet të etnive tjera që jetojnë në po të njëjtin shtet. Nëse i analizojmë shkaqet e stimulimit të natalitetit pas mbarimit të luftës së Dytë Botërore prej shteteve perëndimore, si dhe propagandën e tyre, atëherë fatkeqësisht ne etniteti shqiptar dhe etnitetet tjera që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, gjendemi përball një rezultati mjaft të dhembshëm. Nataliteti enorm i popullit shqiptar fare pa stimulim nga shteti, e ka bërë qeverinë të frikësohet dhe të mendoj për stimulimin e natalitetit në komunat maqedonase. Po shihet, është një frik e hapur nga rritja e numrit të popullsisë shqiptare! Me këtë rritje të numrit të popullsisë, shqiptarët shume shpejt do ta kenë kryetarin e shtetit shqiptar, do të kenë ulëse më shume se të gjithë etnitë tjera në kuvend, ata që sot shqiptarët po i quajnë minoriteti do ta kenë rastin vetë të jetë të tillë. Kjo është një prognozë pesimiste për shtetin e Maqedonisë, por sidoqoftë reale.

Sa u përket etnitetit maqedonas, ky ligj është nënçmues edhe për ata, sepse deri më tani kinse shkak kryesor për lindshmërinë e dobët paska qenë faktori PARA. Si përvojë dhe mësim të kësaj dukurie, e kishim qeverinë e Serbisë ku suksesi ishte mjaft dekurajues. Por, këtu ishte një dallim prej qeveris së Maqedonisë. Qeveria e Serbisë e bëri subvencionimin, edhe ndaj nënave shqiptare me pretekst se shqiptaret në këtë shtet ishin sikurse pika e ujit në det. Më në fund u pa se nataliteti tek shqiptarët ishte dukshëm më i madh, por pa pasur fare ndikim financimi.

Pra, paraja apo subvencionimi nuk është faktori që mund të rrisë natalitetin e një vendi. **Kemi zona shqiptare që jetojnë në varfëri të skajshme, por numri i lindshmërisë është tejet i madh.** Ky ligj nuk është gjë tjetër, pos një ligj i cili manifeston dhe demonstron një formë të qartë diskriminuese, sepse edhe

ashtu nënat maqedonase nuk e kanë vullnetin për të lindur, sikur edhe t'u jepej benefite sa rroga mesatare gjermane për fëmijën e dytë, tretë dhe katërt. **Dëshira e vullnetit për të lindur nuk është në dorë të pushtetit, por në dorë të pushtetmbajtësit absolut, pra të Zotit**. Në bazë të këtij ligji, nënat shqiptare që do të lindin fëmijë pas fëmijës së parë, nuk po i përkitkan këtij shteti. Si është e mundur që një nënë maqedonase ta fiton të drejtën për pensionim nga tatim paguesit e përbashkët, e në anën tjetër një nënë shqiptare që sjell në jetë fëmijë, e që rritë numrin shtetasve të Maqedonisë, të injorohet.

Maqedonia pa shqiptarët mund të rrezikohet, edhe me shuarjen e saj nga harta gjeografike. Nëse shteti i Republikës së Maqedonisë fëmijët e porsalindur i konsideron të huaj, atëherë në çertifikatën e lindjes nuk duhet të kërkojë që shtetësia të jetë e Maqedonisë, sepse një gjë të tillë praktikisht vetë po e kundërshton.

Shqiptarët e Republikës së Maqedonisë kanë qenë të diskriminuar prej kohësh në forma të ndryshme. Tash prej 1 janarit të vitit 2009 diskriminimi i shqiptarit, do të filloj që me lindjen e tij. Nuk duhet harruar faktin se, Zoti si ndëshkim të këtij ligji do ta ulë vullnetin për lindje në zonat ku funksionon ky ligj dhe, do të ngrit vullnetin për lindje në zonat ku nuk funksionon ky ligj. Pra, ju mendoni...

E enjte, 18 Shtator 2008

Zgjedhjet dhe zgjidhja

Si rrjedhojë e jo legjitimitetit qeveritar dhe shumë mos pajtime të tjera, partia e asaj kohe opozitare kërkoi zgjedhje të parakohshme dhe një gjë e tillë u aprovua. Sigurisht që është në natyrën njerëzore të kërkosh alternativa të reja, shpresëdhënëse dhe pragmatike.

Por, a na ka shkuar ndonjëherë mendja, edhe atë prej se ka filluar të funksionojë sistemi shumëpartiak, që pas zgjedhjeve çka fshihet, apo pas zgjedhjeve a ka pasur me të vërtet ndonjëherë zgjidhje të problemeve që kanë qenë para zgjedhjeve?

Shikuar historikisht Republika e Maqedonisë, si shtet shumetnik, e "demokratik" në aspektin e zgjedhjeve dhe, në programet zgjedhore ka qenë mjaft e dështuar dhe e mbështetur në platforma tejet diskriminuese. Të vetmen epërsi partitë politike e kanë pasur, organizimin e fushata parazgjedhore, si dhe thurjen e fjalive dhe premtimeve në mënyrë profesionale.

Është me të vërtetë absurditet që pas shumë zgjedhjeve të mos ketë asnjëherë zgjidhje, të mendohet, organizohet dhe të shpenzohet aq shumë para për fushata zgjedhore, dhe në fund të harrohet dukuria kryesore dhe jetike, pra zgjidhja e problemeve ekonomike, sociale, kombëtare, fetare dhe shumë probleme të tjera. **Ndoshta energjinë për të punuar, prosperuar po e harxhojnë në fushatat parazgjedhore, apo ekziston një variant tjetër mjaft diplomatik apo diplodemagogjik se, ne nëse i realizojmë premtimet e dhëna dhe, nëse i zgjidhim problemet e parashtruara, në zgjedhjet e ardhshme s'kemi çka të premtojmë, si dhe s'kemi çka të zgjidhim në mandatet e ardhshme!** Pra, gjithmonë është lënë diçka, për të mos thënë gjithçka, për më vonë. Kryesisht, logjika e zgjedhjeve në Republikën e

Maqedonisë është mbështetur në kësi lloj propagandash. Edhe pse populli i gjorë është mashtrua disa herë, nuk po heziton të mashtrohet, edhe shumë herë të tjera. Zgjedhjet e vitit ...1998... që u shoqëruan me mos tentim dhe mundim të zgjidhjeve të shumë problemeve kombëtare, në vend të zgjidhjes së këtij labirinti, pushtetarët maqedonas dëshironin që Maqedoninë shumetnike, dal ngadalë ta shndërronin në Maqedoni etnike, duke harruar se edhe emrin e kishin të huazuar me normë të interesit mjaft të lartë, normë (çmim) e cila në pamundësinë e kthimin u shoqërua me mos inkuadrimin në strukturat euro-atlantike. Partia politike shqiptare në pushte e asaj kohe, me gjithë përpjekjet dhe mundimet nuk arriti dot t'i bind partitë politike maqedonase që shqiptareve duhet t'i jepen të drejtat të cilët i takojnë dhe, që burojnë nga natyrshmëria e të qenit njeri.

Kokëfortësia e partive politike maqedonase, nuk kishte të ndalur. Kuptohet padrejtësia arriti në fazën (hiper)diskriminuese ndaj shqiptareve dhe, punët e shtetit për zgjidhjen e problemeve i mori vet populli shqiptar.

Populli shqiptar ashtu i lodhur, i rraskapitur u detyrua t'i kap armët që çështjet e veta t'i zgjidhnin vetë, me anë të forcës, sepse në mënyrë të dhunshme iu morën të drejtat elementare, e të mos flasim për të drejtat tjera.

Pas shumë përpjekjesh për gjetjen e ndonjë gjuhe të përbashkët, në jetën reale institucionale praktike asgjë nuk ndryshoi, dhe në vitin 2001 shpërtheu lufta. Si në çdo rast tjetër, edhe këtu pati humbës dhe fitues. Humbës ishin maqedonasit, kurse fitues ishin shqiptarët duke qenë të ndihmuar nga Zoti dhe ndërkombëtaret, sepse ata ishin në krah të realitetit. E gjithë lufta u kurorëzua me marrëveshjen e Ohrit, marrëveshje e cila në vete ngërtheu barazi të plotë për të gjithë qytetarët që **jetojnë në Republikën e Maqedonisë, pa marr parasysh kombin, gjuhën, fenë dhe racën. Për çudi sot e kësaj dite kjo marrëveshje mbetet objekt diskutimi pa realizim konkret!** Në vitin 2002 pas zgjedhjeve doli fituese partia e cila doli nga lufta, çka ishte një

shpresë për invalidët, ish-ushtarët dhe për statusin e familjeve të dëshmorëve. Pas një mori përpjekjesh, kjo parti disa pika arriti t'i bënë, por esenca e realizimit të marrëveshjes së Ohrit është ende larg realizimit. **Në vitin 2006 u mbajtën zgjedhjet dhe partia që mori bekimin e popullit nuk u lejua të futet në qeveri, por në vend të kësaj u inkuadrua një parti tjetër, me një përkrahje të vogël nga popullata shqiptare në Maqedoni.**

Po ashtu, gjatë fushatave zgjedhore u përballëm me shumë deklarata qesharake, fare pa kuptim. Si p.sh, **"të pamundurën ne do ta bëjmë të mundur"** e ne u themi o ju të nderuar të mundurën bëjeni të mundur, e pamundura është gjithmonë e pamundur.

Në vitin 2008 pati dy herë zgjedhje në pjesën me shumicë shqiptare. Fillimi i fushatave zgjedhore, e kishte marrë të mbrapshtën (e cila u finalizua me një të vrarë dhe shumë të plagosur). Armiqtë maqedonas e shfrytëzuan këtë përçarje të partive politike shqiptare, duke bërë lloj-lloj maskarallëqe, e më pas partitë politike shqiptare sulmoheshin ndërmjet veti, përdornin retorikë të ashpër dhe shumëçka tjetër jonjerëzore. Në fakt, fajtori kryesorë për çfarëdo lloje incidenti ishte faktori politik maqedonas, i cili maksimalisht pa marrë parasysh çmimin dëshironte që, edhe më tej t'i përçaj partitë më të mëdha shqiptare PDSH-në dhe BDI-në. Desh harrova, këto nuk janë fëmijë që t'i manipulojë kush si të dojë!!!

Fitues bindës nga kjo fushë-betejë doli, si zakonisht BDI-ja. Fatkeqësisht, mbrapa për mbrapsht, po i rrinte partia tjetër (e cila parti, asnjëherë në jetën e vetë nuk pati fat të fitonte) dhe ky akt, po e lazdronte Gruevskin, duke e sjellë në një pozitë superiore ndaj BDI-së, sepse kryeministri mendonte se do ta ketë shumë më lehtë me BDI-në, pasi që si alternativë të dyte e kishte partin tjetër shqiptare, e cila mezi priste që të ndodhë ndonjë mospajtim mes fituesve.

Sidoqoftë, fillimi i veprimtarisë së BDI-së ishte i vështirë dhe te opinioni i popullit rezultoi si dështues. Shumë shpejtë BDI-ja, filloi t'i marrë hapat e para drejtë progresit me disa mangësi.

Pas katër muajve qeverisje, kjo parti arriti të shpallë konkurs (i cili konkurs do ta jetësohet në praktik shumë shpejt) për pranimin e 570 nëpunësve shqiptarë. Shpresat e popullatës për këtë parti, bazohen në atë se, kjo parti rrënjët i ka nga lufta, apo thënë më mirë është pjellë e kryengritjes së armatosur. Si duket ky, edhe ishte suksesi i parë në këtë mandat, duke pasuar pastaj padrejtësitë e njëpasnjëshme kundrejt shqiptarëve.

Çdo dështim nga kjo parti do të thotë; njollosje e dëshmorëve, invalidëve dhe ish- ushtarëve. Por, kjo parti nëse nuk ka arritur të mësoj nga e kaluara (e hidhur), atëherë dështimi përfundimtar i kësaj partie dhe i popullit shqiptar do të jetë i sigurt dhe fatal në përgjithësi. Nuk është fitore e kësaj partie, fitimi i zgjedhjeve, apo që iu aprovua vullneti për zgjedhje të parakohshme, por fitore e vërtet është nëse pas këtyre zgjedhjeve do të na sjellë zgjidhje të problemeve elementare, deri te ato të komplikuara.

Ndoshta ky avaz do të vazhdojë tërë jetën, të ketë zgjedhje në kohë e para kohe, por do të ishte gjithçka e kotë nëse politikanët tanë, nuk e kuptojnë se pas zgjedhjeve vijnë zgjidhjet, sikur se pas dimrit që vjen pranvera, e jo pas zgjedhjeve zgjedhje, apo pas dimrit dimri!

E hënë, 27 Tetor 2008

“Ç’të mbjellësh do të korrësh”

Rajoni i Likovës, mbjellësi më i madh në tërë komunat, por fatkeqësisht, vjelësi më i vogël i tërë rajonit!

Rajoni i Likovës gjendet në pjesën veriore të Republikës së Maqedonisë, e cila kufizohet në zonën kufitare me Serbinë dhe më Republikën e Kosovës. Në të kaluarën ky territor ka qenë pjesë e komunës së Kumanovës, e që tash administrativisht i takon komunës së Likovës. Janë bërë polemika nga më të ndryshme, po ashtu nga njerëz të profileve të ndryshëm në momentin e ndarjes prej komunës së Kumanovës. Por, si duket më në fund ndokujt i konvenojë që komuna e Kumanovës, të administrohet ndaras prej asaj të Likovës. Ata projektuesit e decentralizimit, nuk kemi arritur ende dot, t'i kuptojmë se a kanë menduar për veprimtarin kësaj komune në aspektin ekonomik, social dhe atë juridik. Si duket, aktualiteti po fletë se, fare nuk është menduar për këto aspekte të lartcekura. Sepse, komuna e Likovës momentalisht përballet me pasoja, të cilët disa komuna i kanë tejkaluar në vitin 1949. **Si arsyetim për mos investim në këtë komunë vazhdon të mbetet epiteti i ashtuquajtur "zonë e krizës".** Më pas, investimet kapitale dhe jo kapitale po shkojnë në pjesën lindore të Maqedonisë, sepse kështu udhëheqësit po ua prezantojnë gjendjen e komunave.

Për fat të keq, askush prej kësaj komune nuk ka dalë e nuk po del, t’i thotë opinionin zyrtar dhe jozyrtar se, kjo komunë atë emër e ka të trashëguar dhe të pagëzuar qëllimisht prej atyre që nuk ia dëshirojnë të mirën shqiptarëve, dhe se realiteti është krejt ndryshe. Nëse me të vërtet është, kështu komunë me epitet "zonë

e krizës" atëherë si iu vu ky emër? Prej kujt, kur, kush duhet ta heqë, si duhet hequr dhe një varg pyetjesh???

Realiteti është ndryshe, ky epitet famëkeq tashme është vetëm një mit dhe asgjë tjetër! **Ekzistojnë kushte që një rajon të quhet zonë e krizës.. Së pari në atë vend duhet të ketë anarki të plotë politike, juridike, ekonomike dhe sociale, duhet të ketë kriminel të kalibrave të ndryshëm (kriminaliteti të jetë në maksimum), vrasje të përditshme dhe shumë maskarallëqe të tjetra.** Vallë komuna e Likovës i posedon këto të meta? Pa dyshim se jo. Por, ata që ia vënë këtë epitet kësaj komune dëshirojnë me të vërtet të gjenerojnë kriza, pa pasur fare kriza. Skenaristët të cilët punojnë ditë e nate, që kjo komunë të shërbeje si vatër eksperimentesh të natyrave të ndryshme kryesisht konfliktuoze, qëllimit të tyre po u ofrohet çdo ditë e më afër. Po ashtu qëllimit të tyre famëkeqe po u ndihmojnë, edhe disa njerëz të kësaj zone.

Në këtë rajon shpërtheu konflikti serioz, ky rajon u bombarduar gjashtë muaj rresht, në këtë komunë (duke mos i harruar edhe komunat tjera) ranë dëshmor prej viseve të ndryshme shqiptare, këtu u vendos për ardhmërinë e popullit shqiptar në Maqedoni. Ndoshta po e teprojë, nuk kamë çfarë të bëjë, kur vetë veprimtaria e kësaj komune e ka tepruar së kujdesuri dhe së bëri mirë popullit shqiptarë në përgjithësi, e posaçërisht shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni. Bijtë intelektual që u sakrifikuan për kauzën kombëtare lindën nga ky rajon, deputeti shqiptarë Hysni Shaqiri që e braktisi kuvendin për kauzën kombëtare ishte po nga ky rajon, intelektualët e këtij rajoni Arif Seferi, Hamit Thaçi, Naim Ibrahimi e shumë të tjerë u burgosën, disa u vranë për shkollat shqipe, Ismet Jashari (Kumanova) lindi në këtë rajon, hoxha i nderuar Jakup Hasipi lindi dhe u rritë po në këtë rajon, e shumë njerëz të tjerë të shquar lindi ky vend. Ky rajon mbolli shumë për kauzën kombëtare. Por, absurditeti është në atë se, sa kjo komunë arriti t'i korrë të mbjellat e veta, apo ndoshta në ndërkohë këtë rajon e kaploi thatësira! Pa dyshim që e kaploi thatësira, por ajo e

tradhtisë. **Lodhjen e atyre që punuan natë e ditë për këtë çështje madhore e shfrytëzuan pseudo-spiunët e sigurimit sllav, si dhe pasojat e atyre, tashmë disa të "penduar" po i ndjejmë dhe përjetojmë akoma.**

Është paradoksale se po kjo komunë (me tokë pjellore, ku të gjitha mbjelljet ishin të suksesshme) aktualisht është në një gjendje të mjerueshme sociale.

Menjëherë pas luftës kjo komunë shërbeu si mjet për afirmim të partive të ndryshme politike. Në tërë fushatat parazgjedhore këtu u thanë lloj-lloj fjalë dogmatike, e aspak veprimtari pragmatike. Shumë projekte strategjike ikën nga dora e kësaj komune dhe, shkuan në komunat maqedonase, fatmirësisht disa shkuan edhe në komuna të tjera shqiptare. Vallë kjo komunë po shërben dhe, do të shërbej vetëm si krenari historike për popullin shqiptar në përgjithësi? Apo do të mbetët si një monument historik për gjeneratat e ardhshme, ku do të tregohet në mënyrë origjinale se si është bërë luftë në vitin 2001 në këtë komunë.

Përditshmëria jonë po fletë se, kjo komunë do të mbetet si një monument historik. Ngase, vendet të cilët i përkasin një lashtësie domethënëse, në ato vende nuk guxon fare të ketë rrymë, dhe objektet infrastrukturore nuk guxojnë të prekën (përpos ndonjë renovim sipërfaqësor). **Komuna e Likovës i ngjan një monumenti historik**. Këtu nuk ka rrymë sa duhet, është zonë e krizës, nuk investohet fare (përpos disa renovime sipërfaqësore), nuk ndodhin vrasje (sepse dihet, në monumentet historike nuk kemi vrasje, por vetëm fjalë dhe krenari).

E vërteta është se, komuna e Likovës nuk është fare zonë e krizës, por këtu nuk përjashtohet mundësi e krizës sociale, e cila më pas mundë të gjenerojë kriza dhe tek atëherë mund të quhet zonë e krizës.

Pra, mos të harrojmë se po në këtë komunë është begatia e ujit e cila e furnizon tërë komunën e Kumanovës. Pra, jini mirënjohës ndajë kësaj komune dhe nëse dëshironi që kjo komunë të shërbej si vatër konfliktesh, atëherë dine se dëmi do të jetë fatal

për gjithë shtetin, nuk do të lejohet më të lozet me dinjitetin e popullit që jetojnë në komunën e Likovës. Sepse, kjo komunë ashtu siç ka epërsi të mbjellë, shumë shpejtë kursin e përdit-shmërisë mundë ta kthejë në vjeljen e fryteve të vet dhe pastaj nuk do të kenë të drejt (të paktën morale) ankese, komunat tjera për mungesë frutash.
Ju kryetarë i ardhshëm i kësaj komune rurale, sikur ta dini se çfarë ju pretë, do të ishit pak më i kujdesshëm në premtimet e dhëna!

E enjte, 06 Nëntor 2008

Sfidat e sigurisë në Republikën e Maqedonisë

Maqedonia si ish-njësi e federatës së Jugosllavisë socialiste, në momentin e shkëputjes, mbeti e vetmja zonë, apo zonjë që i shpëtojë tmerrit nacionalist serb.

E vetmja njësi federale pati fatin të ndahet, fare pa konflikt, pa më të voglin problem. Ndoshta, edhe kjo ndodhi për shkak të zhvillimit të politikave joparimor ndaj shqiptareve që jetonin në këtë njësi federale.

Menjëherë pas shkëputjes nga Jugosllavia socialiste, tashmë Republika e Maqedonisë, e cila ishte me emër të dyshimtë dhe problematik, u vlerësua nga krerët vendas dhe të huaj si "oazë e paqes" në Ballkan. Por, Republika e Maqedonisë nuk e pati fatin gjithherë që problemet madhore t'i zgjidhë duke bërë çudira, apo me mjete magjike. **Epiteti i ashtuquajtur "oazë e paqes" gradualisht filloi të zbehet, sepse edhe ashtu ky epitet ishte fals dhe nuk mbështetej në argumente shkencore dhe praktike.** Nëse ishte ashtu "oazë e paqes", atëherë komunitet që jetonin në këtë "oazë të paqes" do të silleshin paqësisht, do të jetonin në harmoni të plot mes veti dhe nocioni "sfidë e sigurisë" nuk do të përdorej fare, sepse në atë vend do të mbretëroj siguria e plotë, do të jetë vend progresiv e atraktiv, apo njerëzit me famë do të vinin të jetonin në këtë vend. Praktika dhe realiteti shumë shpejtë e demantuan këtë manipulim.

Privimi nga të drejtat elementare i të gjithë komuniteteve e në veçanti i shqiptarëve, e vuri në dilemë sigurinë kombëtare të Maqedonisë.

Shqiptarët përmes partive politike të sapoformuara e ngritën zërin lart, për padrejtësitë që u bëheshin, po ashtu në rast mosndërmarrje i paralajmëronin se tutje puna si do të shkojë, apo padrejtësitë ndaj etnitetit shqiptarë mund të shkaktojnë trazira dhe njëherit do të jetë një sfidë e rëndë (ndoshta pa alternativa) e sigurisë kombëtare.

Punët politikisht, ekonomikisht, juridikisht sa vinin e keqësoheshin, edhe përkundër përpjekjeve nga ana e partisë politike shqiptare dhe opinionit shqiptarë. Shteti i Maqedonisë pati kritika, edhe nga jashtë për politikat diskriminuese dhe ndëshkimore (veç se ishin shqiptarë) ndaj etniteteve pakicë, edhe pse etniteti shqiptarë nuk ishte pakicë (këtu e kamë fjalën shqiptarët që jetonin në këtë shtet, edhe pa nënshtetësi). Por, kokëfortësia e politik-bërësve maqedonas nuk kishte të ndalur, bile edhe përball murit mjaft të fortë.

Situata në përgjithësi ishte e brishtë, pa shpresë për zhvillim të përgjithshëm, sepse zhvillim provincial dhe individual tek maqedonasit kishte, ata ishin të integruar tërësisht nëpër institucione dhe fabrika të punës. Për këtë arsye paralajmërimi për një konflikt të armatosur të mundshëm, maqedonasit i trondiste dhe brengoste shumë, sepse për ata, ky konflikt ishte fare i panevojshëm (fatkeqësisht nuk e dinin se ka krizë sociale në Maqedoni), përgjithësisht kolltukët në punë dhe shtëpi e bënin të vetën. Numrin e të papunëve në këtë shtet, me shumë lehtësi mund ta gjenin, mjafton ta numëronin vetëm popullatën shqiptare.

Ngjarjet e vitit 1997 në Gostivar dhe Tetovë, e sprovuan edhe më tej sigurinë kombëtare të shtetit. Ishte një dhunë tërësisht e shfrenuar policore-ushtarake. Shkaku i kësaj dhune ishte një manifestim i thjesht i të drejtës elementare, pra vendosja e flamurit përpara ndërtesave komunale në Tetovë dhe Gostivar, si dhe nëpër komunat tjera ku dominonin shqiptarët. Në këtë stuhi "njerëzore" u vranë dhe u burgosën shumë shqiptarë. Kjo ishte një manifestimi i forcës militariste, apo futje frikë ndaj popullatës

civile shqiptare (këtë metodë e përdorin edhe organizatat terroriste).

Dhunimi shumëdimensional, e arriti fazën kulminante, ku më vitin 2001 shpërtheu konflikti i armatosur mes kryengritësve shqiptarë dhe ushtrisë/policisë maqedonase. Kjo e vulosi vërtetësinë e të ashtuquajturës "oazë e paqes". Strukturat ushtarako-policore maqedonase u përgjigjeshin kryengritësve dhe popullit civil shqiptarë në formën më mizore të mundshme, duke përdorur armë vendore dhe armë të blera nga dashamirët e saj sllav. Edhe pse vonë krerët maqedonas me presion nga ndërkombëtaret e kuptuan se etnitetit shqiptar duhet t'i jepen të drejtat që i takojnë. Në suazë të kësaj u nënshkrua Marrëveshja e Ohrit, ku përfundimisht u tha se, Republika e Maqedonisë nuk është vetëm e popullit maqedonas, por edhe shtet i popullit shqiptarë që jetojnë në këto hapësira. Por, epilogu i gjithë kësaj qëndron në atë se, kjo marrëveshje me skadim të afatit për katër vite, ende vazhdon të mbetet objekt diskutimi për zbatim të tërësishëm, apo të pjesërishëm. Nga kjo marrëveshje u nxorën edhe disa nën marrëveshje si, p.sh, Marrëveshja e Majit, e Marsit e ndoshta edhe shumë marrëveshje tjera. **Një këtu duhet pasur parasysh, se këto nën marrëveshje u bënë për të vetmen arsye, pra për t'u mos u marrë vesh asnjëherë.**

Profesorë dhe ekspertë të ndryshim, para refuzimit të Maqedonisë për në NATO, thoshin: nëse Maqedonia refuzohet nga anëtarësimi për në NATO, atëherë dine dhe jeni të sigurt se Maqedonia do të rrezikohej me ndarjen e saj (këtë e thoshin, ngase ishin tepër të sigurt për pranimin e Maqedonisë në NATO)

Pra, Maqedonia nuk u pranua në NATO, çka ishte dhe është një sfidë tepër e rëndë për sigurinë e brendshme, sepse humbi shansin e bashkëngjitjes me "policin botëror". Aktualisht jemi nën ankthe, pikërisht në këtë kohë mjaft të nxehtë tentohet një edukim militarist i qytetareve (mjafton ta përmendim orën policorë prej 21:00 në Kumanovë), mosmarrëveshjet rreth emrin nuk ka shanse të zgjidhen, Nevzat Halili del me një ide

mjaft të guximshme, gjoja se ky shtet duhet të quhet "Unioni Maqedoni-Iliridë", në anën tjetër na kujtohen idetë e Lupço Georgievski, se ky shtet duhet të ndahet, e shumë ide dhe dilema tjera. A thua Republika e Maqedonisë do të ketë jetësim të mëtutjeshëm, apo do të ketë një ndarje të ndershme e të lehtë, sikur në momentin e formimit të saj?

E martë, 18 Nëntor 2008

Festa e 28 nëntorit, ndërmjet gëzimit dhe pikëllimit

Nëntori, ky muaj i cili është karakterizuar me plotë ngjarje madhore historike, një muaj ku ndodhën kthesa të mëdha historike për popullin shqiptar. Ky muaj për neve shqiptarëve është më shumë se muaj, më shumë se ngjarje, më shumë se përditshmëri, është shumë më shumë se sa ne dhe të tjerët mund të shkruajmë për ngjarjet dhe vendimet që kanë ndodhur po në këtë muaj. **Në këtë muaj të vitit 1908 u mbajt Kongresi i Manastirit, në këtë muaj të vitit 1912 u shpall Pavarësia e Shqipërisë, në këtë muaj të vitit 1955 lindi legjenda mbarëshqiptare Adem Jashari, si dhe shumë ngjarje tjera mjaft domethënëse për kombin shqiptar në përgjithësi.**

Sa herë që vjen ky muaj ne shqiptarët (ku do që jemi) ndihemi mjaft të gëzuar dhe këtë ditë e manifestojmë me poezi, dokumentarë, këngë e drama, duke i dhënë kështu një ngjyrë festive tërësisht kombëtare. Është normale që të ndihemi të gëzuar në këtë ditë sepse para 96 viteve, Shqipëria më 28 nëntor e shpalli pavarësinë e saj, ku Ismail Qemaili ngriti flamurin në Vlorë. Kjo pavarësi erdhi si rezultat i angazhimit të palodhur të shqiptarëve me anë të pushkës dhe penës, që ishin nga Kosova në veri e deri në Çamëri në jug, nga Adriatiku e Joni në perëndim e deri në Shkup e në Kumanovë në lindje, dhe të gjithë shqiptarët e diasporës kudo në botë. Por fatkeqësisht historia na mëson diçka të hidhur. Se menjëherë pas tri ditëve, nga shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, e gjithë Kosova, Shqipëria Veri-lindore dhe Shqipëria e Mesme ishin pushtuar nga ushtritë serbe e malazeze. Pra Shqipëria si një trup i bashkuar me të gjitha pjesët dhe organet e saja zuri të shkëputet dhe t'i uzurpohen pjesë vitale të trupit. Për të shqyrtuar problemet politike që rrodhën nga ngjarjet e Ballkanit, Fuqitë e Mëdha (Anglia, Franca, Gjermania, Austro-Hungaria,

Rusia dhe Italia) u morën vesh për ta mbajtura në Londër një konferencë në nivel ambasadorësh. Pas një diskutimi të gjatë dhe të nxehtë, më 22 mars 1913, Konferenca e Ambasadorëve vendosi t'i copëtonte trojet shqiptare, duke shkëputur nga Shqipëria tërë Kosovën dhe viset tjera shqiptare, si Tetovën, Dibrën, Gostivarin, Kërçovën, Strugën, Kumanovën etj., të cilët nga pushtimi i Perandorisë Osmane duhet të kalojnë në pushtim tjetër, pra në atë serbemalazeze. Ky kalkulim mizor i nivelit ndërkombëtar, u shoqërua me trazira dhe konflikte të njëpasnjëshme në Ballkan.

Nga moszgjidhja e problemit shqiptar, Ballkani vazhdon të mbetet një vullkan aktiv. Nëse pyesim se me kënd kufizohet Shqipëria, atëherë do të marrim një përgjigje abstrakte. Nga katër anët e saj, Shqipëria kufizohet me shqiptarët, pra me Shqipërinë natyrale. Askund në botë nuk ndodhë që një shtet të kufizohet me vetveten. E pra kjo është përgjigja abstrakte, sepse edhe pyetja në këto rrethana artificiale për Shqipërinë është po aq abstrakte, apo paradoksale.

Dihet mirëfilli mjekësor dhe logjik, se një trup do të funksionojë ashtu siç duhet, atëherë kur të gjithë pjesët e trupit janë të ndërlidhura mirë ndërmjet vete. Shqipëria sot është një shtet me gjymtyrë të këputura dhe të keqtrajtuar në maksimum. **Sot, vetëm 3.5 milion, prej 8 milion shqiptar punojnë për zhvillimin e Shqipërisë. Pra, edhe ky është njëri prej shumë indikacioneve, që rezulton me zhvillim të ngadalshëm të Shqipërisë, ngase njëri prej kushteve që një shtet të jetë i zhvilluar është edhe madhësia e shportës konsumuese.**

Për këtë arsye, ne shqiptarët që u privuam të jetojmë së bashku me Shqipërinë në një shtet të vetëm, jemi të gëzuar dhe të pikëlluar më 28 nëntor (pavarësisht vitit). Ne shqiptarët e Maqedonisë, Kosovës Lindore, Kosovës, Çamërisë dhe Malit të Zi do ta festojmë festën e 28 Nëntorit, do të gëzohemi, por me zemër të thyer, e me trup të dërmuar. Kjo ditë për ne (e që duhet të jetë edhe për Shqipërinë kështu) është dita ku gërshetohet e mira dhe e keqja, ku papritmas në manifestim mund të vjen ndonjë "zhivo-

rad" apo "alfa" e të na largojë nga tubimi festiv, edhe atë duke përdorur dhunë. Ne në këtë ditë përskaj gëzimit do të vuajmë për gjendjen tonë të mjerueshme kombëtare dhe sociale, ende në këtë ditë ka njerëz që nuk kanë guxim ta manifestojnë, në formë publike festive këtë datë (sepse nga shteti janë të privuar për një të drejtë të tillë) ose ai i cili e ngrit flamurin në shtëpinë e vetë, shumë shpejtë mund të quhet edhe Ismail Qemajl. Kjo tregon rrezikshmërinë e lartë për ngritje të flamurit kombëtar në një shtet "demokratik". Për ne të cilët, në trojet tona jemi shndërruar në minoritete, kjo ditë është një ditë vaji, dëshpërimi e pikëllimi. Neve na ndan padrejtësisht, na transferuan në minoritete, na detyruan të dalim në tri kryengritje të armatosura (asnjëra e mbaruar), na detyruan të mos jemi të populluar në Manastir (Bitollë), të tubohemi në këtë qytet vetëm pas 100-viteve. Ne të cilët, në shtëpitë tona jemi bërë mysafirë, ende përballemi me privimin e përdorimit të gjuhës shqipe, apo për një gjë të tillë ende lejojmë të negociojmë. Ne të cilët, u gëzuam pa masë në momentin e bërjes shtet të Kosovës, në mënyrë faktike e pranuam lindjen e një shteti nga po i njëjti shtet. Nipërit e mbesat tona në një të ardhme jo të largët do të shquhen me aftësitë e tyre shkencore, por identifikimi i tyre do të jetë "filan personi me origjinë shqiptarë", pra vetëm në bazë të origjinës do të identifikohen se paskan pasur gjysha shqiptare, apo integristë (bashkues dhe asimilues me ndonjë popull tjetër)

E pra, ne të cilët jemi në këtë gjendje, në trupin tonë e me tesha të huaja, me një të ardhme mjaft të pasiguritë, pa mëdyshje se në këtë ditë dhe datë do të jemi të gëzuar dhe të pikëlluar dhe festimi ynë do të jetë gjysmak, ashtu edhe siç jemi të tillë me një shtet shqiptar gjysmak, artificial, jo të plotë. Do ta festojmë këtë festë, ashtu siç duhet atëherë kur aspiratat e të rënëve (dëshmorëve) do të bëhen realitet. Pra, betimi dhe aspirata e tyre kanë qenë rikthimi i trojeve shqiptare, në një shtet të përbashkët të quajtur Shqipëri.

E mërkurë, 28 Nëntor 2008

(Kjo ese, është punuar në bashkëpunim me mikun tim, Ardian Ramadani)

Tragjedia për shqiptarin dhe ndaj shqiptarëve, nuk ka të ndalur

Si në të kaluarën e largët ashtu edhe sot, populli shqiptarë vazhdon akoma të mbetët si popull shumë i përvuajtur, i diskriminuar, i persekutuar dhe gjithçka tjetër përpos i privilegjuar dhe i nderuar. Populli shqiptarë në përgjithësi, e në veçanti shqiptarët që jetojnë në Maqedonisë ende përballen me probleme dhe padrejtësi që shumë shekuj më herët popujt tjerë i kaluan. **Përkundër luftës së 2001-shit, përkundër Marrëveshjes së Ohrit, përkundër plagëve të pashëruara, përkundër historisë së dhembshme dhe diskriminuese ndaj këtij populli, dhuna dhe terrori ndaj etnitetit shqiptarë nuk ka të ndalur, edhe më keq, nuk kemi shpresa që një ditë këtu në vendit tonë autokton do të lindë pranvera, e që më nuk do të shkruanim dhe flasim për tragjeditë ndaj këtij populli.** Duke u mbështetur në të kaluarën dhe të tashmen, fatkeqësisht në mënyrë faktike po prognozojmë një të ardhme tejet pesimiste dhe të zymtë për neve shqiptarëve që jetojmë në Republikën e Maqedonisë.

Nën emrin e parandalimit dhe luftimit të "kriminalitetit ekonomikë", njësitë speciale policore "alfa" me urdhër të Ministrisë së Brendshme, maksimalisht po e shfrytëzojnë larjen e disa faturave të prapambetura të vitit 2001. Autoriteteve përgjegjëse nuk i mjaftojë si dëshmi, njësiti paramilitar "Vojvoda" e cila publikisht u deklarua dhe e pranoi sulmin ndaj "Alfa"-ve. Kjo, njëherit shprehë edhe precizitetin dhe profesionalizmin e organeve përgjegjëse për filtrimin dhe analizimin e informatave që vijnë nga jashtë për ndonjë problem të caktuar. Por, ky lloj "profesionalizëm" i seleksionimit të informatave, ndodhë vetëm atëherë

kur sulmuesi paraqitet si prishës i strategjisë së mëtutjeshme. Sepse, nëse dëshirohet të ndërmerret diçka, qoftë për mirë a për keq, patjetër duhet të ekzistojë preteksti. Ndryshe faturat e prapambetura do ngelnin ashtu siç kanë qenë, d.m.th, të pa paguara. Nëse do ishte ashtu, atëherë, ne etniteti shqiptarë do duhej kërkuar (në mënyrë paqësore) disa llogari nga shteti, që ende nuk na i ka paguar, pra në këtë rast, ne jemi huadhënës me hua ende të pa kthyer.

Ajo çka neve më shumë na brengosë është fakti se, i vrari fatkeqësisht është shqiptar (do brengosemi edhe për të tjerët, pavarësisht nacionalitetit), dhe pas tij vazhdojnë të torturohet dhe viktimizohen shqiptarët, pra, ne etniteti shqiptarë në të dy rastet po dalim humbës fatal.

Në varrimin e të ndjerit (Zoti e mëshiroftë) u gërshetuan tre aspekte të jashtëzakonshme, ai kombëtar, fetar dhe shtetëror. Kjo qenka kur ndokush të rrah dhe nuk të le të qashë!!!

Me të vërtet kjo për ne është tejet nënçmuese. Për vrasjen e vëllait tonë të përgjigjemi ne. Paradoks! Nëse kërkojmë përgjigje prej autoriteteve, në lidhje me bastisjen e shtëpive, ata do të na përgjigjen se jemi duke i kryer hetimet për vrasjen e policit shqiptarë. **Si është e mundur gjithmonë të ndodhë kështu, nëse vritet ndonjë policë, apo person civil i etnitetit maqedonas, akuzohen shqiptarët, po ashtu nëse vritet ndonjë shqiptarë prapë akuzohen shqiptarët.** Si është e mundur që ne shqiptarët të jemi kaq të paqytetëruar, e të pamëshirshëm.

Qytetërimin dhe mëshirën tonë, prej kohësh e vërteton durimi përballë torturimit dhe diskriminimit të manifestuar në praktikë prej etnitetit tjetër (shtetit). Edhe nëse dëshirohet dhe tentohet të kapet krimineli, apo vrasësi këtë duhet bërë në mënyrë profesionale, pa i dëmtuar të tjerët, sepse jetojmë në një shoqëri të hapur dhe demokratike dhe shkelja e të drejtave elementare njerëzore është e ndaluar me ligjet vendore, dhe me konventat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, këto dispozita ligjore vlejnë

edhe gjatë sulmeve, përgjimeve, dhe hetimeve. Fundja çfarë faji ka një nënë plakë, një fëmijë, apo një nuse e porsamartuar me rastin në fjalë! Si është e mundur krimineli pas aktit kriminal të qëndroj në shtëpi i rehabilituar dhe të jetojë bashkë me familjen në një gjendje të rehatshme? Pse të bastiset shtëpia në mënyrën më të mundshme mizore, që do ia kenë lakmi edhe kriminelët e kalibrit të rëndë.

Në kësi lloj rastesh, është mjaftë vështirë ta besosh se bastisjet po kryhen nga organet shtetëror të rendit. Vallë njësit speciale dhe policia janë për të na mbrojtur, apo për të na torturuar fizikisht e logjikisht. Në shtete demokratike polici dhe njësit tjera operative shihen me syrin optimist, pavarësisht rastit. Pas gjithë këtyre bastisjeve dhe arrestimeve ende nuk kemi dëgjuar për arrestimin e ndonjë personit të palës tjetër.

Tragjedi e vërtetë për neve shqiptarëve! Në ditën e zgjedhjeve e humbën një shqiptarë (të tjerët festonin), zgjedhjet na detyruan t'i përsërisim, duke u krenuar të tjerët përpara autoriteteve ndërkombëtare së në RM zgjedhjet ishin të drejta dhe demokratike, përpos në pjesën e vogël ku jetojnë shqiptarët (kinse ne qenkemi pjesë e vogël) pati disa parregullsi, pastaj për së dyti herë na detyruan të votonim edhe atë nën tytën e pushkës të njësitit policor, fillimi i sulmeve dhe torturave intensive filloi me etnitetin shqiptarë, u burgos edhe një sopotas i pafajshëm, u vra një shqiptar (Alfa) dhe në vazhdimësi viktimizohen shqiptarët. Të gjithë e kemi të qartë se shumë shpejte fajtori do të deklarohet haptas nga autoritete shtetërorë, por kjo do ndodhë atëherë kur ne si popull skajshmërisht i dërmuar, nuk do mbetemi për asgjë, bile do harrojmë të kërkojmë edhe dëmshpërblim (edhe pse kurrë nuk do mundnin të na dëmshpërblejnë për dëmet e shkaktuara).

Prej kohësh është thënë dhe pohuar se arma e intelektualit është lapsi (kalemi), por si duket të ashtuquajturit "ekspert të sigurisë" i ka kapluar një përgjumje totale dimërore. Habitemi se si qëndrojnë kaq indiferent përballë gjithë këtyre maskarallëqeve, si është e mundur në momentet më të vështirë të na tradhtoni o ju

intelektual "analistë" e "ekspertë të sigurisë". Përse asnjë analizë prej juve nuk e pamë në luftën e 2001-shit (e kamë fjalën duke qenë edhe ju në vendin e ngjarjes) dhe për gjendjen e tanishme përse nuk ndërmerrni asgjë? Paraprakisht e kuptoj, rrogat e larta në "FON" dhe të ardhurat tjera, kinse duke llomotitur për integrimin e vendit në UE, i kanë fajet.

E martë, 23 Dhjetor 2008

Kambanat për Kosovën Lindore

E drejta historike qartë dhe saktë na tregon se Kosova Lindore ka qenë pjesë e Shqipërisë dhe nën administrim të shqiptarëve.

Me këtë hyrje të shkurtër dhe mjaftë domethënëse, po e filloj këtë shkrim, ngase në të shumtën e rasteve historianët dhe analistët serbë thirren dhe mbështetën në të drejtën historike. Ata në këtë të drejtë mbështeten, vetëm atëherë kur nuk kanë ku të mbështeten, kur dëshirojnë të grabisin diçka këtë të drejtë e deformojnë varësisht prej tekave të tyre, sidomos grabitqarë të perfeksionuar dhe të pakompromis janë, atëherë kur bëhet fjalë për grabitje të territoreve të huaja. Prej kohësh është thënë se, fqinjët luajnë një rolë mjaftë të rëndësishëm mbi atë së ju do të kaloni një jetë të rehatshme dhe begatshme, apo jeta e juaj nga barbarizmat fqinjësore do të shndërrohet në një skëterrë. Pra, fqinjësia si fenomen real paraqet gjeneratorin e paqes, apo të dhunës.

Shqipëria në të kaluarën si fqinje e Jugosllavisë, pësoi shumë nga dinakëritë dhe mizoritë e kësaj fqinje lavire. Shqiptarët ishin aty ku janë edhe sot, atëherë ku skish kufi as fqinjë njeri veç Iliri, kështu na thotë këngëtari i shquar shqiptarë Ilir Shaqiri. Shumë vise tjera shqiptare u pushtuan pa të drejtë nga armiqtë sllavë. Nga ky maskarallëk nuk shpëtoj dot as Kosova Lindore. Varfëria, cenimi i të drejtave elementare (të mos flasim për të drejtat të rangut të lartë), dëbimi, maltretimi, provincializmi, privimi nga shumë segmente të jetës dhe gjithçka tjetër përpos progresit dhe të drejtës natyrore, vazhdojnë të jenë pjesë të pandashme të përditshmërisë shqiptare në këtë rajon.

E drejta e vetëvendosjes është e garantuar me ligjet ndërkombëtare, por ja që përballë bishave ky ligj dhe shumë ligje të tjera ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe, për të drejtat e kombeve bien poshtë. Edhe pse prej kohësh, dijetarin mbarëshqiptarë Koço Danën disa e quajtën leninistë e enveristë, por e tashmja dhe e ardhmja çdo ditë e më tepër po i konfirmon tezat e shëndosha të këtij dijetari. Disa analistë, librin e tij "Kryengritja e Pambaruar" e quajtën si libër të pavlerë dhe, kinse nuk po i përkitka realitetit, se në fakt kryengritjet shqiptare paskan mbaruar. Se kryengritjet çlirimtare shqiptare nuk kanë mbaruar e tregon fakti i mos realizmit të shtatë marrëveshjeve për kauzën shqiptare dhe, nën garanci të ndërkombëtarëve.

Meqë, tema jonë është për Kosovën Lindore, ne do të ndalemi në luftën e **UÇPMB-së**, Marrëveshjen e Konçulit dhe rrethanat e pas-marrëveshjes, pra të paqes. **Dihet mirëfilli se, në këtë rajon u bë një luftë me një fillim të paqartë. Disa dolën për të luftuar për të drejta, disa për ribashkimin natyral me Shqipërinë, e disa për shkaqe tjera ende të panjohura, por sidoqoftë rezultatet e asnjërin nuk u realizuan, apo nuk u jetësuan në jetën e tyre praktike.** Kjo luftë me finesa ende të paqarta u kurorëzua me Marrëveshjen e Konçulit. Shikuar, këtë marrëveshje me dioptrinë analizuese edhe sikur të realizohet në tërësi, prapë banorët e këtij rajoni tërësisht nuk do të ishin të kënaqur, sepse e drejta natyrore për tu ribashkuar me Shqipërinë u ndalohej.

Ne thamë që edhe sikur të realizohet kjo marrëveshje në tërësi, pala shqiptarë këtë do ta pranoje me zemër të thyer, por çfarë mundë të themi atëherë kur as 10% nuk është realizuar kjo marrëveshje. Pra, ne jo që mundë të themi, por jemi duke i përjetuar tmerret dhe torturat të cilat nuk rrjedhin as nga marrëveshjet mes kafshëve. Konflikti i armatosur serbo-shqiptar nuk solli asgjë tjetër përpos lindjen e disa partive politike të vogla në këtë rajon, desh harrova edhe një deputet në kuvendin e Serbisë, i cili është një hiç gjë, aq më pak kur bëhet fjalë për realizimin e të drejtave

të shqiptarëve që jetojnë në këtë rajon. Bilancin e përgjithshëm të suksesit Qeveria e Beogradit e finalizoi me sulmin barbar ndaj shqiptarëve të Kosovës Lindore. Mos të harrojmë se këta ish-ushtarë, nuk ishin vetëm pjesëtarë të **UÇK-së,** por edhe të **UÇPMB-së.** Ku mbeti ligji i amnestisë, ku mbeti ndëshkimi i kriminelëve serbë për krimet e kryera në Kosovë, në Preshevë dhe gjetiu? Apo ndoshta nuk ka kush t'i ndëshkoj! Fundja si është e mundur që të arrestuarit shqiptarë të ashtuquajturit "kriminel" pas nëntë vitesh të arrestohen dhe gjatë gjithë asaj kohe ata "kriminelët" të jetojnë në paqe dhe në luftë me varfrinë. Sepse, ne fare mirë e dimë se krimineli do mbetet i tillë, do të jetë i pasur, do ta vazhdon avazin kriminal në kohë paqeje me mjete tjera politike, sikurse kriminelet serbë që aktualisht gjenden nëpër kolltukët qeveritare.

Këta shqiptarë të pafajshëm, sikur të ishin kriminel me të vërtetë dhe t'u ngarkohej vepër penale reale, atëherë nuk do të jetonin nëpër shtëpitë e tyre të papunë, nuk do të rrinin me fytyra të pamaskuar, pra sikur të ishin kriminelë dhe terroristë do të vepronin ashtu sikur vepruan kriminelët e Ballkanit, Mlladiçi, Shesheli, Karaxhiçi, Milloshoviçi e shumë viça, kriminelë të tjerë të specializuar. Por kjo nuk ishte gjë tjetër përpos se një ushtrim i vazhdueshëm i dhunës ndaj shqiptarëve. Përpos maltretimit fizik, ky aksion në vete ngërthen edhe futjen frikë dhe panikë popullatës që jeton në këtë rajon (ashtu siç veprojnë organizatat terroriste). Ekzekutivi i Beogradit dëshiron të veproj, ashtu siç veproi me popullatën e Medvegjës, duke i shpërngulur masovikisht për në Kosovë dhe në mërgim. Është paradoksale që një komunë pothuajse e pastër me shqiptarë, të ketë të punësuar me shumicë serbë edhe atë në vende kyçe të punës.

Pra, lufta, Marrëveshja e Konçulit dhe paqja mbetën fare pa rezultate suksesive, banorët e Kosovës Lindore në vendin e vetë autokton janë shndërruar të huaj, me të drejta mjaftë minuara dhe shpeshherë të eksploduar dhe të eksploatuara në tërësi. Këta banorë i ngjajnë zogut i cili është i mbyllur në kafaz dhe

pandërprerë përmes këndimeve dhe cicërimë kërkon ndihmë, por ja që këtë këngë dhe gjuhë nuk ka kush ta kuptoj, apo bëhen kinse nuk e kuptojnë. Sidoqoftë populli shqiptarë në Kosovën Lindore vazhdon të torturohet, persekutohet dhe dëbohet. Ndaj, bashkohuni, o ju shqiptarë rreth litarit kombëtarë, në mënyrë që sllavit t'i përgjigjemi ashtu siç e meriton.

E martë, 13 Janar 2009

Aneksimi i gjymtyrëve dhe vuajtja e tërë trupit

Të flasësh dhe të shkruash për çështjen shqiptare, se si duhet të jetë, si dhe për pasojat nga të qenit ndryshe, për ndokënd ndoshta do të ishte vetëm një ëndërr dhe kinse nuk duhet harxhuar kohë për komentimin e këtyre ngjarjeve, ngase paska ikur treni i realizimit të ëndrrave. Fillimisht ne skeptikëve iu themi se, ajo fare nuk ka qenë ëndërr, porse ka qenë një realitet i dëshmuar. Sepse, edhe nëse nuk shkruajmë, nuk angazhohemi, në vazhdimësi jemi duke i përjetuar pasojat dhe dhimbjet në tërë trupin, për shkak të aneksimit të pesë gjymtyrëve dhe, mbetja e një gjysmë trupi jo aq funksional. Si është e mundur që të jetë trupi me jetë dhe funksional, pa i poseduar gjymtyrët që janë, dhe të cilët i takojnë natyrshmërisë së njeriut.

Kështu ndodhi me popullin shqiptarë, i cili qe një trup i shëndosh dhe funksional për ardhmërinë e vetë. Kuptohet, nuk e patën fatin e njëjtë të trajtimit të gjithë gjymtyrët e trupit shqiptar! Ndonjëra u dërmua më shumë, ndonjëra pak më pak krahasuar me të parën, por përgjithësisht esenca ishte dhe ngeli e njëjtë. Pra, dëbim, maltretim, persekutim, asimilim dhe gjithçka tjetër mizore. Shqiptarët kur i humbën këto gjymtyrë, u brengosën tej mase, si dhe tentativa e tyre ishte që me çdo kusht të kthehen në një shtet të përbashkët SHQIPTAR (ashtu siç duhej të jetë). Ndaj, në pamundësi për tu bashkuar (sepse vendosnin Fuqitë e Mëdha), detyrimisht u pajuan, por me kusht që gjymtyrët e saj të trajtoheshin ashtu siç duhet dhe tu jepeshin të drejtat e barabarta të cilët i

posedojnë, edhe bashkështetasit e tyre. Fatkeqësisht, asnjëra as tjetra nuk ndodhi!

Njëra prej pesë gjymtyrëve shqiptare quhet Çamëri, e cila gjeografikisht është e lokalizuar në veri-perëndim të Greqisë. Ky rajon i mrekullueshëm ka një trashëgimi të pastër të Shqipërisë dhe, prej vitit 1912 është aneksuar në mënyrë të pandershme (edhe pse aneksim të ndershëm nuk ka) dhe të pajustifikueshme nga Greqia. Ky aneksim ishte si rrjedhojë e vendimit të Fuqive të Mëdha për t'ia dhënë Çamërinë Greqisë.

Njëjtë, sikurse shqiptarët e Malit të Zi, të Kosovës Lindore, të Maqedonisë, si dhe të Kosovës. Gjithçka që jehon në Çamëri, është jehonë dhe tingull shqiptar. Çamët kanë etnitet, tradita dhe zakone të mirëfillta shqiptare. Në të kaluarën, kundrejt këtij popullit që kanë jetuar dhe jetojnë në Çamëri, është kryer gjenocid fizik dhe psikik, kurse tashmë për hir të imazhit ndërkombëtar, likuidimi dhe gjenocidi fizik nuk kryhen më, por tortura psikike dhe asimilimi vazhdojnë të zbatohet. Një pjese bukur e madhe kanë ikur për në Turqi, kurse pjesa shqiptarë (çame) e cila vazhdon akoma të qëndrojë në Çamëri nuk e posedon të drejtën e pronës, si dhe prej shumë të drejtave elementare janë të privuar. Ne shqiptarët që jetojmë, si gjymtyrë në vendin autokton tonin, shumë më lehtë dhe, më qartë do të arrijmë t'i kuptojmë brengat dhe tmerret që ndodhin në Çamëri...

Edhe pse ka shumë të flitet për veprimtarin dhe historikun e çamëve në Greqi, jo vetëm të flitet por edhe të punohet. Për momentin kursin e shkrimit tonë, do ta orientojmë në nxjerrjen dhe marrjen mësim nga një shtet demokratik, anëtare e NATO-së dhe e Bashkimit Evropian. Posaçërisht ky leksion vlen për Republikën e Maqedonisë, e cila përbëhet prej maqedonasve dhe shqiptarëve dhe nga etnitetet e tjera. Neve na mbetët të shtrojmë dilemë se, vallë Republika e Maqedonisë, do t'i plotësoj kriteret dhe të drejtat e etniteteve që jetojnë në këtë shtet, e posaçërisht të etnitetit shqiptar, para inkuadrimit të saj në NATO dhe BE, ose fillimisht do duhej të realizohej në tërësi Marrëveshjen e Ohrit

dhe, tek pastaj të inkuadrohemi në familjet e mëdha dhe progresive, apo kështu siç jemi me status ende të pazgjidhur, të integrohemi në familjet e mëdha?! *Ne kuptohet si familje e copëtuar dhe e vogël*. **Neve që jemi në prag të inkuadrimit për në NATO, duhet të marrim mësim nga çamët që jetojnë në Greqi, po ashtu duhet të marrim mësim edhe nga kurdët që jetojnë në Turqi.** Në bazë të këtyre dhe shumë rasteve tjera, për Republikën e Maqedonisë do të ishte më mirë që njëherë t'i plotësoj kushtet, tu jepen të drejtat e barabartë të gjithëve që jetojnë në këtë shtet, e tek pastaj inkuadrimi spontan do të vije dhe do të ishte i mirëseardhur, qoftë edhe pa dëshirën e dikujt.

Ndokush mendon se me inkuadrimin e shtetit në organizatën më të fuqishme të botës politiko-ushtarë të NATO-së dhe në bashkësinë gjigante shumëdimensionale të BE-së, do të rregullohen dhe do plotësohen të drejtat, bile vetvetiu! Por, rasti i çamëve dhe kurdëve po e demantojnë këtë optimizëm. Çamët në Greqi i ke me të drejta mjaftë të minuara, tashmë në shekullin XXI bëhet fjalë për hapjen e shkollave shqipe në Greqi, përkundër që i ke edhe rreth 300 mijë emigrantë të cilët u pushtuan nga vetë dëshira krahasuar me çamët. Po ashtu kurdët me 20 milionë banorë, i ke me të drejta mjaftë të cunguara që gjë u mohohej shumëçka, edhe njërës edhe tjetrës. Mos të harrojmë se, njëra është në NATO dhe BE, kurse tjetra është vetëm në NATO, ndoshta së shpejti mund të aderojë edhe në BE.

Pra, ne shqiptarët e Maqedonisë duhet menduar dhe analizuar mirë dhe, dëshirat e zjarrta për pranim të vendit në NATO dhe BE, paksa duhet frenuar. Minoritetet në Shqipëri dhe Kosovë do ishin të lumtur për këtë aderim, ngase të drejtat si komunitete pakicë i gëzojnë, ndoshta më shumë se shumica shqiptare. **Mosrealizimi i Marrëveshjes së Ohrit në tërësi dhe, inkuadrimi i Republikës së Maqedonisë në NATO, i ngjanë studentit i cili ka diplomuar në mjekësi pa e kryer lëndën e anatomisë.**

E hënë, 26 Janar 2009

Sërish vjen marsi

Nëse e pranojmë tezën se, nëntori është muaji i krenarisë shqiptare, atëherë çfarë mund të themi për muajin mars, ku dihet mirëfilli se po në këtë muaj filluan sulmet barbare të befasishme ndaj familjes Jashari në Drenicë, po në këtë muaj filloi lufta mes kryengritësve shqiptare dhe atyre maqedonas, po në këtë muaj filluan përgatitjet e kryengritësve shqiptarë kundër pushtuesve sllavë, po në këtë muaj filluan trazirat në Kosovë, të ashtuquajturat si trazira të marsit, si dhe në çdo vit para këtij muaji, këngëtari i shquar nga Kosova Ilir Shaqiri na paralajmëronte me këngën e tij, "*sërish vjen marsi*" për ndonjë konflikt të mundshëm, por edhe për një muaj, i cili për neve shqiptarëve na paralajmëronte që t'i hapim sytë katër e veshët tetë.

Kësisoj, ne shqiptarët kudo që gjendeshim, me ardhjen e këtij muaji nuk ndjeheshim mirë, na pushtonte një ndjejnë pesimizmi, përkundër që në mes të muajit mars fillon pranvera, lulet fillojnë të na kënaqin me aromën e tyre, zëri i bilbilit na rehabiliton trurin tonë të ngarkuar nga stresi i stinëve tjera, si dhe shumëçka tjetër në dobi të shëndetit dhe jetës sonë. Por, ne shqiptarët jo gjithherë kemi mundur t'i shijojmë begatitë e pranverës, ngase në vend të aromave të luleve, e kemi nuhatur aromën e barotit, në vend të zërit të këndshëm të bilbilit i kemi dëgjuar zhurmat trishtuese të tankeve, topave dhe fjalëve ndjellakeqe të njerëzve, si dhe shumëçka tjetër në dëm të shëndetit dhe jetës sonë.

Ne si popull shqiptarë, nuk jemi edhe aq të prirë të besojmë në besëtytni. Me këtë titull nuk dëshirojmë të ndjellim kob ndër njerëzit, sikurse me ardhjen e muajit nëntor që nuk dëshiruam të ndjellim kënaqësi dhe, shpresë për të ardhmen dhe

fatin tonë. Ne besojmë dhe mbështetemi në rrjedhat e kaluara dhe të tashme të popullit shqiptarë dhe, tek pastaj mund të vijmë në përfundim për muajt progresiv apo regresiv në vijim. Sepse, popujt përtacë, si arsyetim të neglizhencës së tyre janë të prirë për nga natyra të besojnë më shumë në besëtytni, sesa në rezultatet nga puna reale e tyre. Askush nuk mund ta arsyetojë dështimin e zgjedhjeve me 22, mars (dashtë Zoti të mos dështojnë), vetëm se ky muaj, kinse për shqiptarët qenka "muaj ogurzi". Të mos harrojmë, zgjedhje fatale patëm në muajin qershor, pra ky nuk ishte ndonjë muaj karakteristik për shqiptarët, edhe pse për nga ndodhitë nuk mund të themi se nuk ishte i tillë.

Pra, zgjedhjet do të vijnë, do të vjen sërish pranvera, por vallë bashkë me fillimin e pranverës, a do të fillojnë të lulëzojnë edhe të drejtat tona natyrore? Në këtë ditë vallë do të votojmë nën tytën e njësitit special "Alfa" dhe, pastaj të flasim për zgjedhje korrekte, demokratike dhe të lira! Athua vallë pas këtyre zgjedhjeve do të kemi zgjidhje, apo kjo do të jetë vetëm një rutinë votimesh sikur çdoherë! Padyshim që do të jetë një rutinë e radhës, sepse në spektrin politik shqiptarë luhet e njëjta lojë, me të njëjtët lojtarë, për dallim prej herëve tjera, disa lojtarë në mozaikun politik i kanë ndërruar numrat dhe petkat, por loja luhet prapë në të njëjtin stadium. Nëpër ndeja të odave (sepse ende zyrtarisht nuk ka filluar fushata) na paraqiten njerëz, të cilët me vite të tëra u pasuruan në maksimum, me vite të tëra mashtruan popullin, si dhe me vite të tëra vetëm llomotitën duke mos punuar asgjë.

Paradoksi tjetër i radhës qëndron tek intelektualët, të cilët para këtyre njerëzve qëndrojnë gatitu dhe ende pa e mbaruar fjalën të vetëquajturit intelektual, ia konfirmojnë dhe afirmojnë fjalinë si të saktë. Sigurisht që edhe psikologu i shquar botëror Frojdi, këtë psikologji oportuniste nuk do të mundte ta deshifronte. Si është e mundur, nga viti në vit të mashtrohemi, zhgënjehemi, dhe prapë para këtyre qëndrojmë gatitu, gojëmbyllur, verbërisht i besojmë dhe, mendojmë se me të vërtet në këtë

mandat do të ketë zgjidhje të problemeve. Zgjedhjet janë një rast i mirë për popullin që përfaqësuesve të tyre t'ia thonë atë që duhet t'i thuhet.

Epërsinë diplomatike të vetme politikanët tanë, e kanë mashtrimin e popullit para zgjedhjeve, dhe pas zgjedhjeve fillon shfaqja e epërsisë së dytë diplomatike, me mbulimin dhe arsyetimin e fjalëve dhe frazave të premtuara para fushatës zgjedhore. Pra, në mënyrë të tërthortë na thonë; "se në atë kohë kur na premtuan ishte një erë mjaftë e fortë, dhe të gjitha premtimet çka i kishin dhënë i kishte marrë era".

Mos të harrojmë se edhe populli ynë e posedon një epërsi profesionale të vlerësimit, por e meta qëndron në atë se, këtë epërsi profesionale populli ynë e vë në funksion në kohë të gabuar. Ndjenjën e vlerësimit të drejtë e posedon menjëherë pas zgjedhjeve, por i gjori popull posa të përfundoj mandati i të zgjedhurit, ndjenja e vlerësimit të drejtë disi i fillon t'i zbehet, pra ndjenja dhe ndërgjegjja e këtij populli mjaft të ndërgjegjshëm, por naiv manifestohet në kohëra të gabuara, vlerësimi bëhet, atëherë kur nuk ka vlerë, dhe atëherë kur duhet me të vërtet të bëhet vlerësimi një gjë të tillë populli ynë nuk e bënë. Ky popull ende fatkeqësisht po vuan nga sindroma e kontradiktores! Juve politikan, ju "lumtë" për mashtrimin afatgjatë të popullit me mendime afatshkurtra, ju bëftë mirë nektari i pranverës, sepse për juve edhe nëse nuk do kemi zgjedhje demokratike, edhe nëse bie viktimë ndokush e ai *ndokush* si çdoherë është shqiptarë, edhe nëse nga shkaku i parregullsive zgjedhore nuk do të mundim të aderojmë për në BE, për ju mjafton që keni pasaporta diplomatike dhe, të shkoni e shëtiteni sa herë që doni në Evropë, Amerike e gjetiu, për ju nuk është me rëndësi sa a do të kemi zgjedhje të drejta, e të lira, sepse ju nuk do të pësoni, por ne populli me traditë viktimizuese do të viktimizohemi në vazhdimësi.

Këtë shkrim po e përmbyllim me tri thënie të urta (njëra profetike); "**Çdo popull duhet të ketë fuqinë dhe mençurinë, nëse i ka të dyja lum për atë popull, nëse e ka vetëm njërën,**

jeton disi, nëse nuk e ka asnjërën, mjerë për atë popull" *(popullore).*

"**Politika është shkathtësi, të merren nga të pasurit paratë, e nga të varfërit votat, me motiv se do t'i mbrosh nga njëri tjetri**" *(Perpiti).* "**Dy kategori njerëzish, nëse janë të mirë, edhe populli do të jetë i mirë, por nëse janë të degjeneruar edhe populli do të jetë i tillë. Ata janë dijetarët dhe pushtetarët**".*(profeti Muhammed).*

E hënë, 02
Mars 2009

(Këtë ese, e kemi punuar së bashku me mikun tim, Ardian Ramadani)

Presidenti i mundshëm shqiptarë dhe Obama

Zgjedhja e Barak Obamës, për kryetar të shtetit më të fuqishëm të botës, zgjoi interesim tek studiuesit e fushave të ndryshme. Disa e quajtën këtë akt, si thyerje praktike e ideologjisë raciste, disa të tjerë këtë rast e cilësuan si vend i mundësive për të gjithë, gjë që këtë virtyt mundë ta kenë vetëm, vendet me demokraci të mirëfilltë! Analizat e shumë analistëve për personalitetin e Obamës dhe vendosjen e tij, në krye të shtetit, ishin tejet me vend. Sepse një afro-amerikan të vendoset në kulm të shtetit, është me të vërtetë dëshmi e vendit/shtetit për vendosjen e njeriut mbi baza të diturisë, kualifikimit dhe përshtatjes!

Por, disa analistë dhe opinionistë shqiptarë gabuan rëndë, atëherë kur e krahasuan si një rast të njëjtë, vendosjen e Barak Obamës në timonin e shtetit të Amerikës dhe vendosjen e presidentit të mundshëm shqiptarë në timonin e shtetit të Maqedonisë. Ku është dallimi ndërmjet, Barak Obamës si kryetar i Amerikës dhe presidentit shqiptar të mundshëm si kryetar i Republikës së Maqedonisë?

Prejardhja e Barak Obamës, siç jemi të njohur të gjithë, është prej Afrike (made in Afrika). Pa më të voglin dyshim personi në fjalë, fare pa problem u integrua dhe shoqërizua në shoqërinë amerikane. Si në aspektin kombëtar dhe atë fetar Obama është renegat! Barak Obama, tërësisht i pranoi rregullat e shtetit ku jetoj. Asnjëherë në fëmijëri dhe gjatë jetës së tij nuk e recitoi, poezinë me titull, "Jam krenar që jam afrikan", por me mburrje të madhe e recitoi poezinë dhe e këndoj këngën, "Jam

krenarë që jam amerikan". Pra, tërësisht dhe me vullnet i pranoi doket, zakonet dhe përgjithësisht vlerat e popullit amerikan.

Tani të kthehemi pak te personalitetet e kandidatëve shqiptarë për kryetarë të mundshëm në shtetin e Maqedonisë! Agron Buxhaku, Mirushe Hoxha dhe Imer Selmani të gjithë këta, janë me prejardhje shqiptare, momentalisht janë shqiptarë, të gjithë këta kanë lindur myslimanë, momentalisht janë myslimanë, të gjithë këta me ëndje të madhe e recitojnë poezinë, "Jam krenar që jam shqiptar", gjeneza e këtyre në këtë vend, është prej atëherë kur Zoti, e bëri fushën fushë, e malin mal, pra asnjëri prej tyre, në asnjë aspekt nuk është renegat. Nëse Barak Obamën e quajnë, afro-amerikan, këta të lartcekurit, lirshëm mundë t'i quajmë shqiptarë të pastër, autokton në vendin e tyre gjeografik. Rasti i Obamës, dukshëm dallon prej presidentit të mundshëm shqiptar. **Ata që trumbetojnë dhe, pyesin për zgjedhjen e kryetarit shqiptarë në Maqedoni sikurse, i Obamës në Amerikë, na nënçmojnë rëndë përgjithësisht neve shqiptarëve ku do që jemi. Neve nuk duhet të na habisë, zgjedhja e një shqiptari për kryetarë të shtetit, është normale, jemi në vendin tonë autokton, i kemi vlerat tona të cilët kanë lindur, nga ky vend ku jemi edhe sot, ndoshta atëherë kur edhe gjeneza e Gruevskit nuk ekzistonte.** Rasti i Obamës dhe "Koha e Obamës" mundë të cilësohet si e njëjtë, atëherë kur një shqiptar, i cili aktualisht jeton dhe vepron në Turqi, por me prejardhje nga Kumanova apo Tetova dhe personi në fjalë (njeriu me prejardhje shqiptare) pas një kohe të gjatë bëhet kryetarë në Turqi, pra tani personi në fjalë (kryetari) lirshëm mund të quhet, shqiptaro-turk. Për këtë rast nuk mundë të themi se nuk është i ngjashëm me rastin e Obamës. Pra, ju të nderuar që u gëzuat me rastin e zgjedhjes së Barak Obamës për president të Amerikës, edhe atë vetëm që t'i tregoni palës maqedonase, se edhe ne si shqiptarë kemi të drejtë të veprojmë sikurse amerikanët me prejardhje afrikane, ju realisht i dhatë vetëm një shkas që ata të luajnë dhe dyshojnë në vazhdimësi në identitetin tonë kombëtarë, i cili është

i qartë dhe i pastër si loti. Dallimi është në prejardhje, pranim absolut të vlerave të vendit ku jeton dhe punon, presidenti në fjalë autokton dhe virtyt autentik prej gjenezës i ka mbetur vetëm ngjyra e lëkurës, kurse ne shqiptarët, gjithçka është e jona, duke filluar prej gjeneve e deri tek fizionomia e jashtme, të gjithë virtytet i kemi dhe i përkasin shqiptarisë. Pra, ky ishte një sqarim modest dhe i shkurtër mbi mos ngjashmërinë e presidentit Barak Obama në Amerikë dhe presidentit shqiptar në Maqedoni.

E hënë, 16 Mars 2009

Vë bast për ardhmërinë

Shumica e njerëzve në ditën e votimit, i realizuan dy vepra të cilat kryesisht kishin të bëjnë me ardhmërinë e tyre. Menjëherë pas votimit, disa njerëz shkuan në bastore (objekte ku prognozohen lojëra të ndryshme, duke u mbështetur në fat) dhe vënë bast për disa ekipe futbollistike, besa disa kishin vënë bast edhe për mundje qenesh.

Mua personalisht ky rast jo i rastësishëm më bëri kureshtarë, fillova të mendoj më ndryshe për partitë politike dhe ngjasimin e tyre me bastoret.

Ata të cilët votuan dhe menjëherë pas këtij akti shkuan për të vërë bast, njëkohësisht e luajtën rolin e një votuesi dhe të një bixhozçiu. Ne këtu nuk do të ndalemi, sepse ky fenomen (votues/bixhozçi) nuk ishte i rastësishëm. Për ta shtjelluar temën tonë më mirë dhe më qartë, paraprakisht duhet të pyesim, pse vallë menjëherë pas votimit këta votues shkuan e vënë bast? *Apo prej bastit shkuan në bast*! Edhe pse, unë asnjërin prej tyre nuk e pyeta për këtë dukuri të njëpasnjëshme, vetë veprimtaria e tyre analogjike tregoi se votimi për partitë politike dhe shkuarja menjëherë në bastore sinjalizon ngjashmërinë ndërmjet tyre.

Në esencë partitë politike nuk janë të pista, ashtu si ne mendojmë, sepse para se gjithash përmes tyre realizohen shumë qëllime dhe projekte në dobi të shoqërisë. Ndërsa, dihet mirëfilli i lojërave të fatit, historikisht janë dëshmuar si virus vdekjeprurës për shoqërinë, i kanë sjellë shumë dëme shoqërisë dhe, në vazhdimësi një gjë të tillë janë duke e bërë. Por, fatkeqësisht realiteti i përditshëm po na tregon se institucionet e partive

politike dhe institucionet e lojërave të fatit në shumë pika po përputhen!

Është realitet i dëshmuar se në lojëra të fatit, shumë njerëz marrin pjesë dhe një pjesë tepër e madhe investon pak për të fituar shumë, por pjesa më e vogël, elita klanore e shoqërisë e merr shumën e tubuar nga të vegjlit me investime të pakta.

I njëjti rast fatkeqësisht po ndodh edhe me partitë politike, një grup i madh njerëzisht po investojnë në partitë politike, por thithjen e gjithë këtyre të mirave po e bënë një grup aristokratësh, grup jo edhe aq i madh, por influencues. Ata që votojnë në shtetet ballkanike, me votën e tyre investojnë në një të ardhme mjaftë të pasiguritë si dhe pa një analizë paraprake. Ata që investojnë (duke prognozuar) duke vërë bast me paratë e tyre në dilema lojërash, probabiliteti rreth fitimit (bingos) është mjaftë i ulët si dhe mungon një analizë paraprake rreth çështjes në fjalë. Edhe pse, paraprakisht dihet dhe ndodhë një zhgënjim për mos zgjedhjen e partisë efikase për të ardhmen, pasojat mbeten të përjetohen me tendencë që në të ardhmen të eliminohen. Bixhozçiu pasi t'i humbë parat, në vetvete ndjenë një zhgënjim për gabimet e bëra gjatë përcaktimit të bastit për preferencat e ndonjë ekipi të caktuar, pra edhe këtu pasojat mbetën të përjetohen, me shpresa për ditë më të mira!

Është i çuditshëm fakti në vendin tonë, për hir të partive politike shumë miq dhe dashamirë i acaruan marrëdhëniet, lidhjet farefisnore i ndërprenë dhe kur një ditë papritmas i sheh duke bërë koalicion partitë të cilët dikur ishin në një armiqësi të përbetuar. Pastaj fytyrat e militantëve ekstremist fillojnë t'i ndërrojnë ngjyrat, më shpejtë se semaforët. Partitë politike dhe liderët shumë shpejtë i harrojnë të kaluarat e tyre armiqësore. Pse vallë fyerjet, vrasjet dhe shumë maskarallëqe tjera i harrojnë aq shpejtë? Dihet. Qysh në fillim ka ekzistuar një armiqësi false ndërmjet liderëve. Por, simpatizantët një gjë të tillë nuk arritën dot ta kuptojnë dhe përfunduan në fiasko. Për këtë arsye partitë politike qenkan bërë sikurse lojërat e fatit! Asgjë

origjinal nuk paskan, përpos militantëve. Njëjtë sikurse pronarët e lojërave të fatit, gjithçka falsë, përpos bastvënësve (injorantëve).

Kuptohet, pas shumë peripecive të shumta, përfundimi nga lojërat e fatit është dhe do mbetet gjithmonë fatalitet. Shumë miq dhe dashamirë u prishën nga shkaku se njëri tjetrin nuk e dëgjuan se cilës ekip duhet t'i jepet fitore, cilës barazi, e cilës penalti. Mjaftë qartë historia psikologjike e njeriut na tregon se, kur dikush humbë (e dihet humbja është mjaftë e madhe dhe e rëndë) nga bixhozi, të gjithë njerëzit përreth, bixhozçiut i duken fajtor. Pastaj një ditë, befasisht i sheh bosët duke ngre dolli dhe duke kaluar një jetë super-luksoze nga parat e naivëve të cilën tërë rrogën dhe jetën e tyre e harxhuan duke shpresuar në ditën e artë të jetës së tyre. Por, ata harruan dhe gabuan rëndë, atëherë kur e pritën ditën e artë duke mos punuar konkretisht asgjë, e kjo do të thotë, **ta gjuash pështymën në drejtim të kundërt të erës**.

Pra, ju të nderuar votues dhe bastvënës, merrni mësim nga fataliteti i mëparshëm i institucioneve të lojërave të fatit dhe i institucioneve të partive politike. Mos e shndërroni votën tuaj në bast, mos e lejoni që vota juaj t'i ngjajë etiketave të bastorëve, sepse dihet mirëfilli, investimi në diçka mjaftë të pasiguritë duke ndenjur, duke shpresuar në fat, njerëzisht është e ndaluar, po ashtu nëse votën tuaj e shndërroni në tiketë bastore, para se gjithash keni shkelur mbi kodin etik të njeriut. Para se të votoni mendoni dhe analizoni mirë se për kënd po votoni, për çka po votoni dhe në vazhdimësi me sinqeritet punoni për votën tuaj, e nëse kështu veprohet, atëherë vota juaj nuk do t'i ngjajë tiketës së lojërave të fatit.

E hënë, 30 Mars 2009

Urime Shqipëri, ngushëllime Maqedoni

NATO - është organizata më e madhe dhe më e fuqishme politike-ushtarake në tërë globin tokësor. Veprimtaria e saj parimore legjitimohet me parimet e Kartës së OKB-së dhe me parimet e demokracive më të dëshmuara të botës.

Roli dhe ndikimi i NATO-s në Ballkan nuk është i ri, apo nuk u manifestua për herë të parë para një viti, as pas një viti, por zgjerimi i kësaj Aleance në Ballkan filloi me pranimin e Greqisë dhe Turqisë, në vitin 1952. Pastaj sfidat e para serioze të kësaj organizate gjigante, në Ballkan ishin krizat e ish-Jugosllavisë, kriza të cilat kishin filluar disa vite pas vdekjes së Titos. Këto kriza të natyrave të ndryshme që ndodhën në ish-Jugosllavi, ishin edhe si rrjedhojë e shpërbërjes së Bashkimit Sovjetik. Kriza e përgjithshme dhe mjaftë shqetësuese, filloi më vitin 1991 me rastin e shkëputjes së Sllovenisë, Kroacisë dhe Maqedonisë. Pastaj vijoi me krizën e Bosnje-Hercegovinës. Ish-Jugosllavia ende mirë pa i shëruar plagët, filloi sulmet barbare dhe gjenocidiale ndaj popullatës shqiptare në Kosovë, i cili konflikt kulmoi në vitin 1999, me ndërhyrjen e NATO-s me mjete ushtarake, për dallim prej Bosnje-Hercegovinës, ku kjo organizata për parandalimin dhe administrimin e konfliktit ndërhyri duke përdorur vetëm mjete politike.

Rasti i ndërhyrjes dhe i goditjes ushtarake të NATO-s mbi Serbinë është i pari në historinë e Aleancës që veproi dhe ndërhyri ushtarakisht jashtë zonës së saj, e cili prej kohësh me rregullore ka intervenuar vetëm në zonat e sigurisë Euroatlantike.

Në kohën, kur NATO sulmonte ushtarakisht Serbinë, Shqipëria de fakto sillej, paraqitej e vepronte sikur të ishte një vend anëtare e

NATO-s. Me këtë sjellje Shqipëria dëshmoi se, ajo është e gatshme dhe e sigurt që një ditë, edhe atë shumë shpejtë do t'i bashkëngjitet këtij organizmi gjigant, po ashtu me këtë akt Shqipëria dëshmoi dhe tregoi se ajo dinë të brengoset për vëllezërit e saj andej kufirit. Qysh prej krijimit si shtet, Shqipëria u përballë me shumë vështirësi, por sfida e cila në vazhdimësi Shqipërinë e sfidoi ishte krijimi i aleancave të rrejshme, sytë e saj i kishte të drejtuar tmerrësisht kah lindja (Bashkimi Sovjetik, Jugosllavi, Kinë, etj.,) pastaj mendjen dhe sytë i kishte ngulitur në vetëizolim, duke mos shikuar për një kohë të gjatë kah perëndimi dhe ShBA-ja. Por, menjëherë pas shpërbërjes së sistemit komunist, Shqipëria u bë më properëndimorja, më pro ShBA-ja në tërë Ballkanin.

Me një intensitet të madh dhe të palodhshëm të punës, Shqipëria punoi për inkuadrimin e vendit në NATO dhe UE. Përskaj shumë turbulencave dhe peripecive që ndodhën në Shqipëri në dekadën e fundit, Shqipëria dhe shqiptaret ku do që janë, më 4 prill të vitit 2009 u bë anëtare e plotë e NATO-s, iu bashkëngjitë organizmit më gjigantë të botës, tashmë lirshëm mundë të themi se, Shqipëria është e barabartë ushtarakisht me çdo shtet të fortë, që dikur shteti shqiptar edhe në ëndërr u frikësonte ta shihte rivalitetin ushtarak me shtetet e fuqishme. Shqipëria jo vetëm në aspektin e sigurisë gjenden në epërsi, por edhe në atë politiko-ekonomik. Tashmë investitorë të jashtëm mund lirshëm të investojnë në Shqipëri, fal Zotit edhe në aspektin e resurseve natyrore është tejet mirë, turizmi sa vjen e rritet dhe perfeksionohet në këtë shtet. Kuptohet, inkuadrimi i Shqipërisë në NATO, nuk është zgjidhje e problemeve në mënyrë magjike, çështja e krimit ekonomik mbetet në qendër të vëmendjes, pra edhe kjo është një e arritur ndoshta jo aq e madhe, por duhet kujtuar që dikur për këtë fenomen shkatërrues as që është folur (të paktën tash është vënë në rendë të ditës kjo temë). Të mos harrojmë se, integrimi i një shteti në NATO do të thotë: *pastrim dhe qartësim i rrugës për në Bashkimin Evropian.*

Sepse, njëri prej standardëve mjaftë të rëndësishme që një vend të integrohen në UE, është edhe çështja e sigurisë kombëtare, e pra si mundë të jetë siguria e brendshme e një shtetit i cili është anëtarë i NATO-s?!

Kuptohet, ekzistojnë kushte dhe parime që një shtet të bëhet anëtare e NATO-s, do të thotë: Shqipëria shumicën e kushteve i ka plotësuar (pa hyrë në detajet rreth plotësimit të kushteve), me identitet kombëtare fare nuk ka problem, me trazira dhe konflikte ndëretnike po ashtu fare nuk ka problem dhe, falë kësaj shkëlqesie, ajo sot është në NATO! Urime Shqipëri dhe shqiptarë inkuadrimi në NATO, më falni shqiptarë që jetoni në tokën e juaj shekullore, e që momentalisht jetoni në Maqedoni, një shtet i cili u krijua përkohësisht dhe artificialisht në periudhën e Titos, e që ende mbahet si i tillë. Për hir të një emri dhe marrëdhënieve jo të mira ndëretnike, sidomos diskriminimi i shqiptarëve në çdo cep të jetës, sot dhe ndoshta në vazhdimësi NATO-n, Maqedonia do ta shoh si një utopi, si një fenomen të paarritshëm, apo si një leksion të pakapshëm. Asnjëherë nuk kemi besuar që fjala e Bush-it, do të mposhtet, aq më pak në samitin e Bukureshtit. Dështimi i Maqedonisë në këtë samit, më qartë dhe më kuptimplotë mund të lexohet ndërmjet rreshtave. Deshifrimi i këtij shifrimi, nuk mund të mos jetë ndryshe, pos marrje e gjithsecilit të saj që natyrshëm i takon.

Pra, urime Shqipëri, ngushëllime Maqedoni, mos u mërzit të gjithë kësaj rruge jemi duke shkuar, përpos juve!

E hënë, 06 Prill 2009

Maqedonia ndërmjet të kaluarës dhe të "shkuarës"

Lexuesi i këtij teksti, në shikim të parë, ndoshta do të mendoj se është bërë ndonjë gabim gjuhësorë nga pakujdesia e autorit. Sepse, titulli i shëndosh gjuhësore, do të duhej të jetë, "*Maqedoni ndërmjet të kaluarës dhe të ardhmes*". Unë do të pajtohem me këtë titull, atëherë kur Republika e Maqedonisë do t'ia filloj ta shikon të tashmen dhe të ardhmen ashtu siç duhet, pra për qëllime gjallëruese dhe integruese. Aktualisht, kursi i përgjithshëm në këtë shtet, është i orientuar dukshëm drejt të kaluarës dhe si rrjedhojë e këtij kursi, tashmë do të kemi qytetarë që i përkasin, "vetëm të kaluarës", qytetarët tashmë detyrimisht duhet të mendojnë vetëm mbi të kaluarën e Maqedonisë, në mënyrë që sa më shumë të tubojnë argumente mbi vërtetësinë e identitetit kombëtare maqedonas. Fushëbetejë e vërtetë intelektuale për autenticitetin e popullit maqedonas.

Qeveria i ka mobilizuar dhe angazhuar shumë piktorë, skulptorë, historianë, linguistikë, etj., vetëm e vetëm që t'i bindë fqinjët e saj për rreth, se ky shtet ka një histori mjaftë të begatshme, bile më të pasur se të Egjiptit. Kryeministri i Maqedonisë, edhe pse është i diplomuar në ekonomi, aktualisht e luan rolin e një historiani mjaftë të "devotshëm" dhe, në mënyrë tmerruese është i indoktrinuar pas tezave kinse të vërteta historike, e që në vazhdimësi dhe në mënyrë ekstreme është duke i dhënë përparësi ngjarjeve historike dhe "heronjve maqedonas" (në mënyrë të hapur është duke i anashkaluar çështjet ekonomike).

Edhe pse kryeministri në fjalë, duke dashur që etnisë së tij t'ia mbrojë dhe promovojë identitetin kombëtarë maqedonas, në

realitet ai është duke i dëmtuar në shumë aspekte. Pavarësisht kostos ekonomike, kryeministri dhe përkrahësit e tij kanë vendosur që, ngjarjet historike dhe të bëmat kinse madhore t'i faktorizojnë brenda dhe jashtë vendit, qofshin edhe të pavërteta dhe të dikujt tjetër këto të kaluara. Por pse pikërisht tash, të gjitha problemet dhe kontestet Qeveria i ka institucionalizuar, në kohën kur, ardhmëria e Maqedonisë në mënyrë pothuajse absolute varet prej qëndrimeve të Greqisë!? Shumë qartë; e huaja, asnjëherë nuk mundë të bëhet e jotja! E pra, pronësomi i ndonjë gjëje që natyrshëm nuk të takon e ka koston e vet, besa edhe veprimtaria manipuluese nuk mundë të mos jetë prezent.

Nëse me këtë emër "Maqedoni" tentohet të begatohet historia e maqedonasve, nga shkaku se dikur në një pjesë të Greqisë së vjetër, kishin ndodhur ngjarje madhore, atëherë ky shtet gabon rëndë, si dhe e ardhmja e këtij shteti në vazhdimësi do të varej prej të kaluarës së atij territori. Unë mund ta kem emrin Ronaldo, por nuk mundë të luaj si ai futboll. Pra, emri nuk qenka gjenerator i suksesit! Nëse nuk hiqet dorë nga kjo doktrinë, atëherë kjo e kaluar dhe heronjtë e kësaj të kaluare, Maqedoninë do ta përplasin në vagonin e trenit të fundit dhe si e tillë do të mbetet përgjithmonë.

Mos të habitemi, nëse një ditë dëgjojmë nga kryeministri Nikolla Gruevski, se edhe Nikolla Tesla ka qenë maqedonas i kësaj Maqedonie, sepse emrin e paska pasur sikurse të kryeministrit aktual të Maqedonisë. Sepse tashmë, Nënën Terezë, Aleksandërin e Madh dhe shumë personalitete të shquara shqiptare i pronësuan, apo tentojnë në vazhdimësi që një gjë të tillë ta bëjnë. Përpos që ky shtet kontestohet për emrin nga Greqia, patjetër dhe në mënyrë urgjente duhet të kontestohet, edhe nga ne shqiptarët për tjetërsimin e paligjshëm të shumë figurave kombëtare shqiptare. Nëse vazhdohet me këtë ritëm vjedhjesh, jo që ky shtet do ta harron NATO-n dhe UE-në, por ky shtet do të pagëzohet me emrin, "Republika Hajdute". Ndoshta pastaj, me këtë emër adekuat, emër i cili do të përputhej me vet veprimtarinë e shtetit, do ta

ketë më lehtë për shumë çështje. Të mos keqkuptohemi, ky shtet, nuk është ekspert vetëm për çështje pronësore të emrave dhe ngjarjeve historike, por edhe në aspektin e tjetërsimit të truallit nuk është keq. Jemi dëshmitarë okularë mbi ndërtimin e kryqeve, kishave e filarmonisë në truallin tonë (ne jemi trashëgimtarë legjitim të atyre parcelave), e ky ndërtim bëhet, edhe nga taksapaguesit shqiptarë?! Pse të mos i jepet Shkupit, pamje tërësisht sllavo-ortodokse?! Paradoksi tjetër është se, të gjitha partitë politike shqiptare heshtin përballë këtyre krimeve kulturore! Ne qytetarët shqiptarë të këtij shteti, brengosemi për këtë veprimtari mjaft alogjike. Sepse edhe ne, në vazhdimësi po i përjetojmë pasojat nga të qenit jashtë NATO-s dhe UE-së. Ne, për hir të një emri që asgjë nuk ka të përbashkët me shqiptarët, do të ngelim, ndoshta me shekuj jashtë këtyre organizatave të mëdha botërore, edhe pse për mos inkuadrimin nëpër këto organizata, nuk është problem vetëm emri.

Ndonëse të gjitha çështjet brenda shtetërore qenkan në rregull! Përpos emrit, Maqedonia ka problem me realizmin e tërësishëm të Marrëveshjes së Ohrit, infrastruktura rrugore në rajonet shqiptare, me të vërtet do ta magjepsë popullin afrikan, korrupsioni dhe evazioni fiskal në masë të madhe është prezent në këtë shtet, si dhe një mal problemesh tjera. Nëse hyjmë në analizë më të thellë, do të shohim se problemi nuk qenka vetëm tek emri, siç dëshirojnë disa ta paraqesin, por problemi qenka tek fshehja e problemeve para faktorit ndërkombëtar. Por, mos të harrojmë se, shumë shpejtë mbeturinat e këtij vendit të cilat aktualisht janë të fshehura, do të dalin në pah, kuptohet nga aroma e tyre e qelbur. Si shërues dhe asgjësues i të gjitha këtyre anomalive, referendumi do të ishte i mirëseardhur. Sepse, demokracia e mirëfilltë funksionon mbi baza të vendosjes së popullit për popullin në popull. Ura lidhëse e gjitha këtyre instruksioneve është ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori! Pra, diagnoza e problemeve është e zbuluar, pritet vetëm intervenimi i kirurgut, e kirurgu absolut tash pas zgjedhjeve padyshim që është, kryeministri Nikolla Gruevski. Por,

neglizhenca dhe indiferenca e qëllimshme e tij ndaj problemeve të shumta, të vënë në një labirint të çuditshëm dhe pa alternativa.

E enjte, 23 Prill 2009

Në ç'farë Maqedonie do jetojmë? Apo...

Llamba e së kaluarës ndriçon të tanishmen (Edith Durham). Plotësisht duhet të pajtohemi me thënien e kësaj gruaje të mençur, sepse realiteti është ashtu. Por, ndodhë që ndonjëherë ne qytetarët e Maqedonisë, nuk pajtohemi me plotë thënie të dijetarëve vendorë e botërorë. Ne nuk pajtohemi, ngase e kaluara dhe e tanishmja në këtë vend na ka imponuar një mospajtim të tillë!

Maksima në fjalë në shtetin tonë, praktikisht bie poshtë! Ngase, çuditërisht llamba e së kaluarës në vendin tonë e errësoi dhe e ngulfati të tanishmen. Ndoshta këtë llambë, që prej fillimit kishin harruar qëllimisht ta ndezin dhe në vazhdimësi dhe llamba në fjalë prodhoi vetëm terr, si dhe ardhmërinë e këtij shteti e vendoj në një turbullirë, ku në brendësi të kësaj turbullire mund të shohin vetëm dy kategori njerëzisht, ata të moralshmit dhe të mençurit. Nga turbullirat e së kaluarës, qartë shihet vendosja ekstreme e shtetit mbi baza etnike maqedonase si dhe diskriminimi i të gjithë komuniteteve (përpos atij maqedonas) në çdo segment të jetës. Në këtë rast, maqedonasit me vetëdije të plotë e ndezën një zjarr për ngrohje, ku etnitetin shqiptarë dhe etnitë tjera, i lanë në mëshirë të acarit të madh, i cili acar qe mjaftë i pamëshirshëm ndaj këtyre etniteteve. Vitet sa vinin e shkonin, njëkohësisht me vajtje-ardhjen e viteve u rritke zjarri, kur një ditë papritmas dëgjuam se maqedonasit u djegën nga zjarri i vetëndezur. Maqedonasit, u djegën nga shkaku se madhësia e zjarrit, i cili qe për ngrohje, ishte i dedikuar për të gjithë komunitetet që jetojnë apo pranuan të jetojnë në Maqedoni. Teprica e zjarrit i dogji!

Ajo e cila realisht na habiti, ishte mos marrja mësim nga e kaluara e hidhur. Ndonëse, nuk i mjaftoi paralajmërimi i zjarrit, i cili qartë i tha mos luani me zjarr se digjeni. Kryeneçësia e tyre

ishte statike dhe me po të njëjtin avaz vazhduan veprimtarin e tyre të fëlliqur.

Të gjithë presidentët e këtij shteti ishin pa legjitimitetin e shqiptarëve, të gjithë këta punuan haptas kundër shqiptarëve, të gjitha problemet madhore shtetërore kinse i zgjidhnin vetë duke mos e inkuadruar fare kuadrin intelektual dhe politik shqiptar. Gjuha shqipe në këtë shtet mbeti vetëm në poezi, si gjuhë e ëmbël e dëlirë e pasur, por asnjëherë e lirë për përdorim, në vazhdimësi në organizimet kinse shkencore nuk lanë fjalë fyese që nuk na sajuan, na thanë e ç'na thanë, por prapë mëshira jonë tejet e madhe i gllabërojë, edhe këto maskarallëqe të radhës.

Pavarësisht të kaluarës së zymtë dhe llambës errësuese, ne shqiptarët detyrimisht u munduam ta harrojmë të kaluarën, duke harruar kështu se, çka duhet të harrohet e çka duhet mbajtur në mend. **Ne pra, vendosëm t'i harrojmë brengat të cilët sillnin vetëm mal brengash, u munduam t'i harrojmë vrasjet, maltretimet, cenimin e të drejtës për shkollim, ne pothuajse u munduam t'i harrojmë të gjitha, vetëm se fillimi i shekulli XXI, të jetë më i begatshëm për ne shqiptarët, më gjallërues për të ardhmen (e kemi fjalën për harresat e viteve pas 2001-shit).**

Por, më kotë ishim munduar t'i harrojmë të gjitha këto zymti. Sepse, edhe pas fillimit të shekullit XXI, Maqedonia vazhdonte të jetë shtet një-nacional, përkundër që populli shqiptare ishte mbi 25%, vazhdonte gjuhë zyrtare të jetë vetëm maqedonishtja, vazhdonin zgjidhjet e problemeve dhe e kryetarëve vetëm prej njërit etnitet, pra atij maqedonas, si dhe gjithçka tjetër vazhdonte përpos nismës së zhvillimit dhe plotësimit të kërkesave të të gjithë komuniteteve që jetonin në shtetin shumetnik e shumë pak etik.

Duke i marrë për bazë të gjitha parametrat e së kaluarës në këtë shtet, fatkeqësisht dhe detyrimisht po vijmë në përfundim të një tanishme dhe të ardhme tejet pesimiste. Pesimiste, sepse e kaluara dhe e tanishmja për shqiptaret dhe të tjerët ishte tepër

zhgënjyese, e ky zhgënjim pa më të voglin dyshim do të kthehet në dështim.

Në pyetjen e gazetarëve në lidhje me mos marrjen pjesë të intelektualëve dhe subjektit politik shqiptar për zgjidhjen e kontekstit rreth emrin, "autokrati" Gruevski me mjaft ironi shprehet, "kur të dëshirojnë shqiptarët mundë të bëhen pjesë e zgjidhjes rreth kontekstit të emrit". Nga kjo përgjigje dinake, arrijmë të kuptojmë se pjesëmarrja e shqiptarëve në kontestin rreth emrit, qenka punë dëshirash, gjoja se autokrati në fjalë nuk paska nevojë t'i bëjë ftesë elitës intelektuale dhe partive politike shqiptare rreth problemeve dhe kontesteve të cilat janë prezent në Maqedoninë "progresive".

Edhe më keq, me këtë përgjigje i nënçmojë të gjithë subjektet politike shqiptare, kinse zgjidhja e emrit qenka fontanë dëshirash, pra kush dëshiron merr pjesë e kush nuk dëshiron është i lirë të mos merr pjesë. Meqë kryeministri qenka liberal sa i përket lirive dhe plotësimit të dëshirave, pse vallë nuk na i miraton dëshirat serioze kombëtare? Fundja, pse nuk na i jep të drejtat që natyrshëm na takojnë? As njëra as tjera nuk është punë dëshirash, por imponim vendimesh, që ndërlidhen me egon idioteske të bashkëpunëtorëve të tij.

Lojërat e tij ishin nga më të ndryshmet. Karrierën e tij e filloi si ekonomist dhe boksier në këtë shtet, pastaj si një njeri kinse i suksesshëm në dikasterin e tij, gradualisht filloi ta zbuloi fytyrën e vet të vërtet, duke ia kultivuar liderëve shqiptarë dëshirën për kërkim të sa më shumë marrëveshjeve të reja, dhe pastaj para faktorit të jashtëm dhe të brendshëm t'i demantoj këto marrëveshje si gënjeshtra, si dhe t'i paraqes liderët shqiptarë si gënjeshtar para popullit të vet, si dhe avazin e tij dhelparak bashkë me disa dashamirë të tij, është duke e vazhduar me paraqitjen e shqiptarëve si malësorë, ardhacak, terroristë dhe njerëz tejet agresiv. **Habi e madhe! Ne të paraqitemi agresiv, përballë bishave të egra.** Ne realisht, duhet të jemi në këtë shtet agresiv, sepse përballë nesh gjenden bishat e egra me rrezikshmëri të lartë.

Me neve luhet, nga shkaku se jemi tejet të butë, e jo se jemi agresivë, sepse po të ishim të tillë, as malet e Karpateve prej nga kanë ardhur nuk do i presin. **Thotë populli ruajuni kur të trashet harami, sepse haku pa vetëdijen tonë mund të reagojë, edhe atë shumë ashpër!**

Ne përfundimisht duhet të thirremi në pak atë mendje që na ka mbetur. Labiliteti i këtij shteti improvizues, në vazhdimësi është duke na dëmtuar. Kemi nevojë për gjëra konkrete: Të jetojmë në këtë shtet bashkërisht me të drejta të barabarta, apo në pamundësi të kësaj t'i themi lamtumirë njëri tjetrit, sepse mjaft më mysafir në shtëpinë tonë, mjaft më me mashtrime që edhe fëmijët e gjepit po i kuptojnë.

Pra, nëse vazhdohet kështu, nëse ndërkohë nuk zgjohemi nga gjumi dimëror e veror, do jemi të detyruar të jetojmë në Maqedoninë antike të Gruevskit, do jetojmë në Maqedoninë ku lejes i themi "*dozvolla*" e certifikatës "*izvod*". Fatmirësisht, përskaj gjithë këtyre errësirave, të gjithë e dimë se jeta në këtë botë është mjaftë e shkurtë, si dhe çdo proces në këtë jetë është i përkohshëm. Ndaj, edhe procesi dhe fenomeni gruevskian duhet patjetër të jetë i përkohshëm. Ndoshta tek pastaj pasardhësit tanë (dhashë Zoti të jen më të zgjuar dhe më vigjilent se ne), mund të jetojnë në një shtet demokratik, në të njëjtin vend ku kemi jetuar edhe ne, por jo edhe në Maqedoninë e sotme!

E mërkurë, 27 Maj 2009

Kombëtar, i drejtë dhe në post shtetëror, aktualisht e pamundur

Para katër muajve, isha jashtëzakonisht i gëzuar që të paktën një herë në jetën time, e pata rastin të shkruaja dhe t'i shprehi ndjenjat e mia në lidhje me fillimin e vlerësimit të personave meritorë, si dhe vendosjen e tyre nëpër poste drejtuese me rëndësi jetike për popullin në përgjithësi dhe, për shqiptarët në veçanti. Unë fatkeqësisht kisha harruar se, në këtë shtet kombinimi **kombëtar, i drejtë, i moralshëm dhe në post shtetëror-drejtues nuk shkon dhe se qenka një kombinim mjaft i papërshtatshëm, pothuajse i pamundur për momentin**. Sepse, ti më kot mundohesh të bësh ndryshime në shoqëri, kur shoqëria e shtresës së "lartë" nuk të përkrah. Lere që nuk të përkrah, por me lloj-lloj metode makiaveliste mundohen të pengojnë, si dhe në fund detyrohesh të japësh vetë dorëheqje nga veprimtaria përkatëse, jo të japësh dorëheqje nga mossukseset, por nga mospërshtatja e qeverisësve që nuk meritojnë as të qeverisen.

Njeriu i cili u pengua pamëshirshëm, kuptohet nga shtresa e shoqërisë së "lart", ishte Selver Jashari, për veprat e të cilit kam shkruar edhe para katër muajve, ku inspirimi im (për shkrimin, "*promotori i ndryshimeve*", i botuar në gazetën Lajm) ishte si rezultat i ballafaqimit të drejtpërdrejtë me ndryshimet tejet pozitive që kishte filluar t'i përjetojë spitali i Kumanovës. Në atë kohë, pata rastin t'i dëgjoja ofshamat tmerruese të mjekëve me traditë korruptuese, pata rastin t'i dëgjoja edhe pasthirrmat trishtuese të disa mjekëve shqipfolës, të cilët nuk mundnin t'i përballonin dot, mbishkrimet në gjuhën shqipe në tërë spitalin dhe në etiketat e tyre, pata rastin t'i dëgjoja disa pakënaqësi nga ata të

cilët dukshëm ishin mishëruar me mbeturinat dhe me papastërit e spitalit, në atë kohë pata rastin ta shoh një menaxhim të përgjithshëm tejet të suksesshëm, brenda dhe jashtë spitalit, që do ia kishin zili edhe studiuesit e shkencës së menaxhmentit, si dhe në mënyrë praktike e pash se si jetësohet Marrëveshja e Ohrit. Ndaj, shpresat e të gjithë popullit, me ardhjen e Selver Jasharit në postin drejtues të spitalit filluan të rilindin, shpresat tona në atë kohë, u shoqëruan me një pragmatizëm mjaft të shëndosh, fenomen i munguar në shoqërinë tonë.

Fatkeqësisht këto shpresa tejet të pa fat, kishin qenë me afat mjaftë të shkurtër!

Sinonimit të ndryshimeve pozitive, ia imponuan dorëheqjen paralelisht me imponimin e kësaj dorëheqje, populli nevojtar për shërbime mjekësorë u privua nga të qenit i respektuar dhe trajtuar si duhet në këtë spital. Drejtori aktual i spitalit edhe pse do të mundohet të sillet mirë, do të mundohet ndoshta të punoj mirë, por, ai në vetvete detyrimisht bart një barrë mjaftë të rëndë, ai pra, pranoj ta zëvendësoj njeriun e pazëvendësueshëm, ai pranoi dhe u gëzua që njeriu i sukseseve të largohen!

Përskaj gjithë këtij epilogu të tmerrshëm dhe rrëqethës, ne shtresa e shoqërisë së ndershme, e morëm një leksion të përjetshëm nga veprimtaria tetë mujore e Selver Jasharit. Veprimtaria e këtij fanari ndryshues na tregoi sesa është vështirë në këtë shtet diskriminues të punohet për shqiptarët, si dhe ndoshta pa vetëdijen e tij, na zbuloi hipokrizinë e ministrave shqiptarë. Sepse, sikur të ishin prej atyre ministrave të drejtë dhe kombëtar, ata nuk do të mundnin të qëndrojnë plot katër vite në kolltuk, duke mos punuar asnjëherë me korrektësi dhe për shqiptarët, ata sikur të kishin ndjenja nuk do e lejonin që favorizimet e ndryshme t'i takojnë vetëm etnitetit maqedonas.

Pra, Selver Jashari praktikisht i demaskoi fytyrat e vërteta të ministrave shqiptarë. Sepse, edhe Selver Jashari sot do të ishte në krye të detyrës, sikur të kishte pranuar të korruptohet, të kishte lidhje pak më intime me zonjushat apo me zonjat sekretare, të mos

i bënte mbishkrimet në gjuhën shqipe, të mos punësonte mjek dhe motra shqiptare në spital, si dhe të mos i shfaqte hapur ndenjët kombëtare reale. Por, për t'i shfaqur hapur këto ndjenja kombëtare reale, se pari duhet t'i kesh në brendësi, e tek pastaj ta vësh flamurin dhe figurat kombëtare në zyre, dhe të jesh proporcional me të gjithë të punësuarit në spital. Selveri nuk i pranoi këto maskarallëqe, këto kënaqësi të përkohshme, por ai e zgjodhi rrugën e vështirë, rrugën me plot sprova e me gjemba, por herët a vonë që të shpie në krenarinë dhe kënaqësinë e përjetshme.

Pra, nga veprimtaria e Selver Jasharit mësuam se, qenka aktualisht e pamundur të jesh dhe të mbetesh kombëtar, i drejtë, i moralshëm dhe njëkohësisht të drejtosh punë madhore për qytetarët e këtij shteti. Ndoshta, disa individë para se të emërohen në poste kyçe, kanë qenë të tillë (të ndershëm), por me kalimin e kohës virtytet kombëtare jo të qëndrueshme, janë shndërruar në të meta profesionale dhe kombëtare. Një gjë të tillë, Selver Jashari nuk e lejoi, as që do e lejon ndonjëherë, e tregoi veten se kush është realisht përballë kësaj sprove mjaft të madhe. Tashmë, ministrat dhe drejtorët do të ndjehen paksa të ngushtuar nga qëndrimi i tyre katërvjeçarë nëpër poste të ndryshme dhe, njëkohësisht të punojnë shumë pak për të mos thënë aspak për shqiptarët. Ata, realisht duhet të ndjehet të turpëruar, kur pas një misioni ministror të kërkojnë mision tjetër drejtues. Sepse, sikur të jen të vetëdijshëm të gjithë ministrat dhe drejtorët për trajtimin e vëllezërve të tyre, dhe puna aq e madhe e me përgjegjësi që i pret, besoni se, pas katër viteve më nuk do të jenë në gjendje të punojnë asgjë, do të kenë probleme serioze me shëndetin, sepse të punosh përballë bishave është vështirë të mbetesh ashtu si ke qenë më parë, por tek ne ndodh e kundërta, pas katër viteve, çuditërisht vijnë në formë!

E hënë, 01 Qershor 2009

Edhe për sa marrëveshje kemi nevojë?

Pritet që në fillim të këtij muaji, të hapet një konkurs në Bruksel për "shkathtësi në përpilimin e marrëveshjeve"! Me sa kemi informata jozyrtare, në këtë konkurs do të marrin pjesë, edhe disa liderë shqiptarë. Me të dëgjuar juria e komisionit pranues dhe testues të këtij konkurse se, edhe liderët shqiptarë do të marrin pjesë në këtë garë, komisionin në fjalë e kishte kapur paniku, ngase pandehnin ata; liderët shqiptarë të paktën në këtë aspekt janë mjeshtër të përkryer. Si rrjedhojë e kësaj frike dhe paragjykimi, juria e kishte ndërruar mendjen, sepse ata fare nuk dëshironin që shqiptarët të ngadhënjenin. Normal, që juria dhe anëtarët e komisionit, nuk dëshironin të ngadhënjenin liderët shqiptarë që jetojnë në Republikën e Maqedonisë sepse po të ishin prej atyre ngadhënjimtarëve, çështjet brenda shtetërore do t'i kishin më mbarë. Kjo i bie, **përtaci më i madh në shtëpinë e tij, ka konkurruar në një konkurs, ku zgjedhet punëtori më i mirë rreth mbarëvajtjes së shtëpisë**.

Në hyrje të sallës ku do mbahej testimi, liderët shqiptarë befasisht e lexuan se konkursi i shpallur i dedikohet, "shkathtësisë për ikje nga realizimi i marrëveshjeve në mënyrë diplomatike". Me arsyetim se, në kohën post-moderne paskemi nevojë edhe për kësi lloj shkathtësish. Teksa e lexonin të hutuar dhe të zhgënjyer liderët shqiptarë këtë lajmërim, përnjëherë në korridorin kryesor i shohin kolegët e tyre maqedonas.

Tutje se çka ndodhi, në këtë garë mashtruese në Bruksel, mendoj se është e kotë t'ju tregojë! Paraprakisht i kemi të qarta shkathtësitë e liderëve maqedonas në ikjen dhe mosrealizim të marrëveshjeve, edhe atë në mënyrë shumë diplomatike. Të mos e

realizosh një marrëveshje, e cila ishte rezultat i një kryengritje të armatosur, si dhe marrëveshja në fjalë të garantohet, edhe nga ndërkombëtarët, kjo me të vërtetë është mjeshtëri tejet e spikatur e liderëve maqedonas. Aq më shumë, të indoktrinuar po ata ndërkombëtarë nga aftësitë manipuluese maqedonase, pohojnë hapur dhe pa doreza se, Maqedonia me të zgjidhur çështjen e emrit, me automatizëm i plotëson kushtet për në NATO dhe shumë shpejt, edhe për në UE.

Ah sikur të mos ishte ndërruar natyra dhe qëllimi i konkursit! Liderët shqiptarë do të ngadhënjenin, ndoshta do ta merrnin edhe ndonjë çmim për letërsi, më falni për përpilim të marrëveshjeve. Sepse, paraprakisht i kemi të qarta shkathtësitë e liderëve shqiptarë në përpilimin e marrëveshjeve. Për këto shkathtësi, dëshmitarë e kemi edhe faktorin ndërkombëtar, i cili është shumë i kujdesshëm në vëzhgim dhe raportim. Edhe pse ne i përjetuam, vazhdojmë t'i përjetojmë tmerret dhe padrejtësitë, tashmë postmoderne prej maqedonasve, mjafton që ndërkombëtarët po vëzhgojnë dhe raportojnë rreth situatës në fjalë. Ku e dimë ne, ndoshta stërnipërit tanë me prejardhje shqiptare, do t'i vjelin frutat e durimit dhe mjerimit tonë! Në ditën e vjeljes së frutave stërnipërit tanë me prejardhje shqiptare, do të flasin shumë gjuhë, por jo edhe gjuhën shqipe. Ata, nuk do ta flasin gjuhën shqipe, sepse në vend që të besuarit e popullit të punojnë të bashkuar rreth realizimit të marrëveshjes, ata e zgjedhën rrugën e përpilimit të sa më shumë marrëveshjeve. Të besuarit e popullit, shumë pak punuan, për këtë shqipe të pastër. Ata ndoshta gjuhën e tyre kombëtare nuk do arrijnë ta mbajnë në formë, të paktën brenda trevave shqiptare, e të mos flasim që këtë gjuhë ta zgjerojnë dhe, shndërrojnë në një gjuhë ndërkombëtare.

Ndoshta në fillim të përpilimit të marrëveshjeve do të duket gjithçka shumë lehtë, ngase përmes këtyre përpilimeve po bëhet edhe një promovim paraprak i partisë apo promovim i para partisë. Pala tjetër, pra fituesja e konkursit në Bruksel, në pamundësi për ta kuptuar emisionin humoristik, "Portokalli", në mënyrë

të drejtpërdrejtë dhe praktike po i shikojnë mishmashet dhe kontradiktat shqiptare rreth marrëveshjeve. Kinse, rasti i Marrëveshjes së Ohrit qenka produkt ushqimor me afat të skaduar. Kjo i ngjan atyre njerëzve të cilët me mburrje, në arsyetim të tradhtisë bashkëshortore, tradhtojnë duke pohuar se, nuk po hahet çdo ditë vetëm grosh. Duke harruar të gjorët se një ditë pala e gjinisë tjetër mund të pyet, vallë hahet çdo ditë lakër e zier. Pra, as njëra as tjetra nuk mund të ndërlidhen me shembuj ushqimorë, sepse marrëveshja, njeriu dhe ushqimi dukshëm dallojnë ndërmjet veti!

Partia e cila pandeh se kjo marrëveshje, qysh në vitin 2004 , ka skaduar në afat, na doli me një propozim të ri, pra me një marrëveshje tjetër krahasuar prej asaj të Ohrit, marsit dhe majit. Meqë kjo parti pandeh se tash e tutje duhet shkuar me marrëveshje të re, nga shkaku i skadimit të afatit të Marrëveshjes së Ohrit, pse vallë këtë konstatim nuk e kontestoi pas vitit 2006? Ndoshta atëherë ishte në pushtet dhe të qenit në pushtet e kërkon një kusht, pra, para se të jesh me vetveten besnik, duhesh së pari të jesh besnik ndaj palës tjetër në koalicion.

Ne habitemi se si dikush e ka plan t'i besoj palës maqedonase në realizmin e marrëveshjeve. Ata nuk e realizuan një marrëveshje e cila rrodhi nga kryengritja e përgjakshme dhe nën garanci të ndërkombëtareve. Marrëveshjet e radhës, nuk janë gjë tjetër pos mashtrime të radhës. Kurse, mashtrimet e radhës nuk janë gjë tjetër, pos mallkime përfundimtare të liderëve shqiptarë! Derisa pala maqedonase, nuk e realizojë në tërësi Marrëveshjen e Ohrit, e cila ishte arteria kryesore për mbajtjen gjallë të këtij shteti, të gjithë marrëveshjet tjera do të ishin një përdhosje dhe një argument i ngadhënjimit të maqedonasve. Përfundimisht, vdekja e Marrëveshjes së Ohrit do të thotë; vdekje e këtij shteti!

Pra, nuk kemi nevojë më për marrëveshje të reja, sepse lojaliteti i shtetit nuk shprehet përmes pranimit të marrëveshjeve të reja, por përmes realizmit të kësaj marrëveshje. **Pyesim, nëse pushteti dhe të gjitha subjektet politike shqiptare nuk qën-**

druan besnik ndaj kësaj marrëveshje, vallë do të qëndrojnë në besë ndaj marrëveshjeve të reja?

E shtunë, 13 Qershor 2009

Maqedonia ndërmjet Evropës dhe Ev(g)ropës

Të synosh në qëllim të mirë dhe ta duash gjallërimin është mase e qartë. Madje të punosh denjësisht për arritjen e këtyre qëllimeve fisnike, është më shumë se besnikëri. Por, ta përkrahsh dhe ta duash qëllimin e pastër dhe të drejtë, e në të njëjtën kohë të punosh për të kundërtën e saj, është më shumë se demagogji. Pastaj, spontanisht rrjedhin hipokrizitë e radhës, kur disa njerëz me shume fytyra trumbetojnë dhe flasin për vendin e tyre të tej-varfër dhe të tej-korruptuar, që shumë shpejtë do t'i bashkëngjitet familjes së madhe dhe progresive evropiane. Trumbetuesit hipokritë harrojnë qëllimisht se, vendi i tyre ndoshta veç më gjendet buzë greminës.

Me kësi lloj kontradiktash dhe anomalish, aktualisht është duke u ballafaquar Republika e Maqedonisë! Shumë njerëz në këtë shtet, u bënë të diplomua, magjistra dhe doktorë, në temën, "Integrimi i Republikës së Maqedonisë në Bashkimin Evropian", apo në tema të kësaj natyre. Gjithçka ishte e kotë në aspektin integrues shtetëror. Sepse, ata të cilën e kishin dhe fatkeqësisht ende vazhdojnë ta kenë në dorë timonin shtetëror dhe adresën e aderimit për në Evropë, si duket këtë timon e kanë orientuar për në Ev(g)ropë. Po të ishin, realisht të orientuar drejtë Evropës, nuk do të ngurronin dot në realizimin dhe jetësimin e standardëve të cilët i kërkon Bashkimi Evropian. Aspak nuk është vështirë të plotësohen standardet të cilët i ka propozuar Këshilli Evropian, ku dihet mirëfilli se ky shtet nuk është hiq më i madh dhe i populluar sa një qytet i Gjermanisë, apo një familje në Kinë.

Kërkesën zyrtare për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Maqedonia e ka dorëzuar më 22 mars të vitit 2004. Me këtë Qeveria e Maqedonisë e ka shprehur vullnet shtetëror dhe të qytetarëve të saj që të anëtarësohet në Bashkimin Evropian. Republika e Maqedonisë paralel me kërkesën zyrtare për anëtarësimin në BE, duhet t'i përmbush standardet, të cilët kërkohen nga BE-ja dhe që njëherit janë kushte fikse që një shtet të integrohen në këtë organizëm gjigant. Cilat pra, janë kushtet apo standardet që kërkohen që një shtet, konkretisht Maqedonia të bëhet anëtare e BE-së? Kërkesa në Këshillin Evropian, të jetë i njohur ndërkombëtarisht (të mos jetë i kontestuar për diçka), realizimi i plotë i Marrëveshjes së Ohrit, reformat rrënjësore në sistemin politik dhe ekonomik, zhvillimin e institucioneve të shtetit të së drejtës, zhvillimin e ekonomisë së tregut, ndërtimin e marrëdhënieve të njëjta të mira me fqinjët dhe pjesëmarrjen aktive në të gjitha iniciativat rajonale, si dhe ca kritere shtesë që njihen si, "Kritere të Kopenhagës", këto janë disa prej kushteve dhe standardeve kryesore.

Plotësimi i këtyre standardëve, Maqedoninë pa më të voglin dyshim do ta shpijnë në Evropë. Këtë, tashmë të gjithë po e dimë! Por, nuk duhet përjashtuar mangësitë në vetë sistemin integrues evropian, kur kemi lëshime dhe tolerancë të qëllimshme për hir të interesave gjeostrategjike, siç ishte rastisi me Bullgarinë dhe Rumaninë. Fatkeqësisht, Maqedonia nuk e ka një epërsi të tillë strategjike, ku do t'i bëhet i mundur integrimi në BE, pa i plotësuar standardet dhe kushtet e propozuara nga Këshilli Evropian. Meqë ky shtet nuk e paska një fat të tillë strategjik, atëherë qenka i detyruar t'i plotësoj standardet e lartcekura. Vallë sa i ka plotësuar ky shtet kushtet dhe standardet për integrim në BE? Të gjitha unanimisht jemi të pajtimin dhe njëkohësisht jemi dëshmitarë se përpos kërkesës për anëtarësim në BE, Maqedonia asnjë standard tjetër nuk e plotëson.

Ky shtet nuk është i njohur ndërkombëtarisht si tërësi (kemi konteste të ndryshme), Marrëveshja e Ohrit si duket është në çastet e fundit të jetës së saj (edhe pse asnjëherë nuk pati jetë të

plotë dhe të shëndoshë), sistemet politike dhe ekonomike, jo që nuk kanë pësuar fare reforma, por në vazhdimësi janë duke e pjekur dhe vendosur sistemin monist partiak me vendimmarrje monopoliste politike, si dhe sistemi ekonomik është duke e përjetuar një centralizim që dikur i përkiste vetëm sistemit të shekullit të kaluar (ndërhyrja e kryeministrit në kompanitë e huaj SWEDMILK dhe EVN dhe shumë ndërhyrje centraliste tjera), zhvillimin e shtetit të së drejtës e dëshmojnë montimet klasike për burgosjen e shqiptarëve të pafajshëm, mbushja e gjykatave me lëndë të cilët i takojnë shekullit të kaluar si dhe mosrespektimi i asgjëje me vlerë, për paraqitjen dhe kuptimin e zhvillimit të ekonomisë së tregut nuk do na mjaftojnë fjalët, as Adam Smithi nuk do mundte ta shpjegonte këto mjegulla rreth situatës aktuale ekonomike, si duket në këtë shtet aktualisht është duke u vendosur dhe mishëruar sistemi i dikurshëm merkantilist, se sa Maqedonia i ka marrëdhëniet e mira me fqinjët e saj, për këtë mjaft qartë flasin dhe dëshmojnë kontestet e shteteve fqinjë ndaj këtij shteti, si dhe për kriteret shtesë të Kopenhagës do të ishte qesharake të flasim! Pra, ata të cilët pandehin dhe shpresojnë se Maqedonia në vitin 2041, më falni në vitin 2014 do të bëhet anëtare e BE-së, do ta gënjenin vetën mjaft rëndë. Sepse, me mendësinë, "dy hapa mbrapa, një pas" mund të bëhesh sportistë i spikatur në vrapim për mbrapsht, por asnjëherë maratonist i suksesshëm me një shpejtësi konstante deri te caku final.

Pra, ne fare pa doreza dhe pa huti, mund të aludojmë se ky shtet me synim teorik drejtë Evropës, me automjetin rus, me nostalgjinë jugosllave dhe me hipnozën antike, praktikisht dhe realisht është duke shkuar drejt Ev(g)ropës. Shkaku i kësaj mendësie të mbrapsht, si duket edhe për varrmihësit do të jetë mjaftë vështirë.

E hënë, 13 Korrik 2009

Mirupafshim mërgimtarë

Shqiptarët prej kohësh e kishin marrë botën nëpër sy. Këtë e kishin bërë nga shkaku se në vendin e tyre ishin shndërruar në njerëz të huaj, në arën e tyre ishin bërë argat të tjetërkujt, si dhe në shtëpinë e tyre ndjeheshin si mysafirë të paftuar dhe të padëshiruar. Meqë kjo punë ashtu ishte, atëherë vendosën përnjëmend ta përjetonin vetën e tyre praktikisht si të huaj, argat dhe mysafirë të paftuar. Pushteti i atëhershëm, po ashtu edhe ky i sotshmi një gjë të tillë mezi e priste, sepse u realizonte me sukses politika shtetërore dëbuese dhe deri diku asimiluese ndaj shqiptarëve. Ky ishte një dëbim dhe asimilim mjaft diplomatik i pushtetit të atëhershëm, kundrejt shqiptarëve autokton! Sepse, pushtetit zullumqar i mjaftonte mohimi i të drejtës për punë dhe për shkollim. Kishte mohime tjera të panumërta të të drejtave natyrale, por pushteti me theks të veçantë ishte i kujdesshëm ndaj këtyre dy dukurive vitale. Pastaj, shqiptarët migrimin social dhe ekzistencial e panë si shteg dhe alternativ të vetëm për ta vazhduar jetën e tyre, edhe më tutje. Çdo vlerë kombëtare dhe fetare, mërgimtarët e parë e ruanin me xhelozi. Ata punonin me zellin më të madh të mundshëm, vetëm e vetëm që një ditë të kthehen në vendlindje me bazament të fortë.

Diaspora shqiptare kontribuoi shumë në financimin e tri luftërave çlirimtare dhe pas çlirimtare. Pothuajse familje të tëra, të mirat ekzistenciale i siguronin nga një burim i vetëm, pra prej djalit apo babait në mërgim. Ishte një mërzi dhe mallëngjim i pa përshkruar në momentin e përcjelljes apo ardhjes së mërgimtarëve. Nënave shqiptare zemrat u gufonin nga të qarit, po ashtu një gjë të tillë e ndjenin edhe ata të bekuarit.

Por, kohërat ndryshuan! **Pas luftërave në trojet tona, ata që nuk kursyen asgjë për këtë kauzë, disi filluan të zhgënjehen.** Sepse, disa të cilët në kohën e luftës punonin në logjistikën e fshehtë, pas luftës u bënë shumë të mëdhenjtë, po ashtu edhe mendjemëdhenj. Ata të cilët nuk kursyen asgjë, kur erdhën në vendlindjet e tyre, mbeten më të injoruarit. Prej tyre kërkohej vetëm investime, edhe atë kjo kërkesë u bënte nëpërmjet mjeteve të informimit, sepse nuk ishte mirë të takoheshin kolegët e dikurshëm (tashmë disa në vendlindje të pasur, disa në mërgim punëtor krahu, por të ndershëm), ku bënin propaganda të ndryshme nëpër klube rreth kauzës kombëtare shqiptare. Dhe, nga viti në vit, ndjenja humane dhe kombëtare për këtë vend dhe, njerëzit pushtetarë të këtij kombi, filloj të dobësohet apo edhe të humbë prore. Ata që dikur ishin në gjendje të jepnin gjithçka për këtë popull, u shndërruan në të dëshpëruar të këtij populli. Fëmijët, posaçërisht ata që ishin lindur në diasporë, spontanisht i vërejtën zhgënjimet e baballarëve të tyre. Dhe kur një ditë, prej këtyre fëmijëve befasisht dëgjuam se vendlindja dhe atdheu i tyre është diaspora (Amerika, Zvicra, Gjermania, Austria e të ngjashme).

Si rezultat i kësaj, ia humbën edhe ëmbëlsinë gjuhës shqipe, duke u ndjerë tejet të lumtur gjatë komunikimit në gjermanisht, anglisht, etj., kulturën dhe vlerat tjera shqiptare filluan t'i zbehin dhe t'i injorojnë, ashtu sikurse pushtetarët aktual që i injoruan baballarët e tyre.

Disa që nuk kishin mundur të fitonin mirë në kohërat e luftës, menduan për kthimin e diasporës shqiptare në diçka kombëtare. Ata pra, në vend të klubeve, ku flitej dhe diskutohej në të kaluarën për organizmin dhe ruajtjen e vlerave të mirëfillta shqiptare, hapën restorante me muzikë kinse shqip. Ndonëse kështu diaspora shqiptare paska mundësi t'i kthehej kulturës së tyre autoktone. Por, ata u bënë kinse harruan se muzikat tallave apo "maxhupe", nuk kishte asgjë të përbashkët me kulturën dhe vlerat shqiptare. Sidoqoftë, ata e bënë të vetën, u pasuruan në aspektin material, u varfëruan dhe i varfëruan të tjetër (injorantët) në

aspektin material, shpirtëror dhe kulturor! Shumë shpejtë me këtë kulturë "maxhupe" u infektuam, edhe ne këtu në vendin tonë. Pushteti zullumqarë, këto kalkulime të pa llogaritura mendësisht, i shihte me një kënaqësi të veçantë. **Sepse, atyre u konvenonte dhe u konvenon që diaspora shqiptare të mos investoj më në armë kundër pushtetit zullumqarë, por në diçka që quhet, "atom për vetveten".** Pushteti ndihej tejet i rehabilituar dhe i çuditur, kur në regjistrin e entit statistikor për të hyra nga jashtë, shihte derdhje marramendëse të mjeteve monetare. **Ku mos të çuditet ky shtet, kur sheh njeriun qyqar i cili vetëm për një dasmë i ka shpenzuar 30 mijë euro, ku me automatizëm për shtetin i cili nuk investon asgjë për ata, shkojnë 5400 euro.**

Pastaj, disa të shastisur pas luksit të madh u hipnotizuan pas vizave. Ndonëse, tashmë kurbeti nuk qenka i rëndë sikur dikur, nuk po banonin shtatë meshkuj në një banesë të vogël, nuk po mendonin për çështjen kombëtare, por jeta tashmë atje na qenka përball veturave të mira, ushqimit të mirë dhe tallavasë së mirë, si dhe kur të vijmë këtu e kallim krejt, hedhim mbeturina në rrugë, e zëmë rrugën me veturë, gjuajmë me kallashnikov apo me tete, dhe shumëçka tjetër mizore. Ndaj, mundësia e vetme për t'i shijuar këto maskarallëqe, qenka të fejohemi me ndonjë me vizë (nuk e kam fjalën për ata që u fejuan ndershmërisht). Aq shumë njëri ishte habitur ku ishte fejuar me një vajzë nga diaspora, sa që të gjithëve ende pa e pyetur mirë, u përgjigjej po unë jam fejuar me vizë, duke harruar kokëboshi se me vizë njeriu nuk fejohet, por me njeri. Gjendja morale në diasporën shqiptare nuk është në nivel. Por, për këtë anarki kombëtare dhe fetare, është përgjegjës pushteti shqiptare në të gjitha trojet tona. Ata bënë një gabim fatal, atëherë kur i injoruan dhe nuk ia lehtësuan shërbimet administrative në kohën e pushimit të tyre.

Pra, ata edhe gjatë kësaj vere u kthyen të dëshpëruar, sikurse ne të lodhur nga qejfet e tyre të shfrenuara. Mirupafshim vëllezër mërgimtarë në një verë më të ndritshme!

E martë, 11 Gusht 2009

“Dituria është forcë, dituria është fuqi”

Askush nuk mund ta mohon faktin se, dituria është fondament i fuqisë lëvizëse në shoqërinë njerëzore dhe parakusht themelor për suksese. Përmes diturisë, njeriu arriti ta njoh vetveten dhe madhështinë e Krijuesit të tij, ta njohë të mirën dhe të keqen, t’i dalloj vlerat prej antivlerave. Nëpërmjet diturisë dhe arsimimit bota arriti ta shohë dritën e zhvillimit teknologjik dhe shkencor! Kur themi nëpërmjet diturisë, me automatizëm aludojmë për dijetarët, të cilët na bërën dhe na bëjnë të mundur t’i shijojmë frytet e diturisë në minierën e pashtershme.

Si rrjedhojë e rëndësisë së madhe të diturisë dhe arsimimit, shumë shtete prej kohësh ia dhanë rëndësinë e duhur diturisë, pra, e institucionalizuan këtë begati. Institucionalizimi i diturisë ka të bëjë me ngritjen e objekteve shkollore dhe përgatitjen, profilizimin e mësuesve apo profesorëve, sepse nuk është thënë kotë: "dituria nuk është vetëm të dish, por atë t’ua transmetosh të tjerëve".

Kësisoj nga viti në vit, nëpër këto objekte shkollore dolën shkencëtarë, konstruktorë, etj., të cilët në vazhdimësi do të kontribuonin për zhvillimin e shoqërisë në përgjithësi. Sepse, investimi dhe përkujdesja e shtetit për arsimim është një tregues tejet i saktë rreth zhvillimit shumëdimensional të shtetit në fjalë.

Siç po shihet, edhe Maqedonia si pjesë e këtij globi tokësor, nuk e anashkaloi dot institucionalizimin e diturisë. Rëndësi të veçantë, arsimimit iu dha në trevjeçarin e fundit, ku flitej se shkolla e mesme do të bëhet e obligueshme. Dhe, ja u bë! Por, a u bënë disa punë të tjera, para se të fillojnë të jetësohen disa ligje që

edhe për vetë Qeverinë janë qesharake. Flitet për kompjuterizimin e shkollave, duke qenë në objekte të kohës së gurit (veçanërisht shkollat shqipe). Flitet për shkollën e mesme si të obligueshme, pa i siguruar Qeveria mjetet elementare për nxënësit skamnorë. Flitet për reforma në shkollë, duke pasur ende mësues të cilët nuk reformohen dot.

Flitet për efikasitetin e mësimit nëpër shkolla, e në anën tjetër i shkelin dhe diskriminojnë mësuesit në aspektin e pagave. Flitet për pranimin e kuadrove të shëndoshë nëpër shkolla, duke qenë ende prezent ndërhyrja e partive politike. Si dhe tash së fundi, Qeveria dhe Ministria e arsimit për ta ngritur kinse ndjenjën për arsimim na dolën me një slogan tejet të shëndosh, aspak për momentin i arsyeshëm, **"Dituria është forcë, dituria është fuqi". Të lozësh me slogane të tilla dhe me dinjitetin e njerëzve nën emrin e maksimave tejet të shëndosha, është më shumë se krim.** Ngase, Qeveria është dashur të mendoj më herët rreth metodave nxitëse për arsimimin e qytetarëve të saj.

Ky slogan do ishte i arsyeshëm në këtë kohë, atëherë kur asnjë të diplomuar të mos e kishim parë duke bredhur rrugëve. Si është e mundur të thuash se dituria është forcë, kur të diturit fare nuk i ofron pranë vetes. Si është e mundur të thuash se dituria na qenka fuqi, kur të fuqishmit dijetarë i ke të nënçmuar, përball një grupi njerëzish injorantë. Fundja si është e mundur të thuhen një slogan kaq madhorë, nga njerëzit që asgjë nuk kanë të përbashkët me diturinë.

Ne fare mirë e dimë se sa kujdeset dhe brengoset Ministria e Arsimit për qytetarët e arsimuar. Ne fare mirë e dimë se sa vështirë është ta botosh një libër në këtë ministri pa pasur fare të njohshëm. Sikur në këtë shtet, me të vërtetë dituria të konsiderohet dhe vlerësohet si forcë apo fuqi, atëherë shteti ynë do të nxjerrë shkencëtarë me plot kuptimin e fjalës, do të botonte libra me vlerë, do të kujdesej për dijetarët të cilët i ka shkelur rrota e padrejtësisë, do të bënte një planifikim arsimor rreth numrit të të

regjistruarve nëpër universitete, e shumë veprimtari tjera frytdhënëse për qytetarët e saj.

Aktualisht kjo fare nuk i intereson Ministrisë së Arsimit, numri i të regjistruarve është paushall, dhe po ashtu pas katër viteve numri i të diplomuarve të papunësuar do jetë paushall. Ne konsiderojmë se Qeveria me këtë slogan është duke lozur padrejtësisht dhe mizorisht me ëmbëlsinë apo natyrshmërinë e shkollave dhe me dinjitetin e dijetarëve. Edhe Bashkimi Sovjetik dhe disa shtete tjera komuniste, dikur shpallnin slogane shumë të mëdha, por nuk kishte asgjë dhe nuk kishte mundësi askush që praktikisht të na tregonte funksionimin dhe ndërlidhjen e sloganeve me veprat e përditshme. Për këtë arsye, ne nuk habitemi aq shumë rreth shembjes së këtij sistemi në formën më të keqe dhe mizore të mundshme.

Kësisoj, shteti ynë e ndezi një zjarr kinse me qëllim të mirë, kurse zjarri pa qëllim është duke e djegur pronarin e po këtij zjarri. Mospërputhja e realitetit me sloganet, i ngjanë njeriut i cili dukshëm është i sëmurë, por paraqitet dhe bëhet kinse nuk ka asgjë.

Pra, të mos luhet me diturinë dhe arsimin, dukuri të cilët e mbajnë gjallë shpirtin e kësaj bote, por të bëhemi realist, të pajtohemi me fatet tona tmerruese, dhe në këtë shtet fare të mos ngurojmë e të themi se, "**Ditura është nder, dituria është vrerë**". Është nder të jesh i ditur, por në këtë shtet të jesh i ditur do të thotë të vjellësh vrerë, sepse të diturit këtu nuk kanë vend, e dihet pse, sepse do të jesh i pakonkurrent dhe i padrejtë ndaj udhëheqësve.

E martë, 18 Gusht 2009

Enciklopedia, si rrjedhojë e rrjedhave të deritanishme

Si duket, kjo enciklopedi tejet skandaloze dhe fyese e Akademisë Maqedonase të Shkencave dhe të Arteve (AMSHA), si asnjëherë më shumë ka zgjuar kureshtje dhe reagime tejet të ashpra, dhe prej njerëzve kryesisht intelektual dhe eminent në politik-bërjen dhe në politik-ç'bërjen e këtij shteti. Për ata që denjësisht prej kohësh e përcollën situatën e përgjithshme të këtij shteti, i cili qe i krijuar pa këmbë, por në shenjë respekti pastaj ia vuan disa këmbë të qelqta, kjo e ndodhur ishte e pritur e aspak e çuditur!

Qysh në vitin 1994, Akademia në fjalë, themelet dhe materialin e kishte siguruar prej vëllait projektues në Beograd. Sinjali i fatkeqësisë së kësaj Akademie kundrejt shqiptarëve autokton u vërejt në mënyrë publike, intelektuale dhe tejet të qartë, atëherë kur profesori i nderuar Ramiz Abdyli, në mënyrë të hapur refuzoi të bashkëpunojë me këtë, "Akademi Maqedonase të Deformimeve dhe të Gjenocideve". Po ashtu refuzimin e njëpasnjëshëm të bashkëpunimit me këta komandant e kishin bërë edhe shumë shkencëtarë tjerë të mirëfilltë! Profesori në fjalë, asnjëherë nuk u nderua me ndonjë çmim, prej kësaj Akademia as, "shkencëtari më i ri i vitit" e as "shkencëtari më i plak i shekullit". Normalisht që profesori në fjalë është vështirë të dekorohet si i tillë, duke qenë të informuar të tjetër për besnikërinë dhe kontributin e tij në shkencën historiografike shqiptare. Pala tjetër, këtyre njerëzve, zhvillimin dhe kultivimin e studimeve të mirëfillta shkencore ua ndaloj, edhe atë me konventa alegorike brenda shtetërore, ngase pastaj po iu prishka rendi shpifës dhe rrënues, kundër të drejtëve

dhe shpirtmirëve (shqiptarëve). Rrjedhojat e përgjithshme të deritanishme në Maqedoni, paraprakisht na kanë paralajmëruar prej kohësh për një gjë të tillë! Kujdes, ky nuk është kulmi i margjinalizimit të shqiptarëve, sepse me reagime në letër dhe me protesta të shëndosha, por jo të përkrahura prej atyre të cilët realisht duhet përkrahur, nuk mund assesi ta ndalojmë avazin diskriminues, diskualifikues dhe diskreditues të Bllazhave. **Ne shqiptarët e këtushëm dhe të atjeshëm, nuk patëm kujdes prej kohësh, në momentin kur toka me një intensitet të ulët, prej 2-3 shkallësh po dridhej (anarkia e përgjithshme në këtë shtet). Dridhjet e vazhdueshme në shkalla jo aq të rrezikshme, gjithmonë kanë qenë paralajmërim për një tërmet të shkallës së lartë dhe shkatërrues.** Si duket, ky parim i shkencës së gjeologjisë, neve shqiptarëve ku do që gjendeshim nuk na tërhoqi sa duhet vëmendjen. Sinjalizim tejet i qartë i këtij shteti që fare nuk na do, ashtu siç jemi (e që në mundohemi me zor të dashurohemi me të) mund të vërehej prej atëherë, kur në mënyrë institucionale na dërmuan fizikisht dhe intelektualisht. Në kohën kur kjo Akademi lavire, në mënyrë shkencore i përgatiste planet kundër shqiptarëve, disa intelektual shqiptarë bënin sehir, shisnin mend vetëm nëpër universitete, bile njërit prej shqiptarëve të këtushëm iu nda çmimi, "shkencëtari më i ri i vitit", pikërisht në kohën kur, shkencëtarët e mirëfilltë që historikisht nuk kursyen asgjë për këtë çështje shqiptare e intelektuale, dhe të cilët i përkisnin një niveli të lart të profesionalizmin u margjinalizuan dukshëm.

Asnjëherë nuk u dekoruan, po ashtu asnjëherë nuk u duartrokitën prej Bllazhave, por në vend të saj u penguan dhe, patën tentativa të pandërprera për t'u internuar dhe zhdukur. Si dhe tash, për të qenë ironia paradoksale, po i njëjti shkencëtar dëshiron t'ia kthejë këtë çmim mbrapa, kinse në atë kohë nuk paska qenë i vetëdijshëm se çka në të vërtetë është dukë planifikuar kjo Akademi famëkeqe kundër shqiptarëve. Jo, edhe atëherë ishte e vetëdijshme, por e meta e autoritetit dhe lavdisë e kishte bërë të vetën. Do të llogaritej patriotizëm i nivelit të Avni

Rrustemit apo të patriotëve tjerë shqiptarë, momenti i dhënies së këtij çmimi, me përgjigje negative nga profesori i nderuar, pra sikurse tash (mirë bëri që iu kërcënua me kthim të këtij çmimi artificial dhe tendencioz, nuk kemi të drejtë morale dhe profesionale t'ia hedhim poshtë tërësisht këtë guxim dhe iniciativë). Për të qenë bindja më e shëndoshë e mospranimit të këtij çmimi tendencioz, mjaftonte një retrospektivë e shkurtër mbi intelektualët e mirëfilltë shqiptarë, se çka i kishte bërë pushteti i atëhershëm dhe i tanishëm në lidhje me dhënien e çmimeve.

Me dhënien e këtij çmimi, nuk kishim të bëjmë me ndonjë gjeni apo shkencëtarë të nivelit të Sabri Godos, Rexhep Qosjes, Arben Putos, Nehas Sopajt, Ramiz Abdylit, Abdi Baletës, Koço Danës, Arben Xhaferit, Abdylmenaf Bexhetit, etj., por me një njeri apo profesor si shumë profesor universitar të tjerë.

Një pjesë dërmuese e shqiptarëve, vuajnë prej sindromës së nxitimit në vlerësime. Historikisht, tek ne kjo është e njohur, e që për pasojë në cilësinë e dëshmisë na mjafton, provokimi i kësaj enciklopedie! Manifestimi i urrejtjes në këtë enciklopedi, ndodhi për shkak të maltretimit dhe, ofendimit të vazhdueshme që iu bënë shqiptarëve. Ata pra, duke filluar prej gjeneve e deri tek trupi si tërësi, na matën mirë pulsin se realisht kush jem ne, a do mund që tek ne ta vendojnë në rend të ditës, parimin, "jepi shqiptarëve si individ, në mënyrë që t'i kontestosh dhe konfiskosh si popull". Ky parim pra, me një sukses tejet të lartë u arrit në këto treva. Edhe pse u injoruam, u dëbuam dhe u nënçmuam në vazhdimësi, prapë tek ne mbretëronte heshtja (në këtë rast heshtja vriste dhe vret shqiptarë). Kur pala tjetër po kontestohet prej gjithkujt për gjithçka, ne prapë në shenjë solidarizimi po mëshirohemi me ta, dhe po mishërohemi me gjendjen e mjerueshme aktuale, në vend të goditjeve shkencore të forta, sepse jemi një komb tërësisht i shëndosh në aspektin e identitetit kombëtarë dhe fetar. Në kohën kur në mënyrë barbare u cenoheshin të drejtat natyrore të shqiptarëve, ne prapë flitnim për zhvillimin dhe kultivimin e bashkëjetesës

shumetnike në po këtë shtet. Në kohën kur nëpër konferenca u quheshim terroristë, ekstremistë dhe fundamentalistë, ne paralelisht me këto shpifje, bisedonim dhe punonim për ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të këtij shteti. Në kohën kur pala tjetër ish-ushtarët i quante të ashtuquajturit ushtarët e UÇK-së dhe terroristë, kurse "ne" nuk hezitonim fare që t'i quanim, "branitellat" apo mbrojtësit e këtij vendi. Shteti i Maqedonisë, në momentin që nuk e realizoi Marrëveshjen e Ohrit në tërësi, e garantuar edhe ndërkombëtarisht, zyrtarisht ngadhënjeu mbi dobësinë dhe pamundësinë e shqiptarëve. Edhe nëse kjo enciklopedi tërhiqet prej tregut të zi dhe prej konsumatorëve korruptues, ne prapë do të mbesim të dëmtuarit dhe të njollosurit. Ngase ne, veç më e morëm shuplakën e radhës prej maniakeve, të vetëquajtur akademikë. Ne sikur të ishim më të zëshëm dhe më të shtrënguar në mbajtjen e perit, sigurisht që kjo bela që sot na gjeti, nuk do të ndodhke fare. Por, lëshimi pe prej kohësh e pjelli këtë ofendim ekstrem!

Ne pra, përfundimisht nëse nuk dëshirojmë që të na përsëriten ngjarjet tmerruese dhe vandale, duhet që sot e mot të mos lëshojmë pe në lidhje me këtë enciklopedi, as mos të lejojmë që të bëhet një enciklopedi tjetër, pa u pastruar kjo mirë prej tregut provokues dhe pa inspektor financiar, si dhe në mënyrë të vazhdueshme të kërkojmë që këta projektues të përgjigjen juridikisht e moralisht për vepër penale. Nëse, pas kësaj zhurme të madhe e protagoniste tërhiqemi, atëherë të gjithë t'i përgatitim ndërtesat dhe tendat tona me material të fortë, sepse qind për qind do na godas një tërmet prej 20 shkallësh të Rihterit!

E martë, 06 Tetor 2009

Filloi të shkruhet enciklopedia e vërtetë

Enciklopedia reale, me pretekst të një enciklopedisë joreale, filloi të shkruhet prej atij momenti, kur albanofobët dhe historio-demagogët, duke e shfrytëzuar edhe pushtetin absolut të tyre, ia morën kompetencat dhe detyrat, albanologëve dhe historiografikëve të mirëfilltë shqiptar. Fatmirësisht, ky akt vandal i kësaj akademie dhe këtij pushteti, nuk u pritë me duartrokitje dhe heshtje, por me reagime të shumta dhe tejet shkencore! Reagimet dhe mobilizimi i elitës intelektuale dhe politike, kundër kësaj enciklopedie vrastare, dëshmoi qartë dhe bindshëm se, maltretimet, ofendimet, margjinalizimet dhe tjetërsimet, ky popull i shumëvuajtur nuk i duron më. Durimi i etnitetit shqiptar, ka mbërritur prej kohësh në kufirin ekstrem, ku si i tillë nuk mund të qëndroj më. Pra, patjetër duhet të shpërthej, për ta manifestuar llavën përvëluese kundër palës keqbërëse! Pala maqedonase i harxhoi të gjitha trikat, mundësitë dhe taktikat e të bërit keq shqiptarëve. Eksperimentet vrastare të palës tjetër, të paktën pas kësaj enciklopedia, shpresojmë që nuk do na përsëriten, ngase i madh e i vogël e kuptojë se, të tjerët apo populli pa identitet, pa mëshirë, si dhe i pa mëshiruar, dëshiron të gjallë të na fus në varrë, edhe atë jo në tokat tona autoktone, por në male diku, prej atje nga kishim ardhur!

Por, për kauzën kombëtare shqiptare, lansimi i një enciklopedie të tillë ishte një rast i mirë, për qërimin e hesapeve të gjithhershme. Ky rast, është një rast tejet i volitshëm që të bëhet ndarja e shapit prej sheqerit, apo të precizohet dhe saktësohet se kush është shap e kush sheqer si dhe cilat të drejta dhe obligime i takojnë të dyve.

Kronologjia e ngjarjeve të tmerrshme në këtë shtet ishte me të vërtetë tejet e dhimbshme dhe e papërshkrueshme për neve, duke filluar që nga themelet e dyshimta të këtij shteti e deri te kulmi improvizues (shfaqja e kësaj enciklopedie). Lutemi që kjo ngjarje skandaloze dhe tendencioze të jetë mejdani, ku do ta marrim sqarimin e shumëpritur, të përhershëm dhe përfundimtarë.

Mobilizimi i të gjithë kokave intelektuale, i opinionit të gjerë dhe i elitës politike shqiptare, me reagimet dhe studimet e tyre shkencore, veç më filluan ta shkruajnë enciklopedinë reale dhe të shëndoshë, për të gjithë popujt që jetojnë në këto treva. Qoftë me vonesë dhe pa paralajmërim të hapur prej akademikëve shqiptar për përgatitjen e një enciklopedie të tillë, shqiptarët me të madhe, duke u mbështetur në argumente të shëndosha albanologjike dhe historiografike, filluan të shkruajnë një enciklopedi, tërësisht tjetër krahas kësaj provokueses. Menjëherë pas promovimit të kësaj enciklopedia prej AMSHA, e që ishte prezent dhe mori fjalën edhe kryeministri i vendit, i njëjti që tashmë dëshiron të paraqitet si i pavarur prej kësaj enciklopedia, filluan të lulëzojnë temat e ndryshme në lidhje me botimin e këtij provokacioni dhe fyerjes së radhës.

Kontribute të veçanta dhanë, mediat e shkruara dhe elektronike, duke ia mundësuar shqiptarëve intelektual t'i paraqesin studimet e tyre, që lirshëm mund të themi se, nëse i mbledhim të gjitha analizat, reagimet, punimet historike, prononcimet dhe konferencat vetëm gjatë kësaj periudhe të shkurtër kohore, pa më të voglin dyshim do të del një libër i ngjashëm me enciklopedinë maqedonase (është realisht maqedonase, ngase në të fyhet rëndë shqiptarët, e improvizohet kombi i vetëquajtur maqedonas) kuptohet, i njëjtë në vëllim e jo në përmbajte!

Me fjalinë e liderit shqiptarë të Ali Ahmetit, e cila ishte e shkurtër në thënie, por e gjerë në kuptim se, "maqedonasit e prishen armëpushimin", tregohet dhe shihet qartë sinqeriteti i kësaj çështje. Fundja, historia e këtij lideri na tregon qartë brengosjen e tij për çështjen shqiptare, po ashtu edhe peshën e

madhe të kësaj fjalie! Kjo fjali, siç thashë edhe më lartë, ishte e vogël dhe e shkurtër, por pesha e saj është gjysma e enciklopedisë shqiptare. Ndërkaq, gjysmën tjetër do e plotësojmë ne opinioni i gjerë, elita intelektuale dhe politika mbarëshqiptare, pavarësisht përkatësisë së tyre partiake.

Pra, me këtë enciklopedi, maqedonasit i zgjuan zhurmshëm shqiptarët prej gjumit, duke i dhënë një rast të mirë dhe të arsyeshëm, që tashmë historinë dhe enciklopedinë për veti, ta shkruajmë vetë, përndryshe do i lejojmë që albanofobët dhe historio-demagogët sllavo-maqedonas, ta shprehin dhe të bëjnë eksperimente me indin e albanologjisë dhe historiografisë shqiptare.

E premte, 09 Tetor 2009

Dashuria dhe urrejtja e parë nuk harrohen dot

Çasti i parë në aspekt të përgjithshëm, gjithmonë dhe gjithherë do mbetet i paharruar, qoftë për mirë apo për keq. Të kesh sukses në dashurinë e parë dhe reale, do të thotë ta kesh siguruar normalitetin dhe lumturinë e jetës së mëtutjeshme, bile edhe atë të përjetshmën. Ndërkaq, urrejtja e parë do shoqërohen me një vazhdimësi të pafundme të tillë (urrejtëse), qoftë edhe nëse në ndërkohë, ndryshojnë qëndrimet. Për nga natyra, njeriu është i prirë të falë, ngase kjo cilësi është prej cilësive të Krijuesit të tij. Edhe pas faljes, në mendjen e njerëzve të sodit, përshtypja e takimit apo veprimit të parë, vështirë është të harrohet, për të mos thënë se, si e tillë mbetet shumë gjata, ndoshta më gjatë se jeta e vet njeriut në tokë. Përgjithësisht, ne shqiptarët përshtypjen e parë të dashurisë së mirëfilltë ndaj shtetit, vetëm njëherë në jetë arritëm ta përjetojmë. Atëherë pra, kur u shpallë Shqipëria e pavarur! Zaten, kjo dashuri e përjetuar përherë të parë si liridashës dhe ushtrues të lirisë në shtetin dhe shtëpinë tonë, e mbajti ndër vite kohezionin kombëtarë në të gjitha trevat shqiptare. Nuk na u shua në asnjë moment, etja dhe dashuria për atdheun dhe mëmëdheun Shqipëri. As atëherë kur, komunizmi e izoloi këtë vend prej vlerave të shëndosha kombëtare dhe fetare! Ngase, përshtypja ndaj këtij vendi ishte tejet e ëmbël dhe si e tillë do mbetet përgjithmonë. Copëtimi i shqiptarëve nga ana e Fuqive të Mëdha, na bëri të mundur ta përjetojmë, edhe urrejtjen e parë, ndaj një armiku të ri i quajtur sllavë, dhe si e tillë, besoj që do mbetet shumë gjatë apo përgjithmonë. Në këto treva në vazhdimësi u loz

me dinjitetin dhe identitetin tonë. Shpeshherë prej sllavëve ne cilësoheshim si fatkeqësi e tyre, ndërsa fatkeqësi e vërtet ishin mu ata fatzinj, ku shumë shpejt u përballën me falimentimin shumë-dimensional, i krijuar po nga dora e tyre. Edhe pse fundi i atyre që i masakruan shqiptarët ishte fatalitet, prapë këto politika shfarosë-se, nuk mbetën dot pa pasues. Njeri prej pasueseve të devotshëm dhe të përbetuar i kësaj mendësie të myktë, ishte edhe kryeministri i Maqedonisë, i cili nuk ka të ndalur së bëri lojëra fatale dhe mashtruese me shqiptarët, por edhe me vetveten. Sidomos, zbulimi i tij i tërësishëm prej anonimitetit personal dhe moral, qe i mundur të shihet me rastin e botimit të enciklopedisë maqedonase, i financuar prej tij, edhe atë në kohën e krizës ekonomike. Edhe pse ishte prezent dhe mori fjalim me rastin e promovimit të kësaj enciklopedie, duke e cilësuar si një të arritur të mirëfilltë shkencore dhe historike, prapë në seancën kuvendare, ai qëndroj dhe u paraqit si i pavarur. Pastaj, kur e kuptoi se qëllimin e kamotshëm e arriti, pra të nënçmimit dhe fyerjes së shqiptarëve, ai kinse u pendua dhe deklaroi se, kjo enciklopedi duhet të përmirësohet se, në të qenkan të fyer shqiptarët. Qëllimisht harroi se, plagët që na shkaktuan, nuk mbyllen me disa korrigjime tejet të vogla, bile plagët që ia shkaktuan popullit të ndershëm shqiptarë, është vështirë t'i mbyllin, edhe sikur të bënë vetëvrasje Bllazhe Ristovski, nga shkaku i gabimit të posa bërë. Në kohët kur maqedonasit e themeluan shtetin e tyre një-nacional, paralelisht me këtë, ne e sendërtuam urrejtjen ndaj këtij shteti. Në atë kohë i kishim disa njerëz që i nuhatshin gjërat objektivisht! Me kalimin e kohës, disa njerëz prej mesit të popullit shqiptarë, me urdhër të palës tjetër, ditë e natë u munduan që, marrëdhënie ndëretnike t'i përmirësojnë, të puqemi në vlera të përbashkëta të shëndosha, ta duam njëri tjetrin, ta mësojmë gjuhën e tyre më mirë se tonën dhe shumë tentativa tjera të shkrirjes së kulturës sonë në kulturën e tyre. Këto projekte, nuk u bëheshin nga dëshira e zjarrtë për të bashkëjetuar së bashku, por në ato projekte kishte para të majme. Sot, nga mesi i të dikurshmëve, kemi të atillë që kinse realisht

brengosen për çështjen e shqiptarëve në Maqedoni. Kuptohet, duke pësuar një dallim dhe ndryshim të vogël në mosfunksionimin e financimit të projekteve prej "Fondacioni Soros"! Ata të palodhshmit, punuan pandërprerë që ta duam njëri tjetrin, në vend që të sqarohemi njëherë e përgjithmonë me njëri tjetrin, tentuan që urrejtjen të na shndërrojnë në dashuri, dhe anasjelltas për palën maqedonase. Prapë ne shqiptarët e këtushëm këtë angazhim të madh dhe përfitues për ta, ia kthyem në pa efekt. Sepse, ky shtet tek ne mbolli urrejtje, e dëshiroj që përmes disa të angazhuarve nga radhët tona, të korrë dashuri! Edhe nëse enciklopedia korrigjohet në disa pjesë kontestuese, ne prapë nuk do mund t'ia falim këtë gabim të qëllimshëm. Ngase, një shtëpi e cila në çdo skutë të materialit të saj, duke i përfshirë edhe ndërtuesit e saj, është e përfshirë me urrejtje, atëherë çdo përmirësim dhe meremetim do jetë i kotë, sepse, asnjëherë nuk do shndërrohet në shtëpi të hareshme me ndërrimin e disa dritareve dhe me ndryshimin e ngjyrës të asaj shtëpie, por ajo do mbetet si e tillë derisa të mos shkatërrohet tërësisht. Rasti i përmirësimit të kësaj enciklopedia i ngjan, djegies së pleshtit për shkak të pisllëkut të jorganit!

Kësisoj, në mungesë të dashurisë absolute në këtë shtet, tash së fundi e përjetuam edhe një urrejtje të tipit të veçantë me rastin e botimit të kësaj enciklopedie. **Enciklopedia e korrigjuar assesi nuk do na qetësoj, përkundrazi pas një boksi të rëndë i mbërthyer me hekur, që njihet tek ne si, "boks i hekurt" ne do e marrim dhe pranojmë, edhe një boks tjetër të radhës.** Për dallim prej të parit, tashti do e pranojmë një goditje me grusht të pastër, pra pa hekur. Forca e goditjes, kësaj radhe do jetë më dëmtuese, sepse brenda vet grushtit mund të ketë ndonjë forcë artificiale të kamufluar prej neobllazhave. Pyesim, kush shkakton dhimbje më shumë, boksi i maskuar apo boksi i mbërthyer me hekur? Të dytë, por të kemi kujdes prej llojit të këtij boksi maskues, ngase eshtrat mund të na shndërrohen në mish!

E hënë, 12 Tetor 2009

Ngjasimi i fushatave parazgjedhore

Shpeshherë, neve shqiptarëve që jetojmë në shtetin tonë, por jo edhe nën pushtetin tonë, na krijohet një bindje tejet e gabuar kinse shqiptari që jeton në Maqedoni, Kosovë Lindore, Mal të Zi dhe Çamëri, dallohet dukshëm në mentalitet prej shqiptarëve të Shqipërisë dhe Kosovës, maje ndërmjet këtyre dy shteteve shqiptare, kemi ndasi të mëdha në veprimtari dhe mendësi. Deri diku janë të arsyeshme, dhe të kuptueshme dallimet ndërmjet nesh! Sepse, të jetosh dekada me radhë nën pushtetin e huaj, dhe të mos i nënshtrohesh fare asimilimit, është e pamundur.

Fatkeqësisht, kemi disa shqiptare të kryeqytetit të një shteti me emër dhe histori të kontestuar, që dukshëm dallohen me shqiptarët që jetojnë në Tiranë dhe Prishtinë. Ndërkaq, janë shumë të përafërt me bashkështetasit e tyre maqedonas! Kësisoj, në Çamëri dhe në Mal të Zi, çështja e asimilimit të çdoditshëm është bërë normale dhe e patjetërsueshme. Për dallim prej këtyre "shehërlive" të vjetër që asimilimin e shohin si gjë normale, nuk tentojnë të mbrohen nga një gjë e tillë.

Nuk është thënë kotë se, edhe njeriun më të egër dhe asocial, e keqja apo rreziku e detyron të bashkohet me të tjerët. Pra, edhe shqiptarët si trung me gjethe të shpërndara, historikisht e keqja apo rreziku i bashkoj. Këtë e argumenton lufta e Kosovës, zemërgjerësia e shqiptarëve që jetojnë në Maqedoni, në Shqipëri, në diasporë dhe në Kosovën Lindore, si dhe anasjelltas! Pas mbarimit të luftërave, disa njerëz fare pa moral nuk i përfunduan dhe harruan llogarit e së kaluarës, të llojit vëllavrasës. Edhe përkundër që tmerrësisht ikën prej armikut, si dhe kur të tjerët i çliruan, gjetën kohë dhe mundësi për ta sulmuar dhe për t'iu

hakmerr mikut apo vëllait për një vezë të pulës. **Ata harruan shumë shpejtë se, serbit ia lan tërë pasurinë!** Ky pra, është një imitim i verbër i atyre të cilët, sot e kësaj dite jetojnë në xhungël, bile atyre u ka hije se fundja jetojnë përnjëmend në xhungël, dhe me mendësi të majmunëve apo të kafshëve tjera.

Ne nuk hezituam që të imitohemi ndërmjet veti, edhe në fenomenin e fushatave parazgjedhore. E pakuptueshme! Ne të imitohemi dhe të ngjajmë ndërmjet veti, vetëm në dukuri të këqija. Absolutisht, nuk ngjajmë në shprehin e të lexuarit, të respektuarit, në të folurit, por në besimin dhe votimin e atyre që gjithherë na gënjejnë, na mashtrojnë dhe na shfrytëzojnë.

Deri atëherë pra, kur nuk do të vetëdijesohemi se banorët e xhunglës nuk bënë t'i imitojmë kjo do na ndodh, dhe në vazhdimësi do na përsëritet, bile mendoj që një ditë, ata do na padisin për plagjiaturë.

Unë një ditë isha në Prishtinë, dhe për së afërmi i pash sesa ata (vëllezërit tanë), ngjasojnë me neve që jetojmë në Maqedoni. Folklorizmi patriotik, premtimet boshe, shpifjet ndërmjet veti, sharjet dhe ofendimet, lavdërimet për namin e bërë, vizita e parqeve dhe të varfërve vetëm në këtë kohë, pastrimi i lapidarit të profesorit Femi Aganit, fitimi i poenëve politik në kurriz të të ndershmëve (dëshmorëve), financimi i gazetave për promovim të partive përkatëse, pushtimi i medieve me reklama të ndryshme, ftesa e këngëtareve të ndryshme, kuptohet duke kënduar me tesha, por pa rroba, pastaj prej atij koncerti po e njëjta elitë politike e frymëzuar prej këngëtares në fjalë, shkoi tek varrezat e dëshmorëve kinse për të bërë homazhe. Besa, në atë vend të dashur për mua, pash edhe një kombi-kamion i cili barte në vete një ekran të madh, e që në brendësin e atij ekrani të madh, fliste një njeri i madh, pra një ish-profesor i imi, prej të cilit më së paku një gjë të tillë e kam pritur! Nëpër tubimet që rastësisht kalova, pash edhe personalitete politike të vendit tonë, që historikisht dhe politikisht kishin qenë të dështuar në vendin e tyre të lindjes.

Fatmirësisht, atë natë fare nuk u ndal rryma, për një çast harrova se gjendem në valën e fushatës parazgjedhore, ku vet nxehtësia dhe dinamika e kësaj fushate prodhonte rrymë, dhe mbushje celularësh për të varfrit që vuanin për ushqim. U gëzova tej mase kur dëgjova në njërën prej medieve të këtij shteti, një fjali të harruar që moti dhe e ngulitur në trurin tim prej atëherë kur fillova ta hedh hapin e parë në këtë jetë. Fjalia që më bëri të rrëqethem dhe të ndihem mirë ishte, "**shqiptarët si shumicë në këtë vend...**", me të vërtetë më kishte marr malli shumë për këtë fjali. Por, njëri që më shoqëronte mua (i njihte mirë rrethanat në këtë vend dhe jashtë tij) më tha se, mos të mërzitem, se edhe ju atje jeni shumicë, ngase maqedonas të pastër shumë pak ka, por ka serb, vlleh, turq, romë, etj., por që për privilegje të caktuara deklarohen si maqedonas, ndërkaq shqiptarët janë shumicë, por fatkeqësia qëndron në atë se, historikisht roli i tyre ka qenë sikurse shkuma e detit, apo sikur shkuma e kokakolës në shuarjen e etjes.

Ç'pash e nuk pash, por në asnjë çast dhe në asnjë pikë nuk vërejta dallim në organizimin e fushatës parazgjedhore. Pra, të paktën në fushata parazgjedhore, shqiptarët që jetojnë në shtetin problematik e të vogël, por i njëjti që nuk i frikohet asnjë shteti, po puqen në mendësi dhe veprimtari me vëllezërit andej gardhit.

E hënë, 19 Tetor 2009

Nostalgjia për "vlerat" maqedonase

Pothuajse jemi prej popujve të rrallë, që marrim dhe shërbehemi në vazhdimësi me vlera të huaja, në të njëjtën kohë ku me bollëk na vërshojnë vlerat tona të pastra, historike dhe autoktone. Dikur ruajtja e vlerave autoktone shqiptare, me të vërtet ishte tejet e rëndë, ngase përpos që mbi paraardhësit tanë sundonte pamëshirshëm pushtuesi, atyre në të njëjtën kohë u mungonte edhe arsimimi. Të ndershmit tanë, përkundër që nuk ishin të arsimuar, por para se gjithash ishin të dinjitetshëm dhe, atyre nuk i mungonte dot ndjenja kombëtare dhe fetare që i shërbente për ruajtjen, kultivimin dhe mbrojtjen e vlerave të tyre kombëtare dhe fetare. Ato nuk pranuan dot t'i nënshtroheshin asimilimit kulturor, pra, edhe pse të pashkolluar e kuptuan mjaft mirë se, ky lloj asimilimi është më i rëndë se pushtimi dhe likuidimi fizik. Kësisoj, ata punonin dhe shpresonin se një ditë do të vijnë bij dhe bija të ndershëm/me, me moral të lartë e me mendje të ndritura, që pastërtisht do t'i dalin zot kësaj toke dhe vlere të bekuar shqiptare.

Me keqardhje, këtë segment të prognozës, detyrimisht duhet që t'ia kontestojmë. Imagjinoni sikur të ishte i mundur zgjimi i tyre prej varrit dhe ta bëjnë një krahasim të thjeshtë mes kohës së atëhershme dhe të sotshmes. Tek pastaj do ta kuptojnë se shumë mirë paskan qenë në varrë dhe mos informimi për neve këndej botës do t'i linte të qetë të rrojnë në atë botë të përjetshme!

Pas disa konflikteve të lodhura për shqiptarët në përgjithësi, e për shqiptarët që jetojnë në Maqedoni në veçanti, disa

analistë të pandërgjegjshëm dhe të papërgjegjshëm, të ftuar për debate të ndryshme në televizionin kombëtar ALSAT-M, që fatmirësisht në këso mediumesh është e garantuar liria e të shprehurit në gjuhën amtare, disa të pandërgjegjshëm që dikush po i thoshte (ka)analistë, në shtjellimin apo pështjellimin e gjërave të ndryshme, po ndjehen tejet të kënaqur dhe të rehabilituar me një nostalgji mallëngjyese, kur po flasin rrjedhshëm në gjuhën maqedonase. Në këtë krim dhe tendencë gjuhësore, edhe përkthyesit nuk po ndjehen mirë, sepse vëllanë e gjakut të tyre po detyrohen ta përkthejnë në shqip, që ta kuptojnë disa vëllezër shqiptarë që nuk e njohim mirë këtë gjuhë bullgare apo maqedonase.

Dikur, me të përmendur fjalën SHQIP, të gjithë shpirtrat dhe zemrat shqiptare i kaplonte një ndjenjë gëzimi dhe pikëllimi. Ndjenjë gëzimi, sepse ende nuk kishin humbur pinjollët që punonin për këtë SHQIPE të pastër dhe të pasur, kurse ndjenjë pikëllimi, sepse ende kjo SHQIPE e pastër nuk u lejonte të jehoj në vendet publike dhe vendimmarrëse. Ndërkaq, në kohën kur të paktën kjo gjuhë e ëmbël ka filluar t'i pushtoj edhe vendet e hapësirat publikë, prapë disa që nuk njohin gjë tjetër përpos interesit material, jetojnë kur përgjigjen dhe "analizojnë" në gjuhën maqedonase. Me këtë sikur dëshirojnë t'i thonë maqedonasve dhe neve se, ne përpos gjuhës tonë e dimë edhe një gjuhë tjetër të huaj. Këta pra, po i ditkan dy gjuhë të huaja, gjuhen shqipen dhe maqedonishten! Kurse, bashkëbisedues e etnitetit maqedonas, edhe pse i dinë disa fjalë në gjuhën shqipe, besa ndonjëri prej tyre lirshëm edhe mund të debatojë në gjuhën shqipe, por ja që asnjërin asnjëherë nuk e kemi dëgjuar të thotë në shqip PO ose JO, e të mos flasim për ndonjë fjali të urtë popullore, ashtu siç ne ndonjëherë nëpër oda të ndejës e kemi zakon të përdormi fjali të urta maqedonase në maqedonisht. Për të qenë paradoksi edhe më i madh, analistët në fjalë flasin dhe brengosen për cenimin dhe censurimin e gjuhës shqipe nëpër vende publike, por kujdes, këtë brengosje ata e artikulojnë në

gjuhën maqedonase, edhe atë në vendin ku i garantohet liria e të shprehurit në gjuhën amtare.

Po ashtu, nëse ndonjëherë i lexoni apo i shfletoni, edhe gazetat maqedonase do të keni rast t'i shihni disa publicistë shqiptarë, që kurrë më parë nuk i keni parë duke shkruar në gjuhën e tyre amtare në gazetat shqiptare. Unë nuk jam kundër, që dikush të shkruaj edhe në gjuhën maqedonase, t'i artikuloj problemet shqiptare edhe në gazeta të tilla, por nuk pajtohem dot që ndonjë shqiptar të shkruaj vetëm në gjuhën maqedonase, për arsye se një analizë po paguaka rreth 70 euro, apo edhe më shumë. Si duket këta të mençur paskan harruar se interesat dhe kontributi kombëtar nuk blihet dhe nuk shitet me para, por me flijim të pasurisë dhe të gjakut, që ata nuk kanë fare mundësi ta ndjejnë, sepse nuk i dinë se çka do të thotë të japësh diçka nga pasuria dhe familja jote për këtë atdhe. Fundja, nëpër këso gazetash, fare nuk do të kesh mundësi t'i shprehish brengat e shqiptarëve! Mos të bëhemi servil e të harrojmë t'i tregojmë palës tjetër se, dikush e shpenzoj tërë pasurinë, dikush dha jetën e dikush familjen, që dikush tjetër t'i vjelë frytet e paraardhësve tanë flijues.

Por, nostalgjia për "vlerat" maqedonase nuk fillon dhe nuk mbaron vetëm me çështjen e përdorimit të gjuhës së tyre...

Unë rrëqethem kur i shohë, edhe disa sipërmarrës shqiptar me punëtore të etnisë maqedonase, edhe atë në kohën dhe vendin ku papunësia te shqiptarët është në maksimum, po ashtu më brengos vullneti i disa shqiptarëve për të blerë produkte maqedonase, në kohën dhe vendin kur të njëjtat produkte i shesin, edhe disa tregtar të ndershëm shqiptarë. **Indinjohem thellë kur dëgjojë për fotografin maqedonas, i cili nëpër mbrëmje të ndryshme gazmore fotografon vajzat dhe gratë shqiptare, në të njëjtën kohë kur vajzat dhe gratë shqiptare i kishin harruar gjysmën e rrobave në shtëpi.** Aq më keq me sytë e mi një ditë i pashë disa "patriotë" shqiptarë, duke kuvenduar për çështjen e statusit të ish-ushtarëve të UÇK-së, invalidët e luftës dhe për dëshmorët e kombit, por ata këtë "brengosje" po e artikulonin

duke pirë birrë të Shkupit, emri i kësaj pije mallkuese në origjinal është "skopsko". Ata përpos që e thyen një ligj të fesë së cilës i përkisnin (ishin myslimanë me emër e me familje), ata me konsumimin e asaj pije në mënyrë të drejtpërdrejtë kontribuuan në mbushjen e qeses së atyre që i dhanë shkas të bisedojnë për dëshmorët e kombit. Konfliktin e armatosur, pikërisht këta pronar të kësaj birrarie dhe disa pronar të ngjashëm me ata, e ndihmuan financiarisht që sa më shumë t'i sjellin dëme shqiptarëve. Kurse po këta shqiptarë, sot në mënyrë vullnetare marrin pjesë në financimin e atij që dikur financonte për t'i mbytur. Por, kompania e kësaj birrarie nuk ka të ndalur së mbyturi shqiptarët. Dikur këtë e bënte në mënyrë të hapur dhe të menjëhershme, kurse aktualisht këtë vdekje të zemrave është duke e bërë nën emrin e liberalizmit njerëzor dhe duke mos u ngutur fare!

Dikush mund të thotë, ore djalë shkenca e ekonomisë dhe e tregtisë nuk njeh dhe nuk bën dallime në kombin, racën dhe gjininë! Kjo është e vërtetë, por e vërtetë vetëm në shtetet e zhvilluara dhe me një demokraci të mirëfilltë, ku mbledhja e mjeteve financiare dhe shpenzimet e të ardhurave publike bëhet në proporcion të drejt për të gjithë. Kurse, në këtë shtet, vallë a kemi ndonjë segment ku pjesëmarrja në detyrime dhe në privilegje është e barabartë për të gjithë? Përpos akumulimit (mbledhjes) të mjeteve monetare që bëhet në mënyrë të barabartë, në asnjë segment tjetër institucional nuk jemi të barabartë!

E mërkurë, 25 Nëntor 2009

Bujanoci - vendi më i (pa)sigurt në Serbi

Përkundër që, prej kohësh flitej për ndërtimin e një baze të madhe ushtarake në një pjesë të rajonit të Kosovës Lindore, prapë pushtetarët e atjeshëm dhe të Shqipërisë Londineze, nuk kishin dot mundësi të gjenin kohë, që të paktën ta sensibilizojnë para faktorit ndërkombëtarë (OKB, OSBE dhe të ngjashme) problematikën në fjalë, edhe pse këto organizata shumë më herët ishin njoftuar për një gjë të tillë, qysh atëherë pra, kur politikanët tanë garonin se cili më hijshëm po e fyen oponentin politik të tij.

Është absurditet i llojit të veçantë dhe trishtues të ndërtohen baza ushtarake serbe në truallin shqiptar, edhe atë me pretekst që të sjellin siguri dhe stabilitet në këtë rajon. Nëse është kështu, atëherë Bujanoci me qytetarët e tij, do të shpallet si vendi më i sigurtë dhe me një ekonomi më të zhvilluar në tërë territorin e Ballkanit perëndimor.

Por, shkenca e sigurisë kombëtare dhe ndërkombëtare e pohon të kundërtën! Kësisoj, në një vend ku, pushtetarët janë të prirë dhe ndjejnë nevojë që të ndërtojnë baza ushtarake, të ndajnë mjete buxhetore për ushtarë profesionistë dhe të investojnë në armatim të kalibrit të rëndë, atëherë vendi apo shteti në fjalë, në aspekt të sigurisë dhe stabilitetit të përgjithshëm nuk është fare në nivel. Ndërkaq, pushtetarët serb në krye me krye(idiotin)tarin, përmes ndërtimit të bazës ushtarake në Cepotin, lokacioni i së cilës është në komunën e Bujanocit, afër kufirit me Kosovën, dëshiron t'i sjell paqe këtyre banorëve, si dhe pjesa më e madhe e kësaj mendësie sllave të myktë është që, shtetit fqinjë (Republikës së Kosovës) t'ia tregoj dhëmbët e luanit

me erën e tyre të qelbur, duke harruar se tashmë Kosova këto dhëmbë i sheh si të miut.

Të gjithë e kemi të qartë, i madh e i vogël se me investim në ushtri, i vetmi fitim dhe fryt është konflikti dhe lufta! Për të qenë ironia edhe më e madhe, këtë e di fort mirë edhe bashkësia ndërkombëtare, por ja që po hesht përballë këtij skandali, bile si shpërblim të gjenocidit në Bosnje, Kosovë dhe në Kosovën Lindore, ka vendosur t'ia bëj të mundur lëvizjen e lirë në tërë territorin e Evropës. Kontradikta tjetër qëndron në atë se, kjo baza famëkeqe po ndërtohet në truallin shqiptar, për t'i mbrojtur shqiptarët prej shqiptarëve të shtetit më të ri në botë. Çudi, serbet (kriminelët) po i mbrojnë shqiptarët prej shqiptarëve! Siç po shihet, Serbia në këto eksperimente dhe kalkulime të turpshme për veten dhe për shqiptarët në veçanti, në mënyrë absolute po manifeston një liri terrorizuese ndaj shqiptarëve. Vallë a gjendet njeri me nam e nishan, që mund t'i pengoj në gjëra të këtilla? Bamir Topi, i cili ende ka frikë të vijë për vizitë te vëllezërit e tij këndej kufirit improvizues dhe, i cili prej vizitës në Kosovë në mesin e serbëve të Kosovës, i cili ofronte paqe ndaj tyre, urojë që shqiptarët e "*Luginës së Preshevës*" të mos keqtrajtohen dhe të mos keqpërdoren, duke harruar qëllimisht i shkreti se përball syve të tij, po keqtrajtohen dhe keqpërdorën këta shqiptarë, ndërkaq Sali Berisha është i tej impresionuar që vendi i tij arriti të inkuadrohen në organizatën më të madhe politike-ushtarake të NATO-s, si dhe aktualisht është duke e luajtur rolin e pajtuesit të gjaqeve, ku maksimalisht është duke punuar që Maqedonia dhe Greqia ta gjejnë një gjuhë të përbashkët rreth zgjidhjes së emrit.

Pse nuk bëhen burra këta, e të vendosin që një dit të vijnë në Bujanoc, të marrin pjesë edhe këta në inaugurimin e kësaj baze, mos u frikoni se s'guxon kush t'ju prek, ngase baza në fjalë është e ndërtuar në truallin e juaj dhe qëllimi i saj është "mbrojtja" e provincës shqiptare. Fundja, ju sot jeni në NATO, në organizatën më të madhe botërore ushtarake, mos i lejoni vëllezërit tuaj të jetojnë përkrah bazës më të madhe serbe, mos e lejoni që armiku

të na mbroj prej mikut tonë, ngase prapë dhe gjithmonë armiku i mikut tonë mbetet armiku i jonë, si dhe mos e lejoni që Serbia ende të vazhdoj të luaj me indin tonë kombëtar. Edhe njëherë ua rikujtoj, Shqipëria sot është në NATO, Kosova sot është shtet, pra, mos të lejojmë që Kosova Lindore të mbetet e përbuzur dhe fare pa shqiptarë, sepse pastaj po del se gëzimi i shqiptarëve i të gjithë trevave, paska qenë i kotë me rastin e inkuadrimit të Shqipërisë në NATO.

Na tingëllon mjaft rëndë, kur disa përfaqësues ndërkombëtarë na thonë se, ju shqiptarët nuk keni arsye më të mërziteni, sepse ju tashmë jeni në NATO, jeni në organizmin më të sigurt të botës, nëse ndonjë shtet shpreh dëshirën e tij për ta provokuar Shqipërinë, ai pra ka hy në bela me Fuqitë e Mëdha. Ç'farë mund t'i themi përfaqësuesit në fjalë, kur po të njëjtët shqiptarë, vëllezërit e gjakut në shtëpinë e vet janë bërë shërbëtor dhe vegla për realizim të planeve gjeostrategjike dhe gjeoekonomike të sllavëve, ku mbrohen duke mos qenë të sulmuar nga askush, përpos prej atyre të cilët pretendojnë se kinse janë duke i mbrojtur, me ndërtimin e sa më shumë bazave ushtarake në truallin shqiptarë.

Këtu paskemi ndarje ekstremi, ku një pjesë e shqiptarëve sot janë në NATO që denjësisht përfaqësohen dhe një pjesë e shqiptarëve sot janë buzë bazave ushtarake serbe ku tmerrësisht përfaqësohen dhe si për gjynah vetëm shikohen prej shtetit shqiptarë i cili sot është më i fortë se kurrë.

Pra, asnjëherë nuk kemi dëgjuar apo lexuar se ujku po u kujdeska për ruajtjen e deleve, përpos në rastet kur ujku kishte planifikuar t'i hajë të gjalla dhe në mënyrën më të lehtë të gjitha delet, me pretekst të këtij llojit të përkujdesjes!

E premte, 25 Dhjetor 2009

Viti 20(01)10, ndërmjet kërcënimeve dhe hipokrizisë

Nëse e pranojmë tezën se dita e mirë shihet në mëngjes, atëherë unë ankohem se, këtë lloj të ditës në fillim të vitit të ri dhe të vjetër, nuk arrita dot ta shoh, përkundër që fillim e mbarim isha prezent në shtetin e Maqedonisë. Tash, ndokush me të drejtë mund të më thotë, është normale që këtë fillim të mbar të mos e kishe parë, kur dihet mirëfilli i të kaluarës së zymtë që ndodhi në këtë vend pa kuvend e pamend!

Kalendarët tona gregoriane, ende pa përfunduar viti 2009 i ndërruam, por edhe pasi përfundoi ky vit, mendësia e qeverisjes dhe përditshmëria e qytetarëve, edhe më tej u thellua dhe batisi në kriza dhe labirinte tendencioze e mashtruese. Kësisoj, në pyetjen e gazetarëve drejtuar politikanëve se, ku do e prisni vitin e ri, ashtu ata të rehabilituar dhe me ca buzëqeshje sporadike që pa dyshim ishin ironike, pohuan se, “shikoni përskaj gjithë këtij viti të lodhshëm dhe të shumë ngarkuar, këtë ndërrim të mot-moteve do e kalojmë në shtëpi me familjen, duke krijuar kështu një ambient të ngrohtë dhe përplot harmoni në familje”.

Jo vetëm unë, por të gjithë ata që din dhe duam të vlerësojnë objektivisht, me këtë rast dhe pohim të tyre, në masë të madhe do të habiten. Si është e mundur që njeriu të paktën për një çast të qëndroj i rehabilituar dhe i kënaqur me familjet e tyre, duke e ditur se po këta të besuarit e popullit, që u zotuan që vajin do e shndërrojnë në buzëqeshje, urinë në ngopje, si dhe jetimët e përmalluar për prindërit e tyre që dhanë jetën për liri, në fëmijë të hareshëm e të gëzuar, të vazhdojnë të mbesin të lumtur duke

dhuruar në familjet e tyre hare dhe gëzim! Por, në vend të këtyre shndërrimeve pozitive, tash pas vitit 2009, disa përgjegjës në këtë shtet, aspak të përgjegjshëm, na kujtuan vitin 2001, njëri duke na përmendur paralajmërimet e Al-Kaedës, për ndonjë sulm të mundshëm në Maqedoni dhe, tjetri duke na bërë neve dhe atyre me dije se, nëse nuk do të zgjidhet statusi i ushtarëve të lirisë, mund të përsëritet viti 2001. Këto dy paralajmërime, që realisht janë kërcënim për sigurinë dhe rehatin e qytetarëve, me automatizëm na kujtojnë vitin 2001, vitin e rëndë dhe shpresues për shqiptarët dhe pretekst e njollosje tendencioze për fenë islame në përgjithësi (Rasti i shkatërrimit të dy kullave binjake). Edhe pse, luftën e 2001-shit, në përgjithësi e përjetuam rëndë, veçanërisht popullata e Komunës së Likovës dhe e malësisë së Tetovës, prapë në fund të dhimbjeve tona shpirtërore vezullonte dhe kumbonte krenaria jonë kombëtare për një të ardhme më të begatshme. Fatkeqësisht, edhe ndjenjat që shpeshherë janë të pagabueshme e nuk tradhtojnë kurrë, pas vetëm katër viteve e pamë se edhe ndjenjat tona ishin shndërruar në ndjenja të hutuara që në vazhdimësi gjeneronin pasaktësi! Ndërkaq, edhe pse kaloi pothuajse një dekadë, më në fund dikujt ia kujtua se, për të arritur diçka në këtë shtet, po dashka me përdor metodën e kërcënimin apo të "ramjes grusht tavolinës".

Por, kush mund të më bind se, edhe nëse si metodë të zgjidhjeve të shumë probleme dhe padrejtësive do e përdorim krenarinë dhe veprimtarinë e vitit 2001, e nuk do na përsëritet prapë "PAS viti 2001"! Jo të nderuar, ajo që ndodhi iku dhe në vazhdimësi na shoqëroi, edhe pse dikush nuk deshi fare ta dëgjoj. Në këtë krenari kombëtare u koritën një pjesë bukur e madhe e intelektualëve, u bë shoshitja e patriotëve teorik dhe praktik, u shkatërruan shumë shtëpi në Sllupçan, Vaksincë, Orizare, Haraçinë e gjetke, u vranë ushtarë, civil shqiptarë, i vranë babë e birë para syve të botës në Tetovë, e prapë vetëdija kombëtare në nivel të udhëheqjes mbeti ajo që ishte më parë, prapë ata që nuk ishin as intelektual, as luftëtarë i pushtuan postet të cilët i gravitonin

privilegje të shumta, prapë ish-ushtarët e thjeshte për një vend pune u deshtë që t'i "nënshtrohen" atyre që luftën e përdornin vetëm si përfitim material dhe atyre që luftën ishin frikuar ta shohin, edhe në ëndërr. Me rëndësi ishte që pas luftës, të ishe një maratonist i shkëlqyer për partitë politike, kjo pra, ishte me rëndësi, bile në një kohë kur sundonte një parti pa legjitimitet të popullit shqiptarë, ishte marre e madhe të lajmërohesh se ke kontribuar diçka për luftën e 2001-shit, edhe pse në radhët e asaj partie politike, kishte njerëz që kishin marrë pjesë ndershmërisht në këtë luftë!

Kështu, këto lëmshe politike dhe ushtarake ma kujtuan betejën e Koshares, ku për çlirimin e atij vendi të bekuar, apo për thyerjen e kufirit shqiptaro-shqiptar, vepronte FARK-u dhe UÇK-ja. Por, po i pyete për divergjencat e tyre rreth asaj beteje të lavdishme, gjithsecili do të përgjigjet, "pavarësisht divergjencave, ne së bashku i shporrëm armiqtë barbar serbo-sllav". Ndërsa te ne, aq shumë ishin të mëdha divergjencat, sa që i lejuam dhe i dhamë mundësi palës tjetër të luajt shesh-besh me ndjenjat tona.

Pas gjithë mposhtjeve politike e njollosjeve ushtarake, nuk e di se kujt i paska mbetur të paktën një qelizë, që nuk ka turp të mendoj për kthimin e vendit në vitin e krenarisë kombëtare (lexo: kujtone, por vetëm mbushuni me mend e ecni përpara), krenari e cila zgjati vetëm katër vite, që për mendimin tim ishte zgjatje e bollshme, kur i merr parasysh disa Komuna dhe qytete shqiptare që këtë luftë të lavdishme e panë vetëm si një insert të shkurtër nëpër ekranet e tyre televizive, e që menjëherë pas luftës u paraqiten si "shpëtimtarë të kombit", ku Komunën e Likovës e lanë në cilësinë e muzeut, bile tash me ndaljen e dritave publike, kjo Komunë e mori pamjen e një muzeu shumë të lashtë, që do e josh për ndonjë hulumtim të mundshëm, edhe Kuzmanin. Në këtë vit, do të jemi të kërcënuar, edhe prej Al-Kaedës!

Po çka i bëri Maqedonia Al-Kaedës? Mos u friko se Al-Kaeda nuk merret me ty, je shumë e vogël, aq e vogël sa që nuk

shihesh, e që në vend të mikroskopit, kjo organizatë tashti po e përdorka vetëm teleskopin, pra mos u tut se nuk të sheh. Fundja, i keni Alfat që do i dalin zot këtij vendi! Por, jo, jo, as njëra as tjetra nuk do të ndodh, porse kjo nuk është gjë tjetër, pos që të filloj edhe në Maqedoni të krijohet një pretekst artificial për luftimin e terrorizmit islamik, e që me automatizëm aludohet për shqiptarët, sepse siç dihet, të gjithë shqiptarët në këtë vend i përkasin besimit Islam. Mjaft më me pretekste artificiale të vet sajuara, mjaft më me leksione dhe informacione të Izraelit, ngase më në fund ju do të pësoni. Kujdes! **O ju të cilët keni krizë të identitetit kombëtare dhe fetarë, zgjohuni o ju të cilët në aspekt kombëtar dhe fetar jeni të pastër si loti!**

E shtunë, 09 Janar 2010

Kryearkitekti i arkitektëve rrënues

Ditët të cilët po i jetojmë në këtë virus shtet të vogël, gjithsesi i ngjajnë njeriut i cili ka nevojë të madhe për gjak, por nga pakujdesia dhe mos dëshira që ky njeri të jetojë tutje, i vonohet qesja me gjak, të cilën vullnetarisht ia ka dhuruar vëllai i vet dhe, në mungesë të këtij shërbimi jetësorë pacienti në fjalë vdesë, e më pastaj përgjegjësit e këtij krimi vijnë në varrimin e të ndjerit dhe shprehin, mërzi, keqardhje dhe ngushëllime që e humbën një shtetas dhe një votues të tyre. Përafërsisht në këtë nivel të gjendjes janë shqiptarët, që ende po jetojnë në Maqedoni. Këtu te ne, askush më nuk ka të drejtë të pohon se, pas çdo dimri vjen pranvera, apo pas çdo të keqe, vjen e mira. Këtu pas çdo dimri, erdhi dimri më i ftohtë se dimri i kaluar dhe pas çdo të keqe përjetuam një të keqe tjetër, që pastaj asgjë nuk na u duk e keqja e kaluar! **Unë shpeshherë po gaboj kur po pohoj në shkrimet e mia se, pas kësaj padrejtësie dhe lajthitje i erdhi fundi kësaj qeverisje dhe shtetit me kësi lloj qeverisjesh, që edhe fituesi i çmimin "Nobel" Ivo Andriqi do ia ketë lakmi për këto plane mjaft diplomatike rreth zhdukjes së gjurmëve historike të shqiptarëve.** Nobelisti në fjalë e mori këtë çmim, sepse ishte shkrimtar i spikatur për kriminelët serb dhe si rrjedhojë e kësaj aftësie ai i hartoi planet në letër për zhdukjen dhe dëbimin e shqiptarëve prej vendeve autoktone të tyre, ndërsa Hitleri nuk e gëzoj një privilegj të tillë, sepse zhdukjen e hebrenjve e kishte bërë pa platformë dhe pa bashkëpunim me akademinë e shkencave. Ndërsa kryearkitekti ynë, për ta fituar një çmim të atillë, është

duke luajtur me standarde të dyfishta, pra duke marrë prej të dyve ngapak "mësim!

Pas një sërë padrejtësish që është duke i bërë kryearkitekti kundrejt nesh, që dikush po i thoshte (pakrye)ministër, këto ditë patëm rastin të njoftohemi me planin e ri të urbanizimit, që me mburrje të madhe na e artikuluan elementin sllavo-ortodokso-barbaro-antik.

Unë tash nuk do e marr përgjegjësin për parashikimin e jetëgjatësisë së kësaj mendësie qeverisjeje. Sepse, pastaj mund të dal qesharak përpara lexuesve, edhe atë në kohën kur këta të "tanët" do të ulën në sofrën e përbashkët për të ngrënë gjellën, po ashtu të përbashkët, ku dikush në fillim të ngrënies do të thotë "bismilah" e dikush do të "kryqëzohen", kurse dikush tjetër do ta filloj ushqimin, duke thënë "në emër të popullin po ia filloj të ha këtë ushqim që na e solli populli, dhe sevapet e këtij ushqimi si hedie do t'ia dërgoj popullit". E pse mërzitesh more popull i dashur, kur hedijet utopike të vijnë njëra pas tjetrës.

Pasi e shikova me kureshtje prezantimin e infrastrukturës së re, e kuptova se realiteti i atëhershëm dhe i sotshëm në lidhje me këto figura, dukshëm bien ndesh me arsyetimin e arkitektëve të sotshëm. Nëse do të vendoset Aleksandëri i Madh në atë vend (ku është vendi i Burmali Xhamisë), nga shkaku se ky hero i madh paska qenë maqedonas dhe maqedonasit e sotshëm janë trashëgimtar të tij, atëherë, urtësia e vendosjes së disa kuajve nuk mund të kuptohen ndryshe, përpos se kuajt e atëhershëm paskan qenë maqedonas dhe këta të sotshmit qenkan trashëgimtar të atyre kuajve. **Nëse do të vendoset figura e Toshe Proevskit në sheshin e përsheshtë, atëherë maqedonasit e dikurshëm, kuptohet nëse edhe për një kohë të gjatë do të mbetën të tillë, do ta kenë rastin të krenohen me "vlerat" e vllehve, e assesi me vlerat maqedonase.**

Këto pak kontradikta të përmendura, edhe më tutje e tregojnë dhe e dëshmojnë zhytjen e kryearkitektit në adoleshencën e tij arrogante. Këto projekte, kryearkitekti lirshëm çdo natë mund

t'ia tregoj gruas dhe fëmijëve të tij, në cilësinë e një ëndrre personale, e assesi neve të cilët jemi të sigurtë se ky plan nuk është gjë tjetër përpos se provokim i radhës dhe mbulim i zhytjes së vendin në recesion ekonomik. Ky avaz i pakuptimtë do të zgjatë për aq kohë sa është në Qeveri ky far kryearkitekti, ndërkaq, qëndrimi i tij në qeverisje do të zgjat për aq kohë sa të mbretëroj kaosi dhe mos zhvillimi ekonomik. **Ai në vend që ta hedh në bronz veturën e BMW-së pranë fabrikës së BMW-së, apo ndonjë veturë e cila do të jetë prodhim i këtij shteti, po ashtu me markë vendore, ai në vend të kësaj, në bronz i hedh kuajt, ku tregon se pranë këtyre jetojnë dhe punojnë kuajt, por jo si kuaj!**

Pas këtij zinxhiri maskarallëqesh, vallë gjendet njeri nga radhët tona që ka guxim të predikon paqe dhe të kërkon mirëkuptim rreth shumë anomalive që po ndodhin në këtë nënqiell? Habitem se si askush nga të besuarit tanë, nuk po i sheh disa shqiptarë që pas "suksesit qeveritar të liberalizmit të vizave" kanë filluar me të madhe ta marrin botën përsëri në sy, ku si vende më të preferuara dhe me kushte pranuese më të lehta, për momentin i janë paraqitur Belgjika dhe Norvegjia, ku të gjorët shqiptarë me padurim po presin që t'i thonë lamtumirë këtij vendi, pra me padurim po presin që të humbin prore (lexo: të asimilohen) dhe ta zvogëlojnë përqindjen e shqiptarëve në këtë vend. Jo unë, por askush tjetër, përveç të besuarve tanë, nuk ka të drejtë t'i ndaloj apo të paktën t'i thotë se, ju nuk duhet të shkoni atje që të asimiloheni, por duhet që ju të qëndroni në vendin tuaj të lindjes, qoftë edhe nëse vdisni për bukë.

Atë çka kryearkitekti nuk e arriti me stimulimin e natalitetit në zonat maqedonase, e me stimulimin e mortalitetit në zonat shqiptare, këtë tashmë po e bënë përmes krijimit të qëllimshëm të kushteve të rënda ekonomiko-sociale në zonat dhe familjet shqiptare. Vallë, a kaq shpejtë i harruam shpërnguljet për në Turqi, Amerikë, Evropë dhe gjetke? Kësisoj, a nuk na vjen fare inati që vëllezërit e gjakut, gjithherë dhe në vazhdimësi t'i quajmë

mërgimtar? A mendoni se këta të dëshpëruar, ndonjëherë do të mendojnë për flamurin dhe gjuhën shqipe, kur e dinë se po nga të njëjtat në vendin e tyre të lindjes ishin të privuar? Cilit të ri, pastaj politikanët shqiptarë do t'i kërkojnë vota, apo nga eksploatimi marramendës i parave jashtëligjore do të organizojnë special aeroplan për mërgatën shqiptare që të vijnë të votojnë për këta. Besoni që ata juve më nuk ju besojnë dot, ata së pari juve nuk ju besojnë se mund të fluturon aeroplani, e lere më diçka tjetër, fundja të drejtën e votës do t'ia privoj ky shtet përmes ligjit.

E pra, nëse e lejojmë që kryearkitekti i arkitektëve rrënues, edhe më tutje të veproj kështu, atëherë, politikanët tanë mund të kërkojnë vota vetëm prej gjyshit tim haxhi 90 vjeçar!

E hënë, 08 Shkurt 2010

Sikur deputetët shqiptarë të kërkojnë azil politik

Duke i parë dhe i përjetuar në vazhdimësinë e pafundme lojërat e fëlliqura të pushtetit politik maqedonas dhe servilizmin e të etshmëve për pushtet, nuk na mbetet tjetër, pos të hapim ndonjë dilemë të re, por e njohur në kokat meditues të popullit, rreth hapave konkret të deputetëve shqiptarë në të ardhmen. Të mos keqkuptohemi! Hapat e deritanishme të deputetëve tanë, nuk i kanë sjell dot mjerimit social dhe anarki personale. Nëse i shikojmë deputetët të mbërthye me plot imunitet si individ fizik apo juridik, atëherë çdo tentativë këshilluese e jona do të bie poshtë, ngase gjendja e tyre individuale dhe familjare në aspektin ekonomiko-financiar është dhe ka qenë e shkëlqyeshme, apo gjithmonë kanë qëndruar ndërmjet ekspansionit financiar dhe bumit ekonomik. Ndaj, nuk do të bëjmë fjalë për statusin dhe për privilegjet e tyre të panumërta individuale, por për obligimet me të cilat i ka ngarkuar populli.

Nëse ndonjë deputet pyetet për rëndësinë e kësaj detyre madhore, ai pa hezitim do të përgjigjet se, “është privilegj i madhe të jesh deputet”, në vend se të thotë, “është përgjegjësi e madhe të jesh deputet”. Fundja, vetë nocioni “deputet” do të thotë, përfaqësues i popullit në Kuvend, i zgjedhur me votim të përgjithshëm të barabartë, të drejtpërdrejtë e të fshehtë, i cili ka për detyrë t’u shërbejë me ndërgjegje e besnikëri interesave të popullit, çështjes së atdheut, mbajtje lidhje të ngushta me zgjedhësit, dhënia llogari përpara tyre, si dhe sensibilizimin e artikulimin e problemeve, brengave dhe pengesave të ndryshme në Kuvend, prej së cilit në bashkëpunim edhe me dy pushtetet tjera, të përpiqen apo të orvaten në gjetjen e shtigjeve dhe zgjidhjeve të shumë halleve të popullit.

Ndërkaq, heshtja vrastare dhe vjedhja, më falni vjelja e frutave që gjenerojnë anarki, pa dyshim që janë indikatorët parësorë që tregojnë të kundërtën e kuptimit të nocionit "deputet". Vetë ndërgjegjja e të qenit deputet në vetë ngërthen shumë obligime, sa që vetëm një pjesë të vogël të thesarit të brendshëm të ndërgjegjes së tyre ta realizojnë në praktikë, atëherë mirëqenia jonë e përgjithshme, s'kishte lënë pa na përshëndet me një buzëqeshje të ëmbël .

Por ja që, keq-qenia jonë na mbyti duke vajtuar, sepse kodi moral dhe ligjet po vuajnë për ruajtjen e virgjërisë së tyre ndër vitesh (lexo: që moti deputetët tanë nuk i kanë lexuar si duhet ligjet).

Të njëjtët deputetët që prej popullit janë angazhuar, për t'i përçuar preokupimet e tyre deri në kuvend, ata janë angazhuar (pa dyshim në përputhje me ligjet duke mos i dal zot asnjë ligji) nëpër shumë komisione tjera që i gravitojnë mëditje për secilin angazhim TEORIK. Teorik, sepse ende s'pamë diçka konkrete prej këtyre të besuarve tanë!

Fjalë bie, unë jam banor i Komunës së Likovës, dhe në pamundësi që personalisht të ankohem, apo të kërkojë që ndonjë temë me një rëndësi të veçantë të vendohen në rend të ditës dhe të diskutojmë, e pastaj ta marrim ndonjë vendim të arsyeshëm për popullin, dhe për këtë detyrë e besova, kuptohen sikurse shumica e popullit një person të zonës tonë që të na përfaqësoj si duhet.

Fatkeqësisht, logjika e tillë e funksionimit në këtë sistem demokratik, në këtë rast më dëmtoi, sepse nëse unë personalisht apo një grup i qytetarëve vendosin që një ditë të shkojnë në kuvend për ankesa dhe heshtje të shumta të deputetëve tanë, qysh në hyrje të objektit do të na kthenin mbrapa, edhe atë bazuar me ligjet që janë propozuar po në kuvend, me arsyetim se juve ka kush ju përfaqëson. Kështu pra, ndodhë kur shalqiri bëhet në degë të qershisë, kurse qershia në loz të shalqirin, dhe çdo thyerje e kokës duke pushuar nën hijen

e pemës së qershisë, në bazë të logjikës vepruese të deputetëve qenka e arsyeshme.

Pas kësaj kontradikte të shumëfishtë, kontradiktë që tolerohet edhe me ligj, mua (lexo: edhe juve) nuk më mbetet tjetër, pos të mësohem besnikërisht të përballem me rrugët e kohës së gurit, ku e mira e vetme e këtyre rrugëve është se, zinxhiri i tankeve do të prishet në mes të rrugës, nëse eventualisht ndonjë e tillë ka vendosur që të na sulmoj, kuptohet sikurse gjithmonë për arsye të vet-krijuara. Përskaj gjithë këtyre marrëzira, neve na mbetet të mallëngjehemi, kur e shohim braktisjen e të rinjve prej fshatrave dhe qyteteve, pastaj dëgjojmë duke u ankuar mësuesit për zvogëlimin e numrit të nxënësve nëpër klasa, si dhe kulmi i gjithë këtij itinerari tmerrues, është shitja e ndonjë kapitali me vlerë e fituar me djers për gjatë tërë jetës dhe shitja e floririt të grave që dikur sinjalizonte fillimin e dashurisë bashkëshortore, duke e shndërruar këtë mjet pastaj në para që sinjalizojnë humbjen e përjetshme të dashurisë atdhetare. Në ndërkohë dëgjojmë një lajm sa i mirë aq edhe prekës. Lajmi ka të bëjë me mospranimin azil të qytetarëve të Maqedonisë. Tashmë kur të kthehen këta të humburit e dyfishtë në vendlindjen e ”vdekjes”, edhe më tej do t’i rëndohet jeta sociale, ngase thesarin e vetëm dhe të fundit e avulluan për një avullim artificial. Pas shumë rrugëtimeve dhe labirinteve të mundimshme, të zgjedhurit e popullit apo lojtarët legjitim në stadium, e shikojnë ndeshjen e futbollit prej në publikë, duke ikur dhelpërisht prej inkuadrimit në lojë.

Pra, që ky itinerar i dhembshëm për shqiptarët të mbyllet, duhet që përfundimisht edhe deputetët tanë ta provojnë “lumturinë” e të kërkuarit dhe të qenit azil, bile këta mund të kërkojnë azil politik, duke u arsyetuar se atje nuk dëgjohet dhe përfillet fare zëri i tyre, edhe atë në një vend demokratik. Në mos më shumë, këta deputetë do të futen në Librin e Genisit, dhe tek pastaj milionat në dollar dhe votat në popull do t’i arsyetohen!

E hënë, 22 Shkurt 2010

Për hir të së kaluarës maqedonase, po ikë e tanishmja shqiptare

Në shtetin e ashtuquajtur Maqedoni, vazhdojnë të ndodhin aq shumë gjëra të habitshme, sa edhe vet Habia nuk po mund t'i bjer vetës në fije, se çka në të vërtet është duke synuar. Nuk kam dot guxim që t'ia bëjë ndonjë pyetje Habisë për gjithë këto lëmshe, sepse frikohem prej ndonjë përgjigje të habitshme, e pastaj për ndonjë shkrim në vijim nga ana ime tërësisht të habitshëm. Por, më besoni, ka ardhur një kohë që pa dëshirën tonë jemi të detyruar të mendojmë rreth të kaluarës së rreme, dhe rreth oligarkëve që po i pastrojnë fëlliqësirat e së kaluarës në ditët e sotme.

Tashmë filloi puna praktike rreth realizimit të "Projektit Shkupi 2014"! Edhe pse e dënuar moralisht, pastaj përmes analizave të ndryshme, debateve nga ana e shoqërisë civile, prapë projekti në fjalë e përjetoi lopatën e parë, pa ndonjë debat serioz në kuvend nga ana e përfaqësuesve shqiptarë. **Gjersa lopata në sheshin e Shkupit funksiononte për ndërtimin e të kaluarës së "lavdishme" maqedonase, e tanishmja shqiptare pa përshëndetjen e të zgjedhurve të popullit ia lagu për në Belgjikë e gjetiu, duke u përballur pastaj me tmerret serioze të kësaj bote. Tek pasi u zbrazën qytetet dhe fshatrat, politikanët tanë e "kuptuan" se kjo është lojë e agjencive turistike, pra si gjithmonë ata u ç'fajësuan nga përgjegjësia e tyre, që as Lumi i Danubit për jetë e mot nuk do mund t'i pastron, madje as shkapërderdhja e tyre në Detin e Zi nuk do i bën fajde.**

Bile, për projektin "Shkupi 2014" qysh herët ishin ç'fajësuar prej përgjegjësisë, duke pohuar se, projekti në fjalë

është bekuar më herët prej subjektit tjetër politik. Shumë mirë që fajin të ndërgjegjshmit nuk po e lënë jetim, edhe kjo është një pjesë e lëmoshës!

Në këtë shtet ka tendenca të ndërtohen edhe fshatra të tërë improvizues, kinse edhe për kësi lloj antikitetesh paskemi nevojë, duke i anashkaluar fshatrat real që balta dhe kushtet tjera mizore janë bërë miq të ngushtë të secilit njeri që jeton në fshat.

Pastaj, gjitha humbjet e kota ekonomike të këtyre projekteve skandaloze, arsyetohen me shtimin e punës së ndërtimtarisë. Pyesim, kush do e merr tenderin për realizimin e këtyre projekteve antike. Nuk e di, por shumë mirë e di se, kompanitë shqiptare fare nuk do të kenë hise në këtë lojë të shtrembërisë historike.

Ndaj, shteti për t'i arsyetuar dhe legjitimuar këto krime ekonomike, kulturore dhe kombëtare, apo për të na detyruar që neve të mendojmë vetëm historikisht, kursin e përgjithshëm e ka orientuar dukshëm drejt të kaluarës tendencioze dhe ikjes nga e tanishme mjeruese. Si rrjedhojë e këtij kursi, tashmë do të kemi qytetarë që i përkasin, "vetëm të kaluarës", do ta sjellin Aleksandërin e vdekur në Maqedoni, por do t'i dëbojnë shqiptarët e gjallë prej Maqedonisë. Gjendemi ndërmjet fushëbetejave të "vërteta" intelektuale rreth autenticitetit të popullit maqedonas dhe projektimit për dëbimin e shqiptarëve autokton! Qeveria për hir të realizmit të kësaj ëndrre antishqiptare dhe antiislame, i ka mobilizuar dhe angazhuar shumë piktorë të kërrusur disa besa edhe të krisur, skulptorë, historianë, linguistikë, etj., vetëm e vetëm që t'i bindë fqinjët e saj për rreth, po ashtu edhe popullin shqiptarë që jeton në këtë shtet pa pushtet, se ky shtet ka një histori mjaftë të begatshme, bile më të pasur se të Egjiptit e të Selanikut. Kryeministri i Maqedonisë, edhe pse është i diplomuar në ekonomi, po ashtu edhe magjistër i kësaj shkence që kurrë si duhet nuk e përdori, aktualisht është duke e luajtur rolin e një historiani tejet të "devotshëm" dhe, në mënyrë tmerruese është i indoktrinuar pas tezave kinse të vërteta historike, e gjithë kjo me qëllim të mbulimit të dobësive ekonomike.

Askund në botë nuk e kemi parë ndonjë kryeministër, aq të aftë në profesionin e tjetërkujt. Dikur historianët do ta cilësojnë kryeministrin aktual si një njeri shumë të aftë i asaj kohë, ngase një ekonomist me anë të historisë së vjedhur, në mënyrë të shkëlqyeshme paska arritur t'i dëbojë dhe detyrojë shqiptarët të enden metropoleve të botës.

Pra, me këto politika sipërfaqësore, tendencioze, historike dhe histerike, pushteti aktual është duke ia lyer kokën me akull popullit gjaknxehtë, është duke e tërhequr vëmendjen prej dështimeve të shumta të politikave të mirëfillta ekonomike, është duke e shikuar si një film të mirë imigrimin dhe lotët e prindërve shqiptarë, por mos harro i "nderuar" pushtet se, kriza sociale tashmë ka filluar të troket, bashkë me këtë edhe sinjali i parë drejt falimentimit të kompanisë së Pasko Kuzmanit, i cili çuditërisht dhe jo rastësisht qenka pronar i këtij shteti me firmë të vjedhur!

E premte, 26 Shkurt 2010

Rrugëtimi nëpër mjegulla

-Përfundim-

Në kohën e pakohë, në kohën kur të paarsyeshmit gjykojnë kinse me arsye, në kohën kur kriminelit po i thuhet i drejtë - qeveritar e të drejtit kriminel, siç ishte rasti me sopotasit e pafajshëm, me palestinezët që në tokat e tyre u shndërruan në argatë të shtypur, me atdhetarët shqiptarë të cilët u internuan nëpër burgjet e Jugosllavisë (Serbisë) dhe të Maqedonisë (FYROM-it) dhe me ish-ushtarët e UÇK-së të arrestuar pafajësisht në Kosovën Lindore, si dhe në kohën kur shumica e njerëzve të zezës po i thonë të bardhë dhe anasjelltas, trumbetimi dhe predikimi për të vërtetën është dhe mbetet një sfidë e radhës, që shpeshherë din të lozë edhe me dinjitetin e njeriut dhe me fatet e kombeve. Nëna e të gjithë të këqijave në shoqërinë bashkëkohore është mishërimi i tyre me të keqen. Pikërisht, pastaj rruga e cila do të shpije deri tek ndriçimi i një të vërtete, do të bëhet dhe përjetohen mjaft rëndë, ku shumica e këtyre udhëtarëve mbetën në gjysmë, kurse disa u kthyen mbrapa, duke u adaptuar me gjendjen e mjerueshme shoqërore. Këtu nuk kemi të bëjmë me llojin e mjerimit që dikur na recitonte Migjeni, por me mjerim të vet dëshiruar apo të vet pranuar, duke u ndje pastaj të lumtur me servimet amorale që po u bëhen shoqërisë sonë në të gjitha aspektet e jetës. Disa që vendosën të jenë udhëtarë deri në fund të jetës së tyre të përkohshme, paraprakisht u kalitën, duke mos e vërejtur një gjë të tillë as vet ata. Kjo ishte një vazhdimësi e rrugës së mbetur prej paraardhësve të tyre. Ata që ishin pak në numër, rrugën e cila të shpije në lavdinë e përjetshme, e kishin ndërprerë për shkak të misionit të përkohshëm në këtë jetë, jo nga dëshira e tyre, por nga dëshira e të Plotfuqishmit absolut. Kurse, disa prej tyre të cilët historikisht nuk

qëndronin mirë me këtë rrugë të mbushur përplot gjemba, as që u nisën nga kjo rrugë për të kërkuar diçka të dobishme për vetën dhe për të tjerët, por ata zgjodhën një rrugë të shtruar me trëndafila dhe lule, po ashtu duke ngrënë petulla, në kohën kur shumica e njerëzve prej mëngjesin deri në mbrëmje nuk konsumonin asgjë. Nuk janë të rralla rastet kur shumica e atyre që zgjodhën rrugën e shkurtër dhe të lehtë në vetvete dhe nga vetvetja pësuan mjerimin dhe mallkimin më të madh të mundshëm të kësaj bote. Kini parasysh togfjalëshin, "të kësaj botë"! Ata menduan se mizorit e tyre do i mbulojnë me vellon e oratorisë, si dhe duke u fshehur pas kopertinave të librit me titull, "Paqe për botën".

Të parët tanë, ata të ndershmëritë nuk thoshin kotë se, "kungulli nuk shkon gjithmonë mbi ujë". Të dyshimtit dhe kontradiktorët, që e zgjodhën rrugën e cila të shpije në lavdinë e përjetshme, por duke udhëtuar në rrugë dhe rrugica të shtruara me asfalt dhe qosheve të mbushura me lule të llojllojta e me aromë të këndshme, nuk i shkojë gjatë kështu, dhe qëllimit kinse të mirë asnjëherë nuk iu ofruan, duke mbetur kështu të mallkuarit dhe të marruarit e përjetshëm. Kurse, fillimi i atyre që për këtë komb dhe fe nuk kursyen asgjë ishte i vështirë, por fundi i tyre i pafund ishte dhe mbeti gjithmonë i këndesh dhe i lezetshëm. Frutat e të munduarve, dëshmorëve dhe të internuarve ne sot po i vjelim.

Sot, Kosova është bërë shtet (edhe pse jo i plotë), Shqipëria në NATO, si dhe sensibilizimi i kauzës kombëtare shqiptare ka filluar edhe zyrtarisht të bisedohet, po ashtu prej njerëzve eminent dhe zyrtarë. Të kuptohemi, ende jemi në gjysmë të rrugës së mundimshme, ende presim dhe duhet të punojmë që frutat t'i vjelim në tërësi, por nuk duhet të harrojmë faktin se historia e njerëzve hipokrit dhe spiun po na përsëritet. Aktualisht, kemi njerëz që nuk dëshirojnë dot të ecin nëpër këtë rrugë të mundimshme dhe të vështirë, ende kemi (ashtu siç kemi pasur gjithmonë) asi lloj njerëzisht të cilët për të arritur një qëllim të pastër dhe frytdhënës dëshirojnë të ecin nëpër rrugë të shtruar me lule dhe me qilim të kuq, duke mos qenë të vetëdijshëm se rruga

në fjalë praktikisht ia hedh poshtë synimet e tyre false dhe përfituese në kurriz të popullit të shumëvuajtur.

Përskaj gjithë këtij epilogu të tmerrshëm, rruga e mundimshme dhe flijuese vazhdon të mos mbetet pa kujdestar dhe veprimtarë të devotshëm.

Në momentin kur Krijuesi vendosi që t'i kthejë prapë tek Ai, atyre iu hapën shumë dyer që i dërgonin në lavdinë, kënaqësinë dhe krenarin e përjetshme. A nuk është vallë, ky një thesar i pashtershëm dhe përplot të mira në jetën e pambarimtë? Këta njerëz i ngjanin dhe i ngjajnë diellit, ku njësoj sikur për vetën, ashtu edhe për të tjerët bëjnë dritë dhe lirojnë ngrohtësi. Kurse ata që e zgjodhën rrugën pa mjegulla dhe pa të reshura në kërkim të realitetin dhe kontributit shoqëror, i ngjanin dhe i ngjajnë llambës së ndezur në pikë të ditës, duke u krenuar dhe llomotitur tek të tjerët se po të mos ishte llamba jonë, ju fare nuk do të shihni, kurse në të vërtetë mu ata nuk janë duke e parë vetveten që i ka mbuluar perdja e injorancës dhe e hipokrizisë, apo pas një kohë të gjatë dikush i bëri që ata të mos e shohin vetën e tyre, në kohën kur të gjithë i shihnin. Fanarët ndriçues në kërkim të realitet dhe të vërtetës së përgjithshme shoqërore nuk u lanë edhe pa u sprovuar nga Krijuesi i tyre. Për ta ishte një sprovë tejet e rëndë, shpifjet që iu bëheshim prej shpifësve.

Shumë shpejtë, ata të zgjedhurit e kuptuan se kjo ishte vetëm një kalitje dhe asgjë tjetër. Ngase, qortimi i nxënësit prej mësuesit në orë të mësimit është mësim për nxënësin! Është normal të kaliten ata, ngase i priste një rrugë tejet e gjatë dhe e mundimshme, vetëm kalitja pra, ia mundësonte dhe lehtësonte të qëndrojnë në atë rrugë me gropa dhe me mjegulla. Ishte dhe është vetëm një rrugë që të dërgon në qëllimin e synuar ndershmërisht. Kurse, kishte shumë rrugë mashtruese që përmes tyre pretendohet të arrihet deri te ky qëllim. Në fakt pretendohej vetëm sa për syfaqësi! Në rrugën me gjemba, ata të devotshmit kishin mundësi të hanin fruta të veprimtarisë së tyre edhe gjatë rrugës, por gjithmonë dhe gjithherë të gjithë e synonin pemën dhe burimin e

pashtershëm. Ndërkaq, pemën dhe burimin e pashtershëm, mendoj se të gjithë e dimë, e ata që nuk e dinë i lusim që të përmirësohen, sepse nuk qenkan në rrugën e qëllimmirëve!

Pra, dhashtë Zoti, që edhe ne si pjesë e këtij globi dhe të kësaj shoqërie të bëhemi pjesë e këtyre udhëtarëve të devotshëm!

E premte, 09 Prill 2010

Shënime për autorin

Iljasa Salihu u lind më 10 prill 1984 në Llojan, të Kumanovës. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa shkollën e mesme të makinerisë në Kumanovë. Ka mbaruar me sukses studimet për ekonomi në Universitetin e Prishtinës. Menjëherë pas diplomimit regjistrohet në studimet postdiplomike në Universitetin e Evropës Juglindore në Tetovë, drejtimi Studime të Sigurisë. Përskaj punës së tij të rregullt në Ministrinë e Mbrojtjes si Administrator Financiar në Shkup, njëkohësisht merret edhe me publicistikë. Ka qenë redaktor i revistës mujore, "Zëri i Shqiptarit", me seli në Prishtinë. Është kontribuues i rregull me shkrime edhe në gazetat shqiptare në Maqedoni, në revistën "Paqja" – Prishtinë, si dhe në disa portale elektronike. Aktualisht jeton në vendlindje.
Ky është libri i tij i parë.

Literatura e shfrytëzuar

1. Napoleon Hill, “*Mendo dhe pasurohu*”, Prishtinë, 2004
2. Ragip Halili, "*Kriminologja" Prihtinë*, 2007
3. Hysen H. Terziu, “*Gjenocidi serb 1912-1956*, Prishtinë 2005
4. Rifat Blakaj, "*EKONOMI E RESURSEVE*", Prishtinë, 2005
5. Shaban Prevalla, revista "Universitas" Vjenë 2004
6. Bejtush Gashi, Pjetër Hidri, "*Konfliktet Ndërkombëtare dhe Ndëretnike*, Prishtinë, 2008
7. Xhemal RUZHDI, “*Konfliktet Botërore*” Kajro, 2002
8. Musa Limani, “*INTEGRIMET EKONOMIKE EVROPIANE*” Prishtinë, 2004
9. Zeki Bejtullahu, “*Bazat e Biznesit*” Prishtinë, 1998
10. Ilia Kristo, “*Biznesi Ndërkombëtar*”, Tiranë, 2004
11. Alfred Adler, “*Ç’kuptim mund të ketë jeta*” Prishtinë, 2004

Shtypi dhe masmediat

TV – “Alsat”, Shkup
TV – “A1”, Shkup
TV – “Klan”, Tiranë,
TV 5 Europe,
Gazeta “The Times” etj,.
Revista mujore “Vepra” Shkup
Revista mujore “Paqja”, Prishtinë
Revista mujore “Zëri i shqiptarit”, Prishtinë
Revista mujore “Kapital”, Shkup
Revista mujore “Time Out”, Kumanovë
Revista javore “Sega”, etj,.